

# **GJEOPOLITIKA**

## **Drejtor & kryeredaktor**

Dr. Sadri RAMABAJA

## **Redaksia**

Dr. Enika Abazi

Dr. Selim Ibraimi

Dr. Dritan Hoti

Dr. Gurakuq Kuçi

## **Këshilli botues**

Dr. Odise Çaçi, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

PhD Agim Krasniqi, MASHT

Dr. Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, ambasador

Dr. Venera Lljunji, Universiteti AAB, Prishtinë

Dr. Gjon Berisha, studiues, Instituti i Historisë, Prishtinë

Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, Prishtinë

Koordinator: Dr. Gurakuq Kuçi

Lektor: Jonuz FETAHU

Përpunimi grafik: Venera ALSHIQI

ISBN...

Revista “Gjeopolitika” del një herë në vit. Artikujt e paraqitur duhet të përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze, të kompjuterizuar, numri i faqeve është i pakufizuar, me shkrim Times New Roman të madhësisë 12 dhe me hapësirë 1.5 ndërmjet rreshtave.

Materialet që na dërgohen duhet të shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe/ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat duhet ta përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar i takon Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Gjeopolitika”, si vendi i parë i botimit.

**INSTITUTI SHQIPTAR PËR GJEOPOLITIKË / ALBANIAN  
INSTITUTE FOR GEOPOLITICS**

[Stema]

**Nr. 1, 2022**

## PËRMBAJTJA

Editorial..... 7

### I. ÇËSHTJA SHQIPTARE NË POLITIKËN RAJONALE

Elvis HOXHA, filozof

I.1 Gjeopolitika e ligjëritimit..... 13

Dr. Sadri RAMABAJA

1.2 Ballkani i hapur dhe gjeopolitika postmoderne serbe..... 25

Shaban MURATI, ambasador

1.3. Ballkani i hapur dhe BALLKANISTËT e kapur ..... 38

Dr. Lisen BASHKURTI

1.4. Ballkani i hapur, varianti ekonomik i ‘Botës Serbe’ ..... 44

Mehmet PRISHTINA, PHD

1.5. Ndikimi rus në Ballkan përfundon aty ku fillon orientimi euroatlantik i shqiptarëve ..... 51

Melazim KOCI, publicist

1.6 BALLKANI I HAPUR APO MASHTRIMI I MADH ..... 59

Bojken ABAZI, politolog

1.7 Dy republikat shqiptare jashtë “Zonës së Novi-Sadit” dhe një padi për drejtësi..... 65

Dr. Selim IBRAIMI

1.8 HIJA E SKEMËS SERBE NË “BALLKANIN E HAPUR” ..... 70

Shqipërim PULA, PhD

1.9 Ballkani i hapur, nismë e dështuar që në start?! ..... 73

### II. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE - KURTHI I GJEOPOLITIKËS SERBE

Prof. Dr. Mazllum BARALIU

2.1 ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË DRITËN E SË DREJTËS KUSHTETUESE ..... 76

Dr. Gurakuq KUÇI	
2.2 Doktrinat Pacta Sunt servanda dhe Rebus Sic Stantibus si balanca ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.....	122

### **III. GJEOPOLITIKA RAJONALE**

Emin AZEMI, publicist	
3.1 MAQEDONI - BULLGARI, NJË TUNEL I MBYLLUR QË KA MUNDUR TË JETË AUTOSTRADË E HAPUR! .....	139

Dr. Albulenë HALILI	
3.2 TABLO E SHKURTËR MBI MAQEDONINË E VERIUT.....	145

Dr. Dritan HOTI, Tiranë	
3.3 Skenarët dhe rrjedhojat e një krize të re në Bosnjë.....	148

### **IV BOTA**

Agim KRASNIQI	
4.1 Ukraina - vendi që vendos fatin e Rendit të Ri Botëror! .....	151

Xhafer SHATRI, publicist	
4.2 UKRAINA, MAKTHI I EVROPËS E TMERRI I RUSISË .....	156

Shaqir VUKAJ*	
4.3 Putini dhe shqiptarët .....	161

Enis REÇICA	
4.4 LUFTA DHE DOBITË E SAJ .....	170

### **V GJEOEKONOMI**

Ali MEHMETI	
5.1 SFIDAT ENERGJETIKE TË QEVERISË SË KOSOVËS .....	178

### **VI. HISTORI**

Dr. Ramiz ABDYLI	
6.1 Përballja e Serbisë me tapitë e Sanxhakut të Nishit.....	183

Dr. Odise ÇAÇI	
6.2 Prapavija strategjike e denigrimit të historisë kombëtare .....	191

Prend Buzhala	
6.3 Në kohët Dradane e Arbërore të Kosovës së sotme dokumentohet gjithmonë shumica katolike .....	198

## **VII. OPINIONE**

Arbër ZAIMI	
7.1 RRUGËT E BOTËS DHE ATO TË SHQIPTARËVE .....	201
Dr. Selim IBRAIMI	
7.2 Rikthimi i thellësisë strategjike.....	209

## **VIII. ANALYSIS IN ENGLISH / ANALIZA NË GJUHËN ANGLEZE**

Dr. Sadri RAMABAJA	
8.1 Serbian strategy to return to Kosova.....	214
PETER MARKO TASE	
8.2 The Baku Process: a Prosperous International Forum of Azerbaijan ..	224



## Editorial

### *Rikthimi te gjeopolitika dhe Agora autentike*

Të nderuar lexues të revistës Gjeopolitika!

Ajo që na shtyu të startojmë me revistën dhe portalin Gjeopolitika ishte, para së gjithash, realizimi i nivelit shqetësues të vetëdijes dhe pjekurisë politike ndër ne. Trashëgimia jonë në lëmin e ushtrimit të ndërgjegjshëm të diplomacisë në dobi të interesit jetik kombëtar, veçanërisht kur bëhet fjalë në raportet me fuqitë rajonale e botërore, lë shumë për të dëshiruar. Por, assesi nuk mund të thuhet se nuk ka edhe qasje pozitive, madje që në start të diplomacisë sonë për krijimin e shtetit modern shqiptar - Lidhja e Prizrenit.

Këto marrëdhënie në lëmin teorik e analitik duhet të pasqyrohen me objektivitet, ndërkaq ekspertiza në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe kushtëzimin historik që imponojnë ato për shtetet e vogla, reflektimi i tyre mbi zhvillimin aktual të proceseve të përgjithshme shoqërore, politike dhe ekonomike në një botë të ndërvarur, do të jetë objekt i trajtimeve që do të publikohen në këtë revistë.

I kisha studiuar rrethanat që e detyruan Profesor Ukshin Hotin të startonte me Demokracinë e tij autentike dhe arsyet që e bënë të shndërrohet në peng të Republikës. e me këtë edhe të shuhet pa gjurmë, duke lënë DeA-në në gjysmë të rrugës. Më kishte bërë shumë përshtypje një ese e veçantë e Arbër Xhaferit, me një titull shumë domethënës: “Piramida e vetëmashtrimit”, ku potencohen arsyet reale të defaktorizimit tonë gjatë dekadës së fundit të shekullit XX-të, që si akt ishte shoqëruar me vrasjen e mendimit politik tok me Agorën tonë tradicionale.

Epoka e demokracisë deliberalë po vjen.

Ashtu si Alexis de Toqueville, “në perëndim të rendit feudal të Evropës”, që ishte mahnitur me demokracinë e kaubojve të Amerikës, ne do të fascinohe mi duke e njohur vetveten dhe Agorën shqiptare, frymën e unitetit e të mendimit që prodhoi ajo.

Ashtu si demokracia e tipit amerikan, edhe demokracia autentike shqiptare, në epokën kur Shteti po i rikthehet fuqishëm gjeopolitikës, ka nevojë për mendim politik të përpunuar, e në përputhje me interesat jetike të vendit dhe të partnerëve strategjikë.

Mungesa e theksuar e parimeve profesionale, e mendimit shkencor politik dhe e gazetarisë analitike në hapësirën shqiptare të këtij lloji, me theks në këtë periudhë tranzicioni të tejzgjatur, ishte e mbetet stimul shtesë dhe nevojë urgjente për një ndërmarrje të kësaj natyre.

Ne do të përkustohemi në përmbushjen e këtyre nevojave, duke i dhënë përparësi informacionit cilësor dhe mendimit politik nga sfera e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës së jashtme, të cilat ndikojnë aq shumë në jetën tonë të përditshme.

Proceset aktuale të trazuarra gjeopolitike dhe gjeoekonomike, si dhe pozicionet e reja gjeostrategjike të ndjekura nga konflikte ushtarake latente dhe klasike në rritje me intensitet nga më të lartit tek ata më të ulët e formojnë para syve tanë një pamje të re globale të botës që e kërcënon zhdukjen e kombeve të vogla edhe nga skena politike botërore.

Shkalla e injorancës politike, e ngarkuar me primitivizmin ideologjik me ngarkesa neotomane etj., ka penguar dukshëm qytetarinë shqiptare për t'i mbështetur ato forca politike drejtuese që janë në gjendje ta mbajnë barrën e përgjegjësisë historike dhe t'i drejtojnë dy republikat tona, në këtë kohë kritike, në përputhje me interesat jetike të Kombit.

Në ndeshtrashat e historisë gjithmonë është jetike të gjenden e të sillen në krye të Shtetit e të Kombit njerëz të guximshëm dhe të mençur. Dështimi i zbulimit të tyre, si rregull, kishte dhe ka pasoja katastrofale dhe shkatërruese për kombet e vogla, të cilat shpesh rezultuan në zhdukjen e plotë fizike të tyre nga faja e dheut, siç dëshmohet me shembuj konkretë nga kohët e lashta biblike deri në kohët moderne të qytetërimit njerëzor.

Revista dhe portali Gjeopolitika, në analizat për e rreth botës shqiptare, por edhe në ato që kanë të bëjnë me vatrat e krizës globale dhe rajonale dhe gjykimet për tendencat e tyre në të ardhmen, udhëhiqet ekskluzivisht nga qasja profesionale dhe shkencore, duke e shmangur tendencën mbizotëruese folklorike e propagandistike brenda këtij profesioni kompleks, i cili më pas degradon dhe zhvlerëson, redukton në një nivel të lëndës me të cilën mund të merret kushdo.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm se një qasje e tillë, në të cilën emocionet dhe pasionet ua lënë vendin fakteve, mund të shkaktojë reagime negative nga ata që nuk e kuptojnë mjaftueshëm gjeopolitikën dhe analitikën, ose thjesht shqetësohen nga qëndrime që nuk mbështetin botëkuptimin e tyre, respektivisht që bien ndesh me interesat e ngushta të tyre.



Megjithatë, ne jemi të bindur se me paanshmërinë dhe profesionalizmin tonë mund të sigurojmë besimin e lexuesve tanë dhe ta zgjerojmë rrethin e tyre shumë përtej kufijve të dy republikave tona. Sepse vetëm E Vërteta të çon drejt përbushjes së plotë të gjakimit për liri e për shtet sovran.

Në këtë numër, në pjesën e parë, kemi përfshirë një cikël kumtesash nga dy konferencat shkencore që kishim për dy tema bosht: **“Ballkani i hapur - dhe gjeopolitika postmoderne serbe”** dhe **“Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe - Kurthi i gjeopolitikës serbe”**, duke mëtuar të hapim siparin e përfshirjes të sa më shumë studiuesve të fushës së mendimit politik shqiptar.

Redaksia e revistës dhe portalit Gjeopolitika ju uron lexim kritik e të këndshëm, respektivisht komunikim në rrafshin intelektual me analistët tanë të shkëlqyeshëm, duke shpresuar se kështu do të mund të kontribuojmë në përbushjen e objektivave që i kemi parashtruar vetes si Institut.

Me respekt,  
Dr. Sadri RAMABAJA



# I. ÇËSHTJA SHQIPTARE NË POLITIKËN RAJONALE

## Republika e Kosovës është vetë kompromisi

Në qendër të vëmendjes së konferencës së sotme është pozita e shqiptarëve në Evropën Juglindore dhe projekti “Ballkani i hapur”, në këtë linjë edhe pozicioni ynë gjeostragjik si Komb.

Në këtë konferencë nëpërmjet kumtesave që do të prezantohen dhe më pas do të botohen në numrin e parë të revistës “Tribuna shqiptare, 1”, pres të sqarohet ky pozicion, të nxirren konkluzione të arta për politikën shqiptare, por edhe të shpërfaqet pozicioni i Serbisë, duke i dhënë përgjigje pyetjes se kujt i përket Serbia aktualisht: Evropës apo Azisë, respektivisht Perëndimit, apo Lindjes? Në rrafshin gjeopolitik, atë gjeoekonomik etj., është e qartë, rajoni është pozicionuar në krahun Perëndimor, ndërkaq Serbia, sikur gjatë gjithë historisë, duke koketuar me Lindjen, respektivisht me Rusinë, përveç që u bë shkas për fillimin e Luftës së Parë Botërore, ishte shkaktare e gjenocidit në Kosovë dhe në Bosnjë në fund të shekullit XX.

Ndërkohë Evropa Juglindore përballet ende me hijet e së kaluarës. Ende ka një konflikt të hapur në mes të gjeografisë dhe historisë, do të thoshte miku im Dr. Skender Hasani. Në këtë konflikt, roli i viktimës sërisht tentohet të shpërndahet, duke e barazuar kështu agresorin me viktimën. Ndërkaq procesi i integritetit në BE tentohet të zëvendësohet me struktura të paqarta, që mund ta sjellin në pikëpyetje integritetin e rajonit si tërësi brenda arkitekturës së sigurisë euroatlantike.

Shpërbërja e Jugosllavisë, ngjashëm si edhe rënia e komunizmit si ideologji në Evropën Lindore e atë Qendrore, solli në skenën politike të Kontinentit të Vjetër një varg shtetesh të reja. Ky proces vazhdoi edhe me shkërmoqjen e përgjakshme të Jugosllavisë, prej nga do të dalin 7 entitete politike, që do t'i bashkohen hartës së re politike të Evropës.

Në këtë proces, Kosova do ta bëjë kompromisin historik që kërkuan aleatët tanë, duke e shtyrë për kohë më të mira vullnetin politik për bashkim me Shtetin amë, dhe duke u pajtuar me krijimin e Shtetit të dytë shqiptar në rajon, si një zgjidhje e qëndrueshme e kundërthënies në rajon, që për bazë ka interesat dhe baraspeshën gjeopolitike.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 prandaj hyn në historinë moderne të shqiptarëve si fitorja e dytë më e madhe e Kombit tonë, pas asaj të shpalljes së pavarësisë më 1912, në Vlorë. Ky akt, de facto, nënkupton korrektimin e pjesshëm të gjëmës historike që pësoi Kombi atëbotë nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), ku Shqipëria që shndërruar në torzo.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe sidomos pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, rajoni ynë gradualisht po i kthehet hemisferës së cilës i përket - Perëndimit, me ç'rast po krijohen parakushtet reale për faktorizimin e Kombit tonë.

Të nderuar kolegë,

Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë me seli në Prishtinë është krijuar më 10 qershor 2021. Është themeluar nga një grup intelektualësh dhe ka qëllim të tij të zhvillojë veprimtari kërkimore-shkencore në fushën e studimeve gjeopolitike dhe historike, të integriteteve evropiane dhe euroatlantike, përfshirë këtu kërkimet shkencore e zhvillimore, si dhe publikimin e rezultateve të tyre.

ISHGJ përmes hulumtimeve kërkimore ndërdisiplinore, konferencave shkencore si kjo që po mbajmë sot, publikimeve të veçanta etj., do t'i shërbejë formimit tonë kolektiv politik, ndërgjegjësimit të forcave politike e qytetarisë aktive lidhur me të qenët Një të Kombit, pozicionimit në rrafshin gjeopolitik dhe prosperimin jo vetëm të dy republikave tona, por edhe të kombit si tërësi. Struktura drejtuese dhe Këshilli Shkencor i ISHGJ përbëhet nga një grup i ekspertëve të fushave të ndryshme të mendimit politik, kryesisht studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare, filozof e historian, por edhe publicistë të njohur nga Shqipëria politike, Kosova, Maqedonia Veriore, Sllovenia, Zvicra, Gjermania, Austria, SHBA,...

Evropa Juglindore ka nevojë për paqe dhe prosperim, duke lënë prapa frymën e konfliktualitetit dhe garës për dominim.

Paqja dhe prosperimi ekonomik është objektiv i të gjitha forcave progresive të rajonit, rrjedhimisht edhe i shqiptarëve.

Duke ndjekur hap pas hapi proceset në rrafshin e mendimit gjeopolitik dhe rirreshtimeve gjeostrategjike në plan global, ISHGJ përmes kësaj konference shkencore synon të nxjerrë përfundime që besojmë se do t'u shërbejnë dy qeverive tona dhe politikës, në përgjithësi.

Kjo qasje e re e Institutit është edhe në shërbim të tejkalimit të kontradiktave ndërmjet faktorit shqiptar dhe ndërtimit të unitetit politik në rrafshin e politikave me karakter gjeopolitik, gjithmonë në përputhje me interesat tona nacionale.

Uroj që konferenca e sotme të sjellë këtë frymë të re, qasje konstruktive, ndërkaq pjesëmarrësve u dëshiroj sukses në prezantimin dhe elaborimin e tezave e ideve të tyre. [S.R]

*(Fjalë rasti në hapjen e Konferencës shkencore: “Evropa Juglindore dhe gjeopolitika sot - ‘Open Ballkan’ dhe çështja shqiptare”, e mbajtur në Prishtinë, më 5. 11. 2021)*

## I.1 Gjeopolitika e ligjërimit



### **Elvis HOXHA, filozof**

Nuk besoj se ky shkrim synon përkufizimin e gjeopolitikës, por më shumë të nxjerrë në pah pamundësimin e politikës prej mostrajtitimit të kualifikuar të gjeopolitikës. Së dyti, ky shkrim do të përpiqet të dëshmojë se kjo e fundit nuk është as dije aq hollësisht e kufizuar në profesionin e marrëdhënieve ndërkombëtare, pra, nuk mund të përjashtojë burimet e larmishme materiale dhe kulturore nga të qenit objekt në formimin e marrëdhënieve gjeopolitike. Sa për shembull po jap këmbënguljen e Beogradit për me i ndalu Kosovës anëtarësimin në UNESCO. Për Beogradin nuk është vetëm problemi që ai ka me njohjen e Kosovës, por po aq pengimi i lindjes së linjave të reja gjeopolitike, sidomos në rrafshin e kulturës dhe historisë. Do të përpiqem të tregoj më së shumti se ndërhyrja në ligjërimitin e gjeopolitikës është edhe përpunim më i vërtetë i kuptimit të saj: të shquarit korrekt të sovranitetit tonë, i marrë ky në statusin e ndryshores në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përveç interesave ekonomike dhe tregtare, një tjetër ind më i thellë punon shoqëritë perëndimore dhe ato lindore. Është rrafshi i performativitetit në indin e tekstit. Shumë shpejt, me pompozitet, përcaktohet terminologjia dhe shijet që mëtojnë se janë të vlefshme për ndonjë të ardhme të mundshme. Ky ind, edhe pse gjithnjë e më shumë në shpërbërje, është ende aty. Ndoshta pritet ndonjëfarë rigjenerimi prej qosheve të painteguara. Ndoshta, nga këto qoshe do të vijë ndonjë puls demokratik dhe mirëfilli politik, ashtu siç po vijnë aktualisht vetëm qëndrime konservatore, reaksionare deri dhe fashiste nga vende të vendosura në Bashkimin evropian, por aspak të integruara. Deri tani

indi ligjërues i integritetit nuk ka qenë veçse një frazë që mbulonte po ata kalkulime gjeopolitike dhe tregtarë që ekzistonin edhe para se Evropa të bashkohej rreth së ardhmes së saj. Përkundrazi, kërkohet të kuptohet se vëzhgimi gjeopolitik dhe ligjërimi mbi gjeopolitikën janë të njëkohshëm.

Më urgjente për ne si shqiptarë është ndërhyrja sadopak në indin e shoqërive perëndimore. Shoqëritë perëndimore janë vendi i lirisë së fjalës pakrahasueshëm me ato lindore. Po për këtë arsye, dhe jo vetëm, këto shoqëri janë kthyer në arenën e ndeshjes së përhershme mes inflacionit të fjalës dhe shpejtësisë së domosdoshme të vendimmarrjes. Aty fabrikohen ligjërimet që shpërndahen nëpër brendësinë e perëndimit, por që, njëkohësisht dhe paradoksalisht, u shërbejnë edhe ligjëtimeve lindore si arsyetim dhe legjitimim. Po aty prodhohet edhe rikthimi i ligjëritimit, me një simetri të kundërt: ajo fjalë ideologjike apo edhe strategjike që shpallet zyrtare në lindje e ka më së shpeshti mundësinë të jetë pjesë e spektaklit të ekstremeve në perëndim.

Aktualisht, ne shqiptarët nuk jemi ndikues në ligjërimin perëndimor – me përjashtim ndoshta të disa muajve tani së fundmi. Mund të zgjedhim sa të duam shembuj të mungesës sonë në gamën e çështjeve të shteteve perëndimore. Një listë e tillë shembujsh nuk do të kishte ndonjë vlerë në një shkrim të tillë. Por, vetëm për të bërë të qartë se për çfarë po flasim, le të përmendim rastin e së djathtës ekstreme franceze, shembull ndoshta i mjaftueshëm.

Kjo e djathtë është në rritje prej të paktën një dekade, e angazhuar dhe dukshëm me rezultat në një ligjërim krejt çoroditës të perceptimit publik francez. Në thelb të ligjëritimit të së djathtës, e cila sot përfaqësohet nga tri grupime – ku mund të përfshihen ndoshta edhe sjellje të lëvizjes së presidentit aktual të Francës – qëndron më së shumti leximi tepër i përçudnuar i historisë. Por kur lexohet historia në mënyrë të shtrembër, detyrimisht dihet që ka nisur të sundojë gjeografia. Kështu që figura më emergjente në të djathtën franceze, edhe pse ajo do të jetë humbëse, është sot e një njeriu që përdor gjithçka për të ndikuar ndjenjat e publikut, sidomos atij publiku që nuk zotëron asnjë instancë kontrolli mbi frazat e hedhura prej demagogëve. Në gojën e kandidatit Zemmour, për ndërtimin e paradigmës së urrejtjes, do të mund të ndeshet pa asnjë etikë edhe shembulli i Kosovës. Por nuk ka rëndësi fakti që Zemmour nuk zgjidhet president. Ekzistenca e tij si kandidat përgjatë gjithë fushatës relativizon bollshëm boshin dhe cinizmin me të cilët vritet demokracia në ligjërimin e kandidatëve të tjerë.

Duhet të kuptojmë se të djathtat populliste nuk kanë asnjë mundësi eksperimentimi. Ato janë grumbullime të stereotipave të ardhur nga çdo e shkuar dhe garantohen nga ideja që shoqëria e mbyllur është ajo ç'duhet premtuar për të ardhmen. Me t'u bërë i ndërgjegjshëm për ekzistencën e Kosovës, një francez i djathtë ekstrem mendon se ka ndeshur në një shtet-

eksperiment krejt të pavlerë. Për fat të keq, në Francën e sotme është e vështirë të lokalizosh si të mundshme ndonjë të djathtë jo ekstreme. Të gjithë kandidatët e saj përpiqen të tregojnë se duan ta garantojnë Francën, ndaj dhe po të gjithë synojnë të përvetësojnë një publik që po e shtyjnë vetë drejt skajit. Për pasojë, aktualisht, ne nuk mund të themi se sot ekziston ndonjë Francë e guximshme. Përkundrazi, sot ndeshim një Francë që po përpiqet të shesë vetëm diçka që e shesin shumë të tjerë.

Në një Francë që do të duhej të prodhonte e shiste në tregun e ideve dhe stilit, përdorimi i Kosovës do të ishte një eksperimentim me probabilitet të mundshëm suksesi. U deshën dy dekada që çdo përdorim i Kosovës në gjuhën më të zëshme të Francës të kthehet më shumë në shpallje të padijes së shoqërisë së saj rreth Kosovës, se në dije të Francës për fuqinë e saj. Por, kjo periudhë dy dekadash është edhe koha gjatë së cilës qeveritë, kuvendet, terreni akademik i Kosovës u tkurr. Kur tkurret ligjërimi demokratik, kthehen edhe një herë popullizmat e frikës. Një gjeopolitikë më e hershme e ligjërimeve do të na kish kthjelluar shumë më herët një direktivë në sjelljen gjeopolitike: nëse ligjërimi ynë tkurret, ka mundësi të tkurret edhe ligjërimi më i fuqishëm i kontinentit. Shtetet e vegjël janë një lloj vetëkontrolli intelektual i shoqërive të mëdha.

Ne morëm vetëm shembullin e Francës, por Evropa përfaqësuese, e drejtuar përballë nesh prej burokratësh të ardhur nga vende që nuk e njohin Kosovën, është rezultat i heshtjes sonë të shumëfishtë në publikun perëndimor. Këtu nis e zë fill nevoja jonë për institute dhe organizime të tjerë shkencorë e kulturorë. Institutet kanë dy detyra: së pari, atë të formulimit të politikës, dhe, së dyti, promovimin e ekzistencës sonë si mendim. Gjeopolitika e ndërmarrë në formë instituti shpreh një aktivizëm të mprehtë në ndërhyrjen politike.

Çdo komb, me historinë e vet, i jep gjeopolitikës një përmbajtje dhe ca dimensione specifike. Nga ana tjetër, sido që të jetë, gjermane, britanike, franceze apo amerikane, gjeopolitika nuk mund të ndajë pastër të brendshmen dhe të jashtmen. Ajo përcaktohet nga historia, sepse gjeografia e politikës, nuk është veçse gjeografia e mbuluar jo vetëm nga pasuritë aktuale, por më së shumti nga historia njerëzore. Duhet të përcaktohet që këtej se në ç'mënyra dhe sa i kushtëzuar është veprimi ynë gjeopolitik nga historia jonë.

Gjeopolitika u kthye në tabu, pikërisht sepse përmbante në vetvete vetëm përkufizimin prej cinizmi të raportit të forcave për territor prodhimi dhe ndikim tregu. Duke mos përparuar kulturalisht njësoj së brendshmi, shtetet e fuqishëm e transferuan problemin e tyre së jashtmi. Kështu që gjeopolitika ka marrë tashmë formën dinake të pushtetit soft. Ajo është një makro-konsumerizëm. Për t'u ngritur nga empiria bruto e marrëdhënieve të psikologji-subjektiviteti i identitetit lypsen institute dhe grupe studimi. Në një botë që nuk ia mbërriti të jetë vend i diferencave, do të duhet të ekzistojë të paktën një ekulibër i identiteteve. Përndryshe stabiliteti botëror nuk do të

rrënohet pa marrë edhe planetin me vete. Dhe ky stabilitet nis e rrënohet më së pari nga prodhimi i hallkave të dobëta. Të prirë për me qenë hallka të dobëta janë ata vendet që shndërrohen progresivisht në të vegjël ideologjikë, kulturorë, energjikë, ekonomikë, diplomatikë dhe gjeopolitikë. Por ajo çka më së pari, në këto hallka të dobëta, bëhet pré e domosdoshme rrënimi është vetë drejtësia.

Ky rrënim endogjen i drejtësisë e ka burimin në fakt gjetkë. Diku tjetër shumësi i ideologjive të politikës i është nënshtruar ideologjisë unike të tregut ku përthithet tashmë gjithçka, që nga vetë ideologjia, deri te energjitë artistike. Diku tjetër, në shtetet e mëdhenj, në fuqitë e mëdha, ka nisur prej kohësh të rrënohet vullneti për drejtësi nga lodhja formale-juridike e demokracisë.

Gjeopolitika ka nisur të marrë karakterin e studimit cinik: studimit të shndërrimit të drejtpërdrejtë të energjisë në treg pa kaluar më në ata ndërmjetësime e shtresëzime që e përcaktojnë shoqërinë si shumëfish. Me këtë lloj gjeopolitike, prodhuesi i mallit të kotë dhe tepër zëvendësues mund të bëhet shumë më i fuqishëm se prodhuesi i mallit cilësor.

Gjeopolitika<sup>1</sup> po kthehet me një shpejtësi marramendëse në *art të shfrytëzimit të kundërthënies* për cilindo shtet që kërkon të shndërrohet në fuqi planetare. Mjaft të shohim Kinën dhe Francën. Shohim nga njëra anë se si Kina realizon një kundërthënie të tillë si ves në tërë *strukturën* e saj. Fuqia e kundërthënies mund të mbërrijë kulmin e vet me prodhimin më të skajshëm neoliberal, por nën flamurin e ideologjisë së skajit tjetër komunist. Në vendin e miliardërëve burgjet janë makina prodhimi shumë të fuqishme.

Ndërsa Franca, përmes të thënave dhe të bërave makro të presidentit të saj, përdor *strategji* kundërthënese. Presidenti nis e skicon një potpuri ceremonish dhe nderimesh për rehabilitimin e Francës së historisë koloniale prej tërë fajeve të para një shekulli mbi popullsitë e Afrikës. Por po aty, po ky president takon me një dashuri të shpallur publikisht emirin porositës të vrasjes makabre të gazetarit në ditët tona - natyrisht për hir të blerjes së një sasie produktesh që shkojnë në ca dhjetëshe miliardash, produkte aspak të zakonshme, sak avionë luftime. Kjo kundërthënie e dytë konsiston në prodhimin e mundësisë së gjëmave të ardhme.

Rentabiliteti i kësaj kundërthënieje është i dyfishtë: sot ajo mund t'i garantojë biznesin kompanive të fuqishme franceze, por nesër mund t'i sigurojë një depozitë për kredi morale ndonjë presidenti të ardhshëm tek do të kritikojë vendimet e Francës së ditëve të Macronit. Shtetet ndëshkohen rrallë me vdekje dhe nuk janë vdekatarë si njerëzit. Por efektet e veseve të shteteve zhduken

---

1 Kërkoj falje për paragrafë të herëpashershëm që mund të ngjajnë si dalje jashtë temës. Besoj se këto “dalje jashtë temës” janë rikthime të studiuesit të gjeopolitikës në indin e brendshëm politik të shoqërive.



bashkë me përfaqësuesit vdekatarë të tyre. Sidomos kur vdes brenda tyre fryma e rezistencës intelektuale. Në këtë vdekje të shumëfishtë e gjen territorin pjellor të vet cinizmi i sotëm neoliberal. Në politikën që mbështet këtë lloj gjeopolitike, kundërthënia është produktive për interesa dhe grupe që në kuptimin demokratik janë kundërproduktivë. Këtë donim të kuptonim kur thamë se cinizmi i gjeopolitikës është në përpjesëtim të drejtë me leximin e keq dhe të vonuar të historisë.

Këtu nis e zë fill pika jonë. Nga sa më sipër, ne mund të themi shumë shkurt se gjeopolitika ku ne nuk bëjmë pjesë duhet parë si degjenerimi i politikës në përcaktimin e linjave materiale të interesave, deri tek ato të tregut. Ky përfundim është i vërtetë nga këndvështrimi i atyre shteteve që në një çast të dhënë të rrjedhës historike e kanë parë veten si kushtëzues të kësaj rrjedhe. Deviza e këtij gjykimi është e dukshme: interesi është sinonim i jostabilitetit, por kur je vetë prodhues i këtij jostabiliteti. Ndërsa vendet e vegjël, për shkak të pjesëmarrjes së tyre të ulët global, ofrojnë një mundësi të kuptimit të ri të së drejtës, demokracisë dhe politikës.

Pikërisht nisur prej cinizmit të përgjithësuar gjeopolitik, tregtar e financiar, ne na intereson realisht kjo pikë. Sepse, në bazë të përkthimit të gjeopolitikës në kundërthënie të politikës, qëndron një vendim psikologjik dhe jo një kontabilitet i qartë i rrethanave dhe mundësive, i shkaqeve dhe kushteve që prodhojnë një ngjarje dhe një sjellje. Ne na duhet ta rikthejmë gjeopolitikën edhe një herë e me sa mundim, falë studimit të botës e vetvetes, në politikë të aftësive njerëzore, institucionale, shoqërore dhe kulturore.

Ne mund ta pajisim gjeopolitikën me një veti të re falë pjesëmarrjes sonë në të: si rigjenerimi i brendshëm i cilitdo shtet që e merr atë seriozisht. Gjë që do të thotë mirëfilli se gjeopolitika duhet të mbetet politikë, edhe pse e lidhur me tokën e detet, nga fakti i thjeshtë sepse shtohen pjesëmarrësit me të drejta të plota në skenën e saj.

Po i rikthehem edhe një herë *pikës së gjeopolitikës si kundërthënie në gji të politikës*.

- Ne e thamë se rezulton të jetë e tillë prej faktit se ajo e zëvendëson përgjithësisht politikën me veprimtari ekstra-politike, madje dhe me interesa të ulët në prodhimin e hallkave të dobëta. Vetë këto hallka krijohen më së shumti dhe më lehtë aty ku sovraniteti është i ulët apo dhe ku vëmendja ndërkombëtare është e ulët për shkak të një raporti të paqartë mes mendësive dhe forcave. Po flasim pra për një kundërthënie tepër sterile në kuptimin politik dhe tepër cinike në kuptimin gjeopolitik.

- Perëndimi dhe Lindja na kanë deklaruar diçka prej stabiliteti që gjendet në jostabilitet. Perëndimi na ka thënë se vendet e dobëta ofrojnë diçka prej stabiliteti sipas këndvështrimit demokratik. Lindja na ka thënë se ka mjaftueshëm stabilitet në vendet me sovranitet të dobët. Mendjelehtësi e të

parëve, dhe dinakëri e të dytëve<sup>2</sup>. Një formë e shprehur aktualisht si hallkë tepër e dobët është Bosnjë-Hercegovina. Kandidatë për të qenë hallka të dobëta janë të gjithë vendet që përfshihen në Ballkanin Perëndimor. Pranë Ruisë kemi disa të tjerë, Ukraina më së fundi, përgjithësisht shtete të dalë prej bashkësisë ideologjike të kampit socialist. Për shkak të mendjelehtësisë konsensuale dhe shndërrimit të shpejtë të shoqërive perëndimore në shoqëri civile dhe hedoniste, ne u kthym në pikën e nisjes. Serbia në Ballkan dhe Rusia në Euro-Azi kanë të njëjtat shtysa territoriale, jo më nën petkun e komunizmit, por neoliberalimit ose globalizmit. Ky është thjesht një shembull i asaj çka thoshim më sipër: ligjërimet perëndimore i kanë shërbyer si instrument legjitimues fuqive lindore.

- Në Perëndim fabrikohen qëndrime raciste në periferitë e përfaqësimit politik, ndërsa në ato të Lindjes, ky racizëm e kjo ksenofobi janë e vetmja lëndë e veprimit politik për vetë institucionet përfaqësues. Rasti i Francës: të dy krahët që kanë pasur lidhje historike, në dy mënyra krejt të ndryshme me Lindjen, janë tashmë ato që fabrikojnë më së shumti gënjeshtat mbi të cilat mbahet e mirëqenë politika e tyre nacionale dhe/ose ideologjike. Po i cilësoj si nacionale dhe ideologjike. Gjeopolitika e nyjave është arma jonë për t'iu kundërvënë gjeopolitikës së analogjisë - Zemmour – dhe gjeopolitikës së nostalgjisë – së çdo komunisti francez alla-Melenchon. Por janë po këto që thurin prirje të bashkëpunimit të mundshëm mes blloqeve, sot mes një sjelljeje anti-amerikane dhe pro-ruse. Janë këto sjellje që e vendosin gjeopolitikën si atë të kundërthënies, që përdorin një binaritet të frikshëm sipas të cilit Rusia është një e keqe e përkohshme, ndërsa Amerika një e keqe e përhershme. Është krejt gjeopolitikë ligjërimesh.

- Sa për indin shoqëror, gjeopolitika ka rezervuar një individ të ri, i cili më së paku mendon se planeti është vendi i tij i përhershëm. Një ndjenjë e qëndrimit të përkohshëm në Tokë i ka zënë vendin tezave romantike të visit. Gjeopolitika e sotme është në thelb anti-romantike, madje edhe krejt anti-metafizike. Ajo mund të kalojë lehtësisht nga efikasiteti i ndërmarrjes në mistikën e shëlbimit, brenda individit, por kurrsesi nuk lejon të ketë kohë vonese dhe qëndrese brenda këtij individit. Më në fund njerëzimi ka arritur atë stad të vetënjohjes që u projektua nga shkencat njerëzore dhe inxhinieria e saj për njohjen neutrale dhe objektive.

---

2 Kur shprehemi për Lindje dhe Perëndim, ne kemi parasysh ndarjen efektive e cila sot ngulmon që prej mbetjeve të Murit dhe që po rigjallërohet me një shpejtësi aq të lartë sa ishte edhe bindja se ndarja e planetit në kampe ishte fenomen i një të shkuare të pakthyeshme. Ardhja në skenë e Afrikës dhe Indisë nuk është ndonjë risi, por vetëm përthellim i ndarjes në taborë më të mëdhenj e më vështirë të llogaritshëm në planin e drejtësisë. Pas shembjes së Murit, bota është bërë më e vogël dhe qytetarët e saj e vuajnë më shumë klaustrofobinë.

Tani mund të shprehemi pikërisht për *pikën tonë të kthesës*, kundër *pikës së kundërthënies*.

Diplomacia jonë duhet të ishte aktive prej kohësh dhe nuk duhet të bëhej as prë e as prodhuese e idesë së rreme të stabilitetit. Duhet të kishim vendosur prej kohësh në prirjen tonë edukimin me përbërës jashtë-brenda lëndën e gjeografisë, dhe komunikimin me përbërës brenda-jashtë lëndën e historisë. Çdo orientim në të kundërt, në 20 vitet e Kosovës së lirë, ka qenë mangësi e pranisë historike të Kosovës në Evropë dhe tepri gjeografike e saj në rajon. Jo më kot kufijtë dhe territori i saj janë të cenueshëm. Së jashtmi mashtrojnë mbi Kosovën me argumente të llojit historik, ndërsa së brendshmi regjimet tanë e varfërojnë vetë elementin tonë të edukimit gjeografik.

Gjeopolitika e brendshme është edukimi i kufijve, i territoreve ku ka një raport forcash për sundim. Për shembull, ne mund të nisim me studimin gjeopolitik të Mitrovicës së Veriut. Shpalosja e të tillave nyjeve mund të na shërbejë edhe për studimin e strategjive të sjelljes politike institucionale, por edhe për nxitjen e idesë së publikut mbi gravitetin e çështjeve publike dhe shtetërore. Përkundrazi, jemi të tërë dëshmitarë të ndikimit të gjerë të relativizmit deri në programet e studimeve të lartë në shkencat shoqërore.

Nëndheshëm, në lidhje me pjesëmarrjen tonë në gjeopolitikë si subjekt që e mendon, e analizon dhe e projekton – brenda mundësive të një kombi në rajon dhe jo të shteteve shqiptarë të veçuar - na duhet të integrojmë edhe një direktivë që na vjen prej kohëve tona të paqëndrueshme. Kjo nis nga të diturit se ç' do të thotë sot të merresh me studimin dhe analizën e gjendjes gjeopolitike të rajonit e botës. Në mënyrë më të thellë do të thotë të dekonstruktosh mendësinë që na ka mbajtur në kushtin ku jemi. Dhe kjo mendësi ka një përbërje tepër të cungët, ndaj dhe bëhet aq e vështirë ta zhbësh atë. Brenda mendësisë sonë janë tri përtaci në përfytyrim, të luajtura në tri kohë: 1. Bota është një e dhënë, shumë e madhe për ne, 2. ngaqë populli ynë është i vogël përballë historisë së larmishme, por e mbyllur ndaj nesh, histori pra e mbyllur e një bote ku nuk bëjmë pjesë si element analizator, 3. ndaj dhe ndërhyrja në botë është punë masive dhe shumë e rëndë për shpatullat tona.

Vesi në gjykimin tonë është i thjeshtë: trashëgimia nuk është operative. Detyrën masive të ndërhyrjes në botë ne e shohim në të gjithë ligjërimet tanë folklorikë dhe modernë, privatë dhe zyrtarë si detyrë të një momenti apo brezi, dhe jo punë të përditshme e të përbrezshme. Trashëgimia është virtyti i pajisjes me një mision kolekti dhe publik. Trashëgimia mund të jepte mirë përfytyrimin e duhur të detyrës masive si e delegueshme nga brezi në brez, nga njeriu te njeriu, nga një pjesë e shoqërisë te një tjetër, madje dhe nga një fakultet i njeriut te një tjetër fakultet i tij. Ndryshimi i kësaj mendësie përbën kushtin e realizimit të pikës kyçe, pra pikës së kthesës. Vesi ynë është vrasja e dyfishtë e besimit: shoqërinë tonë e degdisim pa pushim në gjendjen e një përfaqësimi të padekonstruktueshëm, ndërsa botën e degdisim në statusin e një

të dhëne radikalisht dhe fatalisht objektive<sup>3</sup> – ku nuk ka më vend për ndërhyrje subjektive.

Duhet t'ia nisim kthimit të politikës pikërisht me idenë se ka gjeopolitikë në ekonomi sa dhe në politikë, në energji sa dhe në kulturë. Kjo nismë e kërkon shtetndërtimin përmes instituteve dhe laboratorëve. Çdo linjë e shtetndërtimit që aktivizon trupat shoqërorë së brendshmi, i organizon po ashtu së jashtmi, sipas linjave gjeopolitike të forcës. Aq sa ndërton së brendshmi kthjelltësinë e unitetit, po aq e shpërbën tërësinë jashtë në kuptimësi më të përpunuara dhe më të jetueshme.

Disi papritur po shkruaj se ç'kuptoj unë me reduktimin e deritanishëm të raportit gjeopolitikë-politikë në rastin tonë. Mendoj se janë tre vlerësimet që më së shumti e kanë nxjerrë shqiptarin jashtë qenies historike:

Linja e parë historike (Perandoria) që shkoi kundër shqiptarëve ishte hyrja dhe tretja e tyre nëpër perandori dhe, për pasojë, dobësimi i elementit shtetifikues kombëtar.

Linja e dytë ishte (periferia) ajo e lindjes së shtet-kombeve që e vendosi kombin e dobët në kuptimin e përcaktimit gjuhë-territor në një vonesë të dytë. Nga Perandoritë kaluam te Fuqitë. Pasoja ishte ndarja në copa dhe lënia jashtë këtyre copave e periferive të popullsisë shqiptare, gjë që u vijua me shkëmbimin e popullsisë shqiptare mes perandorisë së largët dhe pushtuesve fqinj. Ky ishte spastrimi i shqiptarëve, si emra apo si trupa, prej periferive. Kjo bëri që copëtimi dhe zvogëlimi i territorit të sillte zvogëlimin e njerëzimit shqiptar në Ballkan. Copëtimi synoi periferizimin e shqiptarëve.

Linja e tretë (sekretimi) është ajo e ndërtimit të shtetit shqiptar me në krye njerëz që ia lehtësojnë punën pushtuesve fqinj tradicionalë. Me fshehjen e përmbajtjes së bisedave të tyre me Athinën dhe Beogradin, Tirana dhe Prishtina ia lehtësojnë politikës greke dhe serbe qenien e tyre shoviniste fizike, historike dhe politike. Kësi pushtetesh, linja e tretë, kanë edhe qëllimin funksional të furnizojnë linjën e dytë anti-shqiptare, prodhimin e periferive ku shqiptari bëhet objekt i lehtë i spastrimit.

Përsëri populli shqiptar nuk di hiçgjë se ç'bëhet në shpinë të tij, territorit dhe pasurive të tij. Si me shtet, si pa shtet, si nën perandori dhe jashtë perandorie, ai është gjithnjë njësoj i përfaqësuar dhe po aq pak i interesuar për kufijtë dhe të ardhmen e tij. Le të shtojmë si shembull të *periferizimit* dhe *sekretimit* të përgjithësuar të elementit shqiptar, trevën shqiptare të Maqedonisë së Veriut. Në mënyrë shumë të aftë edhe aty vijohet ende dobësimi psikologjik i shqiptarëve, sepse ekzistenca e këtij shteti nuk ka më tjetër funksion veçse mbajtjen e gjallë të një aleati të Serbisë në formë shteti. Dhe nuk ka më të qartë

---

3 Për përfytyrimin ose analizueshmërinë tonë subjektive do të rekomandoja në përgjithësi veprën letrare të Krenar Zejnos, ndërsa për reduktimin e statusit të botës e historisë në objektivitete fatale rekomandoj shkrimet e Hysamedin Ferajt.

se funksioni i këtij shteti, i dyshimtë në ekzistencë, është vetëm një: sekretimi i elementit shqiptar, periferizimi i elementit shqiptar.

Pra, në linjën e parë e më të hershme ne menduam se bota kishte marrë fund në formë perandorish të përjetshme. Në linjën e dytë e pamë veten të vonuar dhe organizuam Lidhjen e Prizrenit vetëm në moment të fundit. Në linjën e tretë shpikëm shtetin tonë për me harru se detyra e përfaqësimit dhe sovranitetit është e përditshme. Nëse i pyetni sot shqiptarët e Republikës londineze nëse dinë diçka për demarkacionin, për marrëveshjet në lidhje me detin në jug, për përpjekjen e shkëmbimeve territorialë, për Zajednicën, si përgjigje masive do të shihni një padije shumë të lartë. As nuk ia kanë idenë. Ata mendojnë në mënyrë të pavarur se nuk do të ketë më luftra dhe se nuk ka më pushtime. Arsyeja është e thjeshtë dhe vetëm një: mungesa e gjeopolitikës në ligjërim.

Pra ne ndërtoam shtet për të na vjedhur dijen, pasurinë, projektimin, si dhe për të na vënë në dyshim të ardhmen tonë politike dhe qenien tonë historike. Politikë pa gjeografi, ose gjeografi pa politikë. E thënë më ndryshe: gjeografi pa histori.

Kështu që duhet t'i afrohem në mënyrë urgjente gjeografisë. Ngaqë vendet e sunduara prej mendësisë kolonialiste nuk mund ta mbajnë për të vërtetë diçka që është e tillë në perëndimin përgjithësisht kolonialist: në rrethet intelektuale dhe të thelluara të perëndimit thuhet se gjeografia është reaksionare dhe historia politike, gjë përgjithësisht e vërtetë. Por, nuk zotëron e njëjta ligjëratë në kancelaritë e këtyre vendeve. Në entet e tyre drejtues, çdo ndërmarrje dhe veprimtari i nënshtrohet faktorizimi gjeografik.

Krejt e kundërta duhet të ndodhë në një vend e në një shoqëri si e jona, mbi të cilin mendësia atmosferike që mbretëron është ajo e të kolonizuarit. Historia duhet të jetë vektori politik i mendimit tonë të brendshëm që vepron jashtë. Gjeografia duhet të jetë edukimi i jashtëm që na drejton së brendshmi. Në këtë pikë, nyja gjeopolitike që duhet të shpaloset në kuptimësi të reja është mes trevës shqiptare që ka qenë e pushtuar nga sundimi sllav serb dhe trevës së pushtuar nga ndikimi lindor ideologjik sllav. Për më tepër, kjo nyje e studimit gjeopolitik duhet të zgjerohet. Në këtë rast ajo do të jetë e shtrirë mes ndikimit me pushtim - Shqipëri veriore dhe verilindore, dhe pushtimit me ndikim - Shqipëria zyrtare e sidomos ajo e jugut.

Lipset një dije shumë e artikuluar për të vendosur politikën në termat e gjeografisë, madje në termat e tërë nën-disiplinave të saj. Sepse nuk është në fund të fundit beteja e mendimeve që e shtyn Serbinë t'i bëjë luftë Bosnjës, por beteja për territor, madje për territore që shtynjë e bëjnë të rrokshëm territore të tjerë.

Paqja jonë ideologjike erdhi nga dhënia e territorit. Pra, për të shmangur një beteje ideologjike ku ndiheshim të dobët, ne dhamë territor. Kjo është

thelbësia e mungesës së edukimit gjeopolitik. Shprehja më e thellë e mungesës së këtij edukimi është indiferenca me të cilën përcjellim nismën serbe të Ballkanit të hapur. Një sjellje e dykohshme bën që nën kërcënim të na frymëzojë historia, ndërsa në paqe të na i punojë bindjen gjeopolitika. Nga mendimi në një komb, ne mësuam të jetojmë me shumë shtete, e tani një përpjekje e theksuar po punon që ne të mendojmë me shumë kombe.

Gjeopolitika nuk është vetëm gjendja botërore e shpërndarjes së raporteve të forcave, por para së gjithash *rezultimi i përmasës globale* në cepin ku ne jetojmë dhe prej ku vështrojmë. Që vendet komuniste nuk mund të pretendojnë e as të bëjnë luftë për territore, çuditërisht këtë gjë e kupton dhe e di vetëm shoqëria e Shqipërisë londineze. Sërish dhe çuditërisht Evropa është shumë e kujdesshme jo ndaj vendeve që nuk e nxisin e bëjnë këtë luftë, por ndaj atyre që e projektojnë, e nxisin dhe e bëjnë pa marrë parasysh numrin e viktimave njerëzore.

Çudia në konkluzë është pra fakti se është historik ai popull që bën gjeopolitikë. Kundër-shembull është lufta e dy shteteve komunistë për territor – Vietnam e Kamboxhë. Yves Lacoste na i tregon shumë thjesht e në pak rreshta konfuzionin që krijon ideja se edhe komunizmi përbashkues nuk ia heq planetit natyrën e tij gjeografike. Për të kuptuar se si kthehet një cep në nyje, mjafton shembulli aq tronditës se aleate e Vietnamit ishte Bashkimi Sovjetik, ndërsa e Kmerëve të kuq ishte Kina. Ja një shembull tipik i shpalosjes. Le të kujtohem për ndërhyrjet proruse të komunistëve francezëve pranë udhëheqjes shqiptare në mbledhjen e Moskës.

Ide dhe territor, këto janë dy udhët e betejës, por ne gjejmë shumë pak nga e para dhe shumë nga i dyti kur bëhet fjalë për relacionet mes shteteve. Dhe nuk gjen nyje më intensive gjeopolitike për fuqitë se ç’ka qenë dhe është Ballkani, në të cilin jeton një popull që merret më së paku me analizë gjeopolitike, në qeverisje dhe shoqëri. Po të merreshim me gjopolitikë, do të kishim mundur si shqiptarë të sillnim një stabilitet në Ballkan dhe t’ua bënim të pamundur Fuqive ta projektonin Ballkanin si fuçinë e tyre të barotit.

Në këtë mënyrë vështrimi, do të thosha se shteti shqiptar, më i qartë mbi rolin e vet të brendshëm, është ai që e ka Kosovën për kryeçështje të aksionit politik dhe për kryefjalë të ligjëritit të tij në politikën e jashtme. Po e përsëris veten duke shtuar një cilësim: Kosova është transhendentali gjeopolitik i shtetit shqiptar.

Nga kjo pikë duhet imagjinuar numri i pasojave të dëmshme, të cilat vinin në gjuhën e ish-presidentit Thaçi me fjalët korrigjim i vijës kufitare. Për një gjeopolitolog të vërtetë kjo shprehje thotë shumë probleme. Kufiri është një prej fjalëve kyçe të sovranitetit në këndvështrimin gjeopolitik. Në fund të fundit vetëm pushtimi është shtyrje e asaj linje ndarjeje që quhet kufi. Falë

asaj linje të thjeshtë, vërtet të thjeshtë, jepet ideja e sovranitetit shtetëror, deri edhe përmbajtja e frymës së kombit.

Po jap një shembull shumë ndriçues sa dhe të thjeshtë. U edukuam nga një arsim i tërë arsimor shtetëror se kufiri shqiptar është ai që mbulohet nga sa rreshta ka shkruar Enver Hoxha. Por nuk ishte meraku të na mësohej se sa kishte shkruar Enver Hoxha. Meraku ishte të ngulitej në kokat tona ideja se ky është kufiri maksimal i njësimi të mundshëm të shtetit me kombin për shqiptarët. Kufiri lokalizon në mendjet tona atë territor që na takon dhe ku kemi të drejta. Ndaj në Shqipërinë zyrtare, në opinionin publik, shpesh bëhet pyetja se ç'kërkon Albin Kurti në Shqipëri. Kështu është prodhuar kjo mendësi gjeopolitike e ndalur për shqiptarët në Shqipërinë londineze. Edhe një herë: në mënyrë zyrtare prodhohet periferizimi i elementit shqiptar.

Gjeopolitikë e brendshme është edhe marrëdhënia në fushën e energjisë. Zotërimi i një dijeje të shtjelluar në burimet e energjisë përbën detyrim për institucionin politik. Sidomos kur kjo dije e merr burimin e vet edhe nga linja të tjera vetëdijesimi, si zhdukja progresive e lumenjve përgjatë katastrofës ekologjike, apo edhe rekomandimi i përgjithshëm për pakësim të përdorimit të qymyrit, shtuar këtu loja gjeopolitike ruse me prodhimin dhe eksportimin e gazit.

Një pikë tjetër është se gjeografia fizike është po aq politike sa dhe ajo ekonomike. E tillë ka qenë nyja që u shpalos vetëm nga LV-ja kur bëhej fjalë për demarkacionin. Një moment i gjeografisë fizike që nuk shihet as si çështje sociale e as si nyje e zhvillimeve politike, dëshmon se ne jemi të padrejtuar nga çështja e sigurimit të territoreve, por vetëm prej mbrojtjes së tyre urgjente dhe në çastin kur ato kërcënohen. Sot, aktualisht, Kosova është shteti i vetëm në botë që e ka dramaturgjinë gjeopolitike të shprehur në flamur, ose më mirë që e ka vënë flamurin e vet në kundërthënie me kushtetutën dhe me aktin e shpalljes së pavarësisë.

Tjetër moment i dukshëm i mangësisë gjeopolitike është se marrëveshja konfuzë e 4 shtatorit u nënshkrua nga një qeveri që para pak kohësh u shpall e paligjshme nga gjykata kushtetuese. Një territor shtetëror, i njohur si republikë e pavarur nga vetvetja, përfaqësohet në një marrëveshje të paqartë prej një grupi të paligjshëm. Mangësia jonë gjeopolitike mund të shpjerë në konflikte. Sapo ne kthehemi në subjekt politikisht kundërthënës, bëhemi gjeopolitikisht burim i kundërthënies të raporteve ndërkombëtare. Ndaj, në çdo moment të shfaqjes sonë politike e diplomatike, në mendësinë e përfaqësuesve tanë duhet të jenë të fuqishëm përbërësit historikë të mendësisë dhe ata gjeografikë të perceptimit dhe veprimit.

Ceni i historisë është se ajo prodhon shpesh identifikime mes luftërave dhe raporteve të forcave, ndërsa tepria e gjeografisë është se ajo na shtyn në njohjen rast për rast. Ndaj e kemi disi për detyrë ta shtyjmë, me institut e

universitet, argumentin historik në skenën perëndimore të ligjërimeve, dhe ta bëjmë të gjallë perceptimin gjeopolitik së brendshmi. Me kësi lëvizjesh ne mund të kontribuojmë në stabilitet. Çdo përpjekje për të cilësuar si stabilitet pritjen e konfliktit të ardhshëm, është mashtrim që vjen kryesisht nga Lindja. Për edukimin tonë në fushën ndërkombëtare, gjeopolitika duhet të jetë më së pari rregullimi i raportit mes historisë si fushë e kontabilitetit të të drejtave dhe gjeografisë si terren i shprehjes së forcave.



## 1.2 Ballkani i hapur dhe gjeopolitika postmoderne serbe



### **Dr. Sadri RAMABAJA**

#### **Hyrje**

Përfundimi i Luftës së Ftohtë shënoi edhe fillimin e implodimit të socializmit, që do t'i japë fund BRSS, por edhe Federatës së sllavëve të Jugut të Evropës - Jugosllavisë. Ndërkaq viti 1989 shënon njëkohësisht edhe fillimin e fundit të liberalizmit klasik.

Me këtë akt, siç shprehet I.V. Olerstin, zë fill procesi i restaurimit të neokonservatorizmit dhe restaurimi i Evropës, respektivisht rikthimit të saj në skenën e diplomacisë botërore të rikomponuar. Ky proces do të vazhdojë për dy dekada rresht konform interesave gjeopolitike të fuqive të mëdha. Ndërkaq shfaqja e globalizmit monocentrik, ku fjalën kryesore do ta kenë SHBA-të, do të shenjojë hyrjen në epokën e shembjes së rendit ndërkombëtar, siç njëhej ai përgjatë gjithë epokës së Luftës së Ftohtë.

Ndërkohë, pas përfundimit të luftërave në truallin e ish-Jugosllavisë, shikuar nga ky kontest historik, Ballkani për diçka më shumë e dy dekada, ka përjetuar tranzicion të dyfishtë:

1. Tranzicionin ekonomik-social dhe
2. Tranzicionin e thellë gjeopolitik.

Pranimi i rendit të ri politik - demokracisë liberale, tashmë në gjithë rajonin, ku në mënyrë më të organizuar, e ku nën diktatin e neoliberalizmit ekstrem konservator, ka imponuar transformimin e plotë të pronës dhe të mjeteve të prodhimit. Ky fakt e ka shndërruar Ballkanin në një periferi të pa peshë të ekonomisë së BE-së, ndërkaq në kuptimin gjeoekonomik, ai tashmë ka rrëshqitur në terrenin e rikolonizimit të butë.

Në anën tjetër, tranzicioni gjeopolitik i Ballkanit është në përmbyllje e sipër, duke iu rikthyer shumica e shteteve-kombe hemisferës perëndimore të interesit. Aderimi i Rumanisë dhe Bullgarisë në NATO pati reflektime të ndjeshme edhe në intervenimin e kësaj strukture politiko-ushtarake në Kosovë. Ai proces me peshë gjeostrategjike u pasua me aderimin e Sllovenisë, Kroacisë dhe së fundmi edhe të Malit të Zi dhe Maqedonisë, duke i bërë kështu Serbisë një “rrethim demokratik” të plotë. Me këtë cikël aderimesh, rajoni po shkonte drejt mbylljes së ndikimit rus, duke e kufizuar atë realisht vetëm në Serbi dhe brenda Republika Serbe (në Bosnjë-Hercegovinë). Ndërkaq pesha që kishte dikur Serbia në ish-Jugosllavi vështirë se mund të rikthehet.

Në këto rrethana të reja, në nivelin ndërkombëtar, Beogradi e ka ndjekur një politikë të jashtme dyvektoriale, shpesh skizofrenike midis palëve pothuajse të ballafaquara sërish me elemente të Luftës së re të Ftohtë mes Perëndimit dhe Ruisë.

Dhe nuk është vetëm Serbia në një situatë kaq të papërcaktuar dhe të pakonsoliduar. Ka vende të tjera kryesisht pas konfliktit në Ballkanin Perëndimor - si Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova (de facto) - të cilat nuk janë integruar në BE dhe NATO dhe veprojnë në një situatë politike, ekonomike dhe të sigurisë pothuajse përgjithësisht të paqëndrueshme. Cila është perspektiva e politikës së jashtme të këtyre vendeve dhe sa ndikohet nga dinamikat e brendshme politike? Ku janë vendet e Ballkanit Perëndimor në pozicionimin gjeopolitik të aktorëve me ndikim dhe çfarë pasojash mund të ketë tranzicioni i tyre i vështirë për një kohë të gjatë - këto janë pyetjet që kjo analizë përpiket të përgjigjet.[1]

### ***Politikat e suksesshme lituaneze të energjisë - një leksion për Evropën Juglindore***

Promovimi i Ruisë si një “superfuqi energjetike”, sidomos tani në prag të përfundimit të megaprojektit që do ta furnizojë Gjermanin me gaz - Nord Stream 2, është shqetësues jo vetëm për Perëndimin. Gjermania, që cilësohet si partneri më

i rëndësishëm tregtar, po shndërrohet gjithashtu në partner absolutisht i varur nga furnizimet me energji ruse. Serbia ka kohë që vullnetarisht është plotësisht e varur nga energjia ruse.

Rusia e Putinit është e vetëdijshme për pozicionin e saj të fortë që gëzon në rrafshin ndërkombëtar, ndërkaq rikthimi i saj në Ballkan përmes Serbisë mbetet një prej objektivave të saj strategjike që nuk e fsheh fare. Ky pozicion bazohet jo vetëm në pasurinë e burimeve të vendit. Asnjë shtet tjetër nuk ka kaq shumë lëndë të para. Rusia është prodhuesi më i madh i energjisë në botë; vendi zotëron më shumë se një të tretën e rezervave të gazit natyror në botë, rreth gjashtë për qind të rezervave të naftës në nivel botëror dhe rezervat e dyta më të mëdha të qymyrit. Kjo ngjall frikë gjithandej.

Furnizimi me lëndë të para minerale dhe energjike është tashmë thembra e Akilit e ekonomive në Evropë, veçanërisht për kampionin botëror të eksportit, Gjermaninë. [2]

Por, krahas kësaj, edhe investimet gjermane në Rusi janë enorme.

Prandaj konkludimi i ekspertëve të fushës ekonomike se nuk ka varësi të njëanshme, duket real. Varshmëria rezulton të jetë më shumë reciproke - me avantazhe të gjithanshme. Në këtë plan, duke konstatuar me të drejtë se në shumicën e vendeve konsumatore, ekziston një potencial i lartë për mundësi ekonomike, shkencore dhe teknike për rritjen e efikasitetit të energjisë, në kombinim me dijen si resurs specifik, Gjermania dhe vendet tjera perëndimore, madje edhe Lituania, pretendojnë ta shndërrojnë në një avantazh strategjik në konkurrencën globale.

Politikat e suksesshme lituaneze të energjisë mund të jenë një leksion, jo vetëm për Gjermaninë, por edhe për Evropën Juglindore.

Terminali LNG i Lituanisë ka qenë në funksion në portin e Klaipeda që nga viti 2014; ai ka shërbyer si strukturë e mirëmenduar për pranimin e gazit të lëngshëm natyror - LNG si “gaz natyror të lëngshëm”. Me këtë investim, një nga të parët e këtij lloji në botë, vendi i vogël me vetëm 2,8 milionë banorë ishte në gjendje t’i jepte fund me sukses monopolit të gazit të Moskës në shtetet baltike. Në atë kohë, ministri i Jashtëm Lituanisë, Linas Linkevicius, foli vetëm për një “përparim” për Lituani dhe rajonin, pa rrahur gjoks më shumë.

Ndërkohë SHBA-të kanë vepruar ngjashëm në Greqi, duke vënë në veprim terminale të saj LNG, si në Lituani, e që do të jenë në dispozicion të Evropës Juglindore.

Një nga përkrahësit e diversifikimit në sektorin e energjisë është Tomas Janeliunas. Ai sheh avantazhe shumë të qarta. “Për Lituani, terminali është një garanci e

stabilitetit të çmimeve. Por, gjithashtu ai siguron furnizimin në përgjithësi, sepse vendi nuk është më i varur prej vetëm një furnizuesi, “thotë politologu nga Universiteti i Vilnius-it, një nga ekspertët më të njohur në temën e sigurisë së energjisë.

Aktualisht sot asnjë vend evropian nuk merr më shumë gaz natyror nga Rusia sesa Gjermania; në vitin 2019 ishte 55,6 miliardë metra kub, më shumë se gjysma e importeve të përgjithshme të gazit të Gjermanisë.

Italia doli e dyta me 20,7 miliardë metra kub. Nord Stream 2 së shpejti do të sjellë deri në 55 miliardë metra kub më shumë në Gjermani - gjë që do ta rrisë ndjeshëm varësinë nga Moska. Përkrahësit e projektit të gazsjellësit janë të lumtur të theksojnë se edhe Bashkimi Sovjetik ishte një furnizues i besueshëm i lëndëve të para për Gjermaninë gjatë Luftës së Ftohtë - shqetësimet e Ukrainës ose Qeverisë polake, të cilat Nord Stream 2 i klasifikon si një kërcënim për sigurinë e energjisë të të gjithë BE -së, kështu pretendohet të largohen mënjane.[3]

Këtë gjendje e ka shfrytëzuar Rusia e Putinit, duke e zbrëthyer atë edhe në doktrinën e saj të re strategjike. Në qendër të kësaj doktrine gjithsesi qëndron interesi nacional i kodifikuar me nocionin “Bota ruse”, që në thelb ka rikthimin e ndikimit rus jo vetëm në ish-republikat e BRSS-së, ku kishte pakica ruse, por edhe më tej. Rikthimi i saj “i butë” në Ballkan prandaj është një prej objektivave të gjeopolitikës post-moderne ruse.

Këtë fakt, Serbia po përpiqet ta shfrytëzojë dhe, siç vëren studiuesi J. Bugajski, Serbia, nën sundimin e Presidentit Aleksandar Vuçiq, po përpiqet në mënyrë të dëshpëruar ta imitojë Rusinë. Ajo po kërkon të jetë fuqia dominuese në Ballkanin Perëndimor dhe po e kopjon ideologjinë “Bota ruse” të Putin për një “botë serbe” [4], qoftë kjo edhe më e vogël se ajo ruse. Por, problemi për Beogradin është i dyfishtë: agjenda e tij ekspansioniste do të hasë në rezistencën e të gjithë fqinjëve të tij dhe atë të agjencive ndërkombëtare, ndërsa përpjekja për “madhështi” do të bëjë që Serbia të jetë gjithnjë e më e varur nga përllogaritjet e Moskës, konkludon Bugajski në një editorial për gazetën DITA të Tiranës. [5]

Varësia ekonomike e Serbisë nga Rusia vazhdon të thellohet, veçanërisht në fushën e energjisë. Në janar 2021, Beogradi nisi një ndërlidhje të re gazi përmes Bullgarisë dhe Turqisë, me një pjesë prej 400 kilometrave të gazsjellëses TurkishStream (Rrjedha turke) për gazin rus. Serbia varet pothuajse tërësisht nga furnizimi i energjisë ruse dhe kjo e shton kontrollin e Rusisë mbi shtetin. Por kjo vaërsi e Serbisë ndaj Rusisë edhe më e thellë është në planin ushtarak.

Moska është e prerë që të mos tolerojë asnjë lëvizje të Serbisë drejt anëtarësimit në NATO, konkludon me ët drejtë Bugajski në analizën e tij në fjalë.

Këtë varësi Putini gjithsesi mund ta shfrytëzojë në çastin më të leverdishëm, duke nxitur konfliktin fillimisht në Bosnjë, por pa përjashtuar edhe mundësinë e një Blic-Krieg-e në veriun e Kosovës, që fare lehtë mund ta përfshijë gjithë Ballkanin.

Ndërkohë Bashkimi Evropian për shkak të bllokadës bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut ka vendosur sërish të mos çelë negociatat për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

“Nuk ishte e mundur të binim dakord për miratimin e kornizës së negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Shpresojnë që kjo të arrihet nën presidencën e Sllovenisë”. [6], tha Sekretarja e Portugalisë për Çështjet Evropiane, Ana Paula Zacarias, pas takimit të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme, më 21 qershor, në Luksemburg. Në këtë gjendje pa perspektivë, kur procesi i integritimit të rajonit në BE po shtyhet për në “Kalendrat greke”, dalje në skenën politike me idenë e krijimit të të ashtuquajturit “Ballkani i hapur” rezulton të jetë më shumë një projekt i karakterit gjeopolitik, ku ngatërrohen sferat e interesit të fuqive të jashtme, sesa një zgjidhje e duhur e në kohën e duhur. Emri i tij për ideatorët, duket se është shfrytëzuar si “Letër lakmuesi”, si një mashtrim i llojit të vet e për motive të dyshimta të atyre që e kanë iniciuar.

### ***“Ballkani i hapur” - një alternativë që i kundërvihet procesit integruar në BE***

Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, të cilat, ashtu si Kosova, kanë frikë nga mbizotërimi i Serbisë, nuk tregojnë asnjë interes për Ballkanin e hapur. Ndërkohë edhe Bosnjë-Hercegovina gjithashtu është “tërhequr” nga iniciativa, si duket nga presioni që ka nga bashkësia ndërkombëtare. Ekziston shqetësimi në Malin e Zi se një Bashkim Ballkanik, që de fakto do të ishte një “Jugosllavi e re” pa Slloveninë dhe Kroacinë, por me Shqipërinë brenda, mund të krijohet si një alternativë ndaj anëtarësimit në BE dhe se anëtarësimi në BE mund të zëvendësohet nga diçka tjetër. Dhe kjo nuk ishte ajo që ata dëshironin deri më tani në Podgoricë.

Për sa i përket përmbajtjes, “Ballkani i hapur” tani është pajisur me prerogativa që de fakto janë më shumë sesa lehtësimi i lëvizjes së njerëzve - përkatësisht krijimi i një zone ekonomike rajonale, njohja e diplomave, çështja e lejeve të punës dhe shkëmbimet e studentëve, duke pretenduar madje edhe një treg të brendshëm me të gjithë katër liritë për lëvizjen e mallrave dhe të shërbimeve, njerëzit dhe kapitalin. Megjithatë, ky projekt edhe vetëm si ide ka rezultuar më shumë të jetë në funksion të ringjalljes së tensioneve politike dhe rritës së nacionalizmi, sidomos atij serb. Rrjedhimisht, rezistenca ndaj kësaj ideje ishte më e theksuar në Kosovë dhe Mal të Zi, por ajo pritet të artikullohet edhe më qartë nga qarqet progresive gjithandej brenda Ballkanit Perëndimor dhe nga Brukseli e Uashingtoni.

Për këtë ide, fillimisht të pagëzuar si Margaritis Schinas, nënkryetari i Komisionit Evropian nuk ishte aspak i entuziazmuar, përkundrazi ai atë nuk e shihte në funksion të procesit të integritimit të rajonit në BE.

“Në asnjë mënyrë qëllimi për t’u kthyer në Shengenin tonë të zakonshëm, duke hequr kufizimet aktuale në kufijtë tanë të brendshëm, nuk do të zëvendësohet nga një lloj mini-Shengeni rajonal që e copëton tregun tonë të vetëm dhe diskriminon shtetet anëtare jopjesëmarrëse. Kjo nuk është e mundur”, pohoi ai.

Në veçanti, ai theksoi se nuk dëshironte që e ashtuquajtura ‘fluska e udhëtimit baltik’ të bëhej një tipar afatgjatë, megjithëse ai nuk e kundërshtoi veçanërisht heqjen e kufizimeve në udhëtimet e brendshme midis shteteve të BE me nivele të ngjashme epidemiologjike gjatë pandemisë.

Kjo marrëveshje e re midis Shqipërisë dhe Serbisë ndodh pikërisht kur BE-ja po planifikon ta rishikojë Zonën Shengen.[7]

Kalimi nga iniciativa e Novi-Sadit, që u bë më shumë e njohur me emrin “Mini Shengen”, në “Balkan Open” duhet shikuar edhe si produkt i njëlloj “skepticizmi euro-atlantik”, e si i tillë ai merr një dimension më të strukturuar dhe më të etabluar në mendësinë e politikanëve, të cilët gjatë ditës mendjen e kanë në Bruksel e Uashington, kurse natën punojnë në gjetjen e alternativave për t’i zëvendësuar ato.[8]

Në emisionin e njohur të njërit nga tv-të serbe, RasPravda, St. Protiq, historiani dhe ish-ambasadori serb në Zvicër dhe SHBA, pohon se bombardimet e NATO-s mbi caqet e Armatës serbe dhe mbi qytetet serbe (24 maj 1999 - 10 qershor 1999), paskan ndodhur meqë Perëndimi, më saktë “disa nga fuqitë perëndimore, nuk na honepsin dot si lider të Ballkanit”. Ata, thellon më tej analizën e tij ish-ambasadori dhe ndërkohë studiuesi St. Protiq, e kanë të qartë se “ne serbët, kemi vullnetin dhe dëshirën, fuqinë dhe aftësinë që të krijojmë shtetin nacional dominant në Ballkan, i cili do ta dominonte krejt këtë pjesë të kontinentit. Këtë fakt nuk mund ta tolerojë asnjë nga fuqitë e mëdha, e veçmas jo ato fuqi perëndimore që në këto 20 vjetët e fundit e kishin fjalën kryesore”. [9]

Në këtë linjë është edhe studiuesi i njohur rus i çështjeve ballkanike, Valeri Emeljanov, drejtor i Qendrës Ruse të Analitikës dhe Informacionit. Ai në një analizë, e botuar në 31 korrik 2021, tek trajton idenë për Ballkanin e hapur, duke rreshtuar përfitimet e Serbisë nga kjo nismë, thekson se “*Shqipëria për Beogradin është dalje në det, nga e cila u privua me rënien e Jugosllavisë dhe më vonë të Federatës Serbo-Malazeze*”.

*Tutje ai nënvizon se dy përfituesit kryesorë të nismës do të jenë Serbia dhe Maqedonia.*

*“Serbia, shteti më i fuqishëm i aleancës së ‘Ballkanit të hapur’ natyrisht është e interesuar për vërshimin e mallrave të lira dhe të shërbimeve të lira nga vendet fqinjë. Përveç kësaj, ‘Ballkani i hapur’ është rikthim i qartë tek statusi i liderit*

*rajonale, të cilin Serbia dhe serbët tradicionalisht e kanë pasur në Ballkanin Perëndimor. Mospjesëmarrja e Kosovës në aleancat e tipit të “mini-Shengenit ‘Ballkani i hapur’ - realisht dhe qartë përcaktohet nga fakti se atë e drejton Serbia” - shkruan Valeri Emeljanov.[10]*

Si nacionalisti racional e i matur serb Protiq, edhe sivëllai i tij rus Valeri Emeljanov, nuk e fshehin faktin se ky projekt mund të konsiderohet edhe si kundërvënje BE-së, respektivisht filozofisë bazë mbi të cilën është ngritur ky bashkim sui generis për historinë politike botërore. Prandaj Protiq angazhohet për qasje tjetër ndaj Kosovës, për këmbim popullsisht ndërmjet Serbisë e Kosovës, për aneksimin e gati gjysmës së Bosnjës (Republika Serbe...) dhe krijimin e shtetit-komb të Serbisë.

Projekti “Ballkani i hapur” vallë nuk na qenka pikërisht kjo qasje e Beogradit për krijimin e parakushteve që shpijnë drejt arritjes së këtij objektivit strategjik serb?!

### ***Bashkimi doganor i pamundur***

Për një treg unik, përveç katër lirive që parasheh ideja e “mini-Shengenit”, një bashkim doganor do të ishte i domosdoshëm. Ndërkaq realizimi i këtij objektivit rezulton të jetë thjesht i pakonceptueshëm, sepse të gjashtë vendet kanë tarifa doganore shumë të ndryshme me vendet e tjera të treta. Serbia, për shembull, ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me Rusinë dhe tani gjithashtu një me Bashkimin Euroaziatik.

“Nuk ka gjasa që kufijtë për tregti dhe udhëtime midis vendeve të prekura do të hiqen”, thotë doajeni i ekonomistëve të Evropës Juglindore, Vladimir Gligorov, në lidhje me idenë mini-Shengen për të përditshmen austriake STANDARD. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu kanë marrëveshje me BE-në mbi standardet dhe pengesat tregtare. “Nuk ka asnjë mënyrë për ta sinkronizuar politikën përtej asaj që është rënë dakord me BE”. përmbledh ai.[11]

Presidenti serb Aleksandar Vuçiq u shpreh në një rast tjetër se, në rrethanat kur BE-ja nuk e ka një strategji të qartë ndaj Ballkanit Perëndimor, nisma rajonale Ballkani i hapur paraqet një mundësi, shpresë dhe detyrim të madh për të tri vendet për ta krijuar një të ardhme më të mirë dhe të ndryshme në e tyre.[12]

Ndërkaq në një nga takimet e treshes Vuçiq-Rama-Zajev, presidenti serb Vuçiq nënvizon se “deri në fund të vitit 2021 duam t’i krijojmë kushtet që të kalojmë nga vendi në vend vetëm me kartë identiteti. Këtë me Shqipërinë nuk mund ta bëjmë tani dhe shpresojmë ta arrijmë në takimet e ardhshme. Njëzet e gjashtë orë humbin kamionët duke pritur në kufij dhe shikoni çfarë do të thoshte për ekonominë heqja e këtyre barrierave”.

Këto deklarata të Vuçiqit duhet vështruar të ndërlidhur me strategjinë serbe për dominim në rajon. Por, për hir të së vërtetës, duhet pohuar se rajoni ka nënshkruar marrëveshje paraprake në kuadër të nismave tjera, prandaj tashmë ekziston një marrëveshje ekonomike, por që nuk funksionon. Marrëveshja CEFTA nuk funksionin dhe përgjegjëse për këtë është vetë Serbia. Atëherë është logjike të bësh pyetjen, përse nuk punohet për zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s, por futet në lojë Ballkani i hapur? Konkluzioni është i qartë: përderisa Serbia nuk e njeh Kosovën si subjekt të barabartë në tavolinën e bashkëbisedimeve edhe për projekte të kësaj natyre, përderisa marrëdhëniet politike ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës të mos zgjidhen, çfarëdo marrëveshje qoftë ajo, është vështirë, për të mos thënë e pamundur të funksionojë, e të mos flasim për këtë lloj “bashkimi doganor”, siç prezantohet “Ballkani i hapur” nga treshja e kapur nga oligokratët e rajonit që si duket janë fuqishëm të mbështetur nga ata rusë dhe jo vetëm.

### ***“Ballkani i hapur” e pengon procesin integrues në BE***

Kjo iniciativë duket e pakonsultuar ose minimalisht - e pakoordinuar me fqinjin tonë kryesor, me Kosovën, e cila bashkë me Bosnjën e Malin e Zi e kanë bërë të dështojë që në fillim këtë iniciativë. Qeveria franceze thuhet se ka dijeni për një paketë të plotë të kësaj initiative, e cila në thelbin e vet e zhvendos rajonin nga aksi i integritetit të shpejtë në Bashkimin Evropian dhe, e dyta, fut në labirinte të errëta pavarësinë e Kosovës.

Për ish-diplomatën Shaban Murati, nisma mund të ketë efekte të tjera gjeopolitike. “Realisht, projekti serb është krijimi i një mini-bloku të ri ekonomik dhe politik si alternativë apo sfidë ndaj Bashkimit Evropian. Presidenti serb e shprehu hapur këtë pas refuzimit të BE-së për hapjen e bisedimeve të pranimit me Shqipërinë dhe me Maqedoninë e Veriut, kur tha se ‘refuzimi i BE-së tregon se sa të drejtë kemi ne që jemi lidhur me Rusinë dhe me Kinën’. Orientimin mini-bloqeve ua jep shteti nismëtar ose shteti më i fuqishëm, që në rastin konkret është Serbia. Rusisë i interesojnë vatra të vogla ballkanike të shkëputura nga BE-ja dhe prandaj Moska e përkrah projektin serb të zonës ekonomike ballkaniko-perëndimore”, argumenton Murati.[13]

Murati nënvizon tutje në raport me qëllimet reale të Serbisë që ndërlidhen me Ballkanin e hapur si projekt, duke e cilësuar si “lojë të komplikuar dhe të errët diplomatike dhe të metodës indirekte serbe për të marrë dalje në bregdetin shqiptar të Adriatikut”. Në këtë lojë, sipas Muratit, “Serbia hodhi ne tavolinat diplomatike shashkën që mund të pranonte njohjen e Kosovës në shkëmbim të së drejtës së daljes në bregdetin shqiptar në Adriatik. Është një tezë që e përmend edhe media serbe “B92” në 20 mars 2020, kur del me njoftimin “Një pikë-dalje në det, ky është kompromisi i ofruar Serbisë”. [14]



Vladimir Gligorov thekson se BE-ja do ta donte idenë e “Mini-Shengenit”, sepse “ajo ngadalëson procesin e zgjerimit” dhe meqë BE-ja gjithsesi po promovon bashkëpunimin rajonal për arsye të politikës së sigurisë. Premtimi i Mini-Shengenit është gjithashtu “reklamim i mirë në Evropë” për Vuçiqin dhe Ramën, thotë ai. “Por, kjo nuk paraqet një përmirësim për Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën. Dhe, Mali i Zi nuk dëshiron ndonjë ngadalësim të pranimit të tij në BE”, shpjegon ai tutje. Prandaj, Gligorov arrin në përfundimin se asgjë nuk do të dalë nga e gjithë ideja - “përveç shumë bisedave”. [15]

Shumë studiues të kësaj fushe gjithashtu theksojnë se tashmë ka mjaft iniciativa rajonale. Detyrimet për bashkëpunim më intensiv janë rënë dakord prej kohësh brenda kornizës së marrëveshjes ekzistuese rajonale të tregtisë së lirë CEFTA dhe procesit të Berlinit. Kjo është arsyeja pse ideja Mini-Shengen “duket si një projekt tjetër i bashkëpunimit rajonal, i cili - kam frikë - së shpejti do të mbështetet nga Nisma e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, procesi i bashkëpunimit të Evropës Juglindore, CEFTA dhe kompani të tjera”, thotë eksperti i njohur Florian Bieber i Universitetit të Graz-it, në lidhje me pengesat që iniciativa të tilla u është dashur të përjetojnë deri më tani.

### ***Pozicion i privilegjuar i Serbisë***

Në fakt, marrëveshja rajonale e tregtisë së lirë CEFTA u nënshkrua nga administrata e OKB-së UNMIK në Kosovë, më 2007. Qeveria në Prishtinë më pas theksoi se Kosova do të tërhiqej nga marrëveshja nëse nuk do të përfaqësohej në CEFTA si Republikë tashmë e njohur nga mbi 100 shtete sovraane. Në përgjithësi, tregtia brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor tashmë është kryesisht pa taksa doganore brenda kornizës së CEFTA-s, por kontrollet kufitare ende kërkohen për t’i zbatuar rregullat e origjinës. Në një studim të ri interesant nga Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (WIIW) dhe Fondacioni Bertelsmann, shqyrtohen me përpikëri përpjekjet e mëparshme për ta forcuar bashkëpunimin rajonal dhe në këtë mënyrë edhe të stimulojnë rritjen ekonomike.

Përveç CEFTA-s, Gjermania dhe BE-ja kanë promovuar zgjerimin e infrastrukturës në rajon që nga viti 2014 duke e trajtuar si pjesë të Procesit të Berlinit. Një total prej katër miliardë eurosh do të investohet në zgjerimin e energjisë dhe rrjeteve të transportit.

Autorët e studimit tregojnë se efekti i marrëveshjeve të mëparshme të tregtisë së lirë në rajon ishte shumë më i vogël për Serbinë sesa ishte rasti për pesë shtetet e tjera si Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Krejt kjo, sepse Serbia - e cila është ekonomikisht aq e fortë për sa i përket PBB-së sa të pesë shtetet e tjera së bashku - ka zgjeruar tregtinë e saj me BE-në, me theks

në vitet e fundit. Falë CEFTA-s, tregtia ndërrajonale u rrit me mbi 37%. Nëse Serbia do të përjashtohej nga llogaritja, ajo rritje ishte madje 70 %. [16]

Ndryshe nga Evropa Qendrore dhe Lindore përpara se të bashkoheshin më 2004, nuk kishte asnjë lulëzim në Ballkan - përveç ndoshta investimit të Fiat Chrysler në Serbi. “Gjeografia e armiqësisë”, siç i quajnë autorët e studimit tensionet e vazhdueshme politike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës dhe brenda Bosnjë-Hercegovinës, është vendimtare për mungesën e zhvillimit. Kjo e përforcon dobësinë ekonomike të rajonit, ky është argumenti kryesor.

“Serbia është në qendër të gjeografisë së armiqësisë, stimujt e saj për bashkëpunim të plotë rajonal janë të kufizuar”, theksohet në këtë studim. “Serbia ka probleme territoriale me shumicën e vendeve tjera në rajon, megjithëse në shkallë të ndryshme. E gjithë kjo çon në një shpërndarje shumë të njëanshme të pushtetit rajonal. Fqinjët e Serbisë janë dukshëm më të dobët në pothuajse çdo mënyrë, duke përfshirë popullsinë, fuqinë ushtarake dhe burimet e taksave shumë të vështira për ta arritur ekuilibrin rajonal, “[17] thotë studimi në fjalë.

Zhvillimi ekonomik i rajonit në çdo rast dëmtohet rëndë nga mosmarrëveshjet territoriale dhe bllokadat kushtetuese. Prandaj - pa ndonjë përparim në këto çështje - edhe iniciativat e bashkëpunimit rajonal të tilla si “Ballkani i hapur” nuk mund ta ndryshojnë thelbësisht situatën.

Shih për këtë, autorët e studimit propozojnë qasje më të mirë në buxhetin e BE-së, praninë në bashkimin doganor të BE-së dhe një zgjerim të marrëveshjeve të mëparshme me BE-në. Anëtarësimi në bashkimin doganor të BE-së do të nënkuptojë se shtetet do të duhej t’i barazojnë marrëveshjet e tyre doganore me ato të BE-së. Do të ishte gjithashtu pozitive që të hiqeshin barrierat tregtare. Pra, më shumë Evropë është e nevojshme në Ballkan, jo domosdoshmërisht më shumë ide për bashkëpunim rajonal, në mënyrë që të sigurohet që ekonomitë e varfra të arrijnë hapin me bllokun e prosperuar ekonomik të BE-së.

Zona e re Ballkani i hapur pretendohet të përbëhet nga Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina.

## ***Konkluzione***

Në fjalën e tij gjatë konferencës dyditore ndërkombëtare, Forumi i Prespës për dialog, kryeministri i Kosovës kërkoi që rajoni t’i rikthehet agjendës së integritimit evropian.

Në rast se BE-ja e shtyn tutje këtë agjendë, ka rrezik që rajoni të rrëshqasë sërish në kaos. Sipas studiuës Boris Varga, ekzistojnë katër faktorë kryesorë që ndikojnë në perspektivat e ardhshme të rajonit të Ballkanit Perëndimor:

- a) Ndryshimi i mjedisit të politikës së jashtme
- b) Problemi i dinamikave të brendshme politike
- c) *Faktori Rusi*
- d) *BE -ja dhe paradigma e re integruese [18]*

Për shkak të ngërçit në zgjerimin e BE -së, oferta e anëtarësimit në NATO tash për Kosovën është një lloj zëvendësimi real, por gjithsesi jo i plotë, në procesin integruës euroatlantik. Ndërkaq anëtarësimi në NATO i Malit të Zi dhe Maqedonisë do të duhej nënkuptuar si distancim nga Rusia. Por, ndër vendet që në vitin 2018 ishin objekt trajtimi e analize, vetëm në Maqedoni dhe Kosovë ekzistonte një konsensus i brendshëm social dhe politik në lidhje me anëtarësimin në Aleancë. Për Maqedoninë, anëtarësimi në NATO u dëshmuar se ishte edhe një faktor shtesë i stabilizimit dhe sigurisë.

Gjatë gjithë procesit të integrimit të Ballkanit Perëndimor në BE, për fat të keq, stabilokracia si fenomen që aplikuar si prioritet nga Brukseli. Ky fakt dëshmon se Brukseli shpesh ka aplikuar standarde të dyfishta në vlerësimin e demokratizimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor që po rezulton tashmë me minimin sistematik të demokracisë. Ballkani i hapur është produkt i atyre garniturave të papërgjegjshme politike, sidomos në Serbi dhe Shqipëri, që për kohë të gjatë, gjithsesi pa meritë, gëzonin mbështetjen e Brukselit zyrtar. Në vitet e ‘90-ta të shekullit të kaluar edhe Slobodan Milosheviqi që konsideruar si një faktor stabiliteti. Përfundimi dihet tashmë.

Me refuzimin e hapjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ndjenjat euroskeptike dhe madje edhe antievropiane mund të nxiten më tej në gjithë Ballkanin Perëndimor. Këtë fakt ndërkohë po e shfrytëzojnë autoritarët e tipit të Vuçiqit e Ramës, si në Serbi, ashtu edhe në Shqipëri. Nëse braktiset orientimi evropian, elitat politike të orientuara nga këta liderë autoritarë mund ta kthejnë fare lehtë rajonin në fillimvitet e dekadës së fundit të shekullit të kaluar. Në këtë rast, Serbia do të motivojë shpëputjen në Republikën Serbe, edhe përmes organizimit të një referendumi, ndërkaq Kosovën veriore edhe përmes një “blic krig-e”. Ajo llogarit gjithsesi në mbështetjen e Rusisë për këtë objektiv strategjik të saj.

“Lufta për kthimin e Kosovës nën sovranitetin e Serbisë do të jetë afatgjatë dhe e pasigurt. Ajo duhet e mund të bëhet vetëm përmes një strategjie bashkëpunimi dhe lufte permanente për ta zhvilluar një vetëdije politike autonome gjithandej te popujt e Ballkanit për nevojën për bashkëpunimin e tyre (riafirmimi i fjalëkalimit strategjik “Ballkani për popujt e Ballkanit” dhe “Evropa për evropianët”), duke

fituar kështu një lloj shprese për Evropën e së ardhmes dhe botës. Duke u bërë një vend i fortë ekonomikisht dhe në rrafshin kulturor, Serbia do të rifitojë reputacionin e saj politik dhe do të sigurojë riintegrimin demokratik në këtë gjeohapësirë”. [Dr Ljubiša Mitrović: 2018]

Prandaj iniciativën, respektivisht projektin tashmë të koduar si “Open Balkan” duhet kuptuar si një lloj fjalëkalimi strategjik të Serbisë drejt “Botës serbe”.

Më qartë nuk ka se si thuhet se në themel të projektit “Ballkani i hapur” është pikërisht kjo strategji e përpunuar nga institucionet shkencore serbe në shërbim të politikës.

Rritja e fluiditetit gjeopolitik të Serbisë, në njërën anë, që karakterizohen me raporte të mira qoftë me Moskën, qoftë me Brukselin, por po aq të afërta edhe me Pekinin, dhe, në anën tjetër, profilimi i saj si shtet autoritar, që nënkupton intensifikimi i politikave të forta shtetërore, i kanë imponuar Qeverisë serbe të marrin masa shtesë për t’i zvogëluar rreziqet që lidhen me “ndërveprimet ekonomike ndërmjet shteteve, të cilat kanë përdorur gjithmonë mjete të politikës ekonomike dhe të diplomacisë për të ndjekur qëllimet e tyre gjeopolitike”. [19]

Në kontekstet e analizave gjeopolitike, indikatorët ekonomikë zënë një vend të rëndësishëm në vlerësimin e fuqisë së shtetit.

Interesave jetike të Kombit duhet t’i nënshtrohen interesat tjera politike e ekonomike. Politikat e dy republikave tona (Shqipërisë politike dhe Republikës së Kosovës), duke marrë në konsideratë edhe interesin ekonomik të secilës veç e veç e të që të dyjave tok, janë të shtrënguara të balancojnë midis interesave gjeostrategjike të integritit euroatlantik të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara, që janë partneri ynë kryesor gjeostrategjik, dhe interesave të veta jetike. Procesi i Berlinit, duke qenë në përputhje me interesat gjeostrategjike shqiptare, nuk bie ndesh as me interesat ekonomike të akëcilës palë ndërshqiptare. Përkundrazi, ato përputhen plotësisht.

Udhëheqja e Tiranës aktualisht është e ndarë ndërmjet gjeopolitikës dhe fitimit (nën ndikimin e presionin e oligokratëve), strategjive kryesore gjeopolitike të përbaljes së Kosovës me Serbinë, dhe nevojave për të siguruar rritje të vazhdueshme ekonomike.

Ajo duhet të gjejë rrugëdalje nga iniciativa e pagëzuar tashmë si “Open Ballkan” dhe t’i kthehet interesit jetik kombëtar.

Duke pasur parasysh realitetet e reja në botë, para së gjithash në Evropën Perëndimore dhe atë Juglindore, Shqipëria dhe Kosova duhet t'i ripërkufizojnë prioritetet e politikës së jashtme tok. Këto prioritete para së gjithash duhet të përqendrohen e të koordinohen në mbrojtje të interesit kombëtar.

Shqipëria politike tashmë është pjesë integrale e aleancës politiko-ushtarake më të madhe në historinë e njerëzimit - në NATO. Kosova aktualisht është nën suzerenitetin e Perëndimit (SHBA-ve dhe partnerëve të saj tradicionalë). Këtë fakt duhet shfrytëzuar në maksimum.

---

### ***Fusnotat***

1. Boris Varga: <https://pescanik.net/zapadni-balkan-geopolitika-nedovrsenih-drzava/>
2. <https://internationalepolitik.de/de/russlands-energie-europas-achillesferse>
3. <https://www.welt.de/politik/ausland/article232902687/Energiewende-Litauens-Erfolg-kann-fuer-Deutschland-eine-Lehre-sein.html>
4. <https://www.slobodnaevropa.org/a/vulin-vu%C4%8Di%C4%87-srpski-svet/31366884.html>
5. Dita, 7 gusht 2021  
<http://www.gazetadita.al/raportet-mes-moskes-dhe-beogradit-janusz-bugajski-vucic-mund-te-nxitet-drejt-nje-konfrontimi-ushtarak-ndaj-fqinjeve-ne-ballkan/>
6. <https://www.youtube.com/watch?v=zWBdiar6iH0>
7. <https://www.etiasvisa.com/etias-news/mini-schengen-balkans>
8. Shih: Emin Azemi, Fakti, 31 korrik 2021
9. <https://www.youtube.com/watch?v=AhHqopkTDS0>
10. Shih: “*eadaily.ru*”, 31 korrik 2021
11. Adelheid Wölfl: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>
12. <https://www.glasistre.hr/svijet/vucic-kritizira-eu-kaze-da-je-otvoreni-balkan-povijesna-prilika-za-cijelu-regiju-737408>
13. Shaban Murati: <https://www.ishgj.org/gjeopolitika-rajonale/gjeopolitika-postmoderne-serbe-dhe-endrra-per-dalje-ne-adriatik/>
14. Po aty
15. Adelheid Wölfl: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>
16. Po aty: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>
17. Po aty: <https://www.derstandard.at/story/2000121343070/wenig-begeisterung-fuer-mini-schengen-statt-eu-beitritts-auf-dem>
18. Boris Varga: <https://pescanik.net/zapadni-balkan-geopolitika-nedovrsenih-drzava/>
19. Rovena ALIRAJ, tema e disertacionit me titull: “GJEOPOLITIKA SERBE NË MIJËVJEÇARIN E RI: NDIKIMI I SAJ NË SIGURINË BALLKANIKE DHE HAPËSIRËN SHQIPTARE”  
[https://tradoc.mil.al/images/DOKTORATURAT/Doktoratura\\_Rovena\\_ALIRAJ\\_.pdf](https://tradoc.mil.al/images/DOKTORATURAT/Doktoratura_Rovena_ALIRAJ_.pdf)

### 1.3. Ballkani i hapur dhe BALLKANISTËT e kapur

Tematika diplomatike serbo-ruse në spektaklin e 11 tetorit u fiksua në goditjen e Kosovës, të BE dhe të SHBA, pra në një strategji të lexueshme antiperëndimore dhe antiatlantike.



#### **Shaban MURATI, ambasador**

Në 11-12 tetor, Serbia dhe Rusia organizuan në Beograd ceremoninë jubilarë të 60 vjetorit të mbledhjes së parë të shteteve anëtare të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”, mbajtur në 1961 në ish-kryeqytetin jugosllav. Serbia si shtet i ri i pranuar në OKB në fund të vitit 2000 nuk ka asnjë lidhje me “Lëvizjen e të Paangazhuarve” dhe nuk është as shtet themeluese i asaj lëvizje politiko-diplomatike të viteve 60.

Madje, me gjithë pompën e madhe të ceremonialit të 11 tetorit, Serbia nuk është sot as shtet anëtar i “Lëvizjes së të Paangazhuarve”. Ajo është thjesht shtet vëzhgues siç është Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, etj. të cilat gjithashtu kanë pasur Beogradin kryeqytet në vitin 1961. Por Serbia dhe Rusia u mobilizuan së bashku që të spekulojnë me qytetin, ku u mbajt para 60 vitesh mbledhja e parë e “Lëvizjes së të Paangazhuarve” dhe organizuan një forum diplomatik përkujtimor.

Është diçka komike që Serbia organizon një veprimtari të kushtueshme diplomatike vetëm pse Beogradi ishte në vitin 1961 kryeqyteti, ku u mbajt

mbledhja e parë e kryetarëve të shteteve dhe të qeverive të vendeve të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”. Është njësoj sikur Irani të celebronte përvjetorët e samitit të famshëm të Ruzveltit, Stalinit dhe Çerçilit në Teheran në mesin e Luftës së Dytë Botërore në nëntorin e vitit 1943, vetëm pse u mbajt në kryeqytetin e Iranit.

Serbia dhe Rusia bashkë shpikën një pretekst dhe harxhuan goxha para për të organizuar një forum ndërkombëtar si një spektakël diplomatik, që do ta shfrytëzonin për qëllimet e tyre diplomatike dhe strategjike. Në thelb Rusia është organizatori në prapaskenë i forumit përkujtimor dhe diplomacia ruse u angazhua fort që të bindte shumë shtete të Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine, që të shkonin në atë spektakël serbo-rus. Ministri i jashtëm rus, Sergej Lavrov, që përfaqësoi Rusinë për herë të parë në atë ceremonial, ishte de facto mikpritësi i forumit, dhe ministri i jashtëm serb Nikola Selaković e pohoi në 11 tetor kur deklaroi se “emri i Lavrovit forcon karakterin dhe nivelin e këtij samiti”.

Zyrtarisht Rusia nuk është shtet anëtar i “Lëvizjes së të Paangazhuarve” dhe nuk mund të mos tingëllojë i mjerë servilizmi i shefit të diplomacisë serbe, që zbulon se samitin e forcon ministri i jashtëm rus dhe nuk e forcuakan disa kryetarë shtetesh të disa vendeve afrikane, që morën pjesë dhe që janë ndër shtetet themeluese të “Lëvizjes së të Paangazhuarve” si Gana.

Ministri i jashtëm rus Lavrov diktoi intonimin politik të ceremonialit përkujtimor të Beogradit dhe për këtë zhvilloi me urgjencë një takim kokë më kokë më presidentin e Serbisë Vuçiq të dielën në mbrëmje në 10 tetor, dhe mbajtën edhe një konferencë të përbashkët shtypi, ku u ravijëzua tematika dhe interesi qendror i diplomacisë serbe dhe ruse në organizimin e ceremonialit përkujtimor të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”.

Tematika diplomatike serbo-ruse në spektaklin e 11 tetorit u fiksua në goditjen e Kosovës, të BE dhe të SHBA, pra në një strategji të lexueshme antiperëndimore dhe antiatlantike.

Diplomacia ruse po manifeston një aktivizim të jashtëzakonshëm diplomatik dhe diversiv në të gjitha organizatat dhe organizmat ndërkombëtare, qofshin aktive ose formale. Në këtë kuadër ajo po i kushton vëmendje të veçantë edhe veprimtarisë së saj në gjirin e “Lëvizjes së të Paangazhuarve”, e cila ndonëse është shndërruar në një lëvizje formale, ka të regjistruar 120 shtete anëtare.

Kjo Lëvizje është reduktuar në një NGO gjigande diplomatike ndërkombëtare, që nuk ka asnjë mandat, ndikim apo forcë angazhuese dhe detyruese ndaj

anëtarëve, por thjeshtë mblidhen një herë në tre vjet për të mbajtur fjalime secili shtet-anëtar . Por “Lëvizja e të Paangazhuarve” me 120 shtetet anëtare përfaqëson një audiencë të madhe dhe të lartë diplomatike dhe me shumë interes për të parashtruar qëndrimet dhe synimet dhe natyrisht për të krijuar ndikim, kur është rasti për shtete të fuqishme si Rusia.

Ndaj Serbia dhe Rusia angazhuan forca, përpjekje dhe para për të grumbulluar personalitete politike në ceremonialin përkujtimor të 11 tetorit në Beograd me pretekstin e mbledhjes së parë të kësaj Lëvizje 60 vjet më parë në kryeqytetin jugosllav.

Moskës i duhet “Lëvizja e të Paangazhuarve” si forum dhe instrument për të shtrirë praninë dhe ndikimin e politikës së jashtme ruse në shtetet e Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine, dhe për t’u paraqitur sikur Rusia tani ka përfaqëuar frymën dhe idetë themeluese të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”. Gazeta e njohur ruse “Komersant” shkruante më 11 tetor”.

Interesimi i rritur i Rusisë për “Lëvizjen e të Paangazhuarve” nuk është i rastit. Rusia mori statusin e vëzhguesit në korrik. Në Ministrinë e Jashtme të Rusisë këtë angazhim e quajnë “shembull i qartë i afërsisë së qëndrimeve të vendit tonë dhe të “Lëvizjes së të Paangazhuarve” në shumë probleme globale”. Duket qartë që Moska po intensifikon përpjekjet që të ndërhyjë në “Lëvizjen e të Paangazhuarve” dhe ta orientojë në drejtimet, që do ajo, dhe në radhë të parë që ta nxisë kundër Perëndimit.

Në konkretizim të kësaj strategjie Rusia u kujtua pas 60 vitesh të kërkojë të hyjë në “Lëvizjen e të Paangazhuarve” dhe në korrik të këtij viti u pranua si shtet vëzhgues, në kohën që presidencën e Lëvizjes e ka Azerbajxhani, gjë që ishte një rrethanë e favorshme për Moskën. Ministri i jashtëm rus Lavrov, që përfaqësoi Rusinë në forumin përkujtimor të Beogradit, mbajti vetë fjalim dhe lexoi gjithashtu atje edhe një mesazh të posaçëm drejtuar Lëvizjes nga presidenti rus Vladimir Putin, gjë që flet për rëndësinë që Moska po i jep asaj Lëvizje për interesat e veta. Lavrovi elaboroi tezat e njohura antiperëndimore të diplomacisë ruse për “luftën kundër blloqeve”, për kundërshtimin e “rendit të ri ndërkombëtar me rregulla të vendosura” etj.

Shtypi rus njoftonte me këtë rast se “Rusia bashkohet me të Paangazhuarit”. Është vërtetë ironi që Rusia, shteti i angazhuar në kulm, që përfaqëson një bllok ushtarak si CSTO, aspiron të bëhet superfuqi dhe të vendosë influencën e saj në gjithë rajonet e detet e botës, e paraqet veten si ithtar i mosangazhimit politik e diplomatik. Se sa mund të përputhet Rusia e sotme me vizionin dhe moton themeluese të “Lëvizjes së të Paangazhuarve” për vijën “jashtë



blloqeve”, këtë mund ta shpjegojnë vetëm ata, që e pranuan Rusinë si shtet vëzhgues, duke harruar se Rusia ndërmori agresion kundër Gjeorgjisë në vitin 2008 dhe i shkëputi disa territore, dhe në vitin 2014 ndërmori agresion kundër Ukrainës, duke i aneksuar me dhunë Krimenë dhe mbajtur të pushtuara ende sot e kësaj dite rajonet lindore ukrainase.

Një nga objektivat kryesore të diplomacisë së Serbisë dhe të Ruisë në organizimin e mbledhjes përkujtimore të “Lëvizjes së të Paangazhuarve” në Beograd ishte goditja e shtetit të pavarur të Kosovës, si dhe e SHBA dhe e Perëndimit, të cilët mbështesin shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës.

Grumbullimi diplomatik në Beograd ishte përpjekje e diplomacisë serbe dhe ruse për të shkallëzuar ofensivën e tyre të egër kundër njohjeve ndërkombëtare të shtetit të Kosovës dhe për të nxitur aktet e njëanshme absurde të tërheqjes së njohjeve të shtetit të Kosovës. Shumica ndër ato rreth 120 shtete anëtare të OKB, që e kanë njohur Kosovën, janë nga vendet që bëjnë pjesë në “Lëvizjen e të Paangazhuarve”, sikundër ndër shtetet, që nuk e kanë njohur ende Kosovën, shumica janë gjithashtu nga vendet anëtare të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”.

Ndaj Kosova ishte një nga arsyet kryesore të angazhimit të sforcuar të diplomacisë serbe dhe ruse për organizimin e një takimi diplomatik ndërkombëtar me pretekstin absurd të mbajtjes së mbledhjes themeluese të Lëvizjes, kur Serbia nuk ekzistonte si shtet në atë kohë. Fokusimin kundër Kosovës e sinjalizoi ministri i jashtëm rus Lavrov në konferencën e tij të shtypit me presidentin serb në Beograd në mbrëmjen e 10 tetorit, disa orë para hapjes së ceremonisë përkujtimore, me sulme dhe kërcënime ndaj shtetit të Kosovës, duke proklamuar tezat absurde që Rusia do të përkrahë vetëm zgjidhjen që i intereson Serbisë dhe kjo zgjidhje duhet të miratohet nga Këshilli e Sigurimit të OKB, ku Rusia e ka të drejtën e vetos.

Është e lexueshme se qëndrimi i Ruisë është kundër zgjidhjes së konfliktit dhe normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, përderisa shpall zyrtarisht se Moska përkrah vetëm zgjidhjen që i intereson Serbisë, pra vetëm njërës palë, aleatit të saj strategjik

Temat e konferencës së shtypit të Lavrovit kundër Kosovës presidenti serb Vuçiq i bëri platformë të fjalimit të tij para audiencës diplomatike të përfaqësuesve të vendeve të “Lëvizjes së të Paangazhuarve”. Vuçiq e bëri Kosovën objektivin kryesor të fjalës se tij, sepse diplomacia serbe dhe ruse kanë nevojë të shtrembërohet e vërteta e realiteteve të problemeve dhe e dialogut mes Serbisë dhe Kosovës në Bruksel. Me një ton emfatik presidenti

serb deklaroi në ceremonial se “ Beteja më e dhimbshme është të zgjidhim çështjen e Kosovës dhe të mbrojmë integritetin territorial të vendit. Serbia është e angazhuar për kompromis që të ruajë sigurinë në rajon”.

Me sa duket presidentit serb duhet t’i jenë dhënë informacione jo të sakta sikur shumë shtete të Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine nuk e dinë se çfarë bëhet në Ballkan e as për dialogun midis Serbisë dhe Kosovës në Bruksel dhe ata mund t’i rresh si të duash, meqë siç ka thënë ish-presidenti serb Dobrica Qosiq “rrena është virtyt i serbëve”. Vuçiçi, Lavrovi, diplomacia serbe dhe ruse mendojnë se vendet e Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, nuk e dinë se pavarësia e Kosovës nga Tribunali më i lartë juridik i OKB, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me vendimin e datës 22 korrik 2010 është shpallur se përputhet me ligjin ndërkombëtar dhe me rezolutën 1244 të KS të OKB.

Tribunali juridik i OKB u vu në veprim pas kërkesës së rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ku janë anëtarë të gjithë vendet e “Lëvizjes së të Paangazhuarve”.

Në të vërtetë Serbia dhe Rusia tallen edhe me “mosangazhimin” e tyre, edhe me “Lëvizjen e të Paangazhuarve”, sepse pikërisht në 11 tetor, ditën e hapjes së mbledhjes përkujtimore të 60 vjetorit të “Lëvizjes së të Paangazhuarve” dhe kur presidenti serb dhe ministri i jashtëm rus po mbanin në mbledhjen e madhe fjalimet patetike për dashurinë e re të vendeve të tyre për “mosangazhimin”, në Serbi nisën manovrat e përbashkëta ushtarake të forcave ajrore të Serbisë dhe të Rusisë të koduara “Bars 21”. Dy shtetet e “paangazhuara”, Serbia dhe Rusia, përshëndetën audiencën diplomatike të të paangazhuarve me vringëllim të ri armësh dhe gjuajtësit e tyre fluturonin në qiellin e Beogradit mbi ndërtesën, ku po mbahej mbledhja e zhurmshme përkujtimore e “mosangazhimit”. Madje presidenti serb po i deklaronte audiencës diplomatike se “Ne jemi krenarë, që jemi shtet neutral ushtarakisht”. Sipas të dhënave të Ministrisë serbe të Mbrojtjes, vetëm në vitin 2019, Rusia dhe Serbia kanë zhvilluar 96 manovra ushtarake të përbashkëta.

Ndërkaq ministri i jashtëm rus zgjodhi këtë moment për t’i drejtuar nga Beogradi Bashkimit European mesazhin e qartë se Serbia është e lidhur me Rusinë dhe jo me BE. Disa herë gjatë qëndrimit të tij në Beograd Lavrovi theksoi me forcë “partneritetin e veçantë strategjik midis Rusisë dhe Serbisë”. Mesazhi diplomatik rus drejtuar BE-së ishte se Moska po avancon me shpejtësi në forcimin e varësisë së Serbisë nga Rusia dhe se është iluzore shpresa e BE se Serbia do të shkojë te Evropa.

“E dimë prej kohësh se BE pretendon për Ballkanin Perëndimor dhe thotë se vendet e tjera nuk kanë çfarë kërkojnë këtu. Ky është qëndrim neokolonialist”,- deklaroi ministri i jashtëm rus në Beograd, dhe hodhi poshtë akuzat se Rusia po ndërhyr në punët e brendshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe u kërkoi gazetarëve në konferencën e shtypit që t’i sillnin prova për këtë ndërhyrje. Sipas tij nuk janë prova dënimi nga gjykatat në Mal të Zi të oficerëve të shërbimit sekret rus, që u dënuan me burgim për organizimin prej tyre bashkë me shërbimin sekret serb të grushtit të dështuar të shtetit në Podgoricë në tetor 2016.

Nuk janë prova sipas tij deklaratat e panumërta të presidentit të Malit të Zi, që denoncon ndërhyrjen e Ruisë në punët e brendshme të Malit të Zi. Nuk janë prova sipas tij ndërhyrjet ruse në Bosnje-Hercegovinë, ku po nxitet prej Moskës udhëheqësi fashist Dodik i Republikës Serbe që të bojkotohen institucionet qendrore të shtetit, të krijohet ushtri e veçantë serbe e Banja Llukës saj dhe të zhvillohet referendum për bashkimin me Serbinë.

Nuk janë prova sipas tij ndërhyrja publike dhe inspektimi i ambasadorit rus në Beograd dhe i gjeneralëve rusë të forcat serbe të ndërhyrjes të dislokuara në kufirin me Kosovën gjatë tensioneve të provokuara nga Beogradi në Veriun e Kosovës në muajin shtator.

Lavrovi nuk i quan ndërhyrje të Ruisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, sepse diplomacia ruse e konsideron Ballkanin Perëndimor zonë dhe e drejtë e influencës së Serbisë. Jo rastësisht zëdhënësja e MPJ të Ruisë, Maria Zaharova, në 10 tetor mori zyrtarisht në mbrojtje projektin serb të “Ballkanit të hapur” dhe projektin tjetër hegjemonist serb “bota serbe” të bashkimit të të gjithë serbëve të Ballkanit Perëndimor në një shtet, sepse sipas saj “bota serbe nuk është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar”.

Serbia dhe Rusia tallen me “mosangazhimin” dhe me “Lëvizjen e të paangazhuarve”, siç tallen edhe me “Ballkanin e hapur” dhe me ballkanistët e kapur. Diplomacia serbe dhe ruse guxojnë deri në këtë shkallë, kur janë të bindur se kanë përpara kryetarë shtetesh apo qeverish të inamoruara me veten dhe jo me shtetin dhe me popullin e tyre.

## 1.4. Ballkani i hapur, varianti ekonomik i ‘Botës Serbe’



### **Dr. Lisen BASHKURTI**

Ndonëse u bënë disa vjet dhe janë konsumuar disa samite trepalëshe sërish nisma “Ballkani hapur” vazhdon të ngelet thjeshtë një trojkë Ballkanike. Nisma është iniciuar nga Serbia, në të njëjtën kohë me idenë e “Botës Serbe”. Për këtë arsye nisma “Ballkani hapur” tingëllon si një ribrandim i doktrinës gjeopolitike Serbe në Ballkan. Nisma ‘Ballkani hapur’ është variant ekonomik i “Botës Serbe’. Është pikërisht kjo arsyeja që nisma ka ngjallur një skepticizëm të madh dhe të pandryshueshëm prej vitesh.

Nisma “Ballkan i hapur” ka nisur e tkurrur, e fragmentuar dhe me paqartësi në perspektivën dhe shtrirjen e saj. Këto dobësi të nismës burojnë para së gjithash dhe në krye të të gjithave për shkak të mos mbështetjes së saj në shumë nivele: në nivele kombëtare, rajonale, Evropiane dhe ndërkombëtare.

### ***1. Mbështetje okulte jo kombëtare***

Nisma “Ballkan i hapur” ka nisur nga Beogradi dhe është mbështetur në mënyrë okulte nga dy kryeministrat, të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, Rama dhe Zaev. Në Shqipëri nisma “Ballkan i hapur” filloi gati-gati si një iniciativë konspirative. Ajo nuk u parapri dhe as nuk u shoqërua me paraqitje të hapur transparente në Kuvendin e Shqipërisë, në Komisionin e Politikës së Jashtme të tij, nuk iu nënshtrua debateve publike dhe konsultave me grupet e interesit. Gjithçka ndodhi si një rrufe në qiell pa re. Akoma më tej nisma ”Ballkan i hapur” nuk u parapri me bisedime, dialog e negocime me

Qeverinë e Kosovës, partneriteti me të cilën ka qenë e ngelet strategjik për Shqipërinë.

Në historinë e tranzicionit demokratik të Shqipërisë ka pasur një traditë shumë të mirë. Politika e jashtme e vendit është mbështetur kurdoherë në konsensus. Orientimi Euro-Atlantik, integrimi Evropian, politika e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimi rajonal kanë pasur një mbështetje të gjerë dhe të qëndrueshme konsesuale në politikën shqiptare.

Shqipëria ka marrë pjesë aktivisht në gjithë nismat Rajonale si Pakti i Stabilitetit, Bashkëpunimi Ekonomik e Detit të Zi, Nisma e Evropës Qendrore, Bashkëpunim i Evropës Juglindore, Karta e Adriatikut, Nisma Adriatiko-Joniane - që në tërësinë e tyre i kanë shërbyer në mënyrë të drejtë e të barabartë vendeve të Rajonit tonë për paqen, stabilitetin, demokracinë, zhvillimin, prosperitetin social-ekonomik dhe integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik. Të gjitha këto nisma janë zhvilluar nëpërmjet proceseve dhe procedurave të hapura, me qëllime të qarta, objektiva të përcaktuara, projekte zhvillimore të dakorduara, plane veprimi, paketa financiare fizible dhe kështu kanë siguruar mbështetje politike konsesuale në nivele nacionale. Në analizë të fundit gjithë këto nisma i kanë shërbyer përgatitjes së vendeve të rajonit për integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik.

Konsesusi politik kombëtar i siguron nismave të tilla perspektivë, qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Nisma “Ballkani Hapur”, e iniciuar nga Serbia, si variant ekonomik i “Botës Serbe”, dhe e mbështetur në mënyrë okulte nga dy kryeministrat e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, Rama dhe Zaev nuk ndoqi proceset dhe procedurat e hapura e transparente të nismave paraardhëse rajonale. Kështu që “Ballkani i hapur” nuk gjeti mbështetje politike konsesuale as në vendet që iu bashkuan nismës. Me këtë nisma “Ballkani i hapur” ka vënë në dyshim perspektivën, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e saj.

## ***2. Mbështetje fragmentare, jo rajonale***

Nisma në fjalë e ka emrin “Ballkan i hapur”, por në fakt duket të jetë thjesht një trojkë ballkanike, e asgjë më shumë. Është një asimetri e vërtetë midis emrit të lansuar dhe realitetit brenda nismës. Është i njohur përcaktimi biblës kur thotë se “mënyra sesi vijmë në këtë botë, përcakton edhe mënyrën sesi largohemi prej saj”.

Nisma “Ballkani i hapur” nisi si shumica e nismave tradicionale Ballkanike, midis konspiracionit e publicitetit. Ajo u lansua pothuajse paralelisht me nisëm

e “Botës Serbe”, e cila është parashtrimi në emër të ri të një doktrine të vjetër të Serbisë së Madhe. ‘Bota Serbe’ është vazhdimi në realitetet të reja të doktrinës së Naçertanies të Ilia Garashaninit, të doktrinës së “Përzënies të Shqiptarëve” të Vasa Çubriloviqit, të doktrinës së Ivo Andriqit, të Memorandumit SANU të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë dhe së fundmi të doktrinës së Slobodan Milosheviqit dhe pasuesve bashkëkohor të tij.

Lansimi i ‘Ballkanit të hapur’ paralelisht me “Botën serbe” lypet të vihet në një kontekst të gjerë Ballkanik. Serbia siç do shtet tjetër, nuk mund të ketë dy politika të jashtme. Serbia ka një dhe vetëm një politikë të jashtme. Ajo mishërohet në qëllimin e saj për restaurimin e pozitave të Serbisë në Ballkan me anë të disa rrugëve.

Së pari, nëpërmjet bllokimit të Kosovës dhe nxitjes së minoritetit Serb në Veri dhe në komunat me shumicë Serbe, me anë të projektit të asociacionit të tyre. Së dyti, nëpërmjet politikave separatiste të Republikës Serbe, të udhëhequr nga nacionalisti Dodik në Bosnjë-Hercegovinë. Së treti, nëpërmjet nxitjes së nacionalizmit pro-Serb në Mal të Zi. Së katërti, nëpërmjet mbështetjes në prapavijë të Kishës Ortodokse Serbe si një organizatë politike dhe jo klerikale thellësisht nacionaliste në gjithë zinxhirin e vendeve përreth Serbisë. Së fundi, nëpërmjet mbështetjes së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë dhe elaboreteve të tyre të bazuara në mite manipulative të historisë dhe identitetit të Serbisë kudo në botë.

Skepticizmi i thellë rajonal kundër nismës ‘Ballkani i hapur’ është në fakt skepticizëm i qartë dhe i dukshëm kundër doktrinës restauratore të “Botës serbe” në kushtet e rendit bashkëkohor. Qëndrimet e Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Kosovës kundër kësaj nisme janë na fakt qëndrime mos aprovuese për doktrinën e “Botës serbe”. Të tri këto vende kanë bashkëjetuar thuajse një shekull me Serbinë në kuadër të Jugosllavisë. Ato e njohin politikën e Serbisë më mirë se kushdo tjetër në Ballkan. Kundërshtimi i tyre duhet dëgjuar me kujdesin më të madh dhe lypet të merret seriozisht në konsideratë.

Shumëçka ka ndryshuar në Ballkan. Vetëm Serbia ka ndryshuar fare pak. Kushtetuta e Serbisë është e mbështjellë plotësisht me doktrinën e “Botës serbe”, ose e thënë ndryshe e nacionalizmit serbo-madh. Politikat publike bazë të Serbisë synojnë mbështetjen e projekteve nacionaliste Serbe. Presidenti Vuçiq, Qeveria Bërnabiq, Parlamenti serb me Daçiq, në kohezion të plotë mbështesin një tërësi politikash që synojnë zgjerimin e pranisë dhe të influencave Serbe në Ballkan. Pakicat e huaja brenda Serbisë marginalizohen,

eksterminohen, injorohen nga çdo proces politikë-bërje e vendim-marrje me rëndësi. Kjo duket më qartësisht se kudo në Luginën e Preshevës. Nga ana tjetër, pakicat Serbe rreth e rreth Serbisë nxiten për mosbindje politike, ligjore e civile ndaj shteteve ku janë dhe për separatizëm pro Beogradit.

Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina e ndjejnë më shumë se kushdo tjetër këtë politikë gravitacionale etnocentriste të Beogradit. Projekti 'Ballkan i hapur' synon që para së gjithash të mbështetë këtë rrjet pakicash serbe kudo në Ballkan nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturës ekonomike e tregtare, projekteve të hapura për fuqizimin e tyre dhe infiltrimin në punët e brendshme të shteteve Ballkanike. Atë që Serbia e bën hapur në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë e Mal të Zi, synon ta bëjë në mënyrë tërthore e të padukshme ose sa më pak të dukshme edhe në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut nëpërmjet "Ballkanit të hapur".

Për të gjitha këto arsye tre shtetet e Ballkanit Perëndimor, pra gjysma e Rajonit, nuk e mbështesin këtë nismë, janë skeptik ndaj Serbisë dhe kundërshtojnë një "hapje" të tillë me një shtet që ka tendenca të dukshme resturatore të doktrinës së Serbisë së Madhe. Për vlerësimin e politikës së jashtme të një shteti nuk ka gjithaq rëndësi se çfarë deklaron në retorikën e vet politike ai shtet, por në mënyrën sesi ai vepron e sillet me fqinjët e shtetet e rajonit përreth. Serbia ka një dyzim fare të qartë midis asaj që deklarohet dhe asaj që vepron dhe sillet me fqinjët e saj dhe vendet e Ballkanit në tërësi.

### ***3. Ambiguitet evropiane, jo mbështetje e BE***

Bashkimi Evropian është përballë një sfide të vërtetë në politikat e zgjerimit ndaj Ballkanit Perëndimor. BE-ja e ka bërë të qartë me deklarata, me veprime, me sjellje, me projekte dhe financime të konsiderueshme se është për integrimin e Ballkanit Perëndimor në organizatë.

Pavarësisht kësaj mbështetje Evropiane, sërish vendet e Ballkanit Perëndimor po ecin ngadalë në procesin e integritimit. Ato po ndeshen me probleme të shumta që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, mirëqeverisjen, të drejtat e njeriut, ekonominë e tregut dhe politikat e fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit Rajonal. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimorë kanë probleme në këto aspekte. Përveç këtyre problemeve, Ballkani Perëndimor ka në qendër një shtet që është shumë evaziv në pranimin e adoptimin e vlerave Perëndimore të demokracisë liberale. Ky shtet është Serbia. Serbia është pengesa kryesore e integrimeve evropiane dhe euroatlantike të Ballkanit Perëndimor. Prapa Serbisë është doktrina gjeopolitike e Federatës Ruse. Serbia mbas ngjarjeve të viteve '99 u deklarua se do orientohej tërësisht drejt Bashkimit Evropian, sikundër do të qëndronte në neutralitet ndaj politikave

strategjike të NATO-s. Ndërkohë, fare pak vite më vonë, Serbia bëri një kthesë të plotë në prioritetet e saj në politikën e jashtme. Ajo adoptoi shumë shpejt një politikë të jashtme dy-vektorëshe, Euro-Ruse, si në planin politik, ashtu edhe atë ekonomik e strategjik.

Sot Serbia është vokacioni Evropian në Kremlin dhe vokacioni Rus në Evropë. Akordi Serbo-Rus tanimë dëgjohet gjithandej. Kjo, sepse edhe Rusia ka bërë ndryshime të mëdha gjeopolitike e gjeostrategjike. Pas viteve '90-të, presidenti Jelcin pati deklaruar se Rusia do të ndiqte një qasje rajonale në politikat ndaj Ballkanit. Por, me të ardhur në Kremlin Presidenti Putin, Federata Ruse u deklarua se do ndiqte politika të prioritizimit individual në Ballkan, duke pasur parasysh Serbinë. Rusia, iu kthye kështu doktrinës së vjetër gjeopolitike drejt Ballkanit, të bazuar në aleancën me Serbinë, popullin sllav dhe ortodoks serb. Kjo politike prioritare e individualizuar Ruse me Serbinë duket si në projektet e përbashkëta politike, diplomatike, strategjiko-ushtarake dhe ekonomike midis Serbisë dhe Ruisë, por duket gjithashtu edhe në mbështetjen që Rusia po i bën politikës së Republikës Serbe në Bosnjë-Hercgovinë dhe personalisht nacionalistit Dodik, në ndërhyrjen pa precedent në Malin e Zi dhe në bllokimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Gjithçka në Beograd po merr pamjen e Ruisë së Vogël.

I vënë në një situatë kritike dhe komplekse, Bashkimi Evropian po përpiqet me 'stick and carrot' ta mbajë Serbinë në track-un e vet integruar. Pas vitit '99, Bashkimi Evropian po përpiqet të ri-ekuilibrojë politikat e tij në nivel Rajonal. Thellimi procesit të integrimit me avancimin e kapitujve të tjerë për Serbinë, po dëshmon se Bashkimi Evropian si 'soft power' po dëshmon se po rritë praninë dhe ndikimin e tij në tërë Rajonin. Integrimi në BE vazhdon të konsiderohet si projekti magjik për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në të njëjtën kohë, BE vijon të rrisë politikat e presionit që Serbia të mbështesë evropianizimin e saj dhe të reduktojë rusifikimin. Karta e njohjes së Kosovës nga BE dhe shtetet anëtare të saj bie gjithnjë si kampanë alarmi mbi Beogradin. Por, frika në BE se Serbia mund të shndërrohet në 'Kalë Troje' të Ruisë brenda BE është e dukshme, por, ama, diplomacia e BE din fare mirë të fshehtë këtë frikë me ngjyra e tone optimiste.

Diplomacia e BE duket edhe na qasjen ndaj nismës së "Ballkanit të hapur". Institucione dhe personalitetet të ndryshme brenda BE kanë mbajtur e mbajnë qëndrime kontraverse ndaj kësaj nisme çka do të thotë se BE nuk e mbështetë nismën. Për një kohë të gjatë "Ballkani i hapur" u konsiderua nga zërat e BE si përpjekje për gjetjen e një alternative të integrimit në BE. Më pas u shtuan zërat që vendet e Ballkanit Perëndimor duheshin fokusuar në Procesin e Berlinit si një projekt i BE ndaj Ballkanit Perëndimor. Kohët e fundit nga



Brukseli zyrtar kemi dëgjuar qartësisht definicionin sipas të cilit “Ballkani i hapur” “nuk është një nismë e shëndetshme”. Ndërsa në samitin e fundit të Tiranës, komisionari për Zgjerimin i BE, Varhelhy u shpreh se e admironte këtë nismë dhe apeloj që vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor t’i bashkëngjiten nismës.

Por, në mënyrën më të drejtpërdrejtë dhe pa kurrfarë ambiguiteti diplomacia e BE flet me zërin e Berlinit zyrtar për nismën “Ballkani i hapur”. Qeveria e re Gjermane e Olaf, u deklarua në të njëjtën linjë me qeverinë paraardhësi të Merkelit lidhur me “Ballkanin e hapur”. Qeveria Olaf u shpreh qartazi se nuk mbështet “Ballkanin e hapur”, por Procesin e Berlinit, i cili është një investim i drejtpërdrejtë i BE për të përgatitur Ballkanin Perëndimor me tregun e saj si dhe për të siguruar një konektivitet rajonal dhe midis rajonit dhe organizatës. Pra, diplomacia e BE nuk mbështet mbivendosje nismash rajonale përveç atyre të iniciuara dhe të financuara prej saj.

Me këto qëndrime variable BE vetëm e ka rritur skepticizmin e mëtejshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor për t’iu bashkuar ‘Ballkanit të hapur’. Në thelb politikat e BE maten jo me deklaratat shumëngjyrëshe të diplomacisë së saj, por me paketën financiare që mbështet këto politika. Deri tani asnjë cent nga financat e BE nuk është hedhur për ‘Ballkanin e hapur’, ndërkohë që projektet e BE, duke përfshirë edhe procesin e Berlinit kapin një shumë prej afro 30 miliard euro për Ballkanin Perëndimor. Në BE euro-t flasin më shumë se fjalët. Si ‘soft power’ BE është organizata e euro-diplomacisë.

#### ***4. SHBA mbështet Ballkanin Perëndimor, jo trojkën***

Ne dekadën e fundit diplomacia e ShBA ndaj Ballkanit Perëndimor ka lëvizur në një trajektore krejt të kundërt me atë të Federatës Ruse. Ndërsa Rusia ka kaluar nga qasja rajonale me ekuilibre Ballkanike nën Presidentin Jelcin, drejt prioritizimit të qasjes individuale pro-serbe nën Presidentin Putin, ShBA kanë kaluar nga qasja prioritare individuale pro-Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës të Presidentëve Klinton e Bush, drejt qasjes rajonale me ekuilibre ballkanike të Presidentëve Obama dhe Biden.

Në këtë kontekst lëvizjet e diplomacisë së SHBA drejt Ballkanit Perëndimorë synojnë që të tërheqin Serbinë nga gravitacioni i Kremlinit drejt hapësirave evropiane dhe euroatlantike. Pavarësisht efikasitetit të diplomacisë së ShBA në Ballkanin Perëndimorë, qasja rajonale e tyre do të sjellë impakte me rëndësi me kalimin e kohës për fuqizimin e vlerave Perëndimore në këtë rajon. Këtë proces transformimi rajonal të Ballkanit Perëndimor do e lehtësojë dhe shpejtojë ballafaqimi në rrafsh ndërkombëtare midis Perëndimit në tërësi dhe Federatës Ruse, në veçanti.

Vendosja e diplomacisë së ShBA në kontekst rajonal në Ballkanin Perëndimorë duket qartësisht edhe në mënyrën sesi diplomacia Amerikane i është përafuar nismës së 'Ballkanit të hapur'. Qëndrimi ShBA për këtë nismë është definuar qartësisht në kuadër Rajonal: SHBA mbështetin nismën 'Ballkan i hapur' nëse asaj i bashkëngjiten të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, përndryshe nisma nuk mund të ketë sukses. Ky qëndrim Amerikan është i qartë dhe parimor.

Ballkani Perëndimor nuk është trojkë, por është format gjashtë shtetesh dhe si i tillë ai lypet të formatizojë dhe realizojë gjithë iniciativat e tij rajonale. Kalimi i nismës "Ballkan i hapur" nga trojka aktuale në format gjashtë shtetesh kërkon që Serbia të heq dorë nga qëllimi djallëzor për përdorimin e kësaj nisme si variant ekonomik i "Botës Serbe", që mbështetja okulte nga dyshja Rama-Zaev të zëvendësohet nga gjithëpërfshirja dhe konsensusi politik dhe shoqëror në Shqipëri e Maqedoninë e Veriut, që të vijojnë bisedimet, dialogu e negociatat me Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën dhe Kosovën për përafrimin e qëllimit, të objektivave dhe projekteve të drejta dhe të barabarta për gjithë Rajonin, që të sigurohet mbështetja e plotë dhe institucionale e financiare e BE dhe e SHBA. Përndryshe nisma 'Ballkan i hapur' do të shuhet si shumë nisma rajonale Ballkanike, prapa të cilave janë fshehur qëllime krejtësisht të kundërta nga ato të parashtruara publikisht.

## 1.5. Ndikimi rus në Ballkan përfundon aty ku fillon orientimi euroatlantik i shqiptarëve

Perëndimi ende nuk e ka kuptuar se furnizimi i Serbisë me arsenal armatimi rus nuk është kërcënim vetëm për Kosovën, por edhe për pjesët tjera të Ballkanit dhe të Evropës. U desh të demonstrohet në praktikë fuqia e këtij kërcënimi, për t'u bindur se Kosova ka nevojë për një mbështetje më të madhe perëndimore. Ndoshta është koha që të shqyrtohet seriozisht përfshirja e saj në NATO. Vetëm në këtë mënyrë arrihet paqja dhe stabiliteti i kësaj pjese të Evropës Juglindore, ku Kosova po paguan koston e një neglizhence të pajustificueshme perëndimore.



**Mehmet PRISHTINA, PHD**

### *Hyrje*

Ballkani Perëndimor ndodhet pjesërisht me një këmbë në Evropë, pjesërisht në hartat e vjetra të gjeopolitikës sllave. Kosova dhe Shqipëria ende nuk po mundën të gjejnë një rrugë të vetme për të imponuar një qëndrim dhe një vizion mbi të ardhmen e përbashkët. Tirana dhe Prishtina nuk po flasin me një zë, ndërsa Edi Rama dhe Albin Kurti kanë qëndrime diametralisht të kundërta mbi disa iniciativa rajonale.

Rama e favorizon Ballkanin e hapur, kurse Kurti Procesin e Berlinit. Ky i fundit, në Forumin Strategjik të Bledit, i shpalosi pikëpamjet e tij mbi të ardhmen e rajonit, duke veçuar sundimin i ligjit ndaj oligarkëve, demokratizimin kundrejt autokratëve, përballjen me të kaluarën kundër kriminelëve të luftës dhe reciprocitetin e të drejtave të pakicave karshi hegjemonisë nacionale. Sipas tij, këto katër elemente mund t'i shërbejnë procesit të njohjes, komunikimit dhe ofrimit midis njerëzve në një rajon që ende i vuan pasojat e së kaluarës problematike.

Por, krejt ndryshe mendon Edi Rama. Ai është i lidhur me projektin Ballkani i hapur, duke favorizuar agjenda të paqarta dhe krejt të disfavorshme për Kosovën. Sipas Ramës, Ballkani i hapur ofron mundësi të mëdha bashkëpunimi, qarkullimi dhe komunikimi midis njerëzve, ideve dhe mallrave. Por, ai nuk ka arritur ta sqarojë se si do të jetë e mundur të ndodhë kjo në kushtet kur Kosova nuk njihet si shtet nga Serbia dhe kjo e fundit paraprakisht vendos kushte e barriera për Kosovën.

Sipas Ramës, fermerët e Konispolit do të kenë përfitime të mëdha nga Ballkani i hapur, mirëpo nuk na tregoi se si një fermer i Rahovecit do të mund t'i shesë produktet e veta në Kragujevc, nëse atje nuk mund të shkojë me targat e Republikës së Kosovës.

Me çfarë dokumentesh do të udhëtojnë kosovarët nëpër territorin e Serbisë apo do t'u duhet atyre ta plotësojnë kushtin e Beogradit duke zëvendësuar pasaportat dhe letërnjoftimet e Republikës së Kosovës me dokumente të tjera ku nuk figuron shtetësia e Kosovës.

Nëse Ballkani i hapur është paraparë si një korridor nëpër të cilin do të mund të kalojnë vetëm ata që i plotësojnë kushtet e Beogradit, atëherë i bie që ai korridor duhet të funksionojë me disa sensorë që ua mbyllin dyert atyre që nuk i plotësojnë kushtet e Beogradit.

Ndonëse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, thotë se me Kryeministrin e Kosovës Albin Kurtin ka mosdakordësi konceptuale për Ballkanin e hapur, ai pretendon se kjo nismë është interes strategjik i kombit shqiptar.

Sipas Ramës, Kosova është sovraane të jetë kundër Ballkanit të hapur, por nuk duhet të ndikojë në politikën e jashtme të Shqipërisë. Me fjalë të tjera, Edi Rama e pranon hapur se Shqipëria dhe Kosova duhet të ndjekin rrugë të ndryshme në projektet rajonale. Mirëpo, ai nuk po arrin të sqarojë një dubiozë logjike. Në njërën anë thotë se Ballkani i hapur është në funksion të strategjisë kombëtare të shqiptarëve, ndërsa në anën tjetër nuk diskuton me liderët e

Kosovës për përparësitë dhe të metat e kësaj nisme rajonale. Nëse, siç thotë Rama, kjo qenka në funksion të strategjisë kombëtare, atëherë përse kjo strategji nuk përpunohet në Tiranë dhe në Prishtinë, por Rama parapëlqen të komunikojë me lidërshtipin e Kosovës vetëm përmes konferencave të shtypit, në krah të Vuçiqit dhe Zaevit (!).

Idetë e mëdha, sidomos ato që kanë të bëjnë me të ardhmen e një populli apo të një rajoni, nuk krijohen duke vendosur që në start barriera, siç po ndodh aktualisht me Ballkanin e hapur, ku Vuçiqi ka arritur ta bindë Edi Ramën se Ballkani i hapur mund të funksionojë edhe pa Kosovën. Kjo është e mundur vetëm nëse fermerët e Konispolit e anashkalojnë Rrugën e Kombit dhe Kosovën dhe e zgjedhin Maqedoninë si rrugë transitore për të depërtuar në tregun e Serbisë. Nëse Rama e pranon këtë variant, atëherë këtu s'kemi të bëjmë me kurrfarë strategjie kombëtare, por kemi të bëjmë me një strategji për përjashtimin e Kosovës nga gjeopolitika rajonale, ku fjalën kryesore do ta ketë Serbia dhe jo Shqipëria.

Por, si duket, Ballkani i hapur, si ide dhe si nismë, nuk do të mund të mbijetojë pa mbështetjen e shteteve evropiane. Kundërpërgjigje ndaj kësaj nisme është Procesi i Berlinit. Pikërisht kjo ishte arsyeja që kancelarja gjermane Angela Merkel qëndroi në Tiranë më 14 shtator. Qëllim i vizitës së saj ishte shtyrja përpara e Procesit të Berlinit, i iniciuar në vitin 2014, i cili bazohet në ndihmën dhe përmbushjen e kritereve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Siç dihet, një prej komponentëve më të rëndësishëm të Procesit të Berlinit është e ashtuquajtura “Agjenda për lidhje”, e cila fillimisht synon lidhjen e gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në fushën e transportit dhe energjetikës.

Disa samite që janë mbajtur deri më tani kanë ndihmuar në vendosjen e urave të komunikimit midis udhëheqësve të Ballkanit, si dhe në hartimin e disa projekteve infrastrukturore. Projektet e miratuara për secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor financohen pjesërisht nga mekanizmat e BE-së e pjesërisht nga vetë vendet.

Kosova, sipas qëndrimeve të deritanishme të udhëheqësve të saj, ndodhet në linjë me politikat evropiane të integritit. Nëse qeveria aktuale e saj arrin t'i amortizojë efektet e keqmenaxhimit me institucionet e kaluara dhe të largojë nga radhët e veta llaskuçët e pushtetit, atëherë mund ta përmirësojë imazhin e saj në arenën ndërkombëtare dhe të bëhet një partner serioz dhe i besueshëm. Pikërisht kjo i duhet Kosovës tash, sepse një vend gëzon reputacion ndërkombëtar vetëm atëherë kur arrin të konsolidohet së brendshmi.

Por, gjithsesi, Kosova ka nevojë edhe për mbështetjen e Shqipërisë dhe për koordinim me katër shtetet kryesore evropiane, sidomos tani, kur SHBA po përballet me efektet e kritikave pas tërheqjes nga Afganistani. Diplomacia shqiptare duhet ta përfshijë edhe Kosovën në agjendën e saj të çdoditshme dhe ta afirmojë gjithkund ku ajo ka qasje dhe miq. Vetëm kështu mund të thuhet se shqiptarët janë një komb serioz që kanë shtete të ndryshme, por kanë një strategji të përbashkët për çështjet ende të hapura. Me fjalë të tjera, çdokush që pretendon ta mbyllë çështjen shqiptare pa Kosovën gabohet rëndë. Çështja shqiptare është e paplotë pa Kosovën.

### ***Kosovës i nevojitet një partneritet më i fuqishëm me Shqipërinë***

Kjo atmosferë politike, sociale e shëndetësore nëpër të cilën po kalon bota shqiptare nuk mund të shikohet e veçuar nga ajo çka po ndodhë aktualisht në rajon. Në Tiranë dhe në Beograd patëm kancelaren Merkel në vizitë lamtumirëse, dhe jehona e kësaj vizite vazhdon të interpretohet në mënyra të ndryshme. Ata që kanë mundur të ngelin më të zhgënjyer nga kjo vizitë, sigurisht janë në mesin e atyre që kanë pritur më tepër nga kjo vizitë, ndonëse politika e jashtme e Gjermanisë për Ballkanin tash më është e njohur. Por pritjet nganjëherë janë edhe irracionale, nëse e marrim parasysh faktin se segmentet e caktuara të politikave të jashtme të shteteve evropiane projektohen edhe mbi bazën e situatës në terren, konkretisht në Ballkan. Për rrjedhojë nëse dikush në Prishtinë, bie fjala, ka pritur më shumë nga vizita e kancelares Merkel, do të duhej t'i analizonte veprimet paraprake të politikës kosovare ndaj qasjes dhe interesimit gjerman për të investuar tek ne. Shumë kush nuk e ka të qartë se në marrëdhëniet midis shteteve, përpos miqësisë dhe partneritetit parimor, ka edhe interes. Statistikat flasin se Gjermania shumë më shumë ka investuar në Serbi se sa në Kosovë. Në shikim të parë kjo tingëllon absurde, por e vërteta është më kokëfortë se dëshirat tona. Nëse i hedhim një sy të kaluarës do të shohim se investimet në Kosovë ishin të kushtëzuara nga segmente të caktuara të mafies politike, e cila para interesit publik shihte interesin personal. Për pasojë shumë investues nga Evropa, specifikisht edhe nga Gjermania, pas përvojave të hidhura me njerëzit tanë që kërkonin hise në biznese ende pa startuar ato, transferonin kapitalin e tyre në vende të ndryshme të rajonit, kryesisht në Serbi, në Maqedoni të Veriut e gjeti.

Tani, ajo çka iu intereson njerëzve të dinë, lidhet me atmosferën e biznesit që aktualisht mbretëron në Kosovë dhe sa kjo atmosferë mund të jetë e favorshme për investimet e huaja, përfshi edhe ato gjermane. Kjo pyetje bëhet edhe më me peshë nëse kemi parasysh faktin se votuesit kosovarë në zgjedhjet e fundit parlamentare ia deleguan besimin një elite të re politike, e cila nga shumë kush me të drejtë u quajt "Qeveria e ndryshimit". Sigurisht që është herët të nxirren konkluzione të detajuara mbi bilancin qeverisës të kësaj garniture që aktualisht

është në pushtet, sepse ende nuk janë bërë 6 muaj, mirëpo kur plafoni i premtimeve është shumë i lartë, njerëzit kanë të drejtë të pyesin se pse ata vazhdojnë të ecin të kërrusur, dhe pse nuk mund ta drejtojnë trupin nga problemet e grumbulluara tash e njëzetë vite. Nëse plafoni i premtimeve ka qenë shumë i lartë, atëherë është shumë e logjikshme që çdo kush ta ndiej pulsën e ndryshimit, pa pasur frikën se ai plafon një ditë mund t'ua gërvisht sërish kokat.

Të rinjtë që kryejnë universitete, një kohë të gjatë më tepër vizitonin ueb-faqet e ambasadave të huaja, për të siguruar ndonjë vizë pune, se sa që interesoheshin për ndonjë shpallje a konkurs që do të ishte plotësim i ëndrrave të tyre për punësim. Ata e dinin se edhe nëse kishte shpallje të tilla, ato ishin të rezervuara paraprakisht për ushtarët partiak, të cilët regjistroheshin si të papunë, por vazhdonin të merrnin rrogë pa bërë asnjë ditë punë. Kushti i vetëm i tyre ishte të jesh militant partiak.

Nëse sot bëjmë një anketë me të rinjtë dhe me qytetarë strukturash të ndryshme lidhur me pritjet dhe zhgënjimet nga qeveria aktuale, do të vëreni se grupi i dytë i njerëzve është në rritje. Kjo edhe për faktin se shumë kush ka menduar se qeveria e re po vjen me shkop magjik për t'i korrigjuar deformimet e grumbulluara me vite, por jo pak mendojnë se qeveria e Kryeministrit Kurti nuk po shkëlqen ashtu siç e kanë paramenduar ata që e votuan. Ka plot njerëz që kanë vërejtje në mënyrën se si funksionojnë dikasteret qeveritar, duke akuzuar zyrtarët e lartë se megjithatë nuk ndryshojnë shumë nga pararendësit e tyre. Jo pak njerëz janë të befasuar me disa zgjidhje kadrovike, ku sërish ka ardhur në shprehje nepotizmi dhe kriteri ekskluzivisht i përkatësisë partiake.

Kosova ka shumë më shumë probleme që priten të zgjidhen se sa e ka komoditetin për të rrëshqitur në shtratin e njëfarë vetëkënaqësie. Problemi numër një tani për tani është refuzimi i politikave të Serbisë që e rrezikojnë sovranitetin e Kosovës. Por ky refuzim nuk mund të ndodhë pa një koordinim të mirëfilltë në mes të Prishtinës dhe Tiranës dhe pa konsolidimin e klasës politike në Kosovë. Ne mund të jemi të pakënaqur nga politikanët e huaj, përfshi edhe kancelaren e Merkel, të cilët ende e trajtojnë Vuçiqin si partner të denjë për bashkëpunim, por është koha që gishtin t'ia drejtojmë vetvetes dhe të pyesim çka po ndodhë me mendësinë tonë politike? Çka po ndodhë me politikanët tanë, të cilët më pak kanë harmoni brenda e më shumë miqësi jashtë?

Nëse jemi më vetëkritik, duke apostrofuar të metat në mesin tonë, atëherë më lehtë do ta kemi t'iu kuptojmë qëndrimet e diplomatëve të huaj. Para së gjithash, Kosovës i nevojitet një partneritet më i fuqishëm me Shqipërinë, në mënyrë që të mos kemi disonanca kaq të theksuara siç i kemi tani lidhur me nismat

rajonale të tipit BALLKANI I HAPUR. Kjo është e mundur vetëm nëse Kurti dhe Rama i lënë anash egocentrizmat e tyre dhe i shohin problemet nga prizmi i interesit nacional. Ballkani Perëndimor shumë shpejt nuk do të jetë ky që është, prandaj edhe aleatët tanë nuk do t'i kenë interesimet e njëjta siç i kanë pasur në fillim. Në rrethana të tilla Prishtina dhe Tirana duhet të përpilojnë një agjendë të përbashkët veprimi, e cila do t'i kishte dy funksione – e para, që të punohet me këmbëngulje në ruajtjen e partnerëve tanë strategjikë, sidomos SHBA-të dhe Gjermaninë dhe - e dyta, të demonstron një qëndrim më i fuqishëm politik kundrejt aspiratave të Serbisë për bosnjëzimin e Kosovës.

### ***Roli i Uashingtonit në Ballkan, si rezultat i dështimeve të BE-së***

Tani kur ka filluar qarkullimi i lirë në pikat kufitare Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat lidhin Kosovën me Serbinë, pas largimit të barrkadave të vendosura nga serbët lokalë dhe largimit të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës, shumë kush, nga këndvështrimi i tij, e ka analizuar situatën e krijuar në veri të Kosovës. Dy tetori ka qenë dita dhe afati i tërheqjes së Njësisë Speciale të Policisë dhe zhbllokimit të rrugëve për në Jarinjë e Bërnjak, sipas marrëveshjes së arritur nga Kosova e Serbia në Bruksel. Të shtunën filloi edhe zbatimi i pikës së parë të kësaj marrëveshjeje, e cila e parasheh largimin e protestuesve serbë, si dhe zëvendësimin e njësisë speciale me trupat e KFOR-it në pikat kufitare në veri. Ndërsa pika e dytë, nisi të zbatohet nga 4 tetor 2021, me ç'rast filloi vendosja e përkohshme e sistemit të afisheve, me të cilat si Kosova, ashtu edhe Serbia do të mbulojnë simbolet shtetërore të targave të njëra-tjetrës.

Pika e tretë parasheh që më 21 tetor do të nisë punën një ekip i përbërë nga zyrtarë të BE-së, Kosovës dhe Serbisë për të gjetur një zgjidhje të përhershme. Brenda gjashtë muajve, prej nisjes së takimit të parë, ky grup pune, do të prezantojë gjetjet për një zgjidhje të përhershme në formatin e dialogut të nivelit të lartë.

Marrëveshja Kosovë-Serbi është lavdëruar nga diplomatët ndërkombëtarë, kurse është kritikuar nga opozita dhe një pjesë e mediave në Kosovë.

Marrëveshje mes dy vendeve është e përkohshme dhe do të zgjasë për 6 muaj. Në shtensionimin e situatës një rol të rëndësishëm, përveç zyrtarëve të BE-së, ka luajtur edhe emisari amerikan, Gabriel Escobar. Kjo ka ndikuar që Brukseli ta trajtojë SHBA-në si “partner strategjik më i afërt dhe i rëndësishëm i Bashkimit Evropian”.



Ndërkohë, disa ligjvënës amerikanë i bëjnë thirrje presidentit Joe Biden dhe Sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken që të angazhohen për një zgjidhje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë dhe të dyfishojnë vëmendjen e SHBA për zgjidhjen e tensioneve mes dy vendeve.

The Guardian ka vërejtur se zhvillimet gjatë dy javëve të fundit kanë nxjerrë në pah mungesën e lidershit ndërkombëtar për këtë çështje, veçanërisht nga BE-ja. Prandaj roli i Uashingtonit në tejkalimin e kësaj situate ka ardhur edhe si rezultat i dështimeve të BE-së në imponimin e zgjidhjeve afatgjata.

Në krizën e fundit në mes të Kosovës dhe Serbisë u shfaq edhe Rusia. Ambasadori rus në Beograd ishte i pranishëm në afërsi të kufirit verior të Kosovës, kurse Serbia demonstroi forcë përmes fluturakeve të prodhuara në Rusi.

Perëndimi ende nuk e ka kuptuar se furnizimi i Serbisë me arsenal armatimi rus nuk është kërcënim vetëm për Kosovën, por edhe për pjesët tjera të Ballkanit dhe të Evropës. U desh të demonstrohet në praktikë fuqia e këtij kërcënimi, për t'u bindur se Kosova ka nevojë për një mbështetje më të madhe perëndimore. Ndoshta është koha që të shqyrtohet seriozisht përfshirja e saj në NATO. Vetëm në këtë mënyrë arrihet paqja dhe stabiliteti i kësaj pjese të Evropës Juglindore, ku Kosova po paguan koston e një neglizhence të pajustificueshme perëndimore.

Kjo edhe për faktin se, siç ka thënë në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë Edward Joseph, ligjërues në Universitetin Johns Hopkins në Uashington, shkaku i problemeve në Ballkanin Perëndimor, Serbia nuk e pranon rendin perëndimor. Sipas tij, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, me qasjen e tij ndaj krizës në veri të Kosovës, ka treguar se Serbia ka pranuar dhe ndjek vlerat dhe agjendën e Rosisë dhe Kinës.

Paraqitja e Njësisë special të policisë së Kosovës në Jarinjë dhe Bërnjak në mbështetje të reciprocitetit të aplikuar lidhur me mënyrën e përdorimit të targave të automjeteve, shënoi edhe kufirin ku mbrohen vlerat perëndimore nga ndikimi rus. Kosova ka mundur të rrëshqet në një krizë edhe më të thellë sigurie, por vendosmëria për të refuzuar logjikën serbe të imponimit të arrogancës së mosnjohjes së shtetësisë së Kosovës, dëshmoi se përpjekja për të mbrojtur sovranitetin e saj, Kosova po mbron edhe rendin demokratik perëndimor, i cili u vu në rrezik seriozisht nga aleanca ruso-serbe.

## ***Përfundim***

Në Prishtinë do të vazhdojë të kritikohet marrëveshjes e fundit për mbulimin e simboleve shtetërore në target e automjeteve të Kosovës dhe Serbisë, sepse kjo është edhe detyra e opozitës, por ajo që do të duhej të kihet parasysh është fakti se për herë të parë kufiri në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të trajtohet si administrativ nga Beogradi, siç është trajtuar deri më tani, por si prag që shënon derën e një shteti ku Serbia duhet patjetër të trokas. Për herë të parë Serbia duhet të heqë dorë nga arroganca e saj dhe t'i plotësojë kushtet e Kosovës. Për herë të parë Kosova përmes reciprocitetit të vendosur ndaj Serbisë po e konfirmon gatishmërinë kushtetuese e ligjore për të mbrojtur sovranitetin e saj në çdo cep të territorit. Gjithçka tjetër pastaj është pjesë e debatit mbi atë se a ka mundur Kosova të del më e fuqishme nga kjo situatë e tensionuar, dhe të mos pranojë largimin e Njësisë speciale nga veriu, apo të negociojë për një marrëveshje kompromisi. Me këtë raport të forcave ndërkombëtare, me një BE të shpërqendruar nga problemet e Ballkanit, me një Gjermani pa Merkelin, me një gjeopolitikë rajonale ku në sipërfaqe duken ide që e largojnë Ballkanin nga Procesi i Berlinit etj. Kosova e ka pasur shumë vështirë të demonstrojë njëanshmërinë e saj në imponimin e ndonjë zgjidhjeje që do ta bënte atë më të dinjitetshme. Përkundrazi, çdo minutë e status-quos në formë të barrikadave, rrezikonte shumë gjasat për një stabilitet afatgjatë dhe kjo nuk i ka konvnuar Kosovës. Sidomos nuk i ka konvnuar politikës së saj që përmes reciprocitetit të filluar ndaj Serbisë, ta detyrojë këtë të fundit të pranojë edhe kushtet tjera të Kosovës në dialogun e Brukselit. Kjo, mbase, do të shihet pas disa muajve.

*[Kjo kumtesë u lexua në Konferencën e parë shkencore: “Evropa Juglindore dhe gjeopolitika sot - ‘Open Ballkan’ dhe çështja shqiptare”, e organizuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë dhe mbajtur në Prishtinë, më 5. 11. 2021]*

## 1.6 BALLKANI I HAPUR APO MASHTRIMI I MADH



### **Melazim KOÇI, publicist**

Në Shkup e pagëzuan Open Ballkan. Ishte gabim, sepse forma e vetme e drejtë në gjuhën angleze është Open Ballkan(S). E bënë qëllimisht apo jo, këtë nuk mund ta dimë. Por, ajo që me siguri dihet është fakti që ideja e Ballkanit të hapur nuk është asgjë tjetër, pos një projekt bizar dhe tinëzar, që i prezantuar si angazhim për bashkëpunim rajonal, synim të fundit ka dominimin ekonomik, politik dhe gjeopolitik të Serbisë (si dorë e zgjatur e Ruisë) në këtë pjesë të Evropës Juglindore.

Ballkani i hapur nuk mund të elaborohet pa analizimin e zhvillimeve që i kishin paraprirë. Vendet e Ballkanit Perëndimor tash sa vite janë në rrugëtimin drejtë integrimit në Bashkimin Evropian. Ishte kancelarja gjermane, Angela Merkel, që në vitin 2014 kishte nisur Procesin e Berlinit, si fazë kalimtare dhe përgatitore të integrimit të vendeve të kësaj pjese të Evropës në BE.

Cili është synimi i procesit të Berlinit?

Ai supozoi miratimin e normave dhe standardeve të Bashkimit Evropian, modernizimin dhe fuqizimin e ekonomive dhe ndërlidhjen e tyre në shumë segmente. Një nga qëllimet është edhe Tregu i Përbashkët Rajonal, por mbi parimet e BE-së. Procesi i Berlinit synon gjithashtu t'i kontribuoj pajtimit dhe zgjidhjes së të gjitha problemeve ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Dhe, mbi të gjitha Procesi i Berlinit parasheh gjashtë subjekte të barabarta shtetërore. Në jetësimin e këtij projekti janë të angazhuar shumë faktorë të BE-së. Fillimisht, Komisioni Evropian, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia, Austria, Sllovenia dhe Kroacia. Të angazhuara janë edhe institucionet ndërkombëtare: Banka Evropiane për Rimëkëmbje dhe Zhvillim, Banka Evropiane për Investime dhe institucionet tjera të specializuara për bashkëpunim rajonal. Projektet konkrete që dalin nga procesi i Berlinit kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, sigurinë, migrimin, zhvillimin ekonomik dhe ndërlidhjen infrastrukturore. Të gjitha këto projekte do të financoheshin dhe mbikëqyreshin nga Bashkimi Evropian.

Procesi i Berlinit është nënshkruar nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, por pastaj është minuar nga Serbia.

Pse?

Sepse Procesi i Berlinit në themel ka barazinë e gjashtë shteteve anëtare dhe drejtpërdrejtë ose tërthorazi njohjen e shumë segmenteve të shtetësisë së Kosovës.

Për të shmangur obligimet që dilnin nga procesi i Berlinit, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, projektoi fillimisht Mini-Shengenin dhe pastaj Ballkanin e hapur, të cilit thënë më së buti naivisht iu bashku kryeministri i Shqipërisë Edi Rama dhe kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev. Duke promovuar Ballkanin e hapur, presidenti serb arriti të minimizojë, përkatësisht të relativizojë përgjegjësinë e Serbisë për minimin e procesit të Berlinit. Ballkani i hapur u refuzua jo vetëm nga Kosova dhe Bosnja, por madje edhe nga Qeveria proserbe e Malit të Zi.

Disa ditë pas takimit të Shkupit (fundi i korrikut 2021) ku Mini-Shengeni u pagëzuar me emërtimin Ballkani i hapur, kryeministri i Shqipërisë Edri Rama do të deklaronte se kjo nismë gëzonte mbështetjen e Gjermanisë. E vërteta ishte krejt ndryshe. Berlino, Uashingtoni dhe Brukseli në deklarimet zyrtare menjëherë pas takimit në Tiranë e bënë të qartë të mbështesin Procesin e Berlinit e jo Ballkanin e hapur.

Departamenti Amerikan i Shtetit: *“ShBA mbështesin fuqimisht vijimin e përpjekjeve në Ballkanin Perëndimor për të thelluar dhe forcuar integrimin gjithëpërfshirës rajonal, në bazë të rregullave dhe standardeve të BE-së.”*

BE: *“Një proces me përfshirje të gjithë rajonit të Ballkanit Perëndimor është thelbësor. Është e rëndësishme që rajoni të përparojë në krijimin e një Tregu*

*të Përbashkët Rajonal, një angazhim politik i marrë nga gjashtë udhëheqësit e rajonit në Samitin e Sofjes vjeshtën e kaluar (2020 - Procesi i Berlinit).*

*Gjermania: “Krerët e qeverive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor e riafirmuan angazhimin për këtë projekt historik (Procesi i Berlinit) në samitin e fundit me 5 korrik në Sofje.”*

Në deklaratimet e qendrave perëndimore të vendosjes potenciale Tregu i Përbashkët Rajonal, gjithëpërfshirja dhe rregullat e standardet e BE-së, të gjitha të përfshira në procesin e Berlinit, por jo edhe në Ballkanin e hapur.

Eksperti i njohur për çështjet e Ballkanit, Franz - Lotar Altman, pas takimit të Shkupit kishte deklaruar se Mini-Shengeni ose Ballkani i hapur, nuk ka lidhje me Procesin e Berlinit. Ai kishte potencuar se nën ombrellën e Procesit të Berlinit janë të përfshira edhe shtetet anëtare të BE-së, gjë që do të sillte vendosjen e një zone të gjerë ekonomike ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, me lidhje ekonomike të ngjashme me atë që ka BE-ja me Irlandën dhe Norvegjinë.

Rrjedhimisht dhe logjikshëm shtrohet pyetja: pse Rama dhe Vuçiq anashkalojnë Procesin e Berlinit dhe avancojnë Ballkanin e hapur që nuk ka asnjë lidhje me Bashkimin Evropian!?

A është i saktë dyshimi se Procesi i Berlinit është sabotuar nga Beogradi, Tirana dhe Shkupi, sepse me të Serbia obligohej të njihte segmente të caktuara të shtetësisë së Kosovës?

A është Ballkani i hapur tentim për të izoluar Kosovën dhe për të goditur shtetësinë e saj?

A është Ballkani i hapur reinkarnim i sherreve dhe politikave të vjetra “Ballkani - ballkanasve” dhe tentim për të marginalizuar rolin e Perëndimit në këtë hapësirë?

Ballkani i hapur është vetëm një segment i politikës serbe ndaj Kosovës dhe pse jo edhe Shqipërisë. Beogradi tash e 12 vite zbaton strategjinë e minimumit të shtetësisë së Kosovës në disa rrafshë: në Bruksel përmes dialogut synon ta shantazhojë Kosovën dhe këtë e bënë përmes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndonëse qëllim përfundimtar ka ndarjen e Kosovës. Këtë pohim e konfirmon kryetarja e Komitetit të Helsinkit në Serbi, Sonja Biserko, e cila në vitin 2018 kishte deklaruar: “... Vuçiq dhe Thaçi në Bruksel kanë hapur kanalën për të biseduar për ndarjen e Kosovës, ndërsa në këtë zhvillim

për shkak të ambicieve personale është kyçur edhe Federika Mogerini... Beogradi gjatë gjithë kohës ka kërkuar partner në Tiranë dhe në fund e ka gjetur atë: është kryeministri shqiptar Edi Rama. Bisedimet për ndarjen filluan para dy vitesh kur Rama ishte në Nish (2016), por këto atë botë u zbuluan nga Uashingtoni dhe Londra”. Biserko shton se - “ideja për ndarjen e Kosovës vjen nga Beogradi: ajo ka qenë përherë në qarkullim, në tavolinë dhe nën tavolinë. Gjithçka varej vetëm nga rrethanat ndërkombëtare.”

Ideja e ndarjes së Kosovës nuk ka asnjë dyshim ishte dhe mbetet e mbështetur fuqishëm nga Moska, sepse Beogradi një gjë të tillë nuk mund ta qoj përpara pa mbështetjen politike, diplomatike dhe ushtarake të Ruisë.

Por, pse i duhet Moskës ndarja e Kosovës?

Mbase për të përligjur veprime të tilla në të gjitha vendet fqinje që dikur ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik. Nëse Perëndimi do të miratonte ndarjen e Kosovës, Moska do të dispononte argumentin më të fuqishëm për destabilizimin e vendeve në kufijtë e saj me popullatë ruse, gjithnjë sipas modelit (precedentit) të Kosovës.

Në këtë kontekst, profesori amerikan në Universitetin Hopkins, Eduard Joseph thotë:

“Serbia nën drejtimin e presidentit Vuçiq promovon rendin e Ruisë dhe Kinës. Tregu i Përbashkët Rajonal për Ballkanin, si pjesë e strategjisë për hyrjen në BE, është gjë e mirë, por jo edhe Ballkani i hapur. Kjo nismë (Ballkani i hapur) shton epërsinë relative të Serbisë dhe abstrakton vlerat antidemokratike dhe joliberalë të regjimit serb. Trazirat në rajon i dëshiron Rusia. Ne nuk rekomandojmë Ballkanin e hapur”.

Në këtë frymë gazeta prestigjioze austriake “Der Standard” këto ditë Ballkanin e hapur e cilëson ide të rrezikshme që pason nisma të mëhershëm për ndarjen e Kosovës.

“Është interesant se nisma përfshinë ato forca që u përpoqën vite më parë të shtynin përpara një këmbim terrioresh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ballkani i hapur po shkakton sërish ndarje dhe mosbesim në rajon.”

Ideja e Ballkanit të Hapur në rajonin e Evropës Juglindore nuk gjeti mbështetje. Mosbesimi ndaj këtij projekti është i madh në Prishtinë, Sarajevë, Podgoricë dhe Zagreb.

Analisti politik nga Novi Sadi, Boris Varga, në një shkrim për “Al Jazira Balkans” pohon: “Te Ballkani i Hapur është shpërngulur ‘bota serbe’ dhe ‘popullistët proruse’. Ideja e Trampit që autokratëve t’u lihet Ballkani është kundërthënëse dhe e dëmshme, ndërkohë që u fillua edhe me një ide tjetër edhe më të rrezikshme që problemet të zgjidhen me ndryshimin e kufijve sipas çelësit etnik. Rusia edhe në këtë pikë është konsistente, sepse e ka interesin e marrëveshjes së Dejtonit si simbol i fuqisë amerikane në Ballkan, dhe që njëkohësisht Kosova të mbetet çështje e pazgjidhur, sepse Moskës kjo i garanton prani afatgjate në këtë pjesë të botës. Ballkani i hapur nuk mund të realizohet derisa me të administrojnë kreatorët e idesë serbomadhe sipas modelit të ‘botës ruse’.”

Kryesuesi i Institutit për Studime Evropiane dhe Globale në Zagreb, Angjelko Milardoviç, Ballkanin e Hapur e sheh si rumbullakim të Serbisë së Madhe:

“Nuk kam njohuri se cili është qëllimi i vërtetë i Ballkanit të hapur, pos idesë së ‘botës serbe’. Kjo ide e ka statusin e testit sipas modelit ‘nëse kalon - kalon’. Do të ishte më e sigurtë që Serbia të heqë dorë nga ideologjia serbomadhe e Ilia Garashaninit. Evropa nuk do të lejojë që eksperimentet e ballkanasve të përfundojnë me kriza që kërcënojnë kontinentin.”

Deklarimet e shumicës së njohësve ndërkombëtar dhe rajonal, që gati në unanimitet hedhin poshtë këtë nismë, nxjerrin konkludimin se të njëjtit autorë që ideuan ndarjen e Kosovës, minuan Procesin e Berlinit dhe pastaj inauguruan Ballkanin e Hapur.

Pra, Kosovën duhej ndarë në favor të Serbisë së Madhe dhe nëse kjo nuk kalon, pason Ballkani i hapur me të gjithë serbët në “botën serbe” ashtu si koncepti i Ruisë për “botën ruse”.

Zhvillimet dramatike dhe agresioni mbi Ukrainën dëshmojnë katërçipërisht se kemi të bëjmë me skenar të ideuar në Moskë dhe Beograd. Në Ballkan duhej ndarë Kosovën, si eksperiment për ndarje tjera mbi baza etnike në pjesë tjera në shtetet në fqinjësi të Ruisë.

Në Evropën Juglindore, Ballkani është kompensim për pamundësinë aktuale të ndarjes së Kosovës. Zhvillimet në Ukrainë përfundimisht kanë varrosur idenë e Ballkanit të hapur, sepse do të jetë më shumë se vetëvrasje politike të bashkëpunosh me autoritetet e Beogradit, që mbase e vetmja në Evropë refuzoi të dënojë agresionin brutal ushtarak të Ruisë ndaj Ukrainës dhe të zbatojnë sanksione kundër Moskës.

A e mbylli lufta në Ukrainë kapitullin e Ballkanit të hapur? Çdo tentim eventual për ta mbajtur të gjallë idenë e Ballkanit të hapur do të ishte komprometues dhe politikisht shumë i rrezikshëm për pozicionimin politik dhe gjeopolitik të Kosovës dhe Shqipërisë.



## **1.7 Dy republikat shqiptare jashtë “Zonës së Novi-Sadit” dhe një padi për drejtësi**



### **Bojken ABAZI, politolog**

**Dalja nga “Zona e Novi-Sadit” krijon mundësinë që të marrim një kthesë të madhe në historinë tonë kombëtare dhe për gjithë rajonin. Në Kosovë kemi programin e ri të Qeverisë Kurti, në SHBA programin e ri të administratës Biden.**

**Tiranë, 7 korrik** - Padia për gjenocid kundër Serbisë dhe “Zona e Novi Sadit”, e njohur ndryshe si “mini-Shengeni”, kanë ngritur së fundmi një tymnajë të madhe mediatike dhe debate edhe nëpër konferenca ndërkombëtare.

KM Rama dhe satelitët e tij mediatikë po lënë të kuptohet se pa një padi kundër Serbisë dhe brenda “Zonës së Novi-Sadit” shqiptarët fitojnë; ndërsa me padi kundër Serbisë, jashtë “Zonës së Novi Sadit”, shqiptarët humbasin.

KM Rama e ka shpallur padinë pa rezultate ende pa nisur përgatitjet, ndërkohë që satelitët e tij mediatikë e kanë quajtur kërkesën për bashkëpunim mes dy republikave shqiptare për këtë padi kundër Serbisë si një përpjekje të KM Kurti për të nxjerrë keq kundërshtarët e brendshëm politikë, por edhe për ta shpallur Kryeministrin Rama “armik” dhe për “ta pastruar përjetësisht Serbinë me vendim gjykate”.

Është mbrojtur aq shabllon “Zona e Novi Sadit” sa po deklarojnë që të njëjtin projekt po propozon edhe KM Kurti kur flet për një marrëveshje të re (SEFTA) për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ka rëndësi të kuptojmë ku qëndron e vërteta, çfarë është “Zona e Novi Sadit” dhe ç’do të thotë kjo padi pasi jemi para një mundësie historike.

Prej një dekade, Lëvizja VETËVENDOSJE ka synuar bashkëpunimin e ngushtë me qeverinë në Shqipëri dhe me të gjithë aktorët politikë brenda dy republikave shqiptare për realizimin e zotimit për të ngritur padi kundër Serbisë. Në faqen nr. 15 të Alternativës Qeverisëse të Lëvizjes, hartuar në vitin 2012 dhe publikuar në vitin 2013, është vendosur me shkrim zotimi për ta paditur Serbinë. Në atë kohë, KM Rama ishte në opozitë dhe nuk ka se si synimi të ketë qenë armiqësia me të. Padia për gjenocid kundër Serbisë është në përputhje me Rezolutën e vitit 2019 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që është votuar nga shumica e deputetëve të të gjitha partive shqiptare – jo vetëm nga Lëvizja. Rezoluta dënon gjenocidin dhe, ndër të tjera, kërkon të merren masa për reparacione, dëmshpërblime dhe kërkimfalje - të cilat mund të realizohen përmes ngritjes së padisë. Prandaj, padia nuk është as e re si nismë, as kundër KM Rama, as kundër partive në Kosovë, por vetëm për drejtësi.

Pretendimi se padia për gjenocid nuk do prodhojë rezultate është vazhdim i gabimeve të bëra historikisht. Le t’ia nisim nga e kundërta, nga mosngritja e padisë. Për këtë na flet gjithë historia e gjenocideve të kryera ndaj shqiptarëve përgjatë shekullit XX. Çfarë përfituan shqiptarët që nuk ngritën padi kundër gjenocidit të Greqisë në jug të Shqipërisë, që nisi prej vitit 1913 e vazhdoi në vitin 1944 me gjenocidin kundër shqiptarëve të Çamërisë? Ende sot Greqia mban në fuqi ligjin e luftës, nuk ka kërkuar falje dhe nuk ka kthyer as pronat. Çfarë përfituam si komb që nuk ngritëm padi për gjenocidet e kryera nga Serbia gjatës gjysmës së parë të shekullit XX? Ligji ndërkombëtar kundër gjenocidit u forcua pas Luftës së Dytë Botërore, por shtete të tjera ngritën padi për krimet e kryera ndaj popullsisë së tyre edhe para asaj lufte. Ndërsa ajo çfarë pësuam ne që nuk ngritëm kurrë një padi, ishte një tjetër gjenocid nga Serbia, në fund të shekullit XX, dhe sërish nuk ngritëm padi. Shumë gjenocide, asnjë padi. Vitet kalojnë, dëshmitarët ndërrojnë jetë, shumë kriminelë nderohen në shtetet e tyre për bëmat gjenocidiale ndaj shqiptarëve, padrejtësitë thellohen, aspiratat ekspansioniste të fqinjëve vazhdojnë dhe mbi makabritetet e kryera ndaj nesh si komb, mbi vuajtjet e thella të një populli, politikanët shqiptarë konsolidojnë pushtetet e tyre pa dorëzuar padi, me doktrina të llojit “zero probleme me fqinjët”. Historia e gjenocideve u përsëritet shqiptarëve dhe ne vazhdojmë të refuzojmë të mësojmë prej historisë.

Ligji ndërkombëtar duhet analizuar dhe rastet duhen studiuar për të kuptuar se nuk ka arsye pse të stepemi prej përgatitjes së padisë. Kroacia dhe Bosnje Hercegovina kanë depozituar të dyja padi për gjenocid kundër Serbisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). GJND-ja e rrëzoi padinë e Kroacisë dhe rrëzoi gjithashtu edhe kundërpadinë ndaj Kroacisë që depozitoi Serbia, por nuk “e pastroi” Serbinë. Gjykata njohu krimet e shumta të Serbisë ndaj popullsisë kroate dhe elemente të gjenocidit, por nuk arriti të vërtetonte se synimi final i këtyre krimeve ishte kryerja e gjenocidit – shkatërrimi fizik i plotë ose i pjesshëm i kombit kroat. Ndërsa në rastin e Bosnje-Hercegovinës Gjykata e njohu faktin se ishte kryer gjenocid, por pa e vërtetuar dot se ishte bërë me urdhër direkt të Serbisë. Gjykata ua veshi përgjegjësinë kryesore udhëheqësve lokalë serbë të Bosnjës, ndërsa Serbinë e njohu si fajtorë për mosparandalimin e gjenocidit. Për pasojë, dënimi nuk kërkoi dëmshpërblime prej Serbisë, por i kërkoi asaj të transferojë para drejtësisë ndërkombëtare të gjithë individët e akuzuar për gjenocid. Republika e Kosovës është në një situatë më të favorshme se Bosnje Hercegovina në raport me përgjegjësinë që mban shteti i Serbisë, pasi krimet në Kosovë janë kryer drejtpërdrejt nga Ushtria, Policia dhe paramilitarët e Serbisë.

Kemi shumë ç’ të mësojmë prej studimit të rasteve të ndryshme dhe sigurisht që padia jonë në GJND duhet përgatitur me shumë kujdes. Për këtë arsye, qeveria Kurti ka deklaruar se padia nuk realizohet menjëherë, do kohën e saj për t’u përgatitur dhe planifikohet që të kryhet gjatë vitit të ardhshëm, në mënyrë që të jetë sa më e plotë dhe bindëse. Ndihma që mund të japë Qeveria Rama në këtë drejtim është e pazëvendësueshme dhe nuk lidhet vetëm me depozitim të padisë në GJND, por edhe me fazën aktuale përgatitore. Qeveria Rama mund menjëherë të ndihmonte duke vendosur në dispozicion arkivat e shtetit për periudhën e gjenocidit, ngritjen e ekipeve të përbashkëta të së drejtës ndërkombëtare, të grumbullimit dhe përgatitjes së dëshmitëve, dosjeve, raporteve, etj. Për më tepër, Republika e Shqipërisë do jetë për herë të parë edhe anëtare e Këshillit të Sigurimit në OKB, nga ku mund të përfitojë shumë informacion dhe përvojë. Por qeveria Rama po refuzon të bashkëpunojë qoftë edhe për të dhënë ndihmën në përgatitjen e padisë, duke e shpallur këtë nismë të dështuar ende pa filluar përgatitja dhe duke pretenduar, përmes satelitëve mediatikë, se kjo padi do e pastrojë Serbinë.

Paditë e Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës në GJND nuk e pastruan Serbisë. Sipas Gjykatës, Serbisë i mbeti njolla e zezë e krimeve që ka bërë në këto dy shtete, dhe në rastin e Bosnje Hercegovinës edhe njolla e gjenocidit dhe detyrimi për të vendosur kriminelët gjenocidialë serbë para drejtësisë. Shqetësimi se padia mund të dështoi ngaqë Serbia nuk arriti ta kryente të plotë krimin e gjenocidin në Kosovë, për shkak të ndërhyrjes së NATO-s, bie kur

vërejmë se GjND-ja i dënon palët sipas Konventës për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (Neni 3) edhe kur vërtetohet thjesht tentativa për të kryer gjenocid. Padia në GjND është tejet e rëndësishme për shqiptarët pasi Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë i trajtoi të gjitha palët në konflikt si të barabarta, duke gjykuar vetëm mbi përgjegjësitë individuale të të akuzuarve, por jo edhe mbi përgjegjësinë shtetërore dhe kolektive të agresorit: Serbisë. Padia për gjenocid do ta mbante Serbinë përgjegjëse si shtet, duke e detyruar shoqërinë serbe të ballafaqohet me veprimet dhe mosveprimet e saj që çuan deri në kryerjen e krimit të gjenocidit kundër shqiptarëve.

Faktori kryesor i këtyre dhjetë viteve që ka ndikuar në pastrimin e Serbisë përballë krimeve që ka kryer ndaj kombit shqiptar është fillimisht dialogu pa parime dhe pa kushte i nisur nga Hashim Thaçi, i cili i normalizoi qëndrimet antishqiptare dhe politikanët e Serbisë. Në dialogun e nisur prej Thaçit, Kosova vajti si “cjapi te kasapi”, pa vija të kuqe, duke lëshuar nga sovraniteti dhe integriteti territorial në formë koncesionesh ndaj një Serbie që nuk u ballafaqua me të kaluarën e saj kriminale dhe nuk e njohu pavarësinë. Në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në Republikën e Kosovës më 6 tetor 2019, kur u kuptua brenda natës se Lëvizja VETËVENDOSJE kishte fituar dhe pritej formimi i qeverisë Kurti 1, vetëm katër ditë më vonë, më 10 tetor 2019, u zhvillua në Novi Sad të Serbisë takimi mes Aleksandar Vuçiqit, Edi Ramës dhe Zoran Zaevit për themelimin e “mini-Shengenit” Ballkanik. Pikërisht kur u kuptua se me ardhjen e Albin Kurtit në pushtet rrezikohej rruga e shtruar drejt koncesioneve ndaj Serbisë, stafeta për pastrimin e Serbisë i kaloi, pa humbur kohë, KM Edi Rama.

Nën shembullin e koncesioneve të Hashim Thaçit ndaj Serbisë, KM Rama e futi Republikën e Shqipërisë në “Zonën e Novi Sadit” pa kushte ndaj të kaluarës dhe aktualitetit kriminal të Serbisë. KM Rama na përmend gjithnjë si shembull bashkëpunimi rastin e Francës dhe Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore, pa treguar se para se të lidheshin marrëveshjet që çuan drejt themelimit të BE-së, Gjermania mbajti përgjegjësi kolektive për krimet e nazizmit, duke njohur edhe reparacionet dhe dëmshpërblimet e luftës dhe duke kërkuar zyrtarisht falje. Sakaq, KM Rama i ka ofruar tregun e Republikës së Shqipërisë një Serbie të papënduar, që nuk respekton as parimet elementare tregtare dhe dominon rajonin me praktika ilegale grabitqare si dampingu, të cilat rrënojnë prodhimin vendas dhe punësimin në dy republikat shqiptare. E njëjta Serbi, në tetorin e themelimit të “Zonës së Novi Sadit”, po në vitin 2019, u bë pjesë zyrtarisht edhe e marrëveshjeve të Unionit Ekonomik Euroaziatik të themeluar dhe drejtuar nga Rusia e Putinit.

KM Rama fshihet pas gjethes të fikut kur deklaroi se “mini-Shengeni” (Zona e Novi-Sadit) është projekt evropian që synon zbatimin e katër lirive të BE-së edhe mes vendeve të rajonit. Liritë e BE-së synon t’i zbatojë edhe Rusia e Putinit brenda Unionit Ekonomik Euroaziatik, ku bënë pjesë Serbia. Por kjo nuk e bënë projekt evropian as “Zonën e Novi-Sadit” as Unionin Euroaziatik. BE-ja i ka kërkuar publikisht Serbisë të heqë dorë prej marrëveshjeve me Unionin Euroaziatik nëse synon anëtarësimin. Propozimi i KM Kurti në Samitin e Tiranës për krijimin e Zonës Ekonomike të Evropës Juglindore “SEFTA”, të lidhur përmes një marrëveshjeje mes BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga njëra anë e kushtëzon Serbinë të heqë dorë prej Unionit Euroaziatik e të zbatojë rregullat e tregtisë së ndershme dhe nga ana tjetër përparon statusin e Kosovës si shtet me të drejta të barabarta. “Zona e Novi Sadit” nuk ia krijon Serbisë këtë shqetësim. E thënë më shkoqur, projekti i mbështetur nga KM Rama për “Zonën e Novi Sadit” (mini-Shengeni) ia mundëson Serbisë të qëndrojë në një treg të përbashkët edhe me BE-në (përmes MSA-së) edhe me Rusinë (përmes Unionit Euroaziatik), pa hequr dorë prej politikave të saj ekspansioniste në rajon dhe pa u ballafaquar si shtet me krimet e saj.

Dalja nga “Zona e Novi Sadit” krijon mundësinë që të marrim një kthesë të madhe në historinë tonë kombëtare dhe për gjithë rajonin. Në Kosovë kemi programin e ri të Qeverisë Kurti, në SHBA programin e ri të administratës Biden. Është bërë e qartë se rajoni nuk ka për të zhvilluar marrëdhënie të mira fqinjësore pa e kushtëzuar Serbinë. Në këto 10 vite, çdo koncesion i politikanëve të korruptuar të dy republikave shqiptare ndaj Serbisë, vetëm sa ia ka pastruar asaj imazhin duke ia shtuar oreksin. Këtë e rimësoi Kosova dhe votoi masivisht këtë vit me mbi 50% për një model të ri qeverisës. Ka ardhur koha ta mësojmë mirë edhe në Shqipëri, në mënyrë që së bashku të ndikojmë edhe më shumë tek aleatët tanë ndërkombëtarë në këtë drejtim. Është e domosdoshme që dy republikat shqiptare të punojnë ngushtë me njëra-tjetrën për të realizuar atë që s’kemi bërë kurrë si komb. Kemi nevojën urgjente t’i nxjerrim dy republikat tona nga projektet ekspansioniste të Serbisë, t’i afrojmë në çdo sektorë drejt bashkimit dhe të ngremë për herë të parë në nivel ndërkombëtar një padi për drejtësi.

## 1.8 HIJA E SKEMËS SERBE NË “BALLKANIN E HAPUR”



*Unioni si i tillë me një Serbi pro-ruse do të jetë një rrjet i mirë për veprimin rus në Ballkanin Perëndimor dhe mbajtjen gjallë të armiqësive të vjetra, duke ndërtuar mure të reja. Megjithatë, shqiptarët nuk duhet të hyjnë në aleanca dhe të bëhen pjesë e blloqeve, ku pas nismave si garantues mund të jenë shtete të treta. Prapëseprapë, Kosova në të ardhmen duhet të vendosë se kah do të shkojë në rast të refuzimit të mundshëm nga Perëndimi dhe ndryshimeve radikale në sistemin ndërkombëtar. Politika e kritikave dhe hedhjes poshtë të të gjitha projekteve ndërkombëtare do të ishte e dëmshme për shtetin e ri. Fragmentimi i “Botës Shqiptare” në këtë dekadë veçse ka krijuar përparësi për “Botën Serbe”, ku çuditërisht ka hyrë Shqipëria.*

### **Dr. Selim IBRAIMI**

Nuk është hera e parë që popujt e Ballkanit hynë në aleanca në mes veti ose nëpërmes shteteve të treta ndërtojnë blloqe qofshin për interesa politike dhe ekonomike. Lidhja Ballkanike e fillim shekullit XX ishte ideologjike dhe kryesisht kishte për synim forcimin e kombit serb, botës ortodokse në Ballkanin Jugor dhe padyshim daljes në Adriatik. Shtetet dhe qeveritë së pari shohin interesin nacional e pastaj, po qe se nga bashkëpunimi arrijnë të maksimizojnë të hyrat, qeveritë vendosin të hyjnë në unione. Zakonisht në unionet tregtare dhe ushtarake dominon më i forti, pasi aleancat nuk mund të qëndrojnë pa mjete ushtarake dhe buxhet të qëndrueshëm financiar.

## *Gjeopolitika e tregut*

Në “Ballkanin e hapur” shteti më i fuqishëm është Serbia e cila ka tërhequr pas vetes Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, dy shtete që lëngojnë nga korrupsioni i madh dhe mungesa e shtetit ligjor. Në një refuzim të BE-së, socialisti Rama, neo-komunisti Zaev dhe ultra-nacionalisti Vuçiq u nisën të formojnë unionin e përbashkët tregtar i quajtur së fundmi si “Ballkani i hapur”, kryesisht i projektuar mbi baza të dominimit ekonomik dhe ekspansionit territorial serb. Më vonë, nga dinamikat e jashtme, ideja mund të marrë formën e një Serbie të Madhe, të integruar me të gjitha viset ku jetojnë serbët në një union të vetëm kryesisht me popullatë ortodokse dhe e mbështetur nga buxheti i Serbisë.

Qeveria e Shqipërisë së kryeministrit Edi Rama me vetëdije ka hyrë në varësi me shtetin serb, duke konsideruar se lëvizja e lirë e qytetarëve dhe mallrave do të sjellë përfitime për ekonominë shqiptare. Në parim është në rregull, megjithatë logjika e thjeshtë ekonomike tregon diçka tjetër – Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk kanë kapacitete tregu për ta dominuar ekspansionin tregtar serb. Shqipëria nga mungesa e mjeteve teknologjike dhe eksportit të ultë të mallrave në tregun e përbashkët do të ketë deficit më të madh tregtar krahasuar me Serbinë apo edhe Maqedoninë e Veriut.

Tregu shqiptar do të pushtohet nga mallrat serbe dhe maqedonase, kurse ekonomia shqiptare do të ketë eksport të ultë në “Ballkanin e hapur”. Serbia dhe Maqedonia e Veriut në tregun e përbashkët ballkanik, për shkak se janë vende gjeografikisht të izoluar dhe pa dalje në det, me marrëveshjet e reja krijojnë një mundësi të re strategjike për dalje në ujërat e ngrohta dhe qarkullim të mallrave dhe kapitalit nga porti i Durrësit në pikat tjera strategjike të bregdetit shqiptar. Ky port me tregun e lirë do të jetë në shërbim të tre shteteve anëtare të unionit tregtar, sepse tregu i përbashkët nuk parasheh kufizime për shtetet në të drejtën e shfrytëzimit të pikave strategjike. Në tenxheren e re të tregut të përbashkët shumë çështje ekonomike do të kalojnë në duart e treshes ose, më shkurt, Serbisë dhe deri-diku Maqedonisë së Veriut. Shqipëria, në një gjendje të tillë, do ta ketë të pamundur të eksportoje mallra në Serbi dhe në tregun maqedonas, për arsye të natyrës predatore të qeverive serbo-maqedonase dhe mentalitetit blerës të serbëve dhe maqedonasve ndaj produkteve shqiptare.

Në një raport dy me një për tregun shqiptar, prodhuesi shqiptar do të jetë para kolapsit të përgjithshëm të mos shitjes apo mospasjes treg në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Këtu nuk është e rastit se pse qeveria e Malit të Zi ende po heziton t’i bashkëngjitet kësaj nisme serbo-maqedonase-shqiptare, pasi vetvetiu me këtë veprim do të humbte atë pak sovranitet të fituar me vështirësi

nga Serbia. Duke i njohur serbët mirë, malazezët e moderuar çdo herë e kanë preferuar një Mal të Zi të pavarur nga Serbia. Hyrja në tregun e përbashkët do t'i jepte fund ekonomisë edhe ashtu të dobët malazeze.

### ***Në mungesë të planeve konkrete, reagojnë SHBA dhe BE***

SHBA dhe Bashkimi Evropian (BE) e kanë përshëndetur nismën me fraza të mira duke e mbështetur tregun e përbashkët. Në mungesë të një strategjie afatgjate për Ballkanin Perëndimor, Stejt Departamenti ka mbetur pa nisma serioze dhe tash është detyruar të avancojë Serbinë si aktor dominues në Ballkan me projekte që shkojnë në mbrojtje të interesave serbe dhe forcimit të ekonomisë së Serbisë mbi tregun shqiptar në emër të një tregu të përbashkët. Nga një pikë tjetër, tregu do të izolojë Kosovën, duke ia zvogëluar kapacitetet e import-eksportit ose, thënë shkurt, treshja Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut do ta shkatërrojë ekonominë e Kosovës dhe kjo njëkohësisht do të ndikojë në zhvillimet politike kosovare.

Me unionin e ri, Serbisë nuk i duhet më angazhim ndërkombëtar për çnjohje të Kosovës. Tash aty e ka partnerin shqiptar, qeverinë e Ramës, e cila do të bëjë çmos të mos bashkëpunojë me të gjithë kundërshtarët politikë dhe ata që nuk mendojnë si ai.

Pas “perdes së zezë” janë bërë disa hapa konkrete ndërmjet palës maqedonase dhe serbe, duke nënshkruar një marrëveshje për unifikimin e postave. Këtu nuk është shprehur qartë lideri i BDI-së Ali Ahmeti, partner qeveritar i kryeministrit maqedonas Zoran Zaev, i cili tashmë është i varur nga politika serbe. Maqedonia e Veriut, nën drejtimin e kryeministrit Zaev, në emër të bashkëpunimeve rajonale, gjithnjë e më shumë po bëhet vasale nga Beogradi, pasi shumë zyra ndërkombëtare janë vendosur në Serbi.

Me ardhjen në pushtet të ish komunistëve maqedonas, Shkupi zyrtar si pikë referimi e ka Serbinë dhe :Botën Serbe” të marrëdhënieve ndërkombëtare. Unioni si i tillë, me një Serbi pro-ruse, do të jetë një rrjet i mirë për veprimin rus në Ballkanin Perëndimor dhe mbajtjen gjallë të armiqësive të vjetra duke ndërtuar mure të reja. Megjithatë, shqiptarët nuk duhet të hyjnë në aleanca dhe të bëhen pjesë e blloqeve ku pas nismave si garantues mund të jenë shtete të treta. Me liderët aktualë do të jetë vështirë t'i shohim përparësitë dhe rreziqet e hyrjes në unione, aty ku interesi ekonomik kombëtar përdoret si prodhim për shtetet armike të dy shekujve të fundit. Prapëseprapë, Kosova në të ardhmen duhet të vendosë se kah do të shkojë në rast të refuzimit të mundshëm nga Perëndimi dhe ndryshimet radikale në sistemin ndërkombëtar. Politika e kritikave dhe hedhjes poshtë të të gjitha projekteve ndërkombëtare do të ishte e dëmshme për shtetin e ri. Fragmentimi i “Botës Shqiptare” në këtë dekadë veçse ka krijuar përparësi për “Botën Serbe”, ku çuditërisht ka hyrë Shqipëria.



## 1.9 Ballkani i hapur, nismë e dështuar që në start?!



### **Shqipërim PULA, PhD**

Togfjalëshi ‘Ballkani i hapur’ paraqet një nismë rajonale, një mobilizim politik, e cila synon të shpalos angazhimin e vendeve nismëtare dhe nënshkruese si Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, me arsyen e fqinjësisë së mirë dhe nevojës së bashkëpunimit ekonomik e tregtar.

Po a janë të barabartë në aspektin ekonomik shtetet nënshkruese të kësaj iniciative?

A mund të jetë ky plan i Vuçiqit për forcim ndikimi nga Rusia mbi Ballkanin perëndimor?

A mund të konsiderohet “Ballkani i hapur” një lloj konkurrence e “Procesi i Berlinit“?

Zëra brenda UE-së “Ballkanin e hapur” e kanë konsideruar si iniciativë me fokus më tepër mbi marrëdhëniet politike të vendeve nënshkruese se sa ecje drejtë rrugës integruese për UE.

Roli i shtetit amë, Shqipërisë, karshi Kosovës, në vazhdimësi është përshkruar si simbolik në formësimin identitar-kushtetues dhe ndërtimin institucional, për

shkak edhe të brishtësisë politike si rezultat i tranzicionit të tejzgjatur poshtë Drinit të Bardhë.

Aktualisht, pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë nismë Ballkani i hapur do të gjykohej si dëmtim i rimëkëmbjes kombëtare shqiptare dhe i rishikimit të historisë brenda-shqiptarë. Ngase, pjesë të kësaj nisme, e kemi një shqipëtar aty, në cilësi të kryeministrit, e i cili, para se të ulet në tryeza rajonale do duhej të ulet në tryezën kombëtare.

Sepse padrejtësitë që bëhen nga gabimet politike nuk maten fare.

Madje në forumin Alpbach përfaqësues të UE-së, kësaj iniciative i kanë dhënë vlerësim si e pashëndetshme për rajonin. Për më tepër, nuk e mendoj se kjo nismë lidhet me emër të ndonjërit nga përfaqësuesit politikë të shteteve të rajonit, kjo, fillimisht si ide e më pastaj si nismë konkrete është e porositur dhe se protagonistët e vërtet nuk janë këta që i shohim në skenë.

Iniciativa mbi “Ballkani i hapur” tashmë ka pak përkrahës e shumë kundërshtarë!

Cilado iniciativë qoftë ajo, me shtete si Serbia, me fytyrë të buzëqeshur e veprime tendencioze për ta minuar shtetësinë e Kosovës, natyrisht që është jo serioze dhe fare pak, e shëndetshme për Ballkanin. Andaj, në ato takime, mund të ketë politika edhe të gabuara dhe zotime të dobëta për jetësim të tyre, pa mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Unionit Evropian.

Disa shtete të rajonit (Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut) nuk e kanë fokus kryesor integrimin në UE, por marrëdhëniet politike mes vete.

Unioni Evropian, deri më tash, karotën e shkopin, për vendet e Ballkanit Perëndimor nuk e ka pasur racional. Prandaj dhe, lindin ide, e bëhen iniciativa të tilla, si “Ballkani i hapur” edhe si rezultat i përpjekjeve tashmë të dështuara të UE-së për një ripajtim të sinqertë fqinjësie ndërmjet vende të rajonit tonë, konkretisht Kosovës e Serbisë. UE-ja i kishte nënvlerësuar aspektet e gjeografisë politike dhe demografisë të rajonit tonë, kështu që, mbeti tek vullneti i shteteve të rajonit t’i rikrijonjë dhe forcojnë marrëdhëniet politike të tyre, tërthorazi duke argumentuar edhe një lloj dështimi të UE-së, karshi Ballkani Perëndimor. Për më tepër, kjo iniciativë (“Ballkani i hapur”) duhet të jetë një mësim i rëndësishëm për UE-në, për ta rikthyer seriozisht vëmendjen tek rajoni jone.

Sot Kosova po kalon nëpër njërën ndër fazat më kritike të zhvillimit të vet, ç’është e vërteta, edhe më parë, por tani specifikisht me idenë e ‘Ballkani i hapur’ duke pasur mbështetës dhe kundërshtarë mbi trendët pozitivë e negativë

mbi këtë iniciativë. Është mirë të jemi për ndryshime. Por, ndryshimet duhen paraprakisht analizuar e propozuar mbi shumë çështje, e sikundër edhe motivet e angazhimet për to. Prandaj, konsideroj, se realiteti e e ardhmja historike e shoqërisë jo vetëm se nuk e kërkon, por as nuk e lejon të tashmen të braktis përcaktimin e të ardhmes pro-perëndimore.

Republika jonë, duhet t'i përgjigjet shumë temave e iniciativave që shtrohen në kohëra të ndryshme të zhvillimit, por krahas vlerave që duhen ruajtur të sistemit kushtetues. Ideja, iniciativa mbi 'Ballkani i hapur' do duhej, domosdoshmerisht të merr referencë praktika si kriter substancial si zgjidhje për rajonin e rrjedhimisht për shtetet nënshkruese të kësaj iniciative. Po a janë të barabartë në aspektin ekonomik shtetet nënshkruese të kësaj iniciative? JO, sepse ekonomitë e shteteve nënshkruese as për së afërmi nuk janë të barabarta sepse eksportet në 2020 të 6 vendeve të Ballkanit; Shqipëria 2,23 miliardë, Bosnja 5,36 miliardë, Kosova 0,47 miliard, Mali i Zi 0,34 miliard, Maqedonia e Veriut 5.58 miliardë dhe Serbia 17,05 miliardë, në përlllogaritje del të jetë 5 shtetet së bashku t'i kenë 13,98 miliardë, ndërkaq Serbia e vetme 17,05 miliardë. Atëherë, të bashkohesh rreth një ideje apo të përbashkohesh rreth një nisme, siç e menduar, e para dhe para-së-gjithash, duhet të jesh i barabartë sepse vetëm të barabartit mund bashkërisht të kenë të ardhme.

Natyrisht, e ardhmja, mund të jetë gjithqysh por ide apo iniciativa si 'Ballkani i hapur' nuk duhet vënë në pikëpyetje parimet e barabarësisë. Po ashtu, katër parimet substanciale mbi të cilat është ngritur Unioni Evropian, nuk gjejnë prekje reale e të sinqertë me shtete hegjemoniste, si Serbia, andaj politikat e fqinjësisë së mirë, dhe jetësimi i katër parimeve të UE-së si kategori juridike bëhen të realizuara plotësisht dhe baras vetëm atëherë kur të gjykohet e kaluara dhe kërkohet kërkim-falja, e deri atëherë, çdo ide apo iniciativë, sado bukur e prezantuar, do jetë gjysmake dhe sipërfaqësore nëse do ketë trysni nga qarqe të caktuara mbi qeveritë e vendeve tona. Në kuptim kushtetues e politik, aktualisht nuk mund të ketë veprime të duhura juridike mbi iniciativën e tillë, po vetëm veprim-e të porositura dhe të përshtatura nga politika.

Kosova kujdesshëm duhet analizuar këtë iniciativë dhe sigurisht duhet të veproj me sens të përgjegjësisë institucionale-shtetërore lidhur me gjendjen në vend dhe rajon, e pse jo të ofroj edhe ndonjë platformë si zgjidhje e opsione të shqyrtimit paralel për të shmangur 'deja vu' rajonale.

Deshën apo nuk deshën protagonistët dhe porositësit e kësaj nisme, pa një kuvendim me Kosovën përkatësisht qeverinë e vet, është e gjykuar të dështoj.

## **II. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE - KURTHI I GJEOPOLITIKËS SERBE**

### **2.1 ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË DRITËN E SË DREJTËS KUSHTETUESE**



**Prof. Dr. Mazllum BARALIU**

**MARRËVESHJET E BRUKSELIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS DHE REPUBLIKËS SË SERBISË PËR NORMALIZIMIN  
E MARRËDHËNIEVE DHE MBI PARIMET - E VITEVE 2013 DHE  
2015., SI DHE PASOJAT E TYRE POTENCIALE NË RAST TË  
APLIKIMIT TË TYRE NË PRAKTIKË NË REPUBLIKËN E  
KOSOVËS**

**- NJË ANALIZË KUSHTETUESE-JURIDIKE DISKURSIVE -**

**... “AS NDER, AS TURP, AS GJAK S’KINI  
UNJI KRYET DHE PO RRINI...”**

**KONICA**

**“JU PO I BËNI PRESION KOSOVËS QË TA IMPLEMENTOJË NJË  
ASOCIACION TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË  
KOSOVË.**

**PËRKUNDRAZI, PRESIONI DUHET TË JETË MBI SERBINË, QË  
TA NJOHE PAVARËSINË DHE SOVRANITETIN E KOSOVËS”.**

**BOB MENDENEZ**

**“...FORMIMI I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË  
SERBE MUND TË PARAQESË NJË TERREN TË RI PËR NXITJEN  
E NACIONALIZMIT LOKAL RUS NË KOSOVË.”**

**SONJA BISERKO**

**“NE DUHET VAZHDMISHT DHE PA U LODHUR TA NDËRTOJMË  
DHE VENDOSMËRISHT E ME TË GJITHA MJETET TA RUAJMË E  
TA MBROJMË SHTETIN, TË CILIN E KEMI KRIJUAR ME MUND;  
ME GJAK; ME DJERSË E KALVAR - PA PARË POTHUAJSE ASNJË  
DITË TË BARDHË”.**

**M.SH.B.**

## **PARAHYRJE PËRORIENTUESE SHQYRTIMORE**

Në këtë punim diskursiv shpërfaqën përpjekjet modeste, por të koncentruara dhe integrative të autorit, për të shkoqitur dhe përimtuar disa nga elementët qenësore - ndërdimensionale dhe kompozicionale të marrëveshjeve të Brukselit të prillit të 2013 dhe të gushtit 2015., të lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, si dhe rrjedhojat e tyre potenciale, të cilat do të pasonin - sa i përket funksionimit të rendit tonë kushtetues-juridik - në rast të pranimit dhe aplikimit eventual të këtyre marrëveshjeve në praktikë - në Republikën e Kosovës.

**FJALËT ÇELËS: ASOCIACIONI, MARRËVESHJET, PARIMET,  
KOSOVA**

## **I. PËRGJITHSISHT PËR TRAKTATET NDËRKOMBËTARE DHE PËR PALËT MARRËVESHTORE**

Fillimisht le të shohim, se çka përmban e drejta ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare përmban rregullat, me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis subjekteve të së drejtës ndërkombëtare. Subjektet e së drejtës ndërkombëtare, nga ana tjetër, janë ose mund të jenë **shtetet**; organizatat ndërkombëtare; njësitë federale - në shtetet federative - kuptohet në përputhje me rendet e tyre kushtetuese; distriktet e internacionalizuara dhe në mënyrë indirekte edhe

individët - përfaqësues të caktuar. Këtu parësisht mendohet në reprezentuesit-përfaqësues të kryengritësve, po qe se janë të pranuar si palë ndërluftuese.

Pra palët e traktateve a marrëveshjeve ndërkombëtare, janë ose edhe më mirë mund të jenë të gjitha ato subjekte, që janë të pranuar në të drejtën në përgjithësi apo në të drejtën ndërkombëtare - në veçanti.

Vijimisht subjektet janë ato palë, të cilave u është pranuar apo njohur subjektiviteti ndërkombëtar-juridik. E këtu siç u tha edhe më parë bëjnë pjesë në radhë të parë shtetet. Çdo shtet ka aftësi-zotë -si të lidhjes apo për lidhjen e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare.

Sipas njërit nga të pesë (5) parimet e abatit Gregoar - përkitazi me të drejtat dhe detyrat e shteteve - të vitit 1792.,: **“traktatet që lidhen në mes të shteteve janë të shenjta dhe të pacenueshme”**. Kuptohet që ky parim padyshim që në vetvete e nënkupton dhe e ngërthen domosdo edhe parimin e **barazisë dhe të mirëbesimit** të palëve në traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ndër pesë të drejtat themelore të një shteti, që pretendon të jetë edhe subjekt ndërkombëtar i së drejtës ndërkombëtare dhe të cilave të drejta u përgjigjen ose më mirë, do të duhej t’u përgjigjeshin edhe detyrimet e shteteve të tjera, janë:

**#. E drejta e sovranitetit dhe e pavarësisë;**

**#. E drejta për ekzistencë apo e drejta në mbrojtje;**

**#. E drejta e barazisë ose në barazi;**

**#. E drejta për tu respektuar dhe**

**#. E drejta për të komunikuar a për komunikim me shtetet e tjera.**

#### **a) Pjesët përbërëse të traktateve a marrëveshjeve ndërkombëtare**

Traktatet a marrëveshjet ndërkombëtare, në parim dhe sipas rregullit, përbëhen nga tri pjesë:

1.Pjesa hyrëse apo edhe preambulare;

2.Pjesa qenësore - kryesore ose edhe dispozitive dhe

3.Pjesa përfundimtare ose definitive.

**- Pjesa hyrëse ose preambulare** e traktateve a marrëveshjeve ndërkombëtare inkorporon në vetvete: **titullin; preambulën; thirrjen përëndive; ndërsa në preambulë vihet: emri i shtetit, përfaqësuesit, motivet dhe qëllimet; emrat e bashkëbiseduesve marrëveshtorë apo të negociatorëve - nënshkrues dhe plotfuqishmëritë.**

**- Pjesa qenësore-kryesore ose dispozitive** është në fakt pjesa thelbësore e një marrëveshje dhe si e tillë përfshinë në vete të drejtat dhe detyrimet e palëve apo të subjekteve nënshkruese të marrëveshjes.

**- Në pjesën përfundimtare**, ndërkaq flitet për **fuqizimin e traktatit a marrëveshjes; për mënyrat e ratifikimit; kohëzgjatjen; heqjen dorë nga marrë**

**-veshja; denoncimin; interpretimin; vendin e zbatimit a të implementimit; rezervën...; vendin; datën; vulat etj.**

Marrëveshjet a traktatet ndërkombëtare - në parim ( sikurse edhe bazuar në parimin e parapërmendur të Gregoarit - në këtë shkrim) - dhe përgjithësisht, do të duhej, që ta kenë bazë themelore inkorporimin dhe aplikimin e parimit të mirënjohur: **“PACTA SUNT SERVANDA”** apo në shqip: **“MARRËVESHJA DUHET TË ZBATOHET”**.

Kjo do të thotë se palët a subjektet ndërvepruese-negociatore - gjatë lidhjes së traktateve a marrëveshjeve të caktuara ndërkombëtare, po ato, pas lidhjes dhe ratifikimit të tyre, duhet edhe t'i përmbushin dhe zbatojnë me **MIRËBESIM** - **“BONA FIDAE “**- edhe në praktikë.<sup>4</sup>

Duke u bazuar në bamurinë se pothuajse çdo rregull dhe parim; sado utilitar, autentik, empirik dhe i brumosur qoftë, nuk mund të mos ketë një apo më shumë përjashtime -gjatë udhëtimit dhe zbatimit të tij në jetën praktike.

Kjo jo rrallëherë korrespondon me situata e raste, **kur marrëveshjet ndërkombëtare edhe mund të mos zbatohen fare në praktikë.**

Pamundësia e realizimit dhe zbatimit të një a më shumë traktateve a marrëveshjeve - nga palët përkatëse ndërkombëtare, ndodhë jo rrallë herë në marrëdhëniet ndërkombëtare, parësisht për shkak **të ndodhjes a ndryshimit të rrethanave dhe kushteve të paparashikuara - ( Parimi: “REBUS SIQ STAN -TIBUS).**

Pra, në pamundësi të zbatimit ose në rast të ndryshimit qenësor të kushteve dhe rrethanave ç bazuar në parimin e përmendur pak më parë - **rebus siq stan - tibus - pra, edhe mund edhe duhet të mos zbatohen traktatet a marrëveshjet ndërkombëtare** - paraprkakisht të lidhura e të ratifikuara madje - në mes të shteteve - palë a subjekte të këtyre marrëveshjeve, rrjedhimisht të së drejtës ndërkombëtare, kuptohet në rast kur subjekte marrëveshtore janë shtetet edhe nëse interesat jetike të shteteve - palë të traktateve a marrëveshjeve të tilla e kërkojnë një gjë të tillë nga vetë përfaqësuesit negociatorë.

## **b) Natyra dhe karakteri i traktateve a marrëveshjeve ndërkombëtare**

Traktatet ndërkombëtare nënkuptojnë çdo pajtim të vullnetit në mes të shteteve - palë a subjekte të së drejtës ndërkombëtare, me qëllim të **krijimit, ndryshimit ose ndërprerjes së ndonjë raporti juridik reciprok ose marrëveshje të karakterit marrëveshtor - kontraktual - në mes të shteteve**

---

4 Shih më detajisht dispozitat e nenit 2., të Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe dispozitave të nenit 26 të Konventës së Vjenës

**ose organizatave shtetërore**, me të cilat krijohen të drejta dhe detyrime të caktuara - për palët përkatëse marrëveshtore.

Sipas disa autorëve, marrëveshjet a traktatet ndërkombëtare duhet të lidhen doemos me shkrim, ngase vetëm në këtë mënyrë - sipas tyre, do të mund të konstatohet qartë e çiltër - vullneti i shprehur i palëve. I bashkëngjitemi këtij pikëqëndrimi, ngase siguria juridike dhe qartësia transaksionale në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare, mund të kenë fushështirje dhe zbatim dukshëm më të qartë, më të mirëfilltë, me të sigurt dhe mbase edhe më afatgjatë; ndërsa mosmarrëveshje, rezerva dhe kontestime mund të ketë më pak - në mes të palëve-subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Synimi dhe objektivi kryesor i subjekteve të së drejtës ndërkombëtare –përmes traktateve a marrëveshjeve ndërkombëtare; (qoftë bilaterale; qoftë multilaterale), është që po ato subjekte, të dakordohen për çështje të ndryshme të relevancës dhe interesave primare të shteteve të caktuara – të cilat mund të jenë palë potenciale ose reale e traktateve a marrëveshjeve të caktuara - në mes tyre.

Marrëveshjet a traktatet në të drejtën ndërkombëtare, respektivisht në marrëdhëniet ndërkombëtare, mund të emërtohen edhe me emra të tjerë, si: KONVENTA, PAKTE, MODUS VIVENDI etj. Termi modus Vivendi, përdoret për marrëveshje të përkohshme, për të cilat – në ndërkohë - pritët që në të ardhmen të zëvendësohen me një traktat ose me ndonjë konventë pasuese të natyrës dhe karakterit më afatgjatë.

### **c) Efektet e lidhjes, rrjedhimisht nënshkrimit të marrëveshjeve-traktateve dhe rezerva**

Sipas nenit 14 të Konventës së Vjenës, ratifikimi i një marrëveshjeje, duhet të bëhet nëse:

- a).parashihet shprehimisht;
- b). nëse palët janë dakorduar;
- c). nëse është paraparë me plotfuqishmëritë.

Disa marrëveshje nuk ratifikohen fare, sepse ekziston e drejta diskrecionale e shteteve - palë; ndërsa disa marrëveshje, nuk zbatohen, në qoftë se palët ose njëra palë marrëveshtore, ka shprehur **rezervë** ose nëse kanë kaluar - ndodhur a ja -në zhvilluar rrethana e kushte të reja e të ndryshme ( nga ato që kanë ekzistuar në kohën e lidhjes së një traktati apo marrëveshjeje në mes të dy apo më shumë shteteve - palë dhe subjekte në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare), të cilat dukshëm kanë ndikuar që traktati apo marrëveshja të mos ratifikohet.

**Rezerva** ndërkaq, është një deklaratë e njëanshme e një shteti - që shprehet në ndonjërin fazë të traktatit a marrëveshjes ose edhe më vonë. Pala ose palët, për shkaqe të ndryshme nuk mund të pranojnë detyrime nga traktati a



marrëveshja e caktuar ose edhe vetëm nga një pjesë e vetme e marrëveshjes përkatëse. Disa traktate, siç u tha edhe më parë, mund ta ndalojnë fare dhe shprehimisht rezervën, por kjo për shembull nuk ka ndodhur fare me marrëveshjen e prillit të vitit 2013 ., për asociacionin, të lidhur në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel.

Supozohet deri në konsiderim se një akt ndërkombëtar - **është i vlefshëm**, përderisa nuk dëshmohet ekzistimi i **mangësive apo mungesave të caktuara të tij**, të cilat atë akt e **bëjnë të pavlefshëm**.

## **II. LIDHJA E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE SIPAS LIGJIT PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE TË KOSOVËS**

### ***1. E drejta e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare - sipas Ligjit të Kosovës për marrëveshjet ndërkombëtare***<sup>5</sup>

Të drejtën e nismës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas dispozitave të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare e kanë organet shtetërore të Republikës së Kosovës - në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjin në fuqi. Të gjitha nismat për ndonjë marrëveshje ndërkombëtare, të cilat mund të vijnë nga cilado ministri, sipas këtij ligji miratohen - në parim nga Qeveria; kuptohet, pas rekomandimit të dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës.<sup>6</sup>

Para se të vijojmë me trajtimin e procedurës së shqyrtimit të projekt-marrëveshjeve ndërkombëtare dhe kompetencat për të lidhur këso marrëveshje, le të shohim se si përkufizohet me këtë ligj një marrëveshje, përkatësisht një traktat ndërkombëtar, i cili mund të lidhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, por edhe të parimeve dhe standardeve të së drejtës ndërkombëtare - përgjithësisht.

Sipas dispozitave të nenit 3 të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshje a traktat ndërkombëtar, konsiderohet një marrëveshje, përkatësisht traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare - **në formë të shkruar**, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare, pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura.

Sa i përket **procedurës së shqyrtimit të projekt-marrëveshjeve ndërkombëtare**, tekstet e tyre hartohen nga ministria apo agjencia shtetërore kompetente, iu dërgohet ministrive ose agjencive shtetërore përkatëse - për

---

5 Ligji nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare i Kosovës, i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës/ nr. 28/16 dhjetor 2011, Prishtinë, 2011.

6 Shih dispozitat e nenit 4 të ligjit në trajtim

shqyrtim; ndërsa **kompetenca** ndërlihdur me të gjitha veprimet për sa i takon lidhjes se traktateve apo marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, duke përfshirë këtu edhe negociatat për marrëveshje, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës së Vjenës **i takon**: Presidentit të vendit; Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës.<sup>7</sup>

## ***2. Ratifikimi i marrëveshjeve a traktateve ndërkombëtare dhe rezerva***

Pas procesit të përgatitjes, negocimit dhe lidhjes së traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas ligjit tonë në fuqi, pason ratifikimi i po atyre marrëveshjeve a traktateve ndërkombëtare.

**Ratifikimin** e këtyre traktateve a marrëveshjeve e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës, me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit.<sup>8</sup> Mirëpo, Ligji i Kosovës për marrëveshjet ndërkombëtare, në dispozitat e tij ka inkorporuar edhe **rezervat dhe deklaratat**.

**Rezerva** sipas dispozitës së nenit 3 p.1.9., të ligjit në trajtim, konsiderohet deklarata e njëanshme, që bëhet nga organi kompetent shtetëror, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, aderimit ose miratimit të një marrëveshjeje, me anën e së cilës, po ai organ, synon të përjashtojë ose modifikojë efektet ligjore të dispozitave të caktuara. Gjykuar sipas paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit në trajtim, në qoftë se ekzistojnë rezerva dhe/ose ka deklarata rreth një marrëveshjeje ndërkombëtare, ministria ose agjencia shtetërore përkatëse dhe kompetente e Kosovës i raporton këto te ministritë dhe agjencitë qeveritare relevante - gjatë procedurës së shqyrtimit- në bazë të nenit 5., të po këtij ligji. **Tërheqja nga marrëveshja** ose amendamenti i rezervave dhe/ose i deklarata -ve, në lidhje me marrëveshjen e caktuar ndërkombëtare, duhet t'i nënshtrohet kërkesave të nenit 10 të këtij ligji (paragrafi .3 i nenit 11 të ligjit në trajtim).

## ***3. Ndryshimi dhe plotësimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës***

Sipas ligjit në fuqi të Republikës së Kosovës, **në mënyrë taksative lejohet ndryshimi dhe plotësimi i cilësdos marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në cilëndo kohë, kurdo që konsiderohet se interesat e shtetit, respektivisht të**

---

7 Më gjerësisht, shih dispozitat e nenit 5 ;6;7 dhe 8., të Ligjit për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare i Kosovës

8 Më shumë për këtë, shih nenin 10 të ligjit në trajtim.

**politikës së tij të jashtme a të brendshme e kërkojnë apo e imponojnë një veprim të tillë.**

Një marrëveshje ndërkombëtare e Republikës së Kosovës, mund të ndryshohet ose plotësohet - në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në bazë të procedurës së përcaktuar në këtë ligj për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, përveç nëse parashihet ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare (neni 17 i ligjit në trajtim).

#### ***4. Tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose suspendimi i zbatimit të tyre***

Sipas dispozitave të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, **mund të tërhiqen dhe zbatimi i tyre mundet po ashtu të suspendohet.** Ligji në këtë çështje është mjaftë preciz, strikt dhe decidiv, duke e përcaktuar qartë e çiltër se **tërheqja dhe suspendimi** mund të bëhet vetëm në bazë të dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në bazë të procedurës së vendosur përmes këtij ligji (neni 18. , paragrafi 1 ( një) i ligjit); por megjithatë **në rast nevoje, arsyeje apo shkaku; siç është për shembull ndry -shimi i rrethanave; madje edhe ndryshimi (ardhja) e vetë qeverive të tjera në pushtet - kurdo që qeveria apo institucionet e tjera relevante të Republikës së Kosovë e shohin të arsyeshme; sidomos kur është fjala për ruajtjen e sovranit -tetit të shtetit, kanë të drejtën e tyre sovrane; të pamohueshme dhe të patjetërsueshme për tërheqje nga çfarëdo marrëveshjeje të Republikës së Kosovës.**

Vendimin për tërheqje nga një marrëveshje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose për suspendimin e zbatimit të saj e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës, me dy të tretat ( 2/3) e votave, pas rekomandimit të Presidentit-/es, me iniciativë të tij/saj ose pas propozimit të Qeverisë (neni 18., paragrafi 2., ndërlidhur me paragrafin një (1) të nenit 10., të ligjit në trajtim).

### III. PËRGJITHSISHT SA U PËRKET DISA VROJTIMEVE KONKRETE ANALITIKE-INTETIKE PËRKITAZI ME MARRËVESHJEN E 19 PRILLIT TË VITIT 2013 NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË NË BRUKSEL

#### *1. Konteksti temporal-politik dhe gjendja a diversiteti i opinionit publik në Kosovë, para dhe pas miratimit të marrëveshjes së parë të Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - për Asociacionin e komunave me shumicë të banorëve serbë në Kosovë*

Idetë, synimet, propozimet, veprimet hegjemoniste dhe projektet ekspansioniste serbo-sllave për gllabërimin e tokave shqiptare, duke inkorporuar këtu edhe territorin e Kosovës, as nuk janë të reja dhe as nuk janë shuar kurrë. Ndër të gjithë popujt e Siujdhesës Ilirike (Ballkanit), populli ynë e ka pësuar copëtimin më të madh dhe më tragjik territorial; duke mbetur i ndarë në 6 shtete të siujdhesës dhe në Turqi.

Edhe Kosova, fatkeqësisht e pati fatin e njëjtë historik, me vendet e tjera simotra shqiptare; pra ishte e robëruar nga dora në dorë, deri në qershor të vitit 1999., të shekullit të kaluar.

“Serbia po kërkon ‘hise’ në territorin e Kosovës, pa qenë e ndërgjegjshme se është pikërisht ajo që e kishte pushtuar Kosovën nga viti 1912 dhe disa herë të tjera në ndërkohë: me 1918, më 1945 dhe me 1989”. Pas gjenocidit të fundit, që e bëri në vitet 1998 dhe 1999, Serbia përfundimisht e humbi çdo pretendim a të drejtë reinvendikative; pra të kthimit në gjendjen e mëparshme në Kosovë, por nuk e humbi shpresën për hegjemoni, keqbërje dhe destruksion - ndaj Kosovës dhe njerëzve të saj shumicë në te. Serbia pothuajse në vazhdimësi ka pretenduar dhe ushtruar **destruksionin, metodat më bizare destabilizuese, përpjekje morbide dhe perfide për ndarjen a copëtimin e Kosovës; Asociacionin e komunave me popullsi shumicë serbe e deri të defunksionalizimi dhe zhbërja eventuale totale a parciale e shtetit tonë.**

Duke synuar ndarjen e Kosovës midis saj dhe Shqipërisë, Serbia militare do të donte: **“ta ndajë përgjithmonë atë; pra Kosovën - midis saj, pra Serbisë dhe Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë, ajo do të dëshironte “t’i shmangej” njohjes së Kosovës si shtet i pavarur.”**<sup>9</sup>

#### *2. Dërgimi i çështjes së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë nga Serbia dhe shpallja rezolutive e mendimit të saj pozitiv përkitazi me pavarësinë e Kosovës*

---

9 Akademik, Esat Stavileci, ibidem., fq. 15.

Duke mos pasur mundësi as zgjidhje tjetër - të përshtatshme dhe të super - favorshme për të, por edhe duke shpresuar për një përfundim ndryshe nga që i doli më pas; pra për një përfundim të favorshëm për te, Serbia çështjen e drejtshmërisë së shpalljes dhe validitetit të pavarësisë së Kosovës, e dërgoi në Gjykatën ndërkombëtare të drejtësisë në Hagë të Holandës. Mirëpo shpallja e mendimit të Gjykatës ndërkombëtare të drejtë -sisë në Hagë, në favor të Kosovës ishte një dush i ftoftë për Serbinë e kohës dhe **ishte jo vetëm një verdikt i drejtë dhe korrekt i asaj gjykate, por edhe një fitore glorioze e drejtësisë ndërkombëtare dhe e vetë Kosovës asokohe.**

Pra, shpallja e mendimit të Gjykatës ndërkombëtare të drejtësisë (22 korrik 2010), përkitazi me ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës dhe vetë aktit të pavarësisë - nga Kuvendi i saj, **pa asnjë mëdyshje ishte në fakt, arritja më e madhe e vetë Kosovës, në konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë së saj.**

Kjo gjykatë në të vërtetë, me mendimin e saj rezolutiv-pozitiv, ka konfirmuar qartë dhe çiltër se shpallja e pavarësisë së Kosovës, në asnjë mënyrë dhe në asnjë segment, nuk e ka cenuar fare as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe as Kornizën Kushtetuese, të miratuar asokohe nga administrata ndërkombëtare, e njohur si UNMIK- në Kosovë.

Mirëpo, ndonëse mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në mënyrë meritore dhe të pakontestueshme e rezolutive e ka konfirmuar dhe afirmuar ligjshmërinë ndërkombëtare të shpalljes dhe ekzistimit notor të shtetësisë së Republikës së Kosovës, si dhe ka krijuar kushte dhe rrethana dukshëm më të favorshme për integrim brenda bashkësisë ndërkombëtare, këtë mundësi të artë dhe relevante, as në rrafshin diplomatik dhe as në atë politik, nuk e shfrytëzoi dhe as nuk e kapitalizoi Kosova.

Për rrjedhojë, fatkeqësisht në shtatorin e po të njëjtit vit, do të pasojë një rezolutë - **pa dyshim e pafavorshme dhe e dëmshme** për Kosovën - atë ditë e sot.

### ***3. Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara e 9 shtatorit 2010***

Kjo rezolutë e OKB-së me numër 64/298 e datës 9 shtator 2010 ishte sponsorizuar nga eksponentët e Bashkimit Evropian dhe ata të Serbisë, me qëllim kinse për të ndihmuar dialogun prosperues dhe perspektiv në mes të palëve. Ndonëse përmbajtja e rezolutës kishte synim dhe objektiv parësor dhe ekskluziv zhvillimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizim të marrëdhënieve, respektivisht për çështje teknike - në mes të dy shteteve sovrane -, në ndërkohë u bë e qartë për të gjithë se qëllimi i iniciativës serbe për një rezolutë të tillë, ishte si gjithmonë destruktiv dhe dashakeq - ndaj

Kosovës dhe shtetësisë së saj. Përse? **Sepse Serbia fillimin e dialogut me Kosovën e keqpërdori në arenën ndërkombëtare, duke propaganduar ndër shtete dhe qeveri të ndryshme, se kinse me Kosovën po bisedohej dhe duhej të bisedohej për çështje të statusit të saj të ardhshëm;** ndaj sipas saj edhe shtetet mosnjohëse deri atëherë, nuk do të duhej ta njihnin Kosovën - gjithnjë sipas propagandës së saj helmuese -, por duhej të prisnin epilogun e bisedimeve - për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Prandaj, me plotë gojë dhe argumente të shumta, mund të konstatohet këtu, se diplomacia, rrjedhimisht politika e jashtme dhe diplomacia tejet dhe vazhdimisht perfide serbo-sllave e Beogradit e vuri në lajthim edhe Asamblenë e OKB-së dhe gjithë Organizatën e Kombeve të Bashkuara, por edhe tërë Bashkësinë ndërkombëtare të kombeve të civilizuar; si me këtë rezolutë, po ashtu edhe me veprimet, sjelljet dhe politikat diplomatike të saj në relacion me kinse dialogun me Kosovën.

Përse? Sërish sepse Serbia, duke e manipuluar si OKB-në, po ashtu edhe BE-në dhe Kosovën, më saktësisht përfaqësuesit e saj institucional, ajo nën fashën dhe ombrellën kinse dialoguese - “konstruktive”, inkorporoi me sukses, por në dëm të parikuperueshëm të Kosovës dhe të perspektivës së saj shtet-konsoliduese edhe ato 6 pikat defamoze të Ban Ki Munit edhe shumë e shumë çështje e problematika të tjera - që ishin jashtë kompleksit morbid politik dhe kushtetues-juridik të të ashtuquajturit “Plan i Ahtisarit”; që në fakt ishin çështje kryesisht ose madje edhe ekskluzivisht çështje të brendshme sovraane të Kosovës - për të cilat, pothuajse më shumë se një dekadë, po bisedohet padrejtësisht dhe kundërkushtetutshmërisht me Serbinë dhe BE-në në Bruksel - pa pothuajse asnjë sukses dhe pothuajse asnjë rezultat të prekshëm e konkret afat -gjatë e frytdhënës. Përsëri përse? Ndër të tjera sepse, Serbia po kalkulon dhe po bën obstruksione të qarta; si ndaj Kosovës edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare, pra ajo, nuk është e interesuar që të ketë - madje asnjë marrëveshje përfundimtare për çfarëdo çështje - qoftë ajo edhe çështje minore e lëre më për një kinse marrëveshje gjithëpërfshirëse - për njohje reciproke, siç po trumbetohet me vite, qoftë në Bruksel apo në Prishtinë e gjetiu.

Prandaj, si rrjedhojë e pasojave të kësaj rezolute, mungesës së parimësisë së BE-së; Bashkësisë ndërkombëtare dhe vetë morbiditetit dhe obstruktivitetit të Serbisë; por gjithsesi edhe gabimeve pothuajse të vazhdueshme dhe të pafalshme të Kosovës dhe institucioneve të saj përfaqësuese, rezultatet e procesit të dialogut( fillimisht teknik, që pat filluar me 8 mars 2011., në Bruksel)<sup>10</sup> edhe pas një sage më shumë se dhjetëvjeçare, ishin pothuajse barazi me asgjë.

---

10 Ksenofon Kristafi,: “Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike,UMSH Press dhe Onufri, Tiranë 2018., fq. 406.

Pse? Sepse, përveç tjerash po ky proces, në fakt ishte dhe është edhe tani jo proces teknik apo për çështje teknike reversibile - në mes të dy shteteve sovrane, por një proces i pastër negociator-politik-diplomatik, madje shumë i komplikuar, i cili në të njëjtën kohë është edhe një proces totalisht i pabarabartë dhe joparimor - në mes të palëve – po ashtu të pabarabarta, që vazhdon e nuk përfundon dot, që nga viti 2011 e deri me tash; si një proces më tepër se minor dhe i shtirur; ndërkohë që degradimi dhe dëmtimi i Kosovës, nga stagnimi i procesit të njohjeve e deri të rritja e numrit të shteteve mosnjohëse (çnjohjet nga shtetet paraprakisht njohëse) dhe deri të acetriksi ose fusnota, e cila si një reprezentim i shtetit gjithsesi paraqet një prapakthim serioz për shtetin e Kosovës, e i cili proces ende po vazhdon.

**Vazhdohet po ashtu në mënyrë joparimore, të padrejtë e të pahijshme, jokorrekte e madje edhe të pashembullt e të papranueshme, që në mes të dy shteteve sovrane, të bisedohet e dialogohet pothuajse ekskluzivisht për punë dhe çështje të brendshme të Kosovës dhe më shumë në dëm të saj se sa në dobi të saj.** Kjo gjendje në të vërtetë paraqet dhe nënkupton edhe një prapakthim tjetër fatal në përfaqësim dhe reprezentim të shtetit - nga një surrogat fantom i prototipit: “as mish as peshk”, siç është i ashtuquajtimi UNMIK. Gabimet e tilla të së kaluarës, janë të dënueshme jo vetëm politikisht, por edhe penalisht dhe moralisht, ndaj si të tilla, druaj se kanë dhe do të kenë rrjedhoja tejet negative, madje edhe mbase të pakompensueshme edhe në të ardhmen; ndaj edhe nuk na lejohet që në të ardhmen eventualisht të na përsëritën sërish gabimet e tilla fatale, që për fat të keq na kanë ndodhur relativisht shpesh në të kaluarën.<sup>11</sup>

#### ***4. Disa nga vrojtimit relevante analitike dhe sintetike lidhur me marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, apo si njihet e emërtohet shpesh në opinion publik si Marrëveshja e Brukselit për Asociacionin e komunave me shumicë serbe në Kosovë, e 19 prillit të vitit 2013.***

Bazuar në atë që është shkruar dhe argumentuar më sipër në këtë shkrim, si dhe në standardet dhe parimet, në të cilat mbështetët dhe funksionon me shekuj diplomacia dhe politika e jashtme brendapërbrenda marrëdhënieve ndërkombëtare - në të drejtën ndërkombëtare, krahas problemeve dhe defekteve të pariparueshme strukturale dhe përmbajtjesore, marrëveshja e

---

11 Prof. asoc. dr. Ibrahim Gashi: “Republika e Kosovës si subjekt legal në marrëdhëniet ndërkombëtare - Synimet dhe perspektivat”, në Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Sfidat e shtetndërtimit dhe e Ardhmja e Kosovës, Kollokium shkencor, 15 qershor 2011., fq. 34-35.

ashtuquajtur për normalizim, ka edhe shumë mangësi e defekte të tilla formale - juridike dhe diplomatike - në brendinë e saj.

**4.1.** Me insistimin dhe obstrukcionet diplomatike e negociatore serbe, marrëveshja në fjalë në tërë qenësinë e saj strukturale dhe përmbajtjesore, është difektuoze dhe në shpërputhje me kërkesat dhe standardët e Konventës së Vjenës, dispozitave të Ligjit të Kosovës për traktatet a marrëveshjet ndërkombëtare, uzuset dhe standardet ndërkombëtare, që aplikohen për çdo ditë në transaksionet diplomatike në marrëdhëniet në mes të shteteve të ndryshme - subjekte të së drejtës ndërkombëtare.

Pra, marrëveshjes në trajtim i mungojnë që tri pjesët kryesore, (shiko më detajisht nën pikën I të këtij shkrimi), të cilat janë dhe duhet të jenë të aplikueshme gjatë përpilimit të çdo marrëveshje apo traktati ndërkombëtar - në mes të dy apo më shumë palëve - shteteve - subjekte të së drejtës ndërkombëtare.

**4.1.2.** Marrëveshja është e shkruar **në një copë letre të thjeshtë të formatit A-4** ., pa siglat dhe tiparet e tjera relevante e domosdoshme në transaksionet e tilla ndërkombëtare. Marrëveshja në shqyrtim është shkruar madje edhe me shkronja të vogla. Se këtë marrëveshje e ka “shkruar”, pranuar dhe nënshkruar dikush, mund të kuptohet vetëm nga le të themi “vula” katrore e vënë në pjesën e epërme të djathtë të letrës A-4., ku shkruan: “Qeveria e Kosovës; njësia organizative 01; nr. i protokollit 1039; nr. i faqeve 02; data 19. 4.2013; dhe identifikimi i qytetit të Prishtinës, me Prishtinë; ndonëse Marrëveshja si e tillë ishte proklamuar si e lidhur - në mes të palëve - në Bruksel.

**4.1.3.** Nga teksti i publikuar, marrëveshja në fjalë nuk pasqyron as nënshkrimet e palëve; gjë që ndër të tjera dëshmon faktin notor dhe të pakontestueshëm, që **kjo marrëveshje nuk i plotëson as standardët minimale ndërkombëtare dhe as kërkesat minimale të profesionit, në këtë rast të diplomacisë.**

**4.1.4.** Kjo mënyrë e veprimit në përpilimin e një kinse marrëveshjeje të tillë, ndër të tjera tregon dhe dëshmon faktin se Serbia dhe bashkimi ndërmjetësues-lehtësues evropian ishin ata, që kështu donin dhe ia impononin Kosovës. Pra, **lidhjen dhe pranimin e një marrëveshjeje të pabarabartë dhe skajshmërisht të dëmshme për Kosovën - në mes të palëve të pabarabarta** dhe në një proces kinse dialogimi, por që ishte i imponuar, e në të cilin proces, faktikisht dhe realisht Serbia kinse dialogonte me “përfaqësuesit e Prishtinës” rrjedhimisht “Kontrapartët e një pjese të kinse territorit të tyre”...

**4.1.5.** Nga aspekti formalo-juridik, mbase për dikë e parëndësishme, por në aspektin esencial gjithsesi ka peshë dhe rëndësi të dorës së parë, se kjo marrëveshje nga ana e Kuvendit të Serbisë nuk është ratifikuar, ndërsa nga Kuvendi i Kosovës - me ligj të veçantë dhe votim të duhur, po kjo marrëveshje skajshmërisht e dëmshme për Kosovën - fatkeqësisht është ratifikuar.



**4.1.6.** Mbështetur në dispozitat e Konventës së Vjenës dhe Ligjit të Kosovës për marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshja e prillit të vitit 2013., e lidhur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke e ditur dhe provuar iks herë moslojalitein, jokorrektësinë dhe mosqendrueshmërinë diplomatike të saj në të përmbajturit dhe respektimin e marrëveshjeve që ajo lidh, veçanërisht me Kosovën - në aspektin formal-juridik të paktën është dashur që në mënyrë shprehimore të inkorporojë **edhe rezervën eventuale** për të; si dhe mundësinë **për tërheqje eventuale** nga marrëveshja ndërkombëtare në fjalë.

**4.1.7.** Marrëveshja e Brukselit e 19 prillit 2013 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë **me asnjë element, me asnjë kusht, a segment të saj, nuk i përmbush kërkesat, uzuset, kriteret dhe as standardet ndërkombëtare për të qenë si e tillë një marrëveshje e kompletuar**; brenda kornizave kushtetuese-ligjore dhe respektabile për nënshkrim, ratifikim, e më pas edhe zbatim në praktikë të saj.

## ***4.2. DISA NGA DISPOZITAT DIFEKTUOZE, TË DËMSHME, ME PASOJA DHE TË PAPRANUESHME NË STRUKTURËN PËRMBAJTJESORE TË MARRËVESHJES SË 19 PRILLIT 2013***

**4.2.1.** Çështja e parë që sheshazi bie në sy - që në shikimin e parë të tekstit të pikës së parë të marrëveshjes në trajtim, është loja e padenjë për respekt dhe e padrejtë e përpiluesit të tekstit të saj. Më tutje, është përdorimi diferent i një biçim modeli të pa parë - pingpongian i emërimit të Asociacionit në **mënyrë ambiguitive**, si: **“ASOCIACION/BASHKËSI**, por edhe në mënyrë **alternatorë**, si: **“BASHKËSI /ASOCIACION”**- nëpër pika të ndryshme (në tekstin në gjuhën shqipe të marrëveshjes..

Kjo lojë perfide diplomatike-politike, nuk është pa një dozë a një tjetër djallëzie dhe as pa një qëllim të fundit të paracaktuar. Ky duplifikim sa fraksional, po aq edhe artificial; madje edhe sijamez i tekstit të emërimit të marrëveshjes, si i tillë përdoret deri në fund të tekstit të marrëveshjes. Ky veprim tekstual ka rëndësi dhe peshë të padiskutueshme në zbatimin eventual në praktikë, sepse ka edhe domethënie edhe kuptim diferent - **fjala asociacion** në krahasim me **fjalën bashkësi**, por edhe prodhon efekte po ashtu diferente si njëra po ashtu edhe fjala tjetër nga ky kontekst këndvështrues.

Një përjasje e tillë **ambiguitive dhe intencionalisht fundore**, për të prodhuar efekte të caktuara; gjithësi dyzuese dhe dalluese për palët marrëveshtore, nuk mund të mos konsiderohet -së paku nga shqiptarët e Kosovës si malicioze, malinjë dhe dëmsjellëse; e si e tillë madje sigurisht edhe e papranueshme.

Kjo gjuhë e qëllimshme ambiguitive e **shumëkuptimësisë nacionale ose edhe konceptuale**, mund edhe të emërtohet edhe të tekstualizohet si një soj

terminologjie e intencionalitetit destruktiv. Përse? Sepse mbase qëllimi i dikujt nga pjesëmarrësit apo më saktësisht i lehtësuesit të takimeve, ishte që përmes kontuzioneve ndërlikimore dhe konfuzionimeve nacionale-konceptuale ambiguitive, t'i balancojë deri në nivelin e propozimeve absurdo-utopike e paradoksale kërkesat dhe insistimet e palëve; posaçërisht kërkesat makiaveliste e serike të palës serbe në dialog.

4.2.1.2. Çështja e dytë diskutabile, dubioze dhe që është në shpërputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që gjendet në fjalinë e dytë të pikës së parë të marrëveshjes, ka të bëjë me togfjalëshin: “Asociacion/Bashkësi e komunave **“ME SHUMICË SERBE”**”. Ky formulim marrëveshtor i këtij togfjalëshi, më saktësisht pjesës së dytë të tij, në të vërtetë i jep **karakter të padiskutueshëm ETNIK** ;e më saktësisht se kaq: **MONOETNIK asociacionit të pretenduar** dhe si i tillë është në kundër -shtim total me dispozitat e paragrafit 2 të nenit një 1., të Kushtetutës, sipas të cilave **DISPOZITA: “REPUBLIKA E KOSOVËS ËSHTË SHTET I QYTETARËVE TË SAJ** (pra shtet i qytetarëve të barabartë dhe **jo i etnive**); sipas dispozitave të nenit 3 ., paragrafi një të Kushtetutës SONË, sipas të cilave: “Republika e **Kosovës është SHOQËRI MULTIETNIKE...**” dhe dispozitave të nenit 24., sipas të cilave: “para ligjit (që do të thotë edhe para kushtetutës dhe shtetit), të gjithë (qytetarët - shtetas të Republikës ) - janë të barabartë.

Dispozita e mësipërme e pikës së parë të marrëveshjes, është kryekrejtë antikushtetuese dhe **diskriminuese dhe si e tillë e vë në pikëpyetje gjithë idenë dhe frymën, jo vetëm të Kushtetutës në fuqi, por edhe të vet shtetit të Kosovës si një shtet i komuniteteve rrjedhimisht edhe i qytetarëve të barabartë dhe jo shtet etnik i vetëm një etnie ose kryesisht i një komuniteti**; në këtë rast për më tepër, formulimi i tillë është i **papranueshëm dhe edhe më i pazbatueshëm, ngase një komunitet pakicë pra minoritet, vihet në epërsi privilegjuese mbi komunitetet e tjera; mbi komunitetin shqiptar si shumicë dërmuese dhe përcaktuese në këtë vend; rrjedhimisht e vë komunitetin serb në pozitë jo vetëm superiore, por edhe supreme, në relacion me komunitetet e tjera që jetojnë në komunat e supozuara si pjesë përbërëse e Asociacionit.**

Edhe më qartë se kaq, ky formulim e vë komunitetin pakicë serb, jo vetëm në pjesën veriore të vendit, por në tërë Kosovën, **në një pozitë supreme ndaj të gjitha komuniteteve të tjera edhe ndaj atij shqiptar**. Për më tepër, kjo formë e mbarështrimit marrëveshtor dhe ky pretendim kinse rregulativ kushtetues-juridik - gjykuar nga këndvështrimi i një akribie të mirëfilltë dhe substanciale shkencore e profesionale; madje edhe nga këndvështrimi demokratik, kri -jon një **ASIMETRI rregulative (që në esencë do të thotë derregulim dhe degradim kushtetues-juridik të vendit ) apo edhe më**

saktë e stimulon dhe vetësiguron krijim të një pozite edhe më FAVORIZUESE edhe më MAJORIZUESE të pakicës SERBE mbi shumicën tjetër; rrjedhimisht në literaturë ky fenomen ndeshet dhe shpjegohet edhe si TIRANI E PAKICËS NDAJ SHUMICËS.

Kjo formë malicioze, në mos edhe morbide e të menduarit dhe të shprehurit ex scribere, pretendon të ndërtojë një MODEL dhe NIVEL QEVERISJEJE (përndryshe inekzistent dhe antikushtetues e antiligjor - bazuar në Kushtetutën dhe ligjet në fuqi të Kosovës) - në BAZA ETNIKE i cili jo vetëm që nuk do të mund të funksionoj ose nuk do të lejohet (nga të tjerët) që të funksionoj, por i cili edhe do të mund të dëmtonte seriozisht deri në rrënim bazën solide (tashmë për gati një çerek shekulli të krijuar e kultivuar suksesshëm) multietnike dhe qytetare të shtetit dhe bashkëjetesës së komuniteteve ose nëse doni të qytetarëve të Kosovës, të cilat komunitete - në pjesën e tyre dërmuese gjatë këtyre 21 vjetëve bashkëjetesë, si kurrë më parë, e kanë dëshmuar qëndrueshmërinë dhe perspektivën e këtij modeli shtetëror dhe shoqëror të organizimit dhe funksionimit institucional që e kemi edhe aktualisht, po edhe të bashkëjetesës qytetare - si një perspektivë globale e shekullit në vijim dhe mbase edhe të shekujve në vazhdim.

**4.2.1.3.** Formulimi i pasuesit të dytë të pikës së parë të marrëveshjes, sipas të cilit në - interpretim autentik - do të thotë se: “Anëtarësia (në Asociacion) do të jetë e hapur për çdo komunë tjetër, nëse anëtarët janë në pajtim”.

Teksti i këtij pasuesi të pikës së parë, nuk e përkufizon saktësisht se vetëm komunat me popullsi shumicë serbe, apo edhe të tjerat, mund të anëtarësohen në këtë Asociacion.

Teksti i njëjti lejon mundësinë e interpretimit teleologjik, sipas të cilit edhe komunat e tjera të Kosovës; veçmas ato multietnike, por me popullsi shumicë - joserbe ose edhe ato me popullsi shumicë shqiptare, në një rast të caktuar - qoftë krize, qoftë manipulimi me demokracinë; ose me ligjin e me Kushtetutën; qoftë edhe rast të shprehjes “kolektive” të një “dëshire” eventualisht “plebishitare”, të deklarohen dhe përcaktohen për anëtarësim në Asociacion.

Kjo dhe situata të tjera të paparapara por të ndodhshme, në mos për arsye dhe frymëzime a motive politike, atëherë për arsye ekonomike dhe ekzistenciale të qytetarëve të komunave të tjera (ngase komunat më shumicë popullsie serbe edhe me planin e Ahtisarit për decentralizim edhe me ligjin për vetëqeverisje lokale, janë asimetrikisht të favorizuara si në kompetenca ashtu edhe në donacione, subvencione, kreditime të buta e financime shumëburimore nga brenda vendit; nga Serbia, por edhe nga jashtë vendi), me anëtarësimin eventual edhe të komunave të tjera të Kosovës në këtë Asociacion të pretenduar nga Serbia, **keqas do të mund të vështirësohej pozicioni jo vetëm**

**funksional dhe efikas i shtetit të Kosovës, por edhe e ekzistenca e tij si shtet sovran dhe i pavarur do të mund të vihej seriozisht në pyetje.**

Përse? Sepse shteti rrjedhimisht organizimi shtetëror politik-juridik do të mund të disbalancohej. Nëse shtrohet eventualisht pyetja: Si? Pa vështirësi të mëdha - përmes mekanizmave ventilues, perfid e ambiguitiv, të cilat në mënyrë latente ose edhe më pak latente, janë paraparë dhe inkorporuar në Marrëveshjen në trajtim. Nëse ka nevojë edhe më saktë të elaborohet procesi i disbalancimit të mundshëm, ky proces potencialisht do të mund të ndodhë me kalimin e mundshëm (anëtarësimin) e më shumë komunave - se sa ka tani me shumicë serbe - 10 syresh - në Asociacion). Pra, në këtë mënyrë përfaqësuesit e komunave të Asociacionit do të mund ta shpallnin një republikë tjetër, të cilën do të mund ta njihnin menjëherë ose shpejtësisht disa shtete aleate ose satelite të Ruisë, Serbisë ose të ndonjë tjetri shtet të botës. Po, përse? **Sepse Kosova është dhe për shumë kohë - në të ardhmen - do të vazhdojë të jetë, njëra ndër pikat me interesante aq sa edhe më neuralgjike gjeopolitike dhe gjeostrategjike të botës.**

Krijimi i një gjendjeje të tillë nuk duhet lejuar, ngase nuk i shkon në favor askujt, përveç se interesave strategjike, parësisht të Serbisë hegjemone, për ta destabilizuar, e më pas edhe zhbërë sa më parë dhe me çdo kusht shtetin e Kosovës dhe për ta bërë reivindikimin e saj. Në këtë kontekst, assesi nuk duhet as minimalisht minimizuar e anashkaluar edhe interesat e jashtëzakonshme strategjike të shteteve e blloqeve (ani që joformale - por rrezikuese reale ose potenciale të interesave, sigurisë dhe perspektivës stabile e zhvillimore të Kosovës.

**4.2.1.4.** Një pjesë e tekstit të pikës 2 të marrëveshjes ka të bëjë me modalitetin e shpërbërjes së Asociacionit. Në të vërtetë, sipas këtij formulimi: “shpërbërja a Asociacionit mund të bëhet **VETËM ME VENDIM TË KOMUNAVE PJESEMARRËSE**”.

Duke qenë shumë problematik, ky formulim do të thotë se nëse organet e Asociacionit tejkalojnë kompetencat e tyre që i kanë me statutin eventual ose me ligj, si bie fjala marrja dhe shpallja e ndonjë vendimi për ndonjë “autonomi territoriale” ose edhe të ndonjë “republike” eventuale, siç ekzistojnë tendencat, (së paku nga Beogradi zyrtar, por edhe nga disa qarqe vendore të indoktrinuara nga Beogradi) e planet potencialisht shumëfish të rrezikshme për shtetësinë e Kosovës dhe sovranitetin e saj, **organet dhe as institucionet e Republikës së Kosovës, sipas kësaj dispozite të marrëveshjes, nuk kanë të drejtë që ta shpërbëjnë Asociacionin.** A nuk mjafton kaq për t’u bërë puna suflaq, pa dyshim që po, madje mjafton e tepron. Mirëpo me këtë rast ka diçka tjetër shtesë, që do të duhej veneruar, shpjeguar dhe kuptuar.

E kjo është **ajo e drejta e famshme e VETOS**, e cila rezulton nga formulimi që po e trajtojmë, respektivisht nga kjo marrëveshje, saktësisht metastazike - për nga dispozitat dhe përmbajtja e saj. Pra, trumbetimet e disa nga

ekspozentët pjesëmarrës të kësaj e këtyre marrëveshjeve, si reagim ndaj opinionit publik, jo rrallë herë shpupurisnin duke u krekosur se: “çfarëdo vendimi eventual që dikush mund ta marrë për ta avancuar Asociacionin - pasi ai të themelohet le të themi në një modalitet tjetër qeverisës, siç thuhej e thuhet edhe tani ndonjëherë - bie fjala shndërrimi avancues i Asociacionit në një republikë eventuale të serbëve në Kosovë, ata do ta shpallnin nul - pa vonesë atë farë lloj vendimi”. Por, nëse një herë formohet ai asociacion ashtu siç janë dakorduar me marrëveshjen në shqyrtim - të dy palët në Bruksel, duke e pasur të drejtën e vetos - që në brendi të marrëveshjes, asnjë organ a institucion - me efektivitet të plotë, nuk do të mund t’ua prishë vendimet e tilla organeve të asociacionit.

**4.2.1.5.** Për më shumë së kaq, formulimi pasues i kësaj pike të marrëve -shjës; në një mënyrë të pazakontë; sa konfuze po aq edhe ambiguitive, Asociacionit i jep ingerenca dhe garanci, siç thuhet në tekst: **“ligjore përmes ligjit aplikues dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej dy të tretave (2/3).**

Edhe kjo dispozitë fantome, si e tillë bën pjesë në numrin e atyre dispozitave a pikave të marrëveshjes, që kanë përmbajtje semantike ambiguitive , që sjellin mjegull e tym të lexuesi e sidomos të zbatuesi i tyre. Jo rrallë herë në shtyp, janë përvjedhur edhe shkrime e diskurse, të cilat ngërthenin edhe brendi, të cilat aludonin se këtu bëhet fjalë për një ligj kushtetues i cili do të mund të jetë projektuar nga dikush si një akt më i lartë juridik-rregullativ i Asociacionit, por që ne ndërkohë, formulime të tilla mjegulluese dhe perfide, do të mund të shtyheshin në brendinë e tekstit të statutit eventual të asociacionit dhe më pas të manipulohej edhe shteti i Kosovës edhe qytetari ynë, se kinse kjo që po tentohet të zbatohet nuk është as më pakë dhe as më shumë se sa teksti i shkruar dhe i pranuar nga përfaqësuesit tanë në takimet, rrjedhimisht marrëveshjet tona në BRUKSEL. **Ashtu sikurse dispozitat e sipërelaboruara edhe kjo dispozitë, në tërësi është shumë e dëmshme, por edhe e papranueshme.**

4.2.1.6. Në pikën tre (3) të marrëveshjes së parë të Asociacionit, rrjedhimisht të kinse parimeve të saj, thuhet se struktura e Asociacionit, do të themelohet mbi të njëjtën bazë, si edhe ajo e statutit ekzistues të Asociacionit të komunave të Kosovës. Mirëpo, kjo kinse faktografi e përpiluesve të marrëveshjes nuk qëndron, sepse nga dispozitat e tjera të kësaj marrëveshje dhe të marrëveshjes se dy -të të parimeve të vitit 2015., mund të konkludohet pa mundim të madh diçka krejt tjetër dhe ndryshe. Pra, të Asociacioni në trajtim, në të vërtetë kemi të bëjmë me struktura autonome-vetërregullative-territorialisht dhe substancialisht vetëpërcaktuese dhe vetëvendosëse; rrjedhimisht kemi të bëjmë me një substrat politiko-juridik kuazi shtetëror me tendencë dhe plan, që në një kohë a çast të volitshëm, po ky asociacion eventual, të vetëshpallet dhe të funksionojë si republikë me vete dhe si e pavarur.

4.2.1.7. Marrëveshja në shqyrtim, në pikën 4 të saj, komunave pjesëmarrëse apo që anëtarësohen eventualisht në Asociacion, ua njeh të **drejtën e bashkëpunimit të tyre reversibil**. Synimi dhe qëllimi i këtij lloji bashkëpunimi horizontal i komunave pjesëmarrëse në Asociacion, sipas përpiluesve të marrëveshjes është ushtrimi kolektiv i kompetencave të tyre - përmes Asociacionit.

Sa i përket **bashkëpunimit të komunave**, teksti i pikës 4 të marrëveshjes, është absolutisht i panevojshëm dhe duplikues. Përse ? sepse, kjo çështje është e rregulluar mjaftë mirë mjaftueshmërisht me Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale në Kosovë, sipas të cilit: “komunat mund t’u ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë këtu trajnimin, ngritjen e kapaciteteve, ndihmën teknike ... ,në pajtim me ligjin.

Dispozitat e nenit 31 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale në Kosovë , komunave të Republikës së Kosovës ua lejojnë mundësinë, rrjedhimisht të drejtën e tyre për të formuar asociacion – për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta - në pajtim me ligjin. Edhe në pikën 9.1. të Propozimit gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe në pikën 10.1. të **Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale**<sup>12</sup> - është paparë një mundësi e tillë.

Kushtetuta e Kosovës, në dispozitat e saj të nenit 124.2., të saj (Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale). themelimi i komunave, kufijtë e komunave; mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre, rregullohen me ligj. Sipas paragrafit 4 të po të njëjtit nen të Kushtetutës, :”Komunat kanë të drejtë për **bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar**, kuptohet në pajtim të plotë me ligjin. Bashkëpunimi ndërkomunal (horizontal) dhe ai komunal ndërkombëtar në Republikën e Kosovës, përveç se me Kushtetutë, është rregulluar edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për bashkëpunim

---

12 Sipas kësaj karte evropiane: “Bashkësitë vendore kanë të drejtë, që gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre të bashkëpunojnë dhe Brenda ligjit, të bashkohen me bashkësi të tjera vendore për të realizuar me interes të përbashkët”. Pra, kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të bashkohen, por jo të bashkëpunojnë ndërlidhëshmërisht me jashtë dhe as me qeverinë dhe nivelin tjetër institucional qendror apo kanale duplikuese edhe si pjesë e asociacionit edhe si komuna, rrjedhimisht si njësi bazike të vetëqeverisjes vendore a lokale. Përse sepse ndër të tjera krijohen disbalance në funksionimin e sistemit kushtetues juridik si tërësi dhe jo vetëm të sistemit të vetëqeverisjes vendore a lokale të ne. Sepse e drejta e bashkëpunimit ndërkomunal është e drejtë që mund dhe duhet të sendërtohet ekskluzivisht ose së paku parësisht brenda llojit; pra në nivel horizontal dhe ndërmjet komunave –si njësi të vetëqeverisjes lokale të barabarta dhe të nivelit dhe kompetencave të njejtë dhe jo në mënyrë vertikale- ku bashkëpunimi në rastin e asociacionit e nënkupton tejbartjen a transferin e kompetencave, rrjedhimisht edhe humbjen a zhdukjen e tyre – në një njësi të veçantë vetëqeverisëse; në një nivel tjetër – më të lartë të pushtetit dhe të qeverisjes. Shtrohet pyetja serioze se çka humbin e çka fitojnë komunat në një bashkim dhe ose bashkëpunim të tillë me një strukturë e nivel të ndërmjet të pushtetit dhe qeverisjes, i cili edhe është incognito, fantom i paverifikuar dhe për me tepër edhe mbi të gjitha antikushtetueses dhe antiligjor të ne.

ndërkomunal, si dhe me aktet e tjera sekondare për zbatimin e këtij ligji.<sup>13</sup>Sipas dispozitave të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal, po ky bashkëpunim, në realitet përcakton marrëdhëniet e vendosura midis dy apo më shumë komunave të Kosovës - në bazë të marrëveshjes për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të kompetencave dhe detyrave vetjake, por edhe atyre të zgjeruara të komunave të Kosovës, të përcaktuara me ligj, si dhe për realizimin e interesave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta - në fushën e shërbimeve publike komunale dhe ato të zhvillimit lokal (neni 3 i Ligjit).<sup>14</sup>Bashkëpunim (horizontal) ndërkomunal sipas legjislacionit tonë pozitiv, mund të realizohet nëpërmjet organeve dhe institucioneve të përbashkëta - mikse, ndërmarrjeve të përbashkëta publike, partneriteteve publiko-private; si dhe formave, modaliteteve dhe mekanizmave të tjerë nga më të ndryshëm, me qëllim të arritjes sa më avancuese e gjithëpërfshirëse të interesave , kërkesave dhe nevojave, parësisht të qytetarëve, por edhe të komunave të ndryshme të vendit.<sup>15</sup>

Prandaj, derisa **bashkëpunimi horizontal efikas dhe efektiv** në mes të komunave të Kosovës, në mënyrën më të mirë dhe të avancuar të mundshme, është rregulluar dhe mundësuar me ligjet dhe dokumentet e tjera relevante, përse u dashka që në mënyrë **duplikuese - dubioze dhe mbivendosëse** edhe brënda një njësie a organizmi tjetër “vetëqeverisës”, **fantom, jashtëkushtetues, subsumues dhe sublifikues**, siq është Asociacioni në fjalë, të rirregullohet, të extrarregullohet ose edhe të plus rregullohet - dyfishimi i një bashkëpunimi i cili si i tillë është edhe i tepërt, edhe i panevojshëm edhe çekuilibruar.

**4.2.1.8. “Ushtrimi kolektiv i kompetencave” të komunave**, siç thuhet në pikën 4 të marrëveshjes, për sa i **përket bashkëpunimit**, devijon larg substancës rregulative, por edhe të Kartës evropiane për vetëqeverisje lokale edhe - siç thuhet - ligjit të Kosovës. Pse? Sepse, ushtrimi kolektiv i kompetencave, nënkupton paraprakisht pasjen apo themelimin apo edhe instalimin e një niveli të pushtetit dhe të organizimit e të qeverisjes, por që gjithsesi në praktikë, do të mund të synohet dhe tentohet, të jetë një strukturë organike kolektive – qeverisjeje e barasvlershme me një tërësi e veçorizuar; rrjedhimisht një shumësi institucionale -vetëqeverisëse– kolektive, në suaza të së cilës strukturë edhe do të mund të ushtroheshin ato që marrëveshja qartë e çiltër i quan kompetenca vetjake që nga një komunitet apo më saktë përfaqësuesit e tij minoritar etnik apo edhe me bazë etnike, ushtrohen

---

13 Agim A. Krasniqi, Qeverisja lokale dhe politika, Kolegji Universum, Lena, Prishtinë, 2020, fq. 190; Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (neni 3.paragrafi 1.1); Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale (neni 10).

14 Agim A. Krasniqi, po aty.

15 Agim A. Krasniqi, po. cit. fq.190-191.

kolektivisht dhe në mënyrë plotësisht të mëvetësishme - nga republika tjetër mbetëse në këtë rast kjo republika ekzistuese dhe funksio -nale e Kosovës. Kështu krijohet RES PUBLIKA tjetër fantome; metastazike morbide dhe në të vërtetë nëse është për të gjykuar sipas tekstografisë intencionale të marrëveshjes - kjo është vetë kuazi - Republika e re - me popullsi shumicë etnike serbe - brenda Republikës së tanishme - ekzistuese reale dhe zyrtare të Kosovës.

Ky organizëm para shtetëror e kuazishtetëror, gjithsesi do të kundërshtohet dhe nuk do të pranohet nga shumica demokratike – qytetare e komuniteteve të tjera - as sot as kurrë; pra asnjëherë në Kosovë.

Ndaj në këtë pikë dhe në të gjitha pikat e kësaj marrëveshje dhe marrëveshjes së dytë të ashtuquajtur të parimeve të vitit 2015 të lidhura në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, parësisht institucionet kompetente të Republikës sonë, duhet të kenë përqendrim dhe kujdes maksimal, se në brendinë e që të dy marrëveshjeve brukseliane, për fat të keq tonin, ka përmbajtje vërtetë të dëmshme, të rrezikshme dhe të papranueshme, ndaj edhe nuk duhet assesi të pranohen as dispozitat skajshmërisht diskutabile, ambiguitive, kontraverse, dubioze e të dëmshme - të të dy marrëveshjeve - tashmë të elaboruara e të shkoqitura në detale në këtë shkrim.

4.2.1.9. Sipas **pasuesit të dytë të pikës së 4 (katërt) të marrëveshjes**, Asociacioni do të **ketë mbikëqyrje, që do të thotë edhe kontroll të plotë** mbi fushat e zhvillimit ekonomik , të arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe atij rural. Dhënia kaq e gjerë e autorizimeve dhe kompetencave - Asociacionit - përmes kësaj marrëveshjeje, në të vërtetë e reprezenton asociacionin (ashtu çfarë në esencë - me qëllim të fundit përfundimisht është menduar nga përpiluesi i imagjinuar i kësaj marrëveshjeje), si një entitet specifik dhe special - të ndërmjetëm (në mes të pushtetit lokal dhe atij qendror), por të barabartë në zotësi para autoriteteve qendrore dhe me autoritetet apo institucionet qendrore të Republikës ekzistuese të Kosovës. Pra, realisht dhe praktikisht, do të kemi: “Një republikë të re serbe - në republikën tonë ekzistuese - të përbashkët – të Kosovës. Gjë kjo që gjithsesi është edhe e papranueshme edhe reperkutive por edhe jofunksionale. Aq më tepër edhe tërësisht e panevojshme, sepse, po këto **ingerenca dhe kompetenca mbikëqyrëse**, në realitet, komonat me popullsi shumicë të komunitetit serb asimetricisht i kanë edhe me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe me ligje të tjera në fuqi në Kosovë - aktualisht.

**4.2.1.10.** Në kuadër të pikës pesë (5) , marrëveshja në shqyrtim, asociacionit ia lejon a mundëson edhe të ashtuquajturat: **“KOMPETENCA TJERA SHITESË - SIÇ MUND TË DELEGOHEN NGA AUTORITETE QENDRORE”**.

Nga zbërthimi teleologjik i kësaj sintagme, rezulton se ingerencat dhe autorizim -et e dhëna për asociacionin -nën pikën 4 të marrëveshjes, mund të



zgjerohen edhe në fusha të tjera. Kjo në fakt mundet lehtë të interpretohet si qëllim i sigurt dhe i fundit i përpiluesve dhe ndërmjetësuesve të kësaj marrëveshjeje, pa asnjë mëdyshje ka qenë shndërrimi i asociacionit në strukturë kuazi-shtetërore apo edhe lënia e derës së hapur për asociacionin që, ashtu siç ka ndodhur edhe në Bosnjë-Hercegovinë, edhe këtu po i njëjti asociacion të shndërrohet nga asociacioni në republikë të dytë fantome dhe antikushtetuese - serbosllave në Kosovë.

Një synim i tillë për aq sa është i papranueshëm, po aq është edhe bizar, edhe retrograd edhe i rrezikshëm edhe antidemokratik.

Edhe formulimi marrëveshtor **për mbajtjen e zgjedhjeve lokale**, vetëm në komunat e ashtuquajtura veriore, dëshmon më së miri keqbesimin dhe qëllimin e fundit destruktiv të Serbisë dhe qëndrimin injorant të BE-së dhe përfaqësuesve të kohës të Kosovës, për pasojat e jashtëzakonshme dhe të pallogaritshme, të cilat do të mund t'i shkaktonte dhe i ka shkaktuar tashmë, një dispozitë e tillë e marrëveshjes. Shtrohet pyetja pse? Sepse si rezultat fatkeq i marrëveshjeve sikur është kjo që kemi në trajtim, në ndërkohë u instalua: lista e ashtuquajtur serbe, si një subjekt po ashtu fantom politik, e cila si e tillë e dirigjuar dhe e teledirigjuar nga Beogradi, vazhdimisht bën pengesa dhe opstrukcione ndaj shtetit dhe republikës sonë.

#### **4.2.1.11. Në pikën 6 gjashtë të marrëveshjes, asociacionit i është destinuar ROLI PËRFAQËSUES NË OSE TE AUTORITETET QENDRORE.**

Kjo formë e përfaqësimit është paraparë respektivisht lejuar, jo vetëm në Presidencë - në Këshillin konsultativ të komuniteteve, por edhe më gjerë edhe në Kuvend, edhe në Qeveri dhe gjithandej - në të gjitha organet dhe institucionet e shtetit. Kjo është edhe e pavend edhe në shpërputhje me Kushtetutën dhe në të njëjtën kohë edhe tejet diskriminuese, në raport me qytetarët e tjerë dhe komunitetet e tyre, sepse ato komunitete, në Presidencën e shtetit për shembull, përfaqësohen në Këshillin Konsultativ për komunitete por jo edhe në organet dhe institucionet e tjera – në këtë mënyrë dhe përmes këtij mekanizmi i cili është paraparë për asociacionin e komunave me shumicë popullsie serbe. Pra kërkohet dhe parashihet përfaqësim: “an zhenal” - në të gjitha organet e shtetit. Në këtë mënyrë asociacionin përpiluesit e kanë reprezentuar në aspektin projektabil, si një njësi vetëqeverisëse dhe administrativo-politike si të barabartë me organet qendrore të Kosovës.

Kjo që u tha më sipër, për këtë çështje, ka të bëjë edhe me dispozitën e marrëveshjes së dytë të vitit 2015, më saktësisht me pikën 8 dhe 9 të parimeve të saj, të cilat edhe sipas konstatimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës - në aktgjykimin e saj - në rastin KO130/15, ku parashtruese e kërkesës për shqyrtim ishte ish-presidentja Atifete Jahjaga, e ku nenet 8 dhe 9 të parimeve të përgjithshme të po kësaj marrëveshjeje le të themi

të dytë për asociacionin, nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën tonë, rrjedhimisht as me dispozitat e saj.

Roli dhe funksioni monitorues që i përshkruhet edhe nga përpiluesit e marrëveshjes i lejon Asociacionit - ndaj organeve qendrore të shtetit, në të vërtetë e mbivendosë atje një mekanizëm kuazishtetëror apo më mirë le të thuhet - mbishtetëror), **jo vetëm të karakterit vëzhgues, por edhe kontrollues dhe qortues** - në relacion me të gjitha institucionet, organet dhe mekanizmat e tjerë shtetëror - qendrorë. Vetë lexuesi ynë le të rezonojë dhe konkludojë se çka do të thotë një dispozitë e tillë për Kosovën dhe ardhmërinë e qytetarëve të saj - pa dallim.

**4.2.1.12. PIKA E 9 NËNTË** e Marrëveshjes është një tregues dhe fakt tjetër i pakontestueshëm, që tregon më së miri - në vepër - **diskriminimin në baza etni-ke dhe njëkohësisht derregullimin kushtetues - juridik** të Policisë së Kosovës dhe shkarjeve nga kushtetuta dhe ligji, si zgjidhje e pranueshme dhe kinse e aplikueshme për palët marrëveshtore dhe ndërmjetësin e tyre - në Bruksel.

Në të vërtetë, derisa sipas Ligjit për Policinë e Kosovës, komandantët e stacioneve policore caktohen nga Drejtori i përgjithshëm i Policisë, bazuar në procedurat e brendshme të Policisë (neni 41) i Ligjit, në komunat e Kosovës, ku komuniteti serb është komunitet më i madh etnik, komandantët e stacioneve të policisë dhe komandantët e nënstacioneve të policisë i emëron Ministria e Punëve të Brendshme me propozimin e Kuvendit Komunal dhe të drejtorit të përgjithshëm të policisë, në pajtim me dispozitat e këtij neni (neni 42 I Ligjit) ndërsa, marrëveshja e vitit 2019., në pikën nëntë të saj, ndër të tjera thotë se: “për 4 komunat me shumicë serbe në veri (Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin-Potoku dhe Leposaviqi - Albaniku), komandant i këtij regjioni do të jetë (gjithnjë) një serb i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - nga lista e ofruar nga të katër 4 kryetarët e komunave serbe - në emër të Asociacionit. Do të ketë një komandant tjetër për komunat e Mitrovicës jugore, Skenderajt dhe Vushtrrisë, thuhet e shkruhet në këtë pikë të parapërmendur të asociacionit në fjalë.

Neni 34 i Ligjit të Policisë së Kosovës flet edhe për drejtoritë rajonale, por nuk i cakton ato në baza etnike, as nuk flet as për përkatësi dhe as për preferencë etnike - në ato drejtori rajonale.

Përkundër dispozitave të Kushtetutës por edhe të ligjit për Policinë, që përmendëm më lart, marrëveshja e parë për Asociacionin e vitit 2013, në Bruksel, në kundërshtim me Kushtetutën por edhe me Ligjin për Policinë e Kosovës, **në baza ekskluzivisht etnike dhe të diskriminimit të të tjerëve**, favorizon një etni - në dëm të të tjerave në Kosovë.

Po kështu ndodh edhe me **pikën a dispozitën përkatëse të 10. të marrëveshjes së vitit 2013 edhe sa u përket zgjidhjeve të parapara në të -**

në baza ekskluzivisht antikushtetuese dhe antiligjore; duke instaluar edhe struktura të caktuara çrregulluese dhe krejtësisht politike, artificiale dhe imponuese; por edhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Ligjin për gjykatat e Kosovës.

#### ***IV. ASOCIACIONI I KOMUNAVE MË POPULLSI SHUMICË SERBE NË KOSOVË, SIPAS MARRËVESHJES SË DYTË TË PARIMEVE TË VITIT 2015, E LIDHUR NË BRUKSEL NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SERBISË***

Kjo marrëveshje (e dytë) për kinse parimet, në të vërtetë qëllim dhe objektiv kryesor të saj si duket, ka pasur përthellimin dhe begatimin e mëtejshëm të saj me kompetenca dhe autorizime shtesë të asociacionit të komunave më popullsi shumicë serbe.

**Ad.1.** pikërisht në pikën e parë të saj, marrëveshja e konfiguruar juridikisht dhe esencialisht asociacionin ashtu siç ishte paraparë më parë (në vitin 2013) me marrëveshjen e parë dhe me vonë të konfirmuar përmes ratifikimit - me Ligj - in mbi ratifikimin e marrëveshjes së parë, por edhe siç thuhet: “të bazuar në ligjet e Kosovës”.

**Ad.2.** Përmes pikës së dytë të marrëveshjes, Asociacionit i njihet **KARAKTERI I VEÇANTË**. Mirëpo në gjuhën angleze - **DISTINCT CHARACTER - DON TË THOTË JO TË VEÇANTË, POR TË DALLUAR**, që më tutje mbase do të thotë se kemi të bëjmë me një asociacion me ingerenca dhe kompetenca ekzekutive. Rrjedhimisht nuk kemi të bëjmë me një OJQ., siç pretendonin qeveritë e papërgjegjshme në të kaluarën, duke dashur të kamuflojnë apo më saktë të fshehin nën rrogos gabimet e tyre të pafalshme. Ondërlidhur me nënshkrimin dhe pranimin për aplikim të këtyre dy marrëveshjeve, **POR** kemi të bëjmë me një organizëm **TË NATYRËS DHE TIPAREVE TË VEÇANTA - VETËQEVERISËS** të mirëfilltë dhe ndryshe nga asociacionet e tjera, duke inkorporuar këtu edhe atë të **TË TANISHMIN** të komunave të Kosovës, që është një OJQ ORDINARE.

Nocioni **DEKRET** si në shqip edhe në anglisht nuk korrespondon këtu fare me nocionin apo emërtimin e aktit juridik si **STATUT**, siç na është servuar padrejtësisht nga përfaqësuesit e Kosovës në këtë çështje dhe për hir të së vërtetës, pak më poshtë në këtë pikë të marrëveshjes, na reflektohet edhe nocioni a termi **STATUT**. Sidoqoftë loja terminologjike edhe në këtë marrëveshje, sikurse edhe në atë të parën – për asociacionin, është një lojë malicioze e dëmshme, e pahijshme që të ndodhë dhe të pranohet - në transaksionet kinse diplomatike ndërkombtare dhe mbi të gjitha është një marrëveshje e dëmshme, e turpshme dhe e papranueshme.

**AD.3.** Shqyrtime përkitazimore sa u përket disave nga objektivat e pikës së katërt ( 4) të marrëveshjes në trajtim.

**1.** Le të fillojmë për shembull me togfjalëshin: **“fuqizim i demokracisë lokale”**. Demokracia në esencë dhe në parim, nuk mund të klasifikohet në demokraci lokale, qendrore apo edhe tjetërfare. Ajo ka edhe natyrë edhe karakter edhe mision universal, human; të kudondodhshëm dhe utilitar; duke përfshirë sa më shumë njerëz dhe institucione në ushtrimin e saj.

Ajo pra zhvillohet dhe gjallëron edhe në nivel lokal, por nuk mund të përidefinohet si e tillë- pra e posaçme dhe e dhuruar vetëm për dikë (madje edhe në nivel lokal), ndërsa për dikë tjetër jo - pra të mos i jepet dikujt tjetër, të mos jetë gjithëpërfshirëse dhe për të gjithë – pa dallim.

Pse? Sepse, demokracia edhe si substrat edhe postulat edhe si vlerë ose është universale – që do të duhej të vlej dhe aplikohet për të gjithë ose nuk ekziston fare. Mirëpo, këtu qëllimi i përpiluesit të marrëveshjes - si duket ka qenë që në dobi të asociacionit dhe anëtareve të tij, demokracinë kinse tua inkorporalizoj, veçorizoj dhe perimetrizoj si një substancë, organizëm, njësi dhe modalitet specifik vetëqeverisës - krejt ndryshe dhe si një pandam apo edhe me keq si një tandem konkurrues dhe veprues të pushtetit dhe mëvetësisë qeverisëse, mbikëqyrëse e mbi të gjitha kontrolluese të çdo gjëje në suaza të asociacionit.

**2.** **“Ushtrimi i vështrimit - që do të thotë kontrollit, autorizimeve dhe mbikëqyrjes së plotë sa i përket zhvillimit të ekonomisë lokale”**, në fakt nuk është fare ashtu.

Pse? sepse, të asociacioni kemi të bëjmë me bashkim komunash në një bashkë -si të përbashkët e cila realisht dhe objektivisht përbën një rajon ose edhe më saktë disa rajone (komuna me shumicë popullsie serbe nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës të bashkuara në një bashkësi multikrahinore e rajonale e cila krijon një njësi të mëvetësisë rajonale vetëqeverisëse e territoriale (edhe një pushtet të ndërmjetëm të tretë nga ai ekzistues që me Kushtetutë dhe ligjet e Republikës së Kosovës e që quhet asociacion i komunave me shumicë popullsie serbe.

**3.** **Vështrimësia e plotë apo edhe më saktë fitimi i të drejtës, kompetencave dhe autorizimeve për ushtrimin e një pushteti të përbashkët të komunave të sublimuar në një entitet kuazishtetëror –asociacion, është sqaruar në një masë a vëllim më përpara në këtë shkrim.**

**4.** **Në disa nga nënpikat vijuese të pikës së 4 katërt të kësaj marrëveshjeje, ndër të tjera, është paraparë: “afirmimi, promovimi, koordinimi, dhe avokimi i çështjeve me interes të përbashkët e asociacionit; ofrimi i shërbimeve për anëtarët e rinj; përfaqësimi i tyre te autoritetet qendrore, të gjitha sipas marrëveshjes në përputhje me ligjet e Kosovës. Mirëpo shtrohet pyetja më e logjikshme dhe më legjitime, se çfarë punësh dhe çfarë**

shërbimesh bën Republika e Kosovës, respektivisht organet dhe institucionet tona në ato pjesë të mrekullueshme të vendit tonë.

A nuk paraqet shkelje ligji dhe kushtetute, vënia në pozitë diskriminuese e qytetarëve, përmes përfaqësimit dhe reprezentimeve selektive, të shërbimeve selektive; të ofrimit të mundësive dhe të pozitës selektive dhe të pabarabartë para kushtetutës dhe ligjit etj.

Qytetarët në rast të funksionalizimit të një asociacioni të tillë - sidomos qytetari minoritar -joserb, do të mund të dilematizonte gjendjen e tij civile - para institucioneve, si është e mundur që edhe në mënyrë normative, një vistër i gjerë qytetarësh edhe në këtë shekull të ri të barazisë, të demokracisë e të globalizimit, të jetë i diskriminuar dhe selektivisht ose edhe abandonisht i anashkaluar dhe i privuar nga ushtrimi dhe praktikimi i të drejtës së përfaqësimit!.

**5. Në nënpikat pasuese të marrëveshjes duhet doemos përmendur se edhe: “formësimi i qëndrimeve me interes të përbashkët edhe bashkëpunimi edhe përfaqësimi edhe ushtrimi i pushtetit edhe me kompetenca shtesë, edhe sipas marrëveshjes së parë dhe kësaj të parimeve, mbështetën në prime -sa dhe krijim të një pozite favorizuese e mbi bazë etnike - për komunitetin serb në Kosovë dhe disfavorizuese e diskriminues për të gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.**

**6. E drejta e të ashtuquajturit:” promovim të interesave të komunitetit serb të Kosovës” (pika 9 e marrëveshjes në shqyrtim),** që kuptimisht dhe esencialisht do të thotë e drejtë entitore e përfaqësimit të një strukturë e vetëqeverisëse drejtë organeve dhe institucioneve qendrore - mbi baza etnike jo vetëm që është tejfavorizuese, por është edhe mbivendosje e dispozitave në fuqi të Kushtetutës së Kosovës dhe është diskriminuese në raport me të gjitha komunitetet e tjera në Kosovë.

Pse? Sepse, promovimi nënkupton edhe adresimim eksplicit të kërkesave të çfarëdolloj dhe vetëkupton ingerencë të caktuar zbatimore të asociacionit . Kjo pikë për më tepër literalisht i kundërvihet dhe në një mënyrë apo tjetër e abstrakton deri në mbivendosje nihiluese tekstin e pikës së 8 të kësaj marrëveshjeje.

Përndryshe, përpiluesit e kësaj pike të marrëveshjes dhe marrëveshjes në tërësi, është dashur ta shfletojnë pak Kushtetutën dhe ligjet përkatëse të Republikës sonë e të shohin qartë e çiltër të shkruar e të shpallur, se pozita kushtetuese - juridike e komuniteteve minoritare, veçmas e komunitet serb, është e rregulluar dhe garantuar, po me këtë kushtetutë dhe këto ligje; madje më mirë, më lartë e më shumë se sa këtë e parashohin të gjitha standardët evropiane dhe ato ndërkombëtare së bashku. .

**7. E drejta e asociacionit,** që në funksion të përmbushjes së objektivave të tij, të ketë mundësi, **për të propozuar amendamente legjislative apo të legjislacionit,** siq thuhet në pikën 10 të marrëveshjes, pa asnjë dyshim as

dilemë, vetëkupton përpjekjen e pajisjes - futjes dhe interferimit të asociacionit në fushën e posedimit të ingerencave legislative, duke e fuqizuar kështu asociacion -in në një entitet pushtetmbajtës dhe pushtetprodhues; si një njësi serioze administrative-territoriale dhe vetëqeverisëse - me fuqi taksative edhe legislative, gjë që OJQ-ve (siç pretendohet të simulohet dhe kamuflohet rrolli dhe karakteri kinse i Asociacionit si një organizatë joqeveritare,) nuk iu takon as me kushtetutë dhe as me ligje të tjera të Republikës së Kosovës; madje as gjetiu – askund.

**8. Tendencë për ta mvëshur a pajisur Asociacionin edhe me të drejtën për të iniciuar por edhe të marrë pjesë në procedurat e gjyqësisë së rregullt dhe asaj kushtetuese, është kërcim bosh në kapërcimin e pretenduar të hullisë imagjinare, sepse kjo tendencë kapilare, në fakt paraqet përpjekje të dështuar të përpiluesve të marrëveshjes, që të barasvlerësojnë deri në glorifikim - kompetencat, pozitën dhe fuqinë kushtetuese - juridike të asociacionit me institucionet më relevante dhe më supreme të vendit, siç janë bie fjala Kuvendi i Kosovës, Presidenti dhe Qeveria e Republikës.**

Pra kjo zgjidhje e propozuar në marrëveshjen e dytë të parimeve përkritazi me asociacionin, paraqet jo vetëm shpërprthje, por edhe shkelje klasike dhe flagrante të dispozitave të Kushtetutës sonë. Kjo tendencë e qimentimit dhe suprematizimit të rolit dhe pozitës së paprekshme - sipas modelit dhe modusit (noni me tangere) të asociacionit dhe tabelarizimit imponant të po këtij Asociacioni, në muralin ikonografik të hierarkisë institucionale të Kosovës, vërtetë është shembull i një perfiditeti po ashtu ikonografik e të paprecedent.

**9. E drejta për të nominuar përfaqësues të asociacionit** në institucionet a organet qendrore (pika 13 e marrëveshjes), pa mëdyshje që paraqet një lloj ndërhyrje në punët, veprimtarinë e përditshme dhe ingerencat e këtyre institucioneve qenësore. Një kërkesë e tillë tekstuale (çuditërisht dhe si në mungesë elementare të ndjesisë dhe kujdesit ndaj shtetit të vetë, por edhe korrektësisë elementare - gjenerale), nuk ishte dashur të figurojë në tekst të marrëveshjes, sepse Kosova ka një ligj të veçantë për sigurimin e informacioneve dhe të dhënave përkatëse të të gjitha institucioneve të vendit. Ndaj përse iu dashka dikujt - në këtë rast insistentëve të Asociacionit në Beograd, Bruksel e Prishtinë, që të ketë edhe monitorim të punës së organeve dhe jo vetëm informim nga puna e tyre edhe ashtu edhe kështu obligimisht dhe ligjërisht duhet që të jetë transparente, e qasshme, transparente dhe publike.

## ***V. ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME POPULLËSI SHUMICË SERBE, SIPAS AKTGJYKIMIT NR. KO 130/15 TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS***

Sa i përket qëndrimit të Gjykatës kushtetuese, ndaj kërkesës së ish-Presidentes të vendit, në cilësi të parashtrueses së saj, po ajo në pikën 108 të aktgjykimit, është deklaruar taksativisht, se çështjet e dorëzuara nga Presidentja lidhur me rastin konkret, NR. KO 130/15., janë të natyrës kushtetuese. Ato çështje kanë për qëllim - gjithnjë sipas gjykatës - që të sigurojnë, se themelimi i asociacionit të komunave me popullsi shumicë serbe, është në pajtim me **shkronjën dhe me frymën** e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në këtë kuptim, gjykata kushtetuese, ka gjetur së parashtruesja e kërkesës, është palë e autorizuar, për ta dorëzuar kërkesën, në kuptim të nenit 84. (9) të Kushtetutës sonë. Gjykata kushtetuese me aktgjykimin e saj ka gjetur gjithashtu se e njëjta e ka **juridiksionin**, për ta pranuar kërkesën - si të pranueshme për ta shqyrtuar atë kërkesë si autoritet përfundimtar dhe për ta interpretuar Kushtetutën, në bazë të dispozitave të nenit 112/1 të Kushtetutës.<sup>16</sup>

Gjykuar sipas fushëveprimit të kërkesës, pyetja së cilës do të duhej t'i përgjigjej gjykata në këtë rast, ishte: “ **nëse parimet ishin dhe janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe kornizën e saj; më saktë me frymën e Kushtetutës dhe nenin 3** (Barazia para Ligjit), paragrafi 1., në përputhje me Kapitullin II (Të drejtat dhe liritë themelore) dhe me kapitullin III (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre)” (Aktgj. nr. KO 130/15., fq.20).

Sa u përket **objektivave të asociacionit**, gjykata kushtetuese ka konstatuar se: “kur të elaborohen objektivat e asociacionit - në akt juridik dhe statut, ata duhet të kenë parasysh nenet 12, 81, 123 dhe 124 të Kushtetutës lidhur me statusin, objektivat dhe kompetencat e komunave. Realisht, konkretisht dhe objektivist, akti juridik dhe statuti i asociacionit, nuk duhet të zëvendësojnë ose minojnë statusin e komunave pjesëmarrëse, si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale demokrati -ke, në kuptim të nenit 12 të Kapitullit X të Kushtetutës.

Gjykata e jonë kushtetuese, në aktgjykimin e saj, ka konstatuar se parimet e përcaktuara në objektiva, nuk i plotësojnë tërësisht standardët kushtetuese. Ato objektiva, sipas gjykatës kushtetuese, do të duhej të garantojnë standardet kushtetuese për vetëqeverisje lokale - lidhur me përgjegjësinë e komunave pjesëmarrëse dhe lidhur me marrëdhëniet e tyre me autoritetet qendrore, në kuptim të neneve 124.6 dhe 124.7 - të Kushtetutës.

---

16 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në rastin nr. KO130/15., fq.19., Prishtinë, 23 dhjetor,2015., nr. ref.:AGJB877/15.

Objektivat sipas gjykatës kushtetuese, do të duhej të siguronin përgjegjësinë e komunave pjesëmarrëse, për ta respektuar Kushtetutën - dhe ligjet tona dhe se nuk do të duhej po ato, t'i anashkalojnë ose t'i shmangun rishikimet administrative - nga autoritetet qendrore.

Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës, në aktgjykimin e saj me veçoritë dhe përcaktorët e sipërapostrofuara, duke i analizuar parimet e marrëveshjes së dytë, të cilat kanë të bëjnë **me strukturën organizative të asociacionit**, ka vlerësuar se po **kjo strukturë është në shpërputhje të plotë** me disa nga dispozitat, përndryshe tepër bazike, por edhe dinamike dhe relevante të Kushtetutës sonë, siç janë për shembull:

# dispozitat e nenit tre (3);

#dispozitat e nenit shtatë (7) ;

#.dispozitat e nenit pesëdhjeteshtatë (57) ;

#.dispozitat e nenit gjashtëdhjetenjë (61) ;

#.dispozitat e nenit gjashtëdhjetedy (62 ) dhe

#.dispozitat e nenit njëqindnjë (101) të Kushtetutës sonë.

Këto dispozita të kushtetutës, sipas gjykatës dhe përgjithësisht janë veçanërisht të rëndësishme në rastin e shkrimit tonë, rrjedhimisht përkitazi me Asociacionin, para së gjithash dhe mbi të gjitha,

**SEPSE:**

për shembull, sipas nenit 3/1 të Kushtetutës: **“Republika e Kosovës është SHOQËRI MULTIETNIKE”**... në të cilën: “ushtrimi i autoritetit publik, bazohet në **parimet e BARAZISË PARA LIGJIT - të të gjithë individëve...** si dhe në **mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (paragrafi 2 i nenit 3 të Kushtetutës së Kosovës)** ;

**SEPSE :**

- **rendi kushtetues i Republikës së Kosovës mbështetet në parimet e ... PLURALIZMIT (neni 7 i Kushtetutës sonë) etj.;**

**SEPSE:**

- banorët që i përkasin një grupi të njëjte kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), **GËZOJNË TË DREJTA TË VEQANTA**, të përcaktuara me këtë kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në kapitullin II të kësaj kushtetute (neni 57., i Kushtetutës së Kosovës).

Andaj shtrohet pyetja më elementare e mundshme, se në çfarë baze dhe me çfarë të drejte u dashka që ata që edhe ashtu - deri më tash - fundamentalisht dhe me mekanizma special e maksimal janë mbrojtur dhe mbrohen edhe aktualisht me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Janë garantuar, mbrojtur e mbrohen në vazhdimësi - në mënyrë dhe cilësi të veçantë, por edhe janë



favorizuar e privilegjuar - përmes asociacionit të pretenduar edhe një herë tjetër, në një nivel tjetër të paparë e të paprovuar deri më tash, në mënyrë edhe më cilësore dhe sasiore se gjer më tani, nga disa anë e qarqe edhe tani pa asnjë të drejtë e bazë kërkohet që të mbrohen shumëfish, rrjedhimisht në mënyrë dhe mekanizma antikushtetues dhe antiligjor. etj.

GJYKATA KUSHTETUESE e Republikës së Kosovës, nga sa rezulton nga aktgjykimi i saj, sa i përket **strukturës organizative të Asociacionit**, ndër të tjera ka konkluduar se parimet e përcaktuara në kapitullin përkitazi me strukturën organizative, nuk i plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese (PIKA 160 E AKTGHYKIMIT NË TRAJTIM).

Sa iu përket të drejtave të komuniteteve pakicë, duke përfshirë këtu edhe atë serb, gjykata përmes aktgjykimit të saj rikujton Kapitullin e Tretë III të Kushtetutës, veçmas dispozitat e nenit 57;,59;,; 60.;; 79, si dhe nenin 113 paragrafët 4 dhe shtatë të Kushtetutës sonë. Edhe sa i takon shkëmbimit të rregullt të informatave dhe raporteve - ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës, **Kushtetuta e Kosovës ofron mbrojtje të mjaftueshme**, përmes një mekanizmi të posaçëm - kuptohet bazuar në dispozitën e paragrafit një (1) të nenit 60 të Kushtetutës; ndërsa sa u përket **nismave legislative**, një mundësi adekuate dhe suficiente, pa dyshim që ofron dispozita e paragrafit dy (2) të nenit 60 të Kushtetutës sonë.

Gjykata kushtetuese edhe sa i përket parimeve të përcaktuara në kapitullin për kapacitetin ligjor; buxhetin dhe përkrahjen e asociacionit, si dhe dispozitat e përgjithshme dhe përfundimtare të marrëveshjes së dytë të parimeve, të gjitha këto, sipas gjykatës në fjalë, nuk i plotësojnë tërësisht standardet kushtetuese (pika 186 e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës).

Nga elaborimi i gjertanishëm i aktgjykimit të gjykatës kushtetuese, rezulton se gjykata - marrë në përgjithësi ka bërë një përpjekje të konsiderueshme edhe pse jo sa duhet adekuate dhe as të plotë, ngase në një marrëveshje kinse autentike - burimore të Bashkimit Evropian me Serbinë dhe Kosovën të vitit 2015, që përbëhej nga gjithsej 22 pika ose kapituj, ajo ka konstatuar se në mbi 23 raste ose pika ose dispozita, po e njëjta marrëveshje ka qenë në kundërshtim relativ ose absolut; ndonëse gjykata e quan mospërputhje etj.

Pra, edhe me kaq kjo gjykatë e ka invalidizuar deri në zhbërje dhe inekzistim marrëveshjen e dytë të parimeve dhe kjo është për t'u vlerësuar dhe për t'u respektuar nga i gjithë spektri ynë politik dhe institucional, si dhe nga i tërë opinioni publik kosovar dhe ai ndërkombëtar aktualisht.

Mirëpo, përkundër kësaj që u tha, gjykata kushtetuese në rastin nr. KO 130/15 nuk ka qenë sa duhet e vëmendshme dhe as e përkushtuar ose nuk ka qenë mjaftueshëm kurajoze, objektive, reale dhe e vendosur, (ndonëse në kushtet dhe rrethanat, përndryshe mjaftë konfuze dhe të komplikuar e ndërlikuar) të nxjerrë një vendim plotësisht autonom maksimalisht të përkushtuar dhe katërcipërisht profesional; kuptohet vendim **krejtësisht të pavarur e të**

**pandikuar politikisht nga aktorët dhe faktorët e jashtëm e të brendshëm me influencë.** Përse? Sepse: “Gjykata kushtetuese e Republikës së Kosovës, me këtë aktgjykim, padrejtësisht dhe në mënyrë të pathemeltë, si përfundim të saj ka konstatuar se: “Marrëveshja e parë e ratifikuar në Kuvendin e Republikës me 27 qershor 2013., ka parashikuar themelimin e një asociacioni të komunave me shumicë popullsie serbe në Kosovë”.<sup>17</sup>

Pra, meqë për hir të së vërtetës, që të dy marrëveshjet e Brukselit janë marrëveshje parimesh, që kanë të bëjnë parësisht ose kryesisht përkitazi me themelimin dhe instalimin e një asociacioni fantom, që është skajshmërisht i dëmshëm dhe i rrezikshëm për Republikën e Kosovës e gjykata kushtetuese me aktgjykimin e saj - në më shumë se sa të gjitha nenet - (gjithsej 22 syresh) që ka marrëveshja e dytë; **në 23 raste ka gjetur pika mospëputhëse me Kushtetutën e Kosovës; rrjedhimisht me frymën dhe shkronjën e saj,** pothuaj -se po kaq brumë mospërputhës parimesh me kushtetutën dhe ligjet tona, ka edhe në Marrëveshjen e parë për asociacionin. Mirëpo duke e gatuar dhe lansuar një kompromis totalisht irracional dhe joaplikativ e mbase edhe duke qenë edhe vetë e ndikuar politikisht nga jashtë e nga brenda, gjykata në fjalë i ka kontestuar disa nga parimet e marrëveshjes së dytë, **por jo edhe të së parës.**

Ndaj, edhe vetë gjykata kushtetuese, kam përshtypjen se, nuk ka qenë plotësisht e bindur për verdiktin e saj, megjithatë ka udhëzuar, që në përputhje me dispozitat dhe parimet e marrëveshjes së parë, dosido, të themelohet asociacioni monoetnik i komunave me shumicë banorësh serb në Kosovë.

Prandaj, nga sa u tha gjer më tani, **Gjykata Kushtetuese, në mënyrë krejtësisht të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, në aktgjykimin e saj, konstaton se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe: “do të themelohet, siç është paraparë me Marrëveshjen e parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës”.**<sup>18</sup>

---

17 Më detalisht për këtë, shih pikën tre (3) të aktgjykimit në trajtim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nr.KO 130/15.

18 Shih pikën dy (II) të konstatimeve vendimarrëse të gjykatës në aktgjykimin e saj, fq.39.

## ***VI. MARRËVESHJET PËR ASOCIACIONIN NË KUSHTET DHE RRETHANAT E NDRYSHUARA NË NDËRKOHË***

### **1. Parimet doktrinare ndërkombëtare Bona Fide, Pacta sunt Servanda dhe Rebus Sic Stantibus**

#### **1.1.Parimi i Mirëbesimit ose latinisht Bona Fide**

Është fakt notor i preferuar dhe synim e objektiv i çdo subjekti të së drejtës ndërkombëtare dhe në transaksionet apo marrëdhëniet ndërkombëtare, që kurdo që po këto subjekte (parësisht shtete) lidhin traktate apo marrëveshje ndërkombëtare, po ato të lidhen, ratifikohen dhe zbatohen **ME MIRËBESIM (BONA FI -DE)**. Ky është një parim i mirënjohur dhe i mirështirë e mirëpranuar ndërkombëtarisht i së drejtës ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare. **Bona fide**, pra vetëkupton besimin e mirë dhe eventualisht të fortë e të qëndrueshëm e afatgjatë (për aq sa zgjat edhe vlerëshmëria e një akti juridik ndërkombëtar, pra i një marrëveshjeje a traktati ndërkombëtar. Parimi në trajtim, ngërthen në vetvete edhe sjelljen e palëve marrëveshtore me njëra-tjetrën në mënyrë të ndershme, korrekte, si dhe reciprokisht dhe vazhdimisht respektuese me njëra-tjetrën, si palë a si partner bashkëpunimi reciprok.<sup>19</sup> Ndërkohë që në rastin tonë konkret, është fakt notor historik, juridik dhe politik, se Serbia në asnjë çast; **në asnjë rast dhe në asnjë marrëveshje**, gjer me tani nuk ka vepruar dhe as punuar **në mirëbesim** ndaj Kosovës; përkundrazi me hile, me perfiditet dhe me destruktivitet skajnor, me qëllim të fundit, kryesor dhe permanent, që ta rrënojë dhe shkatërrojë subjektivitetin shtetëror rrjedhimisht ta zhbëjë shtetin e Kosovës.

**1.2. Parimi Pacta Sunt Servanda - shqip - Marrëveshja duhet të respektohet** - në të drejtën ndërkombëtare dhe përgjithësisht në marrëdhëniet e përditshme dhe ato kontraktuale jetësore, ka zanafillë të hershme e rëndësi dhe gamë të gjerë aplikimi. Ky parim, nënkupton **respektimin deri në fund të marrëveshjeve apo traktateve në mes të palëve** (në rastin tonë në mes të shteteve) apo midis subjekteve të së drejtës nacionale dhe asaj ndërkombëtare. Mbështetur në dispozitat e Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve :”Çdo traktat a marrëveshje në fuqi është i detyrueshëm për palët në te dhe duhet të zbatohet nga ana e tyre - me mirëbesim” (neni 26.). Respektimi dhe zbatimi i këtij parimi të së drejtës ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare, sjell siguri dhe stabilitet në zhvillimin e marrëdhënieve në

---

19 Dr. Gurakuq Kuçi: Doktrina Pacta Sunt Servanda dhe Rebus Sic Stantibus si balanca ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë (kumtesë në dorëshkrim, fq. 1.)

arenën ndërkombëtare - në mes të shteteve, popujve dhe kombeve. Po ashtu ky parim gjen dhe duhet edhe më shumë të gjej - tani dhe në të ardhmen aplikim dhe respektim nga ana e palëve a pjesëmarrësve në transaksionet ndërkombëtare, parësisht në marrëdhëniet diplomatike e ndërshtetërore, por edhe në ato ekonomike e të tjera relevante.

### 1.2.3.

Mirëpo jeta dhe marrëdhëniet në mes të shteteve, popujve dhe individëve; veçanërisht në nivelin ndërkombëtar transaksional, me kalimin e ditëve dhe viteve, jo rrallëherë - për shkak të rrethanave, rrjedhimisht të ndikimit të tyre qoftë direkt ose indirekt - **në ndërkohë pësojnë edhe ndryshime - në shkallë apo edhe gama të ndryshme.**

Pikërisht ato ndryshime që mund të ndodhin potencialisht dhe realisht - nga momenti i lidhjes së një traktati, konvente apo edhe marrëveshje e deri në zbatimin dhe aplikimin e tij, kanë të bëjnë me **parimin Rebus Sic Stantibus.**

Sipas historianit dhe kritikut letrar anglez Thomas Rymer, kushtet dhe rrethanat e caktuara - gjatë rrjedhave të caktuara kohore i ndryshojnë rastet (Circumstances alter Cases) dhe jo e kundërta.

Sipas doktrinës, nga ana tjetër, ndryshimet e kushteve dhe rrethanave, apo parësisht vetë rrethanat, doemos lypset të jenë **fundamentale, të rëndësishme dhe me peshë e gamë gjithëpërfshirëse.**

Si pjesë përbërëse dhe relevante e Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve, **parimi a doktrina Rrebus Sic Stantibus e bën të pazbatueshëm një traktat, marrëveshje ose kontratë - për shkak të ndryshimit esencial dhe fundamental të rrethanave.** Është qenësore dhe më peshë e rendësi parësore, që rrethanat të jene edhe të paparashikuara , por edhe të pa pritura.<sup>20</sup>

Është krejtësisht e drejtë e kuptueshme dhe e arsyeshme, që derisa ekzistojnë rrethana dhe marrëdhënie të tilla - në mes palëve - të pandryshuara, sa u përket marrëveshjeve a traktateve ndërkombëtare, të vlej dhe respektohet edhe parimi a doktrina e mirëbesimit - bona fide edhe ajo e pacta sunt servanda. Mirëpo, në çastin kur **paparshikueshmërisht dhe papritur e pa kujtuar ndryshojnë kushtet dhe rrethanat , atëherë parimi rebus sic stantibus i derogon deplason dhe i zëvendëson në plotëni - të dy parimet apo doktrinën e sipër-elaboruara.**

---

20 Dr. Gurakuq Kuçi., op. cit., fq.2.

**Pikërisht kjo është situata me marrëveshjet e Asociacionit të lidhura në Bruksel, në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pra nga data dhe viti i lidhjeve së tyre ( në vitin 2013 dhe 2015), në Republikën tonë janë bërë ndryshime e ndryshime kolosale, esenciale dhe me ndikim e impakt të jashtëzakonshëm për nga rëndësia dhe fuqia. Në të vërtetë, ndryshimi më i madh ka të bëjë me shprehjen e besimit referencial të votuesve ndaj subjekteve politike që tani janë në qeverisje në zgjedhjet qendrore - nacionale të vitit të kaluar.**

Së këndejmi natyrshëm lypset kuptuar dhe shpjeguar se, ardhja e çdo qeverie, varësisht nga shkalla dhe niveli i përgjegjshmërisë që tregon e dëshmon; varësisht nga serioziteti dhe obligimet që ka ndaj popullit të saj, si dhe ndaj kushte -tutës së vendit, do të silltet në këto relacione; duke krijuar dhe zbatuar politika të përgjegjshme dhe ndryshe nga paraardhësit e saj, dhe kjo formë e sjelljes dhe qeverisjes është plotësisht dhe padiskutueshmërisht legjitime dhe legale. Rrjedhimisht, duke u bazuar në parimin ndërkombëtarisht të pranuar; parimin e mirënjohur dhe planetar:” **Rebus Sic Stantibus - të ndryshimit të rrethanave**”, po kjo qeveri e ka të drejtën e Zotit dhe të popullit, që të mos e zbatoj asnjërën nga të dy marrëveshjet dhe marrëveshjet e tjera eventuale, të cilat mund të jenë të dëmshme dhe të papranueshme, e të lidhura paraprakisht me Serbinë, rrjedhimisht me cilindo shtet a subjekt tjetër të së drejtës ndërkombëtare në Botë.

Në qoftë se kësaj që u tha më sipër ia shtojmë edhe faktin dhe argumentin e pa -kundërshtueshëm dhe të pakontestueshëm, se në rast të themelimit të Asociacionit, **cenohen deri në pariparim edhe interesat më jetike të qëndrueshmërisë organizative - funksionale, të sigurisë dhe perspektivës së republikës sonë**, atëherë e drejta e Kosovës, për të mos pranuar - në dëm të saj e të interesave të saj, formimin e kurrfarë asociacioni; aq më tepër totalisht të panevojshëm por edhe kronikisht të dëmshëm për shtetin dhe popullin e Kosovës.

Prandaj, **interesat jetike të vendit** ndërlidhëshmërisht kanë të bëjnë me **ndryshimin rrënjësor të rrethanave** të ne dhe janë arsye e plotë e mirëfilltë dhe e mjaftueshme, në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare, **që Kosova të mos e pranojë formimin e asociacionit të komunave me shumicë të popullsisë serbe.**

Vetëm këto vitet e fundit, po të bëjmë një vështrim global të situatës, kemi numër të konsideruar të rasteve, kur qeveritë e ndryshme, **në kushte dhe rrethana të ndryshuara fundamentalisht, janë tërhequr nga marrëveshjet dhe nga traktatet e ndryshme.** Shembulli i Qeverisë Tramp në SHBA., kur

tërhiqet nga marrëveshja multilaterale e globale për klimën; nga marrëveshja e aleatëve të saj dhe të vetë SHBA-së me Iranin - marrëveshje kjo tejet e rëndësishme multilaterale për çarmatim bërthamor të Iranit; nga marrëveshja për tregti - me Kinën etj.

**Kjo formë e veprimit është plotësisht legjitime dhe është çështje e padiskutueshme sovrane dhe legale e çdo qeverie, që në dallim nga ndonjë qeveri tjetër paraprahe t'i ndryshojë politikat edhe në relacion me marrëdhëniet ndërkombëtare në mes shtetesh.**

Përndryshe, rastet e tërheqjes nga marrëveshjet apo traktatet ndërkombëtare - bilaterale ose multilaterale, në të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në mes shtetesh, të cilat janë ndërmarrë dhe kanë ndodhur edhe para konventës së Vjenës janë të shumta. Këtu po i vëmë në spikamë vetëm disa më specifike dhe më karakteristike e argumentuese nga këto raste:

\*Me 1926., **Kina** e ka **shfuqizuar njëanshmërisht** traktatin e saj me **Belgjikën** nga viti 1865;

\*Në konferencën e Gjenevës të mbajtur me 20 prill të vitit 1922, **ish-Bashkimi Sovjetik (BRSS) do të tërhiqet nga të gjitha marrëveshjet e mëparshme** të bëra para revolucionit të viti 1917.;

\***Franca** me 11 mars të vitit 1966 ia drejtoi vendeve të NATO-së një memorandum. **ku i njoftonte me ndryshimin e rrethanave ekzistuese në Botë**, që nga viti 1949., me ç'rast ajo donte, që të vinte theksin në veprime të pavarura edhe jashtë NATO-së etj.

Ka madje autorë, të cilët mendojnë dendur, se edhe për të ashtuquajturën Rezolutë 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, do të duhej dhe do të mundej - pa ekuivoqe, të vlej **PARIMI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE - REBUS SIC STANTIBUS**. Pra, ky është parim i ndryshimit të kushteve dhe rrethanave. Përse? sepse, që nga koha e Rezolutës 1244., të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e deri me sot, kanë kaluar shumë e shumë vjet dhe **kanë ndodhur shumë NDRYSHIME RRËNJËSORE TË RRETHANAVE**, në të cilat u miratua ajo rezolutë.

Sipas këtij këndvështrimi, tanimë është krijuar momentumi dhe terreni tejet i favorshëm juridik, për zbatimin e **parimit të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare - rebus sic stantibus**.

Pra mbështetur në syzheun e Konventës së Vjenës të vitit 1969 për të drejtën e traktateve, tashmë janë përmbushur ose më mirë të themi ekzistojnë të gjitha arsyet dhe argumentet juridike-ndërkombëtare, për të kërkuar edhe zyrtarisht, që Rezoluta 1244., si një nga llojet e marrëveshjeve ndërkombëtare, e **cila tashmë, që moti është tejkaluar nga realiteti pasues, respektivisht nga**

rrethanat e stërndryshuara - të abrogohet edhe juridikisht, respektivisht të shpallet zyrtarisht e pavlefshme dhe inekzistente.<sup>21</sup>

## ***PASOJAT JURIDIKE-POLITIKE TË THEMELIMIT TË ASOCIACIONIT DHE FUNKSIONALIZIMIT EVENTUAL TË TIJ PËR SHTETËSINË DHE ARDHMËRINË E REPUBLIKËS DHE TË SHTETIT TË KOSOVËS***

### **1. Pakëfjalë në sfond**

Para gabimit trashanik dhe të pafalshëm të elitave të papërgjegjshme qeverisëse të Kosovës, siç ka qenë formimi i të ashtuquajturës gjykatë të dhomave të specializuara, po edhe më shkurtë thënë gjykatës speciale në Hagë, gabimi më i madh dhe po ashtu i pafalshëm i po atyre elitave politike - qeverisëse të Kosovës, padyshim që ishte dhe mbetet për aktualitetin dhe historinë e Kosovës, pranimi i nënshkrimit të marrëveshjeve për asociacionin e komunave me popullsi shumicë serbe në Kosovë.

Opinion i publik - në pjesën luanore a dërmuese të tij, që nga aktet e nënshkrimeve dhe në vazhdimësi - deri në momentin e pikërisht, me forcë e ka kundërshtuar dhe po e kundërshton edhe tani - vendosmërisht themelimin dhe zbatimin e një asociacioni të tillë në Kosovë.

Sipas disa sondazheve që janë bërë në ndërkohë, edhe pjesëtarët e komunitetit pakicë serb - banorë të veriut të Kosovës, **nuk janë deklaruar me shumicë, për formimin e asociacionit si prioritet të tyre.** Në të vërtetë, vetëm 13% të këtyre banorëve janë deklaruar se Kosova, duhet ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë; 38% e tyre - gjatë sondazheve, kanë kërkuar më tepër siguri; 27% -kanë kërkuar respektim të ligjit dhe mosdiskriminim, ndërsa 8% e banorëve të intervistuar, kanë kërkuar lidhje me Serbinë.

Së këndejmi, në një vend, në të cilin komunitetet pakicë, duke përfshirë edhe komunitetin serb; madje posaçërisht këtë komunitet ( i cili edhe në relacion me komunitetin shumicë shqiptar dhe me komunitetet e tjera pakicë, qoftë me kushtetutë, qoftë me ligjet e tjera, është edhe më i privilegjuar dhe më favorizuar se komunitetet e tjera), edhe kushtetuta edhe ligjet tona ua njohin të drejtat dhe liritë themelore individuale dhe kolektive, **mbi të gjitha uzuset dhe standardet ndërkombëtare, që janë aktualisht të njohur dhe të proklamuar në Botë,** ku qëndron arsyeja e imponimit të marrëveshjeve të tilla të pafavorshme për komunitetet e tjera (pakicë e shumicë); marrëveshje

---

21 Ksenofon Kristafi, Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike, UMSH Press dhe Onufri, Tiranë, 2018, fq. 283.

këto tepër dubioze e të rrezikshme për sovranitetin dhe prosperitetin e shtetit tonë dhe madje edhe skajshmërisht të dëmshme për Kosovën?

## **2. Por cilat janë pasojat reperkutive në rast të pranimit, themelimit dhe aplikimit në praktikë të të dy marrëveshjeve - të vitit 2013 dhe 2015 të Brukselit për Asociacionin, - të lidhura në ndërmjet Kosovës dhe Serbisë**

Pasojat janë edhe të shumta edhe të pariparueshme për shtetin dhe popullin e Kosovës, pa dallim. Pikërisht pasojat e mundshme njëherësh janë edhe arsye kryesore, për shkak të të cilave institucionet kompetente të shtetit dhe Republikës, nuk do të duhej kurrësi ta pranonin themelimin dhe as funksionalizimin e asociacionit të komunave më popullsi shumicë serbe.

Ja në vazhdim vetëm disa nga pasojat specifikuish më reperkutive për Kosovën:

#. Asociacioni i komunave me popullsi shumicë serbe, i tillë çfarë është strukturuar dhe mbarështuar nga palët, edhe pas aktgjykimit dhe me aktgjykimin e gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, po të themelohej, **do të mund të ishte një kreature, jo vetëm kuazi-shtetërore e vetëqeverisëse, por një shtet në shtet ose brenda shtetit**, me një substancë vetëqeverisëse antikushtetuese e cila kreature do të rrezikonte në esencë dhe në tërësinë e tij, po këtë shtet dhe shoqërinë kosovare në tërësi.

#. Asociacioni si një **entitet a strukturë vetëqeverisëse e mëvetësishme** me primesa të sigurta shtetërore - në kuptimin e funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë vetëqeverisëse, me mundësinë e zgjerimit të tij edhe me komunat tjera, si dhe me pamundësinë e askujt; pra as të organeve shtetërore qendrore të Kosovës, që ta shpërbëjnë asociacionin e pretenduar - në rastin eventual konkret edhe të tejkalimit të kompetencave, do të **shkaktonte asimetri të mëtejme dhe çekuilibrim të shtetit** (duke anëtarësuar më shumë komuna në atë asociacion, se sa komunat që do të mbeteshin jashtë asociacionit) dhe duke e **rrezikuar kështu drejtpërsëdrejti dhe katërçipërisht Republikën ekzistuese të Kosovës, deri në dekompozimin apo zhbërjen eventuale - totale të saj - në favor të një tjetre “Republikë”, e cila do të mund të ishte e barabartë ose edhe më e madhe se kjo e tanishmja - që do të mbetej. Pra, kjo “republika” e dytë eventuale dhe potencialisht e pretenduar, e cila në fakt do të ishte antirepublika apo edhe kontrarepublika serbo-ruse e Republikës sonë të Kosovës, si në aspektin etato-administrativ-territorial, ashtu edhe në atë organizativ-funksional; do të ishte dhe do të tentonte të funksiononte; të paktën si një kundërpeshë ose si një tandem pandam – i kësaj republikës sonë ekzistuese – në të gjitha dimensionet dhe aspektet e mundshme.**



#. Asociacioni **do të ishte një organizëm antikushtetues** edhe nga fakti se kundërkushtetutëshmërisht është ideuar dhe dizajnuar, që të jetë **monoetnik**, rrjedhimisht **favorizues e privilegjues në dobi të minoritetit serb**, ndërkaq **majorizues e diskriminues ndaj komuniteteve të tjera pakicë**, që mund të jetojnë në

brenda kufijve të asociacionit eventual.

#. Duke qenë i projektuar në marrëveshjet gjegjëse si monoetnik, asociacioni **do ta cenojë kushtetutën tonë e cila e garanton karakterin multietnik dhe atë qytet -ar të Republikës së Kosovës**; por do t'i cenojë po ashtu edhe postulatet kryesore e bazike të EVROPËS, rrjedhimisht edhe të BE-së , të cilat nga Revolucioni borgjez francez e deri me sot mbështeten në: **“Deklaratën mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit”** (La declaration des droits de l/home et de citoyen...) e **jo posaçërisht dhe ekskluzivisht në të drejtat kolektive të etnive të caktuara** .Përse? sepse kategoria: “HOMO-HOMINEM” NË SHQIP NJERIU(INDIVID) NJERIU, RESPEKTIVISHT QYTETARIT (CIVITAS-CIVITATIS) apo edhe më shumë se kaq, kategoria njeri dhe njerëzorja, si kategori bazike edhe filozofike edhe ekzistencialiste, në esencën e tyre padyshim që ngërthejnë edhe qenësinë edhe dinamikën edhe dialektikën e grupacionit apo të kolektivitetit të caktuar; qoftë ai kolektivitet grup etnik; popull apo edhe komb.

Pra për ta thjeshtuar edhe pak, meqë Kushtetuta e jonë, me dispozitat e saj, shtetin e Kosovës e ka përcaktuar si pluralist; si shtet (bashkim) të qytetarëve - pjesëtarë të etnive dhe fe -ve të caktuara, atëherë po kjo kushtetutë duke i mbrojtur me përpikëri dhe konsekuencë të drejtat e qytetarit i ngërthen barabarësisht - në po këtë kompozicion edhe të drejtat e komuniteteve etnike. Ndaj nuk ka nevojë, që përmes një asociacioni fantom e kancerogjen - antikushtetues, po këto të drejta një komuniteti etnik - në baza ekskluzivisht etnike t'i mbrohen shumëfish më mirë; më lart e më cilësisht - ndërsa të tjerave komunitete dhe sidomos pjesëtarëve të tyre - ndonëse si qytetar të barabartë të Republikës, po këto të drejta tui diskriminohen deri edhe në mohim të plotë të tyre.

Për askënd te ne, në Evropë dhe askund tjetër, nuk do të ishte mirë as edhe e shëndetshme - nga këndvështrimi i zhvillimit sa më intensiv e më avancues demokratik, që të lejohen e zhvillohen ide, projekte e ideologji ekstreme edhe me primesa të mundshme mbase nacionalsocialiste - shoviniste e fashiste në emër të kinse barazisë dhe as të ndonjë lloj drejtësie imagjinative. Mirëpo, për fatin e keq të njerëzimit, sot e gjithë ditën në Rusi, për shembull, ne jemi dëshmitarë të gjallë të ideve, projekteve e për më tepër edhe të veprimeve konkrete invazive - puro fashiste dhe zhbërëse.

Pikërisht nën ndikimin e ideve të tilla ekstreme, ekspansioniste dhe ekstremiste fashiste - të ideologëve putinian, të sojit e të sorollopit të

Aleksandër Dugin -it, për fat të keq tonin, ne për çdo ditë po shohim shkatërrimet barbare dhe makabre të neoperandorisë ruse, ndaj një populli fare të pafajshëm të Ukrainës. Kjo që po ndodhë tani në Ukrainë, si duket është fillimi i realizimit të megalloideve skajshmërisht ortodokse pansllaviste, të krijimit të një perandorie, siç do të thoshte Dugin të “Euroazisë”, e cila do të duhej të ishte domosdo nën tutelën rusomadhe. Kjo perandori, gjithnjë sipas Duginit dhe mbase zbatuesit neurotik të tij - Putinit, një ditë diellore për ta, do të duhej të shtrihej nga Dablina në Vlladivostok dhe nga Vlladivostoku në oqeanin Indian; duke përfshirë këtu edhe Japoninë si pjesë e perandorisë, por edhe Evropën edhe Kinën e shkatërruar - sipas tyre dhe të nënshtruar - pikërisht nga po kjo përan dori e së keqës. Në veprën e tij të konsideruar si kryesore: **“Themelet e gjeopolitikës: E ardhmja gjeopolitike e Rusisë”**, botuar në vitin 1997. Aleksandër Dugin e përshkruan në detaje projekt -in e tij (përndryshe shumë kohë më parë të planifikuar në etapa) e i cili tashmë si duket ka filluar praktikisht të realizohet – në format dhe mënyrat më tragjike të mundshme - në Ukrainë.

Me sjelljet që kishte Serbia më parë dhe që i ka edhe sot, nuk është larg mendsh, që Putini rus, t’ia këtë rezervuar një rrol dhe vend të caktuar - kuptohet destruktiv Serbisë - brendapërbrenda këtij projekti shfarosës - gjenocidal. Me projekte të tilla eventualisht gjenocidale, Serbia nuk do ta këtë vështirë të adaptohet me Rusinë e t’i menaxhojë ato, sepse ka përvojë të mjaftueshme fatkeqe - nga luftërat e saja ballkanike të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

#. Asociacioni do të mund t’i cenonte edhe përpjekjet, përndryshe trendore dhe prosperitative, të qytetarëve dhe institucioneve tona, si dhe gjithandej Evropës, për të ndërtuar një shtet më modern, më demokratik dhe pse jo **edhe shtet post-modern** i cili do të mund të hapëronte **pandam dhe në tandem me rendin e ri ndërkombëtar postmodern; shtet ky i cili synimin kryesor e ka që të jetë dukshëm më pluralist**; (por jo të jetë shtet etnik dhe as më etnik ashtu siç aktualisht pretendohet. Pra, në avenir shteti synohet të jetë edhe më kompleks; më avancues, por që në asnjë mënyrë, nuk do të duhej të jetë më i paorganizuar; më i pakonsoliduar dhe as më burokratik. Dorën në zemër, ky model apo lloj shteti i pretenduar, **nuk do duhej të ishte as më pak nacionalist e sidomos jo të ishte kaotik, siç mund të jenë - aty-këtu - një apo më shumë shtete para -moderne e madje edhe moderne të kohës.**<sup>22</sup>

#. Edhe nëse nga ithtarët e instalimit me çdo kusht të këtij lloj biçim asociacioni, do të vazhdohej të insistohej themelimi dhe funksionalizimi i tij, po këta; BE-ja dhe Beogradi zyrtar, do të duhej ta kenë të qartë, se qytetarët e Kosovës, siq nuk e kanë pranuar dhe as lejuar që mbi nëntë vite të themelohej

---

22 Shih më gjërësisht: Robert Cooper: “Shpërbërja e kombeve - rend dhe kaos në shekullin e njëzetentë, Botimet Dudaj, Tiranë, 2011, fq. 76-77.

**ky lloj surrog- antivetëqeverisë malinj** (le të kujtojmë vetëm mbi 205 000 nënshkrime peticionale të qytetarëve të Kosovës - drejtuar Kuvendit të Kosovës - aso kohe), sepse rrjedhojat e instalimit të tij, do të sillnin në vepër, në të vërtetë **instalimin e tiranisë dhe tiranizimin e pakicës**; në këtë rast do të mund ta kish -im potencialisht të pranishëm dhe në vepër - funksional dhe efikas fenomenin e tiranisë së një pakice; asaj serbe - në planin gjithëkosovar - ndaj shumicës tjetër demokratike, që përbën komunitetin shqiptar dhe të gjitha komunitetet e tjera etnike në Republikën e Kosovës. Dhe këtë fenomen nuk e lejojnë; në mos as -kusht tjetër, atëherë qytetarët e Republikës së Kosovës - jo se jo.

#. Një asociacion **me sufiks-prefiksin: “serb”**, do të ishte skajshmërisht dhe katërçipërisht cenes dhe morbid, për shtetin tonë, sepse sufiksi: “serb”- e përfaqëson dhe simbolizon një substrat shtetëror-territorial-vetëqeverisë - me shtrirje territoriale - në biçim të lëkurës së leopardit, pothuajse në tërë Kosovën mund të ngërthejë në vetvete një precedent fatal dhe i paprecedentë, që një minoritet etnik - në baza krejtësisht antikushtetuese – etnike -, juridiksht dhe faktikisht të trajtohet dhe konsiderohet si: “popull”, ndërsa shumica dërmuese demokratike në këtë vend, të trajtohet si një “tepricë”, për të mos thënë “mbetje minoritare” dhe edhe më -tutje të konsiderohet dhe të quhet vetëm multietnike dhe vetëm qytetare e jo etnike. Kjo mund të jetë edhe diskriminuese edhe e patolerueshme edhe e papranueshme.

#. Një asociacion i pretenduar mbi baza etnike **e përdhosë e zhbënë dhe zhbën edhe idenë edhe konceptin edhe parimin kushtetues bazik të shtetit me karakter multietnik dhe qytetar dhe jo etnik të Kosovës**. Shtet ky në të cilin themelimi dhe aplikimi në jetën praktike të asociacionit, **sjell deri te majorizimi politik i shumicës demokratike nga pakica**. Pakicë kjo e cila në rrjedhë të përshtatshme kohore (në mungesë të mirëbesimit) i krijon vetes, atyre të cilët e inspirojnë, indoktrinojnë dhe e instrumentalizojnë, si dhe atyre që e pasojnë, hapësirë për devalorizimin, dominimin, diskriminimin dhe defaktorizimin e po kë -saj shumice - deri në minimizimin apo edhe heshtjen - zhbërjen totale të saj.

#. Asociacioni via fakti do të **pengonte dhe dobësonte pa fund integrimin e mëtejme** (më dinamik dhe më propulziv - se sa gjer më tani) të serbëve lokal në strukturat institucionale – shtetërore kosovare - përkundrazi instalimi dhe fuqizimi i këtij asociacioni, do të mund të forconte fuqimisht - deri në pashkëputshmëri dhe destruksion, lidhjet përndryshe edhe tani shumë të fuqishme dhe të shumëfishta të komunitetit në fjalë - me institucionet dhe mekanizmat e tjerë relevant dhe kompetent të Beogradit; si dhe do të forconte a avanconte edhe më shumë e më **fort qeverisjen e konstituuar në baza etnike e rajonale**, por edhe të **dirigjuar ekskluzivisht dhe tërësisht nga Beogradi** zyrtar.

#.Asociacioni si një pistë a platformë morbide metastazike aterimi, instalimi dhe strukturimi të një kreature jashtë kushtetuese dhe kundërligjore, që si për nga qëllimi, objektivat ashtu edhe për nga destinimi dhe adresimi, do t'i ngjante si veja vesë, asociacionit fillestar që më vonë u shndërrua në Republikën e sotme serbe në Bosnje e Hercegovinë, por tani në një gëzhgjë fare të re, por më qëllime dhe synime krejtësisht të njëjta -hegjemone dhe ekspansioniste – në territorin e republikës së lirë, demokratike dhe sovrane të Kosovës. Ky tip i asociacionit do të ishte tepër i dëmshëm i rrezikshëm dhe me pasoja të pariparueshme për ardhmërinë dhe perspektivën e Kosovës - si shtet dhe të qytetarëve të të gjitha komuniteteve të saj.

#. Asociacioni si i tillë **do të mund të ishte një lloj kërcënimi a kanosje serioze për sa i përket integritetit territorial, unitaritetit dhe sovranitetit të shtetit** në tërësi, sepse asociacionin e tillë një herë të formuar, bazuar në marrëveshjet për asociacionin, realisht dhe objektivisht, nuk do të mund ta shformësojë apo ta shpërbëjë askush, pa pëlqimin e komunave anëtare të asociacionit. Fakt dhe mundësi kjo që ndërthen rezerva dhe mundësi shumë potenciale dhe të pakompensuara, që anëtarët e po këtij asociacioni, nesër a pasnesër njëanëshmërisht dhe në mënyrë antikushtetuese, **ta shpallin një strukturë tjetër të tipit të një republike serbe - brenda Republikës së Kosovës**, të cilën mbase potencialisht- bazuar edhe në situatën dhe gjendjen aktuale gjeopolitike dhe gjeostrategjike në rajon, Evropë dhe në Botë, do të mund të njihej shumë shpejtë ose në ndërkohë nga Serbia, Rusia si dhe aleatët apo satelitët e tyre - të cilët fatkeqësisht edhe për shkak të reminishencave reliktuozë të të ashtuquajturës lëvizje e të painkuadruarve, si dhe të ish-Paktit të Varshavës. Shtetet eventualisht dhe potencialisht njohëse të kësaj strukture organizative-funksionale sa malinje e gangrenoze, po aq metastazike dhe surrogate, por njëkohësisht edhe tejet të rrezikshme për Kosovën dhe më gjerë, do të mund të ishin relativisht brengosës për nga numri i tyre.

Në këtë mënyrë dhe me këso lloj veprimesh Republika e Kosovës dhe sovraniteti e perspektivat e saj konsoliduese e zhvillimore, sidomos në planin ndërkombëtar, do të mund të rrezikoheshin qenësisht.

#. Asociacioni jo vetëm që është i dëmshëm dhe si i tillë edhe i papranueshëm, **por ai është edhe i panevojshëm** sepse, si Plani i ashtuquajtur i Ahtisarit, po ashtu edhe Kushtetuta dhe Ligjet e Kosovës (sidomos ato që rregullojnë fushat gjegjëse në nivel të pushtetit dhe vetëqeverisjes lokale), të drejtat dhe liritë e komuniteteve, rrjedhimisht edhe pozitën e tyre kushtetuese e ligjore e kanë rregulluar dhe sot e kësaj dite kjo pozitë e tyre, si e tillë zbatohet - në përputhje me standardet më të larta demokratike, se sa kudo tjetër në Botë.

Ky pra është realiteti dhe e vërteta e jonë e pakontestueshme, ndaj krahas kësaj pozite mbistandardizuese e të hipëravancuar kushtetuese-juridike që vlen posaçërisht dhe ekskluzivisht për vetëm pjesëtarët e një komuniteti minoritar, po u dashka që për nevojat morbide dhe ekspansioniste e patologjike te një

regjimi autarkik dhe nacionalshovenist të Beogradit u dashka, që me çdo kusht dhe padrejtësisht të formohet një surrogat destabilizues dhe dubioz për nga qëllimet dhe mjetet, të formohet vetëm dhe specifikisht për një minoritet (konkretisht atë serb) në Kosovë, ani që në bazë të Kushtetutës së Kosovës një asociacion për të gjitha komunat - pa dallim etnie, tashmë, që shumë vite suksesshëm ekziston dhe vepron në Republikën tonë.

Është për të ardhur keq kur në platforma të ndryshme, reale ose virtuale has shkrime pretencioze, si për shembull ai: “European Centre for Minority Issues Kosovo”, me titull Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe - kalimi i udhëkryqit i disa koautorëve i qershorit të vitit 2016, studim i mbështetur nga PAX e ndonjë tjetër, të cilat, nën rreze të Diellit e të dritës, mjugullojnë me kinse hulumtimet e tyre - realitetin, si dhe kornizën tashmë të shkruar në këto dy marrëveshjet e elaboruara edhe në këtë shkrim; ku pa ndonjë akribi të mirëfilltë e të mjaftueshme faktesh dhe rezultate shkencore-profesionale, si dhe pa ndonjë pike -mbështetje të mjaftueshme kushtetuese-juridike dhe as logjike e empirike, trumbetojnë lirshëm, sikur duke ngrenë havëll, se kanë zbuluar modelin a zgjidhjen më të mirë të pranueshme, duke u pajtuar me formimin e një surrogati fantom, kuazishtetëror - brenda shtetit të Kosovës; një asociacion mbi një tjetër asociacion - tash -me ekzistues dhe funksional në Kosovë apo edhe asociacion për çdo fushëveprimtari jete e pune të ne; kuptohet në baza krejtësisht antikushtetuese dhe antiligjore; madje edhe njëetnike, por në dobi ekskluzivisht të një minoriteti etnik e në dëm kolosal dhe mbase edhe të pa kompensueshëm të gjithë shoqërisë kosovare.

#. Meqë, bazuar në dispozitat e që të dy marrëveshjeve të Brukselit për Asociacionin, duke ngërthyer në vete kompetenca dhe ingerenca jo vetëm ekzekutive, por edhe shtetvepruese e shtetfunksionuese, po këto marrëveshje, në fakt, paraqesin një biçim modeli më shumë se kuazishtetëror të paprecedent, po ky model asociacioni, nuk duhet të themelohet, sepse ndër të tjera bie drejtpërsëdrejti në kolizion me vetë idenë dhe procesin e themelimit dhe zhvillimit të Bashkimit Evropian, si një organizëm specifik regjional mbinacional par excellence, që do të thotë se po ky model, që nga fillimet e tij është ideuar e zhvilluar jashtë kornizave dhe premisave etnike, e **parësisht në vlerat e përbashkëta evropiane qytetare ose të qytetarisë evropiane. Pra pikërisht në premise të njëjta me parimet, në të cilat është përpiluar dhe miratuar edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Shih sidomos nenin 7 të kësaj Kushtetute).**

#. Për fund, pa marrë parasysh se si janë sjellë dhe si kanë vepruar qeverisjet e më hershme, përndryshe gjithsesi përgjegjëse moralisht, politikisht dhe materialisht, për koncesionet dhe gabimet fatale, siç janë nënshkrimi i këtyre dy marrëveshjeve me Serbinë - për asociacionin, INSTITCIONEVE TË TANISHME, QEVERISË SË KOSOVËS dhe as QYTETARËVE TË SAJ, në

asnjë mënyrë, nuk iu lejohej që të bëjnë gabimet e njëjta me qeveritë e mëparshme. Pra, nuk kanë asnjë bazë kushtetuese dhe as ligjore, që të pranojnë të themelojnë Asociacionin e komunave me popullsi njëetnike serbe në Kosovë.

#. Nuk bën që Kosova dhe populli i saj të shndërrohen në mysafirë në shtëpinë e tyre.

#. Nuk bën Kosova, siç thoshte **Susan Henders**: “**që brenda territorit të saj të lejohet ganglione asimetrike dhe surrogate autonome - në dëm të integritetit territorial, të sovranitetit dhe unitaritetit të saj, sepse kështu do t’i shkelte me të dyja këmbët, kushtetutën dhe ligjet e vendit**”.

#. Kosova ka dhënë gjithçka më të shtrenjtë dhe më me vlerë, që ka pasur, për ta fituar lirinë, pavarësinë dhe për ta gëzuar koekzistencën paqësore. Tani ajo nuk ka më shumë se çka të jap, **përveç se të ofroj dakordim për një marrëveshje të dyanshme; gjithëpërfshirëse dhe të pakushte me Serbinë** – për normalizim dhe për njohje të ndërsjellë, si dhe për fqinjësi normale me Serbinë dhe me të gjitha shtetet e tjera në Siujdhesën Ilirike.

#. Dikush diku-diku, për shkaqe dhe interesa të qarqeve të caktuara, f liste më herët e po flet e shkruan edhe tani, se dialogu Kosovë-Serbi duhet të përmbyllet me kompromis. Kompromisin kryesor, Kosova e ka bërë që në kushtetutën e saj, kur e ka shkruar dhe pranuar që Kosova të mos i bashkohet Shqipërisë. Hap ky I një kompromisi tipik, i cili procesin e natyrshëm, legjitim dhe historik të bashkimit kombëtar për momentin e pikërishtëm e ka lënë në gjysmë të rrugës. Ajo që mbase Kosova do të mund të bënte kompromis eventual, bazuar në premisat e parimit të mirënjohur ndërkombëtar – çdo ditë i aplikueshëm në marrëdhëniet dhe marrëveshjet a traktatet bilaterale e multilaterale - në mes të shteteve sovraane - parimit të reciprocitetit, mund të jetë rregullimi i pozitës kushtetuese-juridike - **jo vetëm të shqiptarëve etnikë - në Kosovën Lindore, por edhe të shqiptarëve dhe boshnjakëve në Sanxhak** <sup>23</sup> **dhe në gjithë territorin e Republikës së Serbisë - në nivel të njëjtë me pozitën dhe të drejtat, që serbët lokal i gëzojnë në Kosovë.**

#. Duke e përmbyllur këtë shkrim, m’u kujtua një maksimë e njohur e së Drejtës Romake, me këtë përmbajtje:

**“NEMO PLUS IURIS AD ALIUM TRANSFERE POTEST QUAM IPSE HABET”, që në shqip i bie: “ASKUSH NUK U JEP MË TEPËR TË DREJTË TË TJERËVE SE SA VETË QË KA”.**

---

23 Sepse edhe Serbia në Kosovë - me të drejtë ose jo, por në vazhdimësi, përveç për minoritetin serb e ka ngritur çështjen e pozitës kushtetuese - juridike dhe të përgjithshme edhe për minoritetet e tjera në Kosovë.

Në këtë kuptim, si mendon dikush në Bruksel, në Beograd apo kudo qoftë se Kosova dhe institucionet e saj, një qeveri e përgjegjshme e saj, çfarë në esencë do të duhej domosdoshmërisht të jetë secila syresh - duke përfshirë edhe qeverinë dhe institucionet e tanishme në qeverisje, do të duhej, siç thonë dhe insistojnë ata pa asnjë të drejtë, që të pranonte asociacionin ani që ai, pa asnjë mëdyshje është në dëm të Kosovës dhe në dobi të Serbisë, Ruisë dhe satelitëve të tyre, për ta destabilizuar dhe për ta ngujuar në vetvete dhe nga vetvetja Kosovën - në një rrjetë merimange, nga e cila nuk do të mund të dilte mbase kurrë.

Si është e mundur, që bashkësia ndërkombëtare e di që Serbia në kushtetutën e saj e ka Kosovën pjesë përbërëse - territorialisht, kushtetutshmërisht dhe administrativisht dhe përkundër këtij fakti notor, nga ajo pra nga Serbia, nuk kërkohet që ta heqë atë zgjidhje - sa absurde dhe utopike, po aq edhe gangrenoze dhe malinje nga kushtetuta e saj, për të kërkuar paqe e normalizim me Kosovën dhe të tjerët - që po i bezdisë me shekuj të tërë - në Siujdhesën Ilirike, ndërsa nga Kosova, përkundrazi kërkohet në mënyrë herë - herë edhe ultimative edhe pa asnjë bazë dhe asnjë të drejtë, QË AJO TA KURTHUROJË DHE GJYMTOJË VETVETEN; diçka që edhe ata vetë, në vendet dhe për vendet e tyre - kurrë nuk do ta bënin, për interesa eventualisht ose edhe potencialisht destruktive dhe shkatërrimtare të të tjerëve - siç vepron Serborusia - në relacion me Kosovën.

**DIXI (EX SCRIBERE) ET SALVAVI SPIRITUM MEUM - E THASHË  
(NË TË SHKRUAR OSE ME SHKRIM) DHE E ÇLIROVA SHPIRTIN  
TIM**

## **REFERENCAT**

**KSENOFON KRISTAFI: “Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike (Gjenevë, 1998-2002), UMSH Press dhe Onufri, Tiranë, 2018.**

**SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT DHE E ARDHMJA E KOSOVËS, Kollokiumi shkencor, 15 qershor 2011, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Seksioni i shkencave shoqërore, Prishtinë, 2012.**

**AGIMA. KRASNIQI: “Qeverisja lokale dhe politika, Kolegji Universum, sh.a.: “Lena”, Prishtinë, 2020.**

**PAVARËSIA E KOSOVËS DHE SFIDAT E SHTETNDËRTIMIT, Simpozium shkencor ndërkombëtar (17 maj 2018) , Akademia e**

**Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i shkencave shoqërore, Prishtinë, 2019.**

**ROBERT COOPER: “Shpërbërja e kombeve - rend dhe kaos në shekullin e njëzetentë, Botimet Dudaj, Tiranë, 2011.**

**Dr. GURAKUQ KUÇI: “Doktrinat Pacta Sunt Servanda dhe Rebus Sic Stan -tibus si balanca ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe”, Kumtesë në dorëshkrim e autorit**

**ASOCIACIONI/BASHKËSIA E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË - PARIMET E PËRGJITHSHME/ELEMENTET KRYESORE (Marrëveshja e parë e datës 19 prill të vitit 2013, në BRUKSEL**

**LIGJI NR. 04/L-052 PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE I KOSOVËS, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 28/16 DHJETOR 2011, PRISHTINË.**

**ASSOCIATION/COMMUNITY OF SERB MAJORITY MUNICIPALITIES IN KOSOVO - GENERAL PRINCIPLES/MAIN ELEMENTS.**

**AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS në rastin nr. KO 130/15., Prishtinë, 23 dhjetor 2015., nr. ref. AGJB 77/15.**

**HENDERS, SUSAN, 2013, Territoriality, Asymmetry and Autonomy: “catalonia, Corsika, Hong Kong and Tibet., New York: Palgrave MacMillan., Google Scholar.**

**Peci, Edona. 2013: “Marrëveshja e 19 prillit neutrale ndaj statusit”, Gazeta: “Jeta në Kosovë”, 27 maj 2013., <http://gazetajnk.com...>**

**UNGA (United Nations General Assembly)., 2010: “Resolution Adopted by the General Assembly: Request for an Advisory Opinion on the International Court of Justice on whether the Unilateral Declaration of Independence of Kosova is in Accordance with International Law.”Sixty-fourth session, A/RES/64/298, Goog-le Scholar.**

**AHTISAARI MARTTI: “Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement”, UN doc S/2007/168., Retrieved December 15., 2013., <http://www.unos-ec.org...>**



**JURGEN HABERMAS: “Kriza e unionit evropian në dritën e një konstitucionalizmi të së drejtës ndërkombëtare (Një ese mbi Kushtetutën Evropiane), Asdreni, Shkup, 2013.**

**ALBERT VERDOODT: “La protection des droits de l/ home dans les Etats plurilingues,Fernand NATHAN, 1973, PARIS; Editions LABOR, BRUXELLES, 1973.**

**REPUBLIKA E KOSOVËS-QEVERIA -KOSOVO IN INTERNATIONAL CO -URT OF JUSTICE - KOSOVA NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, 2010.**

**THE AMBIGUOUS NATION - CASE STUDIES FROM SOUTHEASTERN EUROPE IN THE 20th CENTURY, Edited by Ulf Bruunbauer and Hannes Grandits, Oldenbourg Verlag, Munchen, 2013.**

## 2.2 Doktrinat Pacta Sunt servanda dhe Rebus Sic Stantibus si balanca ndaj Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe



### **Dr. Gurakuq KUÇI**

#### **Hyrje**

Në konferencën e të dërguarit nga Bashkimi Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, z. Miroslav Lajçak dhe të dërguarit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, z. Gabriel Escobar, u potencua doktrina *Pacta sunt servanda* si argument diplomatik. Kjo doktrinë e përmendur nga z. Lajçak u citua gjerë e gjatë në mediat e Serbisë dhe fatkeqësisht pa debat u citua edhe nga disa media në Kosovë. Kjo doktrinë është keqpërdorur po ashtu edhe nga disa njohës vendës duke shfrytëzuar famën e tyre në publik.

Në konferencën e mbajtur me 2 shkurt 2022, nga dy të dërguarit ishte e organizuar në mënyrë të tillë që t'u përgjigjeshin pyetjeve të gazetarëve, gjegjësisht dilemave të popullit në Kosovë për shumë tema me interes. Mirëpo, për habinë edhe të të dërguarve, që shihej tronditja nga qëndrimet e tyre në mimikë dhe gjestikulacion, konferencës i dhanë ton pyetjet pa sens të gazetarëve për temat që janë më së paku në interes të qytetarëve dhe Kosovës!

Në masë dërmuese pyetjet e gazetarëve u përqendruan në çështjen e asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ato madje për shumëçka mund të cilësohen si mjet presioni ndaj Qeverisë së Kosovës në dobi të zbatimit të marrëveshjes për Asociacionin! Duke bërë aq shumë pyetje në këtë drejtim, mediat tona e shtynë z. Lajçak që të bëjë një koment, duke zënë në gojë edhe doktrinën *Pacta sunt servanda*.

Sipas kësaj doktrine, marrëveshjet e nënshkruara duhet të zbatohen, dhe atë bazuar në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të 22 majit 1969. SHBA-ja nuk është nënshkruese e kësaj Konvente, mirëpo i njeh disa pjesë të saj si pjesë e të drejtës ndërkombëtare zakonore siç argumentohet nga Dalton, et al. (1984).

Objekt trajtimi në këtë kumtesë, fillimisht kemi bërë vetë thelbin e doktrinës *Pacta sunt servanda*, me theks klauzolën e quajtur *Rebus Sic Stantibus*, duke ju kthyer pastaj marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe dhe riparë atë në terma parcialë, që mundësojnë rrugëdalje nga pozicioni aktual.

## Korniza ligjore

*Pacta sunt servanda* bënë pjesë në nenin 26 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve (1969) të pjesës së tretë mbi rezervimin, zbatimin dhe interpretimin e traktateve, në seksionin e parë tek rezervimi i traktateve.

Neni 26, “*Pacta sunt servanda*” thotë: “Çdo traktat në fuqi është i detyrueshëm për palët në të dhe duhet të zbatohet prej tyre në mirëbesim” (1969).

Zbatimi i marrëveshjeve në *mirëbesim* është po ashtu pjesë e ligjeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, që më terma latin njihet si *bona fide*. “Çdo traktat në fuqi është i detyrueshëm për palët në të dhe duhet të zbatohet prej tyre në mirëbesim” (1969).

Malcolm Shaw (2003) duke folur për *pacta sunt servanda* thotë: “në mungesë të një besimi minimal të caktuar se shtetet do të përmbushin detyrimet e tyre të traktatit me mirëbesim, nuk ka asnjë arsye që vendet të hyjnë në detyrime të tilla me njëri-tjetrin” (p, 812).

Shaw gjithashtu në kuadër të paqes tërheq vëmendjen edhe tek doktrina e bashkekzistencës paqësore. Shaw (2021) thotë: “Doktrina e bashkëjetesës paqësore u mendua gjithashtu të përfshinte ide të tilla si fqinjësia e mirë, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe respektimi në mirëbesim i detyrimeve ndërkombëtare” (pp. 430-431).

Ky nocion nënkupton parimin e mirëbesimit (besim i mirë) si komponentë kyçe e shumicës së rendeve juridike historike dhe moderne, dhe si një “parim i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare”. Parimi kërkon që palët “të sillen në mënyrë të ndershme dhe të drejtë me njëra-tjetrën (...) dhe të përmbahen nga përfitimi i padrejtë” (Zouari, 2020).

Klauzolën *pacta sunt servanda* e kufizojnë vetëm normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, të cilat emërtohen si *jus cogens*, që ndryshe njihen si të detyrueshme (peremptory norm). Neni 64 Konventës potencon taksativisht: “Shfaqja e një norme të re urdhëruese të së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare *jus cogens*” i Traktatit thotë: Nëse shfaqet një normë e re

urdhëruese e së drejtës së përgjithshme ndërkombëtare, çdo traktat ekzistues që është në kundërshtim me atë normë bëhet i pavlefshëm dhe përfundon”.

Në të njëjtin kuadër të parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare që e kufizon *Pacta sunt servanda*, është klauzola e quajtur *Rebus Sic Stantibus*.

Rrethanat ndryshojnë rastet (Circumstances alter cases), thoshte historiani dhe kritiku letrar anglez Thomas Rymer.

Klauzola *rebus sic stantibus* është po ashtu pjesë e Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve. Kjo klauzolë është doktrinë ligjore që lejon, që një kontratë ose një traktat të bëhet i pazbatueshëm për shkak të ndryshimit thelbësor të rrethanave. Në të drejtën ndërkombëtare publike kjo klauzolë ndryshe njihet edhe si klauzolë arratisje apo shpëtimi.

Neni 62 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve e parasheh mbulueshmërinë e kësaj klauzole në atë që quhet *Ndryshimi themelor i rrethanave* (*Fundamental change of circumstances*).

Bazuar në këtë dispozitë, një ndryshim i rrethanave përfshinë:

1. Rrethanat ekzistuese në kohën e konkluzioneve të traktatit;
2. Çështjet themelore/fundamentale;
3. Rrethanat e paparashikuara nga palët;
4. Ekzistenca e rrethanave duhet të ketë krijuar një bazë thelbësore për pëlqimin e palëve për t’u lidhur nga traktati; dhe
5. Efekti i ndryshimit duhet të jetë transformimi rrënjësor i fushëveprimit të obligimeve që duhet të kryhen.

Sipas profesorit të së drejtës ndërkombëtare nga Humboldt University në Berlin, Julian Kulaga (2020), thotë se, tri kërkesat e fundit tregojnë se doktrina ekziston për t’i dhënë efekt synimeve dhe pritjeve të përbashkëta të palëve të cilat po ndiqen me lidhjen e traktatit.

Oliver J. Lissitzyn (1967), para Konventës së Vjenës, e ka zhvilluar termin *pritjet e përbashkëta* (*shared-expectations*). Sipas këtij termi, qasja duhet të marrë parasysh synimet e të gjitha palëve në traktat. Ndërkaq sipas Kulagas, *rebus sic stantibus* vë qasjen më shumë tek efektet negative tek një palë e vetme.

Kulaga (2020) për përdorimin e klauzolës *rebus sic stantibus* konsideron se dy fusha të ndryshme argumentesh janë shfaqur kohët e fundit jashtë kontekstit gjyqësor.

Në fushën e parë e i vë *ndryshimet e politikës në sferën e brendshme*. Kjo ka të bëjë me argumentin e zhvilluar që thirrret në rregullimet e reja kushtetuese të rendit juridik të brendshëm të shtetit thirrës, e të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim thelbësor të rrethanave që lejon përfundimin e traktateve sipas ligjit ndërkombëtar.

Këtu ai përmend disa raste, si:

1. Përfundimi i pesë traktateve dypalëshe nga Polonia më 1999 për bashkëpunimin kulturor dhe shkencor me BRSS-në, Kamboxhian, Laosin, Mongolinë dhe Kubën.

2. Rezoluta e Asamblesë Kombëtare të Kenias që kërkon tërheqjen nga Statuti i Romës (2013).

3. Marrëveshja dypalëshe investive ndërmjet Kilit dhe Ekuadorit. Më 2010 Gjykata Kushtetuese e Ekuadorit gjeti shkelje, duke e konsideruar atë si një marrëveshje që bie në kundërshtim me kushtetutën e kësaj të fundit.

Në fushën e dytë, Kulaga (2020) i vë *argumentet e interesave jetike shtetërore*. Kjo nisët nga argumenti i Ekuadorit, që u përmend më herët, i cili bazohet në ndryshimin thelbësor të rrethanave, meqë konstatohej se ajo shkatërronte besimin e popullit ekuadorian dhe që ishte vetëm një hap i shkurtër drejt argumentit jetik të interesave të shtetit.

Për disa shtete, vlerat dhe normat e mbrojtura nga kushtetutat e tyre janë jetike për vetë-ruajtjen dhe zhvillimin e tyre. Prandaj, nuk është çudi që linja e dytë e arsytimit, që synon të justifikojë një ndryshim rrënjësor të rrethanave, është ajo e interesave jetike të shtetit.

Këtu Kulaga (2020) përmend këto raste:

1. Përfundimi i traktatit të ABM (2001) nga SHBA-ja;

2. Marrëveshjen për Menaxhimin dhe Asgjësimin e Plutoniumit të vitit 2000 ndërmjet SHBA-së dhe Rusisë, kjo e fundit e pezulloi me 2016 në emër të ndryshimit të rrethanave, interesit shtetëror për përdorim për prodhimin e energjisë.

3. Ligji i Frenimit të azilantëve nga Danimarka me 2017 që ishte ndërmarrë në emër të *Opinio juris*.

*Opinio juris sive necessitatis* ose vetëm “*Opinio juris*, ose besimi se një veprimtari shtetëror është ligjrisht e detyrueshme, është faktori që e kthen përdorimin në zakon dhe e bën atë pjesë të rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Për ta thënë pak më ndryshe, shtetet do të sillen në një mënyrë të caktuar sepse janë të bindur se është e detyrueshme për ta që ta bëjnë këtë, ose, siç shprehet Konkluzioni 9(1) i ILC, ‘praktika në fjalë duhet të ndërmerret me një ndjenjë të drejtë ligjore apo detyrimi’” (Shaw, 2021, p. 526) (Draft conclusions on identification of customary international law, with commentaries, 2018).

Raste të cilat vlen të përmenden, që janë ndërmarrë nën klauzolën *rebus sic stantibus* para Konventës së Vjenës, janë:

1. Me 1926 Kina shfuqizon njëanshëm traktatin me Belgjikën nga 1865;

2. Me 1924 Norvegjia shfuqizon traktatin e lidhur me Suedinë me 1907 me rastin e ndarjes se dy vendeve;
3. Franca me 1932 mori vendim që nën klauzolën, të mos zbatojë shlyerjen e borxheve të Luftës së Parë Botërore ndaj SHBA-së;
4. Në Konferencën e Gjenevës me 20 prill 1922, BRSS-ja tërhiqet nga të gjitha marrëveshjet e mëparshme të bëra para Revolucionit të vitit 1917;
5. Kontestimi i Egjiptit të Traktatit me Britaninë me 1936 që doli para Këshillit të Sigurimit me 1947, por që nuk arriti rezultate të kënaqshme;
6. Franca me 11 mars 1966 i drejtoi vendeve të NATO-së një memorandum, ku i njoftonte për ndryshimin e rrethanave ekzistuese në botë që nga 1949, meqë ajo donte të vinte theksin aty për veprime të pavarura edhe jashtë NATO-së;
7. Me 9 gusht 1941, presidenti i SHBA-së, Franklin D. Roosvelt, pezulloi funksionimin e Konventës Ndërkombëtare të Linjës së ngarkimit të 5 korrikut 1930 për anijet në ujërat tregtare të SHBA-së (Haraszi, 1975, pp. 16-37).

Sipas autorëve të së drejtës ndërkombëtare publike, ekzistojnë dy lloje mundësish të zbatimit të klauzolës *rebus sic stantibus*. Ajo e tërheqjes parçiale dhe ajo e tërheqjes së tërësishme (Kulaga, 2020). Pra, kjo e drejtë mundëson që në zbatim të traktatit të krijohen edhe rrethana tjera. Rastet e përmendura më lartë janë argumentime mbi këto dy lloj tërheqjesh bazuar në klauzolën *rebus sic stantibus*. Këtu nuk e kemi pa të arsyeshme t'i sjellim të përmbledhura të gjitha rastet, meqë, një gjë e tillë sa është pothuajse e pamundur, është edhe e pajustificueshme në respektim të kohës dhe natyrës së këtij punimi.

### ***Marrëveshja e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë***

Me 25 gusht 2015 u arrit një marrëveshje në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë (25 Gusht 2015). Ky lloj asociacioni u përball me shumë kundërshtime të brendshme. Si pasojë, presidentja e Republikës, në gusht të vitit 2015 çështjen e referon në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (*Presidentja Jahjaga Sot Dërgon Asociacionin Në Kushtetuese*, 2015).

Gjykata Kushtetuese më 10 nëntor 2015 merr vendim që marrëveshja për asociacionin ka 23 shkelje kushtetuese (përderisa vetë marrëveshja për asociacionin i ka 22 nene), por ajo nuk e hedh poshtë atë në tërësi, duke lënë mundësinë që të vazhdohet me tutje me ndryshimet e duhura dhe më pas edhe aplikimin e saj (Aktgjykim në rastin nr. KO130/15 2015).

Në kuadër të këtij vendimi gjykata lejoi të kuptohet se, përkundër faktit se marrëveshja është në kundërshtim me kushtetutën, meqë ajo nuk pati guxim

ta lejojë të kalojë si e tillë, pasi ashtu bëhej shkelja e kushtetutës, nuk pati as guxim që ta hedhë atë në tërësi si të paaplikueshme.

Nga ky pozicion jo i mirë që e futi Republikën politika përmes marrëveshjeve të 2013-ës dhe asaj të 2015-ës, e më pas edhe Gjykata Kushtetuese me vendimin tejet joprofesional, duhet të veprojë sërish politika dhe diplomacia, pavarësisht se ajo do të shtrëngohet të ecë *mbi tehun e thikës*, disi ngjashëm siç kanë vepruar SHBA-ja në mbrojtje të Kosovës në GjND, por edhe kjo e fundit me opinionin e saj pro pavarësisë së Kosovës.

## ***Konkluzione***

Neni 21 i marrëveshjes për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, saktësisht një pjesë e atij neni, thotë: “Statuti do të konfirmohet me dekret, pas marrëveshjes në Dialog. Secili amendament do të prezantohet nga Asociacioni/Bashkësia, do të konfirmohet me dekret dhe do të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese” (2015).

Mirëpo, një vendim i tillë, siç e cekëm, u referua për në Gjykatën Kushtetuese para se të procedohet me themelimin e Asociacionit dhe kushtetuesja i parapriu me një vendim, siç e cilësuam më lartë - joprofesional në shkallën e duhur.

Duhet të kujtojmë se, deklaratat, qoftë nga SHBA-ja, ashtu edhe nga BE-ja, nuk janë më këmbëngulëse që asociacioni duhet të zbatohet ashtu siç e parasheh marrëveshja e vitit 2015.

SHBA-të dhe BE-ja po kërkojnë një lloj zbatimi të marrëveshjes (duke marrë në konsideratë modelet ekzistuese të strukturave të ngjashme në botë) dhe në të njëjtën kohë një rrugëdalje. Ky formulim i diplomacisë perëndimore, lë të kuptohet se marrëveshja ka hapësirë të ndryshojë dhe zbatohet (Deutsche Welle, 2022). Në këtë rrafsh tani më këmbëngulëse janë SHBA-të. Por, SHBA-të, siç e cekëm më lartë, nuk janë nënshkrues të Konventës së Vjenës për të drejtën e traktateve.

Marrëveshja për Asociacionin është pjesë e marrëveshjeve të procesit drejt paqes me Serbinë dhe njohjes së Kosovës nga kjo e fundit. Andaj, si të tilla marrëveshja duhet të dërgojë drejt zgjidhjes së problemeve në mirëbesim. Si e tillë ajo nuk duhet të jetë marrëveshje që shkakton probleme në të ardhmen, deri edhe në minimin e stabilitetit.

Çdo marrëveshje e arritur në atë mënyrë, që defunksionalizon Republikën, minon paqen, duhet të hidhet poshtë, qoftë nga Kosova, qoftë nga Serbia.

Meqë Serbia nuk e pushton dot Kosovën, ndërkaq Kosova është e interesuar të arrijë paqen me Serbinë, atëherë ecja e tyre tutje në procesin integrues në BE mbetet e varur nga ky proces. Përveç kësaj, edhe durimit diplomatik të superfuqive mund t'i vije fundi. Por, në këtë rrafsh, presioni gjithsesi duhet drejtuar nga faktori real destabilizues - nga Beogradi.

Nëse marrëveshja për Asociacionin, siç është arritur me 2015, nuk i kontribuon paqes, ajo nuk është një marrëveshje *bona fide*, pasi njëra nga palët, konkretisht Serbia, po sillet në mënyrë të pandershme dhe dëshiron me çdo kusht të përfitojë në mënyrë të padrejtë.

*Pacta sunt servanda* është një parim i rëndësishëm i normave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare publike, mirëpo, të njëjtat parime e kufizojnë atë në kuadër të korpusit të normave *jus cogens*, pasi si normë e re urdhëruese ndaj marrëveshjeve jo të drejta, parashihen e duhet të jenë, marrëveshjet *bona fide*.

Për këtë arsye ekziston klauzola *rebus sic stantibus*. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka treguar që marrëveshja për Asociacionin nuk është e ndërtuar mbi qëllimet *bona fide* të të dyja palëve; ndërkaq me vendimin e saj Gjykata Kushtetuese ka treguar që marrëveshja nuk është e vlefshme, as në parimet e saj fillestare, pasi si e tillë, ajo prek interesat vitale të shtetit, rrjedhimisht parçialisht ajo është e pavlefshme. Duke u bazuar në norma të tilla, nuk ka të drejtë madje as Serbia të kërkojë që të zbatohet marrëveshja për Asociacionin bazuar në parimet e vitit 2015. Një gjë të tillë po e pohojnë me gjuhën e diplomacisë edhe SHBA-ja dhe BE-ja.

Nënshkrimi i marrëveshjes, me gjasë, nuk ishte i parashikueshëm që do të ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës nga asnjëra nga palët në dialog, e madje as nga ndërmjetësuesit, apo kështu rezononte vetëm pala kosovare?! Rrjedhimisht, vendimi i kushtetueses mbi marrëveshjen si të tillë, deri më tani ka ndryshuar sjelljen e shumë palëve karshi saj, përveç Serbisë. Një marrëveshje e tillë, atëherë kalon tek klauzola *rebus sic stantibus*, pasi si e tillë nuk mund të hyjë në korpusin e traktateve *pacta sunt servanda*, meqë ajo nuk shpreh më *pritet e përbashkëta*, por vetëm të një pale.

Kjo marrëveshje si e tillë, siç është vu re, prek edhe sferën e brendshme dhe atë të jashtme të Republikës së Kosovës, nëse procesohet si e tillë tutje, pra bazuar në parimet e vitit 2015.

Qeveria e Kosovës karshi kësaj marrëveshje është e detyruar të veprojë konform dispozitës të së drejtës ndërkombëtare *opinio juris*. Përndryshe, ajo



do të vepronte në kundërshtim me interesat e shtetit dhe të popullit të Kosovës dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe paqen.

SHBA-ja dhe BE-ja ndaj kësaj marrëveshje kanë ndryshuar qëndrim; ata tashmë kërkojnë që kjo marrëveshje të hapet. Këtë po ia kërkojnë edhe Qeverisë së Kosovës, duke nënkuptuar që marrëveshja të bëhet temë e diskutimit.

Për të ndjekur së pari interesat e Kosovës, dhe për të ruajtur partneritetin e mirë me SHBA-në dhe BE-në, marrëveshja duhet të shikohet në terma parcial, gjë që bazuar në *pacta sunt servanta* nënkupton se Kosova po e zbaton marrëveshjen. Mirëpo, bazuar në doktrinën *rebus sic stantibus* dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese Qeveria duhet ta ndryshojë atë parcialisht, duke e sjellë atë në përputhshmëri të plotë me parimin e *bona fide* (*good faith / mirëbesim*) dhe *opinio juris*.

### **Referencat:**

Aktgjykim në rastin nr. KO130/15. (2015). Marrë Shkurt 17, 2022, from [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk\\_ko\\_130\\_15\\_shq.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf)

Association/Community of Serb majority municipalites in Kosovo - general principles main elements [Asociacioni/Bashkësia e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë - parimet e përgjithshme elementet kryesore]. (25 Gusht 2015). Marrë Shkurt 17, 2022, from [https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825\\_02\\_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements\\_en.pdf](https://eeas.europa.eu/archives/docs/statements-eeas/docs/150825_02_association-community-of-serb-majority-municipalities-in-kosovo-general-principles-main-elements_en.pdf)

Dalton, R. E., Vierdag, E. W., Frankowska, M., & Tipson, F. S. (1984). The Vienna Convention on the Law of Treaties: Consequences for the United States. *Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law)*, 78, 276–284. <http://www.jstor.org/stable/25658229>

Deutsche Welle. (2022, February 2). *Escobar dhe Lajçak: Marrëveshjet me Serbinë të zbatohen*. DW.COM. Retrieved February 17, 2022, from <https://www.dw.com/sq/escobar-dhe-laj%C3%A7ak-marr%C3%ABveshjet-me-serbin%C3%AB-t%C3%AB-zbatohen-nuk-imponohen-modele-p%C3%ABr-asociacionin/a-60639329>

Draft conclusions on identification of customary international law, with commentaries (2018) Retrieved February 17, 2022, from [https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/1\\_13\\_2018.pdf](https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/commentaries/1_13_2018.pdf)

Haraszti, G. (1975). *Treaties and the Fundamental Change of Circumstances*. Martinus Nijhoff.

Kulaga, J. (2020). A renaissance of the doctrine of Rebus Sic Stantibus?. *International & Comparative Law Quarterly*, 69(2), 477-497.

Lissitzyn, O. J. (1967). Treaties and changed circumstances (rebus sic stantibus). *American Journal of International Law*, 61(4), 895-922.

*Presidentja Jahjaga sot dërgon asociacionin në kushtetuese [President Jahjaga today sends the association to the constitution]*. (2015, October 30). KosovaPress. Retrieved February 17, 2022, from <http://old.kosovapress.com/sq/lajme/presidentja-jahjaga-sot-dergon-asociacionin-ne-kushtetuese-54871/>

Shaw, M. N. (2003). *International Law* (5th ed.). Cambridge University Press.

Shaw, M. N. (2021). *International Law* (9th ed.). Cambridge University Press.

Vienna Convention on the law of treaties (with annex). Concluded at Vienna on 23 May 1969. (1969). Retrieved February 17, 2022, from <https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201155/volume-1155-i-18232-english.pdf>

Zouari, M. A. (2020, December 31). *The “Bona fide” (Good faith) Principle*. Jus Mundi. Retrieved February 17, 2022, from [https://jusmundi.com/en/document/wiki/en-bona-fide-principle#:~:text=Definition,-1.&text=The%20bona%20fide%20\(good%20faith,refrain%20from%20taking%20unfair%20advantage%E2%80%9D](https://jusmundi.com/en/document/wiki/en-bona-fide-principle#:~:text=Definition,-1.&text=The%20bona%20fide%20(good%20faith,refrain%20from%20taking%20unfair%20advantage%E2%80%9D).

## **2.3 Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe - Kapitull specifik i gjeopolitikës postmoderne serbe**

**Shkruan: Dr. Sadri RAMABAJA**

### *Hyrje*

*Që nga qershori i 1999-tës, kur pas plot 78 ditë bombardimesh të caqeve serbe nga Aleanca Veriatlantike, iu dha fund luftës me përmasa gjenocidi në Kosovë, përballja mes makroforcave që do të përcaktojnë të ardhmen e saj si entitet politik vazhdon. Në njërën anë janë shqiptarët shumicë absolute, që do të mëtojnë rrumbullakimin e ndërtimit të shtetit të ri, si kompromis përballë gjakimit historik për bashkim me Shqipërinë, e, në anën tjetër serbët, respektivisht Serbia, që përmes institucioneve paralele ka pretenduar ndarjen e Kosovës. Pala e tretë, pas shpalljes së pavarësisë, do të jetë BE-ja, që konform Rezolutës së OKB (2010), do të angazhohet si fasilituese e dialogut për normalizim të marrëdhënieve.*

*Tejzgjatja e dialogut ka prodhuar Marrëveshjen e 19 prillit 2013 dhe atë të 25 korrikut 2015, si nusprodukt i saj, e cila do të refuzohet nga Gjykata Kushtetuese. BE-ja me qëndrimin neutral ndaj Kosovës si shtet kishte kontribuar në promovimin e asimetrisë politike, duke përfunduar në mbështetje të Beogradit në procesin e defunksionalizimit të Republikës përmes imponimit në rritje të realizimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, si hap i parë drejt ndarjes së Kosovës.*

*Në këtë trajtesë do të provojmë të hedhim dritë pikërisht mbi këtë objektiv të gjeopolitikës postmoderne serbe.*

### ***Ka ardhur momenti i së vërtetës në marrëdhëniet shqiptaro-serbe***

Angazhimi i një ekipi të tërë diplomatësh amerikanë në Ballkanin Perëndimor dhe ideja që viti 2022 të jetë edhe fundi i D-lin-it për një marrëveshje politike ndërmjet Serbisë e Kosovës, respektivisht serbëve e shqiptarëve, si dy prej kombeve me peshë specifike në Evropën Juglindore, shënon momentin e së vërtetës ndërmjet dy kombeve tona, por edhe epilogun e interesave gjeopolitike të Perëndimit në përballje me Rusinë në këtë pjesë të Kontinentit të Vjetër.

Serbia duket se ende nuk e ka të qartë rrezikun në të cilin mund të gjendet krejt papritur, në rast se pretendon ta imitojë Rusinë në shtrirjen e influencës së saj përmes aplikimit të të ashtuquajturës “Botë serbe”. Ballkani Perëndimor pas

largimit të trupave serbe nga Kosova (qershor 1999) dhe pas rrëzimit të Qeverisë së Krivokapiqit më 4 shkurt 2022 në Podgoricë, është duke u pozicionuar qartë në sferën e interesave gjeostrategjike perëndimore.

Për mundësinë e vringëllimit të armëve serbe, qoftë në Bosnjë apo në Kosovë, në funksion të zgjerimit të sërishëm të Lebensraum-it serb, Beogradi ndërkohë po mëson nga leksioni i Ukrainës, atë që nuk e kishte përvetësuar si duhet nga fundi i Jugosllavisë.

Prandaj ditët e fundit po dëgjohen deklarata nga vetë kreu i Serbisë, që shënjojnë një lloj predispozite për ta ulur pasionin dhe panikun për një shpërthim të mundshëm e të shpejtë në Bosnjë a Kosovë.

\* \* \*

Dialogu i ndërmjetësuar dhe i lehtësuar nga Brukseli, e i mbështetur nga Uashingtoni për vite të tëra (në vitet 2017-2018), përmes angazhimit për ndarjen e Kosovës në emër të ripërcaktimit të kufirit shqiptaro-serb ishte futur në rrugë pa krye.

Revolucioni i heshtur i 14 shkurtit 2021 sikur ka imponuar stivimin në sirtarë të historisë të projektit për ndarjen e Kosovës, e me këtë rishikimin e plotë të procesit të dialogut.

Këtë fakt e dëshmoi vizita e dyshes Eskobar-Lajçak së fundmi në Prishtinë e në Beograd.

Tashmë nuk bëhet fjalë për alternativën: o territor, o Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, siç trumbetuan gjatë një lagje jo pa peshë e politikanëve dhe mediave që mbështeste projektin e akorduar nga dyshja Thaçi-Vuçiq, kohë para takimit në Alpbah të Austrisë. (Le të kujtojmë se pikërisht më 25 gusht 2018, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ai i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, hapur kishin folur për idenë e ndryshimit të kufijve).

Fraza që përdori Thaçi, jo vetëm atë ditë, por edhe në disa konferenca të përditshme që mbajti me t'u kthyer në Prishtinë, ishte pikërisht ajo për 'korigjim kufijsh'. Ajo ishte sinjifikuesi politik, respektivisht shënjesi i takimit atëbotë në Alpbah. Mbase Vuçiqi shtroi pyetjen tri-katër herë në panel se ku janë kufijtë ndërmjet Kosovës e Serbisë, ndërkaq askush - as Thaçi madje - nuk i tha se kufijtë ekzistojnë, ai la të kuptohej se duhej rënë në ujdë për kufij të rinj ndërmjet serbëve e shqiptarëve. (Në serbisht ai këtë akt e ka cilësuar si 'razgraničenje').

Jo rrallë para mediave, në të ashtuquajturën "konsultë me popullin", e ka cilësuar edhe si hap drejt zgjidhjes së konfliktit shekullor ndërmjet serbëve e shqiptarëve, dy popujve më të mëdhenj të Ballkanit Perëndimor, siç shprehej

ai. Kështu e cilësoi edhe në takimin e Alpbahut, ku të pranishëm ishin presidenti austriak, Alexander Van der Bellen dhe Komisionari i BE-së për Zgjerim, Johannes Hahn, tok me presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor, që duket se ishin të parapërgatitur, meqë takimi ishte orkestruar mirë nga dyshja Thaçi-Vuçiq, duke marrë parasysh se njëzëri takimin do ta cilësojnë si një zhvillim të ri e ‘moment historik’.

Me këtë akt ishte lënë mënjanë Marrëveshja e prillit 2013, e plotësuar në detaje nga ajo e gushtit 2015, meqë Gjykata jonë Kushtetuese dhe opozita ishin dëshmuar si të përgjegjshme, duke iu kundërvënë idesë së promovimit të Republikës Serbe brenda Shtetit të Kosovës, duke hedhur një hap tjetër që do t'i dëmtonte rëndë interesat strategjike të Republikës dhe të kombit, në tërësi.

Në emër të normalizimit të marrëdhënieve, më 19 prill 2013 Kosova ka nënshkruar marrëveshjen e parë me Serbinë. Sipas saj parashihej themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, që do të pasonte me integrimin e pjesëtarëve të strukturave paralele serbe në institucionet e Kosovës. Kjo nënkuptonte mundësinë e shndërruar në kusht nga serbët për zgjedhjen e komandantit rajonal të Policisë (përkatësia etnike e së cilit/cilës theksohet se duhet të jetë serb), mbajtjen e zgjedhjeve edhe në veri të Kosovës, etj. Kjo marrëveshje është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndërkaq më pas është aprovuar edhe kushtetutshmëria e saj nga Gjykata Kushtetuese. Në atë proces verifikimi e aprovimi, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar vetëm pjesën e procedurave të ratifikimit, por jo edhe pjesën përmbajtjesore të marrëveshjes. Në qoftë se, edhe vetëm për kërsëri analitike, lexohet përmbajtja e Marrëveshjes së 19 prillit, ajo venerohet qartë se nuk është në tërësinë e saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet aktuale në Kosovë, nënvizon si fakt studiuesi Adem Beha.[1]

Marrëveshja e 19 prillit 2013 - nëse e përdorim terminologjinë e John Rawls - shkel parimin e drejtësisë si paanshmëri, që nënkupton para së gjithash parimin e qytetarëve të lirë e të barabartë. Por, përtej asaj marrëveshjeje, Serbia, meqë tashmë po gjykonte se ishte momentum politik ta realizojë idenë pararendëse - atë të ndarjes së Kosovës dhe aneksimit të veriut, meqë kishte investuar në këtë plan shumë gjatë periudhës 2016-2018, duke përfituar edhe nga fakti se ndërkohë ishte etabluar administrata e Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë, ndërkaq tashmë e kishte të garantuar mbështetjen e miqve të saj tradicionalë evropianë, po lihej në sirtarë marrëveshja mbi Asociacionin dhe po kalohej në atë të ndarjes së Kosovës.

Sipas kreatorëve të marrëveshjes për ndarjen e Kosovës, ajo si akt duhej të përmyllet më së voni deri në marsin e vitit 2019, shprehej këshilltari për çështje të sigurisë të Donald Trumpit, John Bolton. Siç pohon ai në një

intervistë dhënë balkaninsight.com, përmes institutit të tij, në dobi të idesë për ndarjen e Kosovës, ishte angazhuar edhe Tony Bler dhe përfaqësues të qeverive evropiane. Tutje ai kujton se brenda Bashkimit Evropian, nuk kishte unanimitet në këtë pikëpamje, por kishte evropianë mjaft seriozë që i bindën ekspertët e Departamentit të Shtetit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare të SHBA-ve se ia vlente që ta lejonim që procesi të ecte.[2]

Prandaj, kori i këshilltarëve politikë të ish-presidentit Hashim Thaçi dhe ajo lagje e mediave që mbështeste atë, po trumbetonte për momentumin politik të duhur. Pikërisht kjo atmosferë e krijuar e kishte shtyrë presidentin serb të mos kursente lëvdatat në adresë të Thaçit në Alpbach, tek pohoi publikisht se Thaçi ishte ‘politikan më i mirë se ai (vetë)’! Kjo deklaratë e Vuçiqit duket t’i ketë gëdhulur sedrën Hashim Thaçit dhe t’i tingëllojë si e besueshme mundësia që po i ofronte ky “moment historik”, duke marrë në konsideratë edhe premtimet e mundshme që t’i shmangej Gjykatës Speciale. Shih për këtë, duket se janë këto arsye pse ai nuk do t’i kontrollonte dot emocionet e do të deklaronte se ‘ne [Thaçi e Vuçiqi] nuk jemi djem problematikë’ (We are not problematic guys), në anglishten e tij të çalë!

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është projekt tashmë i realizuar me sukses në Bosnjë. Edhe atje filloi si asociacion i komunave serbe dhe përfundoi me shtetin në shtet - Republikën Serbe. Si i tillë, ky projekt është kapitull i gjeopolitikës moderne serbe. Këtë e dëshmon qartë intelektual i serb Dr. Ljubisha Mitroviq:

*“Lufta për kthimin e Kosovës nën sovranitetin e Serbisë do të jetë afatgjatë dhe e pasigurt. Ajo duhet e mund të bëhet vetëm përmes një strategjie bashkëpunimi dhe luftime permanente për ta zhvilluar një vetëdije politike autonome gjithandej te popujt e Ballkanit për nevojën për bashkëpunimin e tyre (riafirmimi i fjalëkalimit strategjik “Ballkani për popujt e Ballkanit” dhe “Evropa për evropianët”), duke fituar kështu një lloj shprese për Evropën e së ardhmes dhe të botës. Duke u bërë një vend i fortë ekonomikisht dhe në rrafshin kulturor, Serbia do ta rifitojë reputacionin e saj politik dhe do të sigurojë riintegrimin demokratik në këtë gjeohapësirë”.*[3] [Dr, Ljubiša Mitrović: 2018]

Asociacioni rrjedhimisht mbetet si vetë nocioni “Bota serbe” - një lloj fjalëkalimi strategjik i Beogradit drejt aneksimit të veriut të Kosovës dhe krijimit të të ashtuquajturës “Botë serbe”.

Forumi i Alpbach-ut po zhvillohej vetëm dy ditë pas konferencës së famshme të këshilltarit për Siguri Kombëtare i presidentit amerikan, Donald Trump, John Bolton, mbajtur në Kiev, më 24 gusht 2018, ku kishte deklaruar se SHBA-të nuk do të përjashtonin apo kundërshtonin një zgjidhje me këmbime terrioresh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëse të dyja vendet binin dakord për

këtë. Këto deklarata vinin një javë pasi që gazeta prestigjioze “The Financial Times” shkruante se “Kosova dhe Serbia po i afroreshin një zgjidhjeje me ndarje të Kosovës”.

Përmes kësaj deklarate po vihej në pah çarja në politikën amerikane ndërmjet këshilltarit për Siguri Kombëtare (John Boltonit) dhe Departamentit Amerikan të Shtetit, të udhëhequr nga Sekretari Pompeo. Ky i fundit, më 20 gusht 2019, pas takimit me Presidentin e Serbisë Vuçiq, në një kumtesë të lëshuar, theksoi “nevojën për zgjidhje me njohje të ndërsjellë të të dyja vendeve, pa përmendur çështjen e kufijve”. Ajo ndërkohë do të përforcohet nga administrata e re e Joe Bidenit, me theks në letrën e Sekretarit Amerikan të Shtetit për kryeministrin Albin Kurti, ku thekson se mungesa e zgjidhjes në marrëdhëniet Kosovë-Serbi mbetet pengesë për integrimin euroatlantik të Kosovës. Ndërkaq në një letër që i kishte dërguar Vuçiqit, më 23 shkurt 2021, e publikuar në “Novosti”, Blinken kishte thënë se synimi i SHBA-së është një marrëveshje gjithëpërfshirëse ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, e përqendruar te njohja e ndërsjellë.[4]

### ***Agjenda e munguar e Brukselit për Kosovën dhe uniteti i maskuar***

Vizita e Ndihmës/Sekretarit amerikan për Evropën dhe Azinë, Gabriel Eskobar, së fundmi, tok me të ngarkuarin e BE-së për dialogun ndërmjet Kosovës e Serbisë, Aleksander Lajçak, në Prishtinë e në Beograd, kur u hoq nga tavolina “ultimatumi” që kishte vënë Brukseli më parë: o Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe - o ndarja e Kosovës, ndërkohë ka shkaktuar konfuzion të vërtetë midis aleatëve perëndimorë. Ndërkaq këmbëngulja e vazhdueshme për terminologjinë që asocion “unitet” mes aleatëve euroatlantikë rreth epilogut të këtij dialogu, tregon qartë kompleksitetin dhe mosmarrëveshjet për të ardhmen e Kosovës dhe të Oshqiptarëve në BE, që mund të jenë, pas rastit të Ukrainës, fatale për të ardhmen e vetë Evropës. Këtë fakt duket tashmë e ka të qartë sidomos Uashingtoni.

Brukseli kishte kohë që e kishte zhvendosur fokusin e dialogut nga çështja qenësore e tij: njohja reciproke ndërmjet dy shteteve, që me të drejtë u cilësua nga diplomati ynë Shaban Murati si “Perspektivë amerikane” për Kosovën[5] tek dialogu për normalizim.

Mesazhi i diplomatit të lartë amerikan në Prishtinë, sipas Muratit, kishte dy parametra kryesorë:

1. SHBA-të mbështesin pavarësinë, integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës;
2. SHBA-të janë për qëndrueshmërinë e dialogut në çështjen e njohjes reciproke midis dy shteteve, kërkesë e parashtruar nga presidenti amerikan Xho Bajden

më 7 shkurt 2021 në komunikimin me shkrim me presidentin e Serbisë Vuçiq.[6]

Qëndrimi i mefshtë i Brukselit, por që po rrezikonte de fakto interesat gjeopolitike të SHBA-ve në rajon, i dha Uashingtonit mundësinë për t'u kthyer sërish në rolin qenësor, respektivisht t'i "marrë frenat në duart e veta" për përmbylljen e këtij procesi. Me fjalë të tjera, tash e tutje, Uashingtoni, në emër edhe të Brukselit (BE-së), do t'i japë ton dialogut dhe vetë fundit të tij, natyrisht duke marrë në konsideratë para së gjithash interesat e tij.

Vizita e dyshes së diplomatëve perëndimorë, sidomos në Beograd, dëshmoi se jo gjithçka është idilike, ashtu siç do të dëshironin të ishte. Rikthimi i Aleksander Vuçiqit tani tek Marrëveshja e prillit të 2013 për Asociacionin mbetet thembra e Akilit edhe për diplomacinë amerikane. Në fakt, edhe pse i sikletshëm - në stilin e tij të njohur që të kujton Milosheviqin - Vuçiqi fill pastaj pohoi sërish, si papagall, vetëm të vërtetën e zhveshur serbe: "Serbia nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës, për aq kohë sa unë jam president!" Por, pikërisht tek kjo "e vërtetë serbe" thyhen shtizat mes diplomacisë euroatlantike.

Diplomacia amerikane tashmë e ka të qartë se Asociacioni i Komunave Serbe për Beogradin është vetëm prolog drejt ndarjes së Kosovës, por është diplomacia evropiane ajo që po dëshmon se Brukselit i ka munguar agjenda reale për Kosovën. Në këtë dihotomi konceptimesh për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor, Beogradi nuk ka hezituuar ta bëjë publik projektin gjeostrategjik për "Botën serbe", brenda së cilit e sheh edhe veriun e Kosovës.

### ***Ballkani në darët e gjeopolitikës***

Situata përgjithësisht në Ballkanin Perëndimor vazhdon të jetë tejet konfuze. Mali i Zi tek më 4 shkurt, kur e rrëzoi qeverinë klerofashiste që erdhi në pushtet falë ndërhyrjes së hapur të Serbisë dhe Ruisë, po i rikthehet vetvetes dhe sferës së interesit strategjik perëndimor. Në Bosnjë vringëllimi i armëve, sidomos në Republikën Serbe, bëhet me potencë të theksuar dhe fare hapur. Një pjesë e shteteve të rajonit, sidomos Serbia dhe Bosnja - me theks në këtë mes Republika Serbe, vazhdojnë të jenë sferë e ndikimit të Ruisë, Kinës, por edhe Turqisë.

Por, për dallim p.sh. nga ukrainasit, që janë të vetëdijshëm për pozitën e rrezikshme në të cilën ndodhet vendi i tyre - i vendosur mes interesave të Ruisë dhe fuqive të Perëndimit, serbët, përkundrazi, nuk janë fare të vetëdijshëm për këtë "lojë" të rrezikshme, ku mund të rikthehen.



Mirëpo, derisa është e sigurt që qytetarët askund nuk do të donin të kthehen në fillimet e dekadës së fundit të shekullit të kaluar, duke u zhytur sërish në luftë, historia, sidomos ajo e Bosnjës, na mëson se ajo, pra lufta, fillon në kushte të tilla të papritshme (edhe kur nuk është e dëshirueshme). Në përplasjet ndërmjet palëve, vjen një çast kur diplomacia bllokohet, ndërkaq tashmë fillon të rrjedhë momenti kur gjërat dalin jashtë kontrollit. Atëherë diplomacia ua lëshon vendin armëve - jo vetëm marshit të tankeve, por edhe futjes në “provë” të armëve ultramoderne.

Në këtë rrjedhë ndeshtrashash, kur Ballkani po hyn sërish në darët e gjeopolitikës, Xhek Smith, prokuror amerikan me përvojë në hetime politike të rangut të lartë dhe hetime penale ndërkombëtare, do të emërohej Prokuror i Specializuar për Ballkanin Perëndimor, që për objektiv ka luftën ndaj krimit të organizuar si burim kryesor financiar për strukturat politike që mund të jenë dorë e zgjatur e agjendës ruse dhe terrorizmit.

Për rëndësinë, respektivisht rrezikshmërinë që përfaqësojnë këto struktura të krimit të organizuar e të katapultuar edhe në politikë, por edhe për përhapjen e tyre në botë, flitet në Rezolutën e Konferencës VIII Ndërkombëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e mbajtur në Kubë, në vitin 1990. Në tekstin e rezolutës në fjalë qe nënvizuar se, “krimi i organizuar rreshtohet si problem i dytë për botën pas atij ekologjik dhe se një shtet tashmë nuk është në gjendje ta përballojë dhe t’i dalë mbanë i vetëm kësaj problematike në territorin e tij.[7]

Ballkani Perëndimor ndërkohë rikthehet në vëmendjen e Uashingtonit si zonë e interesit strategjik amerikan, që mund të cenohet nga forca të kësaj natyre, por që lehtësisht bie nën ndikimin e Ruisë. Zhvillimet politike në Bosnjë e Mal të Zi e dëshmojnë këtë tezë katërçipërisht. Në këtë prizëm duhet shikuar angazhimin e SHBA-ve në Ballkanin Perëndimor në luftën kundër krimit të organizuar dhe ndërvarësisë së politikës ndaj qarqeve të inkriminuara në politikë. Krejt këtë duhet shikuar si pjesë e doktrinës së J. Bidenit në mbrojtje të pozicionit gjeopolitik dhe të demokracive liberale në përballje me neofashizmin, që po vepron hapur nën siglën e demokracive iliberale.

## **Përfundim**

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe duhet trajtuar ashtu si ishte: si marrëveshje e imponuar nga aleatët e Beogradit brenda BE-së, të koordinuar me këto qarqe neofashiste në rajon, por edhe si shantazh ndaj krerëve të politikës kosovare, të cilët Beogradi kishte kohë që i kishte instaluar si marioneta në krye të Republikës.

Imponimi i Asociacionit si shtesë e Planit të Ahtisarit, që u garantonte komunave me shumicë serbe të drejta më të gjera se Karta Evropiane për

Pushtetin Lokal, paraqet dështimin e projektit të bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën si bashkësi e qytetarëve të barabartë dhe një model që do të ketë efekte domino, jo vetëm në rajon. Imponimi i tij, de fakto, e defunksionalizon Republikën.

Perëndimi si tërësi duhet t'i marrë në konsideratë dy kthesat historike që ndodhën në rajon brenda një periudhe jo më të gjatë se një vjet: atë të 14 shkurtit 2021, që prodhoi revolucionin i heshtur në Kosovë, në njërën anë, dhe atë të 4 shkurtit 2022 në Podgoricë, kur u rrëzua qeveria klerofashiste e instaluar nga Kisha Serbe dhe politika subversive serbo-ruse.

Këto dy ngjarje duhet parë si tërësi integrale e perspektivës amerikane për Ballkanin Perëndimor.

Perspektiva amerikane, siç pohon diplomati ynë i mirënjohur Shaban Murati, “ka dy parametra kryesorë:

1. SHBA-të mbështetin pavarësinë, integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës.
2. SHBA-të janë për qëndrueshmërinë e dialogut në çështjen e njohjes reciproke ndërmjet dy shteteve...”[8]

Kjo u dëshmuar edhe në letrën e fundit (12. 2. 2022) të J. Biden-it për kreun e Serbisë, A. Vuçiq, në të cilën pohohet qartë se ka ardhur koha që dialogu duhet të marrë fund përmes njohjes reciproke, si diçka krejtësisht e pritshme nga pala amerikane. Ky fakt dëshmon se tashmë ka ardhur momenti i së vërtetës në marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

---

[1] <https://sbunker.net/teh/68713/mbi-zanafillen-e-asociacionit-te-komunave-serbe-9-deshtime/>

[2] <https://balkaninsight.com/2020/07/15/ish-keshilltari-i-trump-vajton-mundesine-e-humbur-rreth-kosoves/?lang=sq>

[3] <https://www.youtube.com/watch?v=KUwtCBfLGJ4>

[4] Shih: Specijalna poruka za Vučića od Antonija

Blinkena, <https://www.novosti.rs>, 31 mars 2021

[5] Shih: <https://www.ishgj.org/analize/perspektiva-amerikane-per-kosoven/>

[6] Po aty

[7] Dr Ergys LLANAJ, Temë disertacioni: Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar — një ndër zgjidhjet efikase të luftës kundër terrorizmit: Rast analize Ballkani Perëndimor dhe Shqipëria, UT, Tiranë 2018]

[8] Shaban Murati: <https://www.ishgj.org/analize/perspektiva-amerikane-per-kosoven/>

### III. GJEOPOLITIKA RAJONALE

#### 3.1 MAQEDONI - BULLGARI, NJË TUNEL I MBYLLUR QË KA MUNDUR TË JETË AUTOSTRADË E HAPUR!



#### **Emin AZEMI, publicist**

Shqiptarët ishin dhe duhet të ngelin konsekuent në mbështetjen e frymës euroatlantike në Maqedoninë e Veriut. Ata edhe tani duhet të tregojnë konsekuencë, duke kundërshtuar çfarëdo rezolute që e dëmton këtë frymë. Rezoluta e VMRO-DPMNE-së nuk mundet të riparojë keqmenaxhimin e procesit të deritanishëm të bisedimeve me Bullgarinë, andaj duhet të gjendet një rrugë tjetër e cila më shpejt do të sillte në tryezë ndonjë marrëveshje mirëkuptimi në mes të dy vendeve.

Shkup, 12 korrik, 2021 - Bullgaria deri më tani ka miratuar dy rezoluta në Parlament për të bllokuar pranimin në BE të Maqedonisë së Veriut. Tani radhën e ka kjo e fundit - të bllokojë vetveten, me një rezolutë që do të përdorej më tepër për konsum të brendshëm politik, se sa që do të ketë ndonjë efekt të jashtëm, sidomos ndaj fqinjit të saj lindor. Sepse, edhe në Bullgari u rrëzuan dy qeveri dhe lufta e brendshme politike u përdor për të atakuar kundërshtarët, duke luajtur në kartën e Maqedonisë.

Sofja zyrtare insiston në pesë kërkesat e saj drejtuar Shkupit që fillimisht emërtimi i gjatë dhe i shkurtër i vendit t'i atribuohet vetëm subjektit politik “Republika e Maqedonisë së Veriut”, e jo rajonit gjeografik “Maqedonia e

Veriut”, pjesë të së cilës, sipas Sofjes zyrtare, ndodhen brenda kufijve të Bullgarisë.

Pastaj kërkohet që “Republika e Maqedonisë së Veriut përfundimisht të heqë dorë nga kërkesat për pakicën maqedonase në Bullgari”.

Në kërkesën e tretë, Bullgaria fton Maqedoninë e Veriut të “fillojë procesin e rehabilitimit të viktimave të komunizmit jugosllav, të cilët kishin përjetuar represion në territorin e saj për shkak të vetëdijesimit bullgar”.

Sipas kërkesës së katërt, Maqedonia e Veriut duhet të adaptojë me Bullgarinë përmbajtjen e programeve arsimore, me qëllim të “reflektimit objektiv të historisë së përbashkët drejt eliminimit të përmbajtjeve që nxisin urrejtje ndaj Bullgarisë”.

“Në territorin e Maqedonisë së Veriut duhet të mënjanohej të gjitha tabelat dhe mbishkrimet që përhapin urrejtje ndaj Bullgarisë dhe bullgarëve”, thuhet në kërkesën e pestë të Sofjes zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore në Shkup

## ***BALLKANI PERENDIMOR, NJË KORSI E VEÇANTË ME LËVIZJE TË NGADALSHME EUROPIANE!***

Ka ende forca politike në rajon që koketojnë në mes veti (si në kohën e Aleancës Ballkanike) për të frenuar proceset euro-integruese. Kjo tendencë shpërfaqet edhe në rastin e Maqedonisë së Veriut, bllokimi i së cilës po ndodhë, jo për ndonjë betejë identitare, por për shkaqe të një gjeopolitike të re rajonale që po duan ta imponojnë qarqe të caktuara politike, duke frenuar dhe, mundësisht, ngadalësuar procesin eurointegrues të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përfituese më e madhe e këtij aksioni eurospektik sigurisht që është Rusia, ndonëse ajo nuk po duket të veprojë në sipërfaqe, përderisa ka eksponentë që e bëjnë punën e saj në hapësirën politike të Ballkanit Perëndimor, sidomos në Beograd, Sofje, e pse jo edhe në Shkup, ku ditë më pare dëgjuam këtë parullë: “Duam Evropën, por më shumë duam veten tonë”. Kryeministri konservativ hungarez Viktor Urban, gjatë pritjes që i bëri në fundjavë presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u shpreh se Hungaria pa kurrfarë hezitimi e mbështet anëtarësimin e Serbisë në BE, për arsye se, siç tha ai, prapa saj qëndron gjithë Ballkani Perëndimor. “Përderisa të mos integrohet Serbia, Ballkani Perëndimor nuk do të jetë i integruar. Serbia është shtet i rëndësishëm, këtë edhe BE duhet ta kuptojë”, nënvizoi Urban.

Si është e mundur të integrohen në BE para Serbisë, Shqipëria e Maqedonia?! Është kjo një pyetje thelbësore që përbën lajtmotivin e gjeopolitikës së re rajonale, e cila është e prirë ta shohë Ballkanin Perëndimor si një zonë me korsin të veçantë ku janë të kufizuara shpejtësitë e lëvizjes evropiane. Këtu,

mbase, mund ta ketë burimin edhe ideja për Mini-Shengenin që favorizohet kaq shumë nga Beogradi dhe qorrazi mbështetet nga Tirana dhe Shkupi.

Në një të ardhme të afërt, ndoshta puna më e mençur e Ali Ahmetit do të ishte ta bindë Zoran Zaevin që të heqë dorë nga ideja e Mini-Shengenit, sepse vetëm në këtë mënyrë Aleksandar Vuçiqi do të ngelë pa mbështetjen e Edi Ramës. Ky i fundit do ta braktisë këtë ide vetëm nëse Ali Ahmeti e bënë lëvizjen e duhur me partnerin qeverisës në Shkup.

Maqedonia e Veriut bashkë me Shqipërinë, Kosovën dhe me Malin e Zi, duhet të thellojnë bashkëpunimin reciprok në kuadër të Procesit të Berlinit. Jorastësisht vëzhgues të paanshëm me të drejtë kanë konstatuar se Mini-Shengeni është dublim i procesit të Berlinit, dhe si i tillë ka zëvendësuar Gjermaninë me Serbinë.

Sipas Demush Shashës, fakti që në Mini-Shengen, tri shtetet; Shqipëria, RMV dhe Serbia kanë përjashtuar vendet e BE, tregon se rolin udhëheqës, natyrshëm do e ketë Serbia, si shteti më i madh dhe më i fuqishëm.

“Me Mini-Shengenin, Rama, Vuçiq dhe Zaev kanë përjashtuar të gjithë miqtë e Kosovës, vendet e BE nga Procesi i Berlinit. Pra, rolin udhëheqës natyrshëm do e ketë Serbia, si shteti më i madh dhe më i fuqishëm. Kosova nuk ka pse zëvendëson Berlinin me një forum ku fjalën kryesore e ka Serbia. Nuk e kalon testin e nevojshëm politik që Kosova t’i bashkohet. Procesi i Berlinit ka siguruar mekanizma, çfarëdo mekanizmi tjetër është tentativë për ta penguar”, është shprehur analisti Shasha.

Maqedonia e Veriut nuk duhet të marrë pjesë në forumet e Mini-Shengenit dhe gjithsesi ta kundërshtojë këtë iniciativë, sepse edhe vetë tre liderët që e nisën, nuk e besojnë më.

## ***REZOLUTA MAQEDONASE - KOMPENSIM I DINJITETIT TË HUMBUR!***

Rezoluta e VMRO-DPMNE-së, e propozuar ditë më parë për bisedimet me Bullgarinë, kërkon konsensus të gjerë lidhur me negociatat për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë dhe zhbllokimin e procesit të integritit evropian. VMRO-DPMNE u ka bërë ftesë të gjitha forcave politike që të miratohet në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut kjo rezolutë, përmes së cilës këmbëngul që “negociatat me Bullgarinë të zhvillohen në pozita të barabarta, duke respektuar të drejtën ndërkombëtare, pa asnjë kusht nga njëra palë ose nga tjetra dhe me respektimin e dinjitetit të popullit maqedonas”.

Ftesës për të mbështetur këtë rezolutë, i është përgjigjur pozitivisht Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë, por edhe Bashkimi Demokratik për Integrim.

“Absolutisht solidarizohemi me bashkëqytetarët tanë maqedonas sepse ne dimë më së miri se çfarë do të thotë të kontestohet gjuha, përdorimi i gjuhës, kulturën e historia etj. Vlerësojmë se me metoda të shekullit të 19 nuk mundet të zgjidhen problemet e shekullit 21. Presim që në zgjedhjet në Bullgari të fitojnë forcat progresive demokratike që do të mundësojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes sonë me Sofjen dhe hapjen e negociatave në dhjetor”, është shprehur zv.kryeministri i parë Artan Grubi, duke prezantuar në këtë formë qëndrimin e partisë së tij.

Opozita shqiptare, e përfaqësuar nga Aleanca për Shqiptarët është deklaruar për Rezolutën duke vlerësuar se temat e këtilla dhe procesi integrues në të njëjtën kohë, janë shumë serioze, meritojnë një trajtim më serioz e institucional dhe nuk mund të merren vendime vetëm në bazë të deklaratave politike dhe partiake.

“Ne jemi në konsultim profesional edhe me faktorë të brendshëm, por edhe me faktorin ndërkombëtarë, me qëllim që të mos lejohet as edhe ndonjë pasojë aksidentale. Debati rreth temave të këtilla nuk mund të zhvillohet përmes konferencave për shtyp nga selitë partiake, por nevojitet një debat i mirëfilltë në institucionin më të lartë ligjvënës në vend. Të dëgjojmë të gjitha detajet, argumentet e palëve në Kuvend dhe aty do shpalosim edhe argumentet dhe qëndrimet tona”, thotë ASH-ja opozitare.

Vijat e kuqe të Rezolutës maqedonase mund të kuptohen edhe si korniza të një procesi antiintegrues brenda të cilit synohet të futet Maqedonia, pa fajin e qytetarëve të saj, përgjithësisht, dhe të shqiptarëve, posaçërisht.

Përgjigja e Maqedonisë me Rezolutë ndaj qëndrimeve negatore bullgare, është një hap i gabuar dhe i hedhur mbrapsht, për arsye se punën e parë që ka qenë dashur ta bëjë Shkupi zyrtar do të duhej të ishte propozimi i një marrëveshjeje mirëkuptimi me Bullgarinë, e cila do të ishte pjesë e një procesi afatgjatë të qëndrimeve në mes të dy vendeve. Ky proces ka qenë dashur të ketë mediator një emisar të BE-së dhe të udhëhiqet nga politikanët e të dyja vendeve, e jo nga historianët, sepse këta të fundit u dëshmuar se në vend se të hapin udhë, i mbyllën ato. Kur historianët përdoren si mashë nga politikanët, në fund rezultojnë që edhe masha është djegur, edhe mishi ka mbetur i pangrënë.

Ashtu siç kanë ecur deri më tani bisedimet maqedonaso-bullgare, u dëshmuar se ka shkuar krejt mbrapsht. Ka shkuar ashtu siç nuk do të duhej të shkonte, sepse gjithkund në mes shteteve serioze fillimisht arrihet marrëveshja, e pastaj formohen komisionet. Në rastin e Maqedonisë dhe Bullgarisë ndodhi e kundërta. Fillimisht u krijua Komisioni i historianëve, pastaj u lansuan rezolutat bllokuese, ndërkohë që marrëveshja finale nuk duket asgjëkund në horizont.

## ***MARRËDHËNIET MAQEDONASO-BULLGARE DHE SHQIPTARËT***

As bullgarët, as maqedonasit nuk janë korrekt me shqiptarët. Përderisa përfaqësues të ndryshëm publik e institucional bullgarë japin deklarata “giciluese” për veshin e shqiptarëve, duke i përdorur ata si pykë në “pyllin e dendur” të mosmarrëveshjeve identitare me maqedonasit, këta të fundit tani janë kujtuar të kërkojnë solidarizimin e shqiptarëve lidhur me rezolutën që do t’ua tregonte vijat e kuqe bullgarëve.

Nëse i referohemi historisë, Bullgaria ishte pjesë e Aleancës Ballkanike që synonte të jetësonte në praktikë vendimet e Shën Stefanit për gllabërimin e trojeve shqiptare. Por, në anën tjetër, Bullgaria luante në dy karta ndaj faktorit shqiptar, duke toleruar veprimtarinë antiosmane të shoqatave shqiptare në Sofje. Bullgarisë i konvenonin shqiptarët si “element destabilizues” në Perandorinë Osmane, sepse vetëm në këtë mënyrë ajo i realizonte qëllimet e saj kundër Portës së Lartë.

Divergjencat bullgaro-maqedonase kanë qenë të shumta, por jo rrallë është dëshmuar se këto divergjenca janë shndërruar në një gjuhë të përbashkët sa i përket elementit shqiptar ortodoks. Në lëvizjen revolucionare maqedonase, të përkrahur nga bullgarët, pati mjaft eksponent të shqiptarëve ortodoks, në mesin e të cilëve edhe Petar Çaulevi (në vitin 1913 vihet në shërbim të Qeverisë së Ismail Qemalit në Vlorë), Kristo Bageri (i biri i Josif Bagerit) etj. dhe kjo ishte arsyeja se pse Bullgaria ishte kundër autonomisë maqedonase, sepse në themel të saj qëndronin shqiptarët ortodoksë. Ky ishte edhe shkaku pse elementi shqiptar ortodoks u ndoq me të madhe nga autoritet bullgare dhe për pasojë Petar Çaulevi gjeti strehim në Shqipëri, kurse Kristo Bagerin e helmuan. Babait të këtij të fundit, Josif Bagerit, madje në dokumente ia falsifikuan edhe përkatësinë fetare, duke e ‘kryqëzuar’ në protestant. Si duket shqiptarët ortodoks paraqitnin pengesën kryesore për Bullgarinë që t’i shtrijë pretendimet historike ndaj Maqedonisë.

Por, hiq më korrekt ndaj shqiptarëve nuk u sollën as maqedonasit. Përveç faktit që ata vazhdojnë të shprehin animozitet të pafshehur kundër gjuhës shqipe dhe karakterit autokton të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, duke refuzuar kategorikisht që ata t’i përfshijnë si element shtetformues në Kushtetutë, maqedonasit po mundohen që edhe në raportet me Bullgarinë t’i përdorin shqiptarët si një gomë rezervë që do t’i shpëtonin në ujërat e trazuar të gjeopolitikës rajonale.

Shqiptarët, nga ana e tyre, gjithmonë patën ndjeshmëri civilizuese ndaj problemeve identitare të maqedonasve, duke mos u solidarizuar me fqinjët në mohimin e gjuhës, emrit, kishës, historisë maqedonase. Por, kjo nuk ka mjaftuar që lojaliteti dhe mirëkuptimi i shqiptarëve të mos ketë kurrfarë vlere

në kandin e prishur të matjeve ala-maqedonçe. Kjo u pa edhe me rastin e përfshirjes së një shqiptari në Komisionin e historisë, atëherë kur procesi veç kishte përfunduar dhe me këtë synohej të legjitimohej ky proces i dështuar përmes një shqiptari. Çuditërisht faktori politik shqiptar nuk e pati të zhvilluar sensin e reagimit ndaj kësaj çoroditjeje, sepse ashiqare shihej se roli i një historiani shqiptar në atë Komision ishte vetëm sa për kozmetikë dhe për të pjesëtuar artificialisht përgjegjësinë për dështimet eventuale në bisedimet me Bullgarinë.

Shqiptarët ishin dhe duhet të ngelin konsekuent në mbështetjen e frymës euroatlantike në Maqedoninë e Veriut. Ata edhe tani duhet të tregojnë konsekuencë, duke kundërshtuar çfarëdo rezolute që e dëmton këtë frymë. Fundja, kontesti maqedonaso-bullgar, nuk është në mes të dy kombeve por në mes të dy shteteve dhe për rrjedhojë shqiptarët si pjesëtarë të barabartë të shtetit të Maqedonisë së Veriut duhet të distancohen nga formulat etnike të shekullit 19, atëherë kur bashkë me formimin e kombeve, formohej edhe ndërgjegjja historike për avancimin e tyre. Tani jetojmë në shek. 21 dhe tingëllon anakronike që të ndërtohen shtete moderne me koncepte të shek. 19. Shqiptarët duhet të jenë ata që sensin shtetndërtues ta demonstrojnë në praktikë duke flakur nga përdorimi metodat bllokuese në procesin e rëndësishëm eurointegrujes.

Shqiptarët edhe në kontestin me Greqinë, ashtu edhe në mosmarrëveshjet me Bullgarinë kanë dëshmuar përkushtimin e duhur fqinjësor ndaj bashkëqytetarëve maqedonas, por ky mirëkuptim nuk duhet të vlejë tani kur qarqe të caktuara politike në Maqedoni, me apo pa vetëdije, bëhen palë me tendencat eurospektike.

Rezoluta e VMRO-DPMNE-së nuk mundet të riparojë keqmenaxhimin e procesit të deritanishëm të bisedimeve me Bullgarinë, andaj duhet të gjendet një rrugë tjetër e cila më shpejt do të sillte në tryezë ndonjë marrëveshje mirëkuptimi në mes të dy vendeve.



### 3.2 TABLO E SHKURTËR MBI MAQEDONINË E VERIUT



#### **Dr. Albulenë HALILI**

Maqedonia e Veriut është një shtet unitarist atipik. Është një shtet de jure monoetnik, madje etnocentrik, i ndërtuar në një shoqëri de facto multietnike.

Problemet, apo të gjitha çështjet e hapura në Maqedoninë e Veriut janë të natyrës ontologjike, pra, kanë të bëjnë me vetë qenien e saj.

- E para, gjeneza e Maqedonisë së Veriut si shtet.

Maqedonia u krijua në vitin 1945, nga Tito, si shtet-tampon mes Shqipërisë dhe Bullgarisë nga njëra anë, dhe Serbisë e Greqisë nga ana tjetër, në një territor të kontestueshëm, për të siguruar një stabilitet gjeostrategjik dhe gjeopolitik rajonal.

Maqedonia që njësi e Federatës jugosllave me status të republikës, pra, sipas kushtetutës së 1974, edhe me të drejtë shkëputjeje. Në vitin 1991, Maqedonia organizoi referendumin për pavarësi, të cilin e bojkotuan shqiptarët, të cilët pa vullnetin e tyre mbetën brenda kufijve të këtij shteti.

Ky fakt, e bën procesin e pavarësimit një proces jolegjitim. Për më tepër, në vitin 1992, shqiptarët organizuan vetë një referendum për autonomi territoriale dhe politike, ku 92% e pjesëmarrësve u deklaruan “për”. Ky referendum u injorua nga të gjithë aktorët, të vendit e ndërkombëtarë.

- Së dyti, filli i të gjitha problemeve, të cilat pengojnë mbarëvajtjen e këtij shteti, gjendet pikërisht në aktin më të lartë juridik të këtij shteti, që është kushtetuta.

Në preambulën e saj thuhet se shteti i takon popullit maqedonas dhe pjesëve të popujve të tjerë që jetojnë në këtë shtet, në mesin e të cilëve radhiten edhe shqiptarët. Pra, shqiptarët, janë kategori e nënrenditur kushtetuese. E njëjta vlen edhe për gjuhën shqipe, të cilës, si kushtetuta edhe Ligji për përdorimin e gjuhëve, i referohen me frazën “gjuhën të cilën e flasin më shumë se 20% e popullatës”.

Pas luftës së vitit 2001, me Marrëveshjen e Ohrit, e cila u nënshkrua me ndërmjetësimin ndërkombëtar, u bënë ca ndryshime kushtetuese, por nuk u krijuan mekanizmat të cilat do të siguronin jetësimin e tyre. Koncepti i shtetit vijon të jetë i paprekur, pra në shpërputhje me natyrën e shoqërisë që jeton në këtë shtet.

- Së treti, terri demografik.

Për shkak të natyrës së këtij shteti, numri i banorëve të etnive që jetojnë në Maqedoninë e Veriut përcakton gjithçka, duke nisur nga kushtetuta ku përcaktohet se kujt i përket sovraniteti, pra, pronësia mbi shtetin, të drejtat kolektive, përfaqësimi në institucione, ndarja territoriale, listat zgjedhore, përdorimi i gjuhës shqipe në territorin e shtetit, shpërndarja buxhetore nëpër rajone, e kështu me radhë.

Maqedonia e Veriut nuk e ka kryer procesin e regjistrimit të popullsisë që nga viti 2002. Maqedonasit vazhdojnë të sundojnë me politikat e bazuara nga të dhëna të vjetëruara. Trendet demografike ndryshojnë me ritëm të shpejtë, sidomos kur krahasojmë numrin në rritje të lindjeve të shqiptarët në raport me maqedonasit, apo edhe për shkak të migrimit masiv të të rinjve në vendet e Evropës Qendrore.

- Së fundmi, kontestet bilaterale të Maqedonisë së Veriut me të gjithë fqinjët, me përjashtim të shqiptarëve.

Mëdyshjet identitare dhe përpjekjet utopike për krijimin e një kombi të ri politik u ndeshën me interesat e të gjithë fqinjëve përreth: greke (për flamurin dhe emrin), bullgare (gjuhën dhe etnogjenezën), serbe (kishën), ndërkaq së brendshmi edhe me interesat e shqiptarëve të cilët jetojnë në këtë shtet, të cilët nuk pranojnë të bëhen pjesë e këtij konstruksioni të paqenë, pra e një kombi politik, ku ata do të ishin maqedonas me prejardhje shqiptare.

Mospërfillja e çështjeve të lartpërmendura mund të sjellë “mjellmat e zeza”, apo ato që në anglisht njihen si “black swans” për Maqedoninë e Veriut. Aktorët politikë shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, të organizuar kryesisht në formë partish politike, kanë qenë deri tani, kryesisht, prania e papranishme apo e keqja e domosdoshme në pushtetin e këtij shteti. Pa dashur të amnistoj

asnjërën nga strukturat politike shqiptare deri tani, gjykoj se kjo ka ndodhur për disa arsye:

- së pari, për shkak se inferioriteti shqiptar është kushtetues;
- së dyti, për shkak të ndikimit të strukturave shtetërore maqedonase në përzgjedhjen e kuadrove udhëheqëse shqiptare;
- së treti, mungesa e përvojës institucionale e shqiptarëve, e determinuar nga rrethana të njohura historike; dhe së fundmi,
- përzgjedhja e kuadrove në bazë të kriterëve të tjera, përpos atyre të meritokracisë e kompetencës.

Këto arsye kanë bërë që pushtetizimi i individit të ecë në raport të zhdrejtë me pushtetizimin e popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Sot, për shkak edhe të ndërrimit të rrethanave dhe arsimimit (Universiteti i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Universiteti i Tetovës, është themeluar në vitin 1994), shqiptarët po politizohen në kuptimin e njëmendët të fjalës, duke u bërë të vetëdijshëm për domosdonë e drejtësisë dhe statusit të barabartë kushtetues e shoqëror në këtë shtet. Ky politizim ka filluar dalëngadalë të pasqyrohet edhe në politikëbërjen dhe ndërrimin e mendësisë shtetërore.

Ndonëse ky është një proces i gjatë, i cili do kohë, vullnet, mund, dhe mbi të gjitha, ndryshime thelbësore, në kuptimin e përshtatjes së rregullimit kushtetues, me realitetin e shoqërisë që jeton në Maqedoninë e Veriut.

### 3.3 Skenarët dhe rrjedhojat e një krize të re në Bosnjë



#### **Dr. Dritan HOTI, Tiranë**

Ndonëse bën pjesë në regjistrin e krizave etnike, ajo që ka ndodhur në Bosnje-Hercegovinë diferencohet nëpërmjet disa karakteristikave prej një krize tipike etnike. Teksa në rastin e një krize të mirëfillte etnike, dy ose më shumë komunitete të ndryshme etnike futen në një konflikt historik të papajtueshëm, në rastin e Bosnjës bëhet fjalë për një popullsi me përkatësi të njëjtë etnike, por me besim të ndryshëm fetar, atë mysliman, ortodoks e katolik ( boshnjakët, serbët dhe kroatët) si dhe një dinamike historike jo homogjene. Bosnje-Hercegovina po ashtu si i gjithë Ballkani u përfshi në skemat e rivaliteteve gjeopolitike e strategjike të fuqive apo perandorive evropiane të shtrira deri Evropën Juglindore apo të interesuara për të, duke nisur nga 1878 e në vazhdim. Pikërisht në Kongresin e Berlinit (1878) u përcaktua një klauzolë, së cilës iu referua Perandoria austriake kur aneksoi Bosnjë-Hercegovinën 3 dekada më vonë, në 1908, në momentin kur agjitacioni politik i Serbisë në Ballkan po bëhej gjithnjë e më shumë më agresiv.

Në të njëjtën kohë, ky mandat i Austrisë mbi Bosnjën shkonte edhe kundër projeksioneve të atëhershme të Rusisë në Ballkan, e cila synonte një organizim të ri të sllavëve të jugut si një strukturë e kontrolluar dhe pikëmbështetëse e saj në këtë rajon. Kur ka munguar përfshirja e drejtpërdrejtë e fuqive të mëdha në rastin e Bosnje-Hercegovinës, kjo mungesë u ka lënë mundësi elementëve përbërës etnikë atje, të hedhin poshtë çdo mundësi kohabitacioni etnik me njëri-tjetrin në emër të sensit të njëjtë të historisë me entitetet e shtetërore, me të cilat ato kanë përkatësi të njëjtë fetare. Ky ishte edhe shkaku i luftës civile që mbërtheu Bosnjën në vitet 1991-1994 duke arritur kulmin e krizës me

krimet genocidare të kryera nga formacionet paramilitare serbe të Bosnjës, të përkrahura edhe nga Beogradi. Ndryshe nga e shkuara historike, këtë radhë disi me vonesë ndërhyrja ndërkombëtare, e kryesuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës imponoi nëpërmjet marrëveshjes së Dayton-it në Ohio 1995 një zgjidhje që mbështetej mbi një ndarje administrativo-institucionale proporcionale, në të cilën përfshihen që të dyja entitetet përbërëse të saj, Federata boshnjako-kroate (51%) si dhe Republika Serbe (49%).

Konfliktet etnike shënjojnë në të shumtën e rasteve nga një konstante, e cila përshkruan etapat e ndryshme të historisë duke përfshirë edhe transformimet e mëdha ekonomiko-teknologjike, e cila qëndron si e pandryshueshme. Ndjesitë e përkatësisë etnike, pra, ato kombëtariste dhe në raste të caktuara me konotacion fetar, iu rezistojnë edhe tendencave transformuese të gjeopolitikës si dhe formulave të reja të diplomacisë ndërkombëtare, saqë ato në të gjitha herët paraqiten në format e dinamikës së tyre tradicionale. Tensionet në rritje të kohëve të fundit në Bosnjë, të simbolizuara në qëndrimet e liderit të Republika Serbe, Mirolad Dodik, me frymëzimin e Beogradit duket se favorizojnë projeksionet për implementimin e skemave aktuale të diplomacisë ruse në këtë rajon. Rusia, e cila edhe në ditët tona u qëndron modaliteteve tradicionale të politikës së saj të jashtme, synon në rajone të ndryshme të botës ndërtimin e vatrave ose një kordonit shtetesh të kontrolluara apo influencuara direkt prej saj.

Konkretisht, në rastin e Bosnje-Hercegovinës, precedenti më i fundit, ai i konstituimit të një korpusi milicie të pavarur të serbëve të Bosnjës si dhe thirrjeve kërcënuese të liderit të tyre, M. Dodik e bindën përfaqësuesin e lartë të komunitetit ndërkombëtar, ish-ministrin konservator gjerman Christian Schmidt që mban edhe lidhje të mira personale me Uashingtonin ku nëpërmjet një letre zyrtare të kërkojë një përforsim të trupave ushtarake ndërkombëtare në Bosnjë për të frenuar mundësisht një përshpejtim të një procesi shpërbërës atje. Në këto kushte një rritje e menjëhershme e forcave ndërkombëtare në Bosnje-Hercegovinë në emër të ruajtjes së status quo-së do t'i shtynte serbët e alarmuar të kërkonin edhe një zmadhim edhe me domethënës të mekanizmave ushtarake të Rusisë brenda tyre, duke e shndërruar Ballkanin përëndimor në një terren rivaliteti direkt ndërmjet shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat së fundmi kanë rikonfirmuar edhe njëherë garancinë e tyre në respektimin e Marrëveshjes së Dayton-it, si dhe Rusisë me interesa të kundërta me të.

Në këtë rast natyra e rivaliteteve gjeopolitike në Ballkan nuk do të ishte analoge me përmbajtjen e krizës aktuale në Ukrainë, me të cilën Rusia ka lidhje të drejtpërdrejta territoriale nëpërmjet enklavave ruse në pjesën lindore të saj, por do t'u ngjajë më shumë ballafaqimeve gjeopolitike e strategjike të

Rusisë me Perandorinë Austriake të fillimshekullit të kaluar. Më tej, precipitimi i prirjes që ka të bëjë me mosnjohjen nga e vazhdimet të integritetit të Bosnjës nga Republika Serbe do të ushqente një proces të rikonceptimit të çështjeve kombëtare në Evropën juglindore të ngelura të papërfunduara që nga gjysma e dytë e shekullit të XIX, duke stimuluar skenarë të riformatimeve shtetërore në Ballkan. Përderisa përmasa dhe forca e “botës serbe” në Ballkanin Perëndimor nuk e garanton dot plotësisht një radikalizim të tillë ushtarak në këtë rajon, ajo, pra, Serbia e mbështetur nga Rusia do të preferonin formulën tjetër, atë të inkurajimit e të ndryshimeve politike të brendshme në favor të tyre brenda kordonit të shteteve sllavo-ortodokse në Ballkanin Perëndimor, konkretisht në Malin e Zi si dhe në Maqedoninë e Veriut.

Gjendja aktuale në Ballkan si dhe evoluimi i saj nuk përcaktohen aq shumë nga iniciativa që burojnë vetë brenda rajonit, por nga kompleksiteti i tendencave kryesore të gjeopolitikës ndërkombëtare, e cilat si rrjedhojë gjejnë jehonë direkte në këtë rajon. Vendndodhja si dhe statusi i Bosnje-Hercegovinës, i cili në një pamje të parë duket fare i parëndësishëm, mundet të shërbejë si precedent i një radikalizmi të madh politik me rrjedhoja të kontrolluara prej ku lindin edhe ndryshimet domethënëse gjeopolitike për rajonin. Përtej kësaj, rasti i Bosnjës duket i ndryshëm prej ligjësive të historisë, të cilat predikojnë se historia nuk përsëritet. Në Bosnjë duket se historia e përsërit veten e saj në një formë ciklike.

## IV BOTA

### 4.1 Ukraina - vendi që vendos fatin e Rendit të Ri Botëror!



#### Agim KRASNIQI

**Lufta në Ukrainë ka hyrë në javën e saj të katërt, dhe shikuar në rrethanat e gjeografisë politike, çështja e Ukrainës është çështje e mbijetesës së Rusisë, ndërsa nga ana tjetër në interesin e Perëndimit qëndron fakti i vazhdimit të përcaktimit të konditave të Rendit të Ri botëror, të çimentuara në liberalizmin politik dhe ekonomik.**

#### I

Përderisa pjesën më të madhe të gjysmës së dytë të shekullit XX, Bashkimi Sovjetik e ka pasur në kontroll Euro-Azinë, nga Gjermania Qendrore deri në Paqësor, në jug deri në Kaukaz dhe Hindu Kishu. Pasi Bashkimi Sovjetik u shpërbë, Rusia sot po lufton për pikëmbështetje në rajon, sepse sipas pikëpamjeve ruse, Ukraina është vendi në hollin e Kremlinit, dhe në kushtet e armëve moderne, shtrirja e NATO-s në atë pjesë të Euro Azisë paraqitet si një trampolinë për kërcënimin e saj. Meqë Ukraina ishte rreshtuar me ShBA-të, duke iu larguar Federatës Ruse, rusët besojnë se Shtetet e Bashkuara janë një trup i huaj në territorin e Euro Azisë, dhe sipas formulës së tyre “pse një fuqi jo euro aziatike, do të duhej të sundonte Euro Azinë, ku ka një Kinë, Indi, Iran, madje edhe Rusi, Gjermani, e Francë”. Kështu që ngritja e sqeparit rus në këtë luftë, mund të jetë shumë më afatgjatë.

Tani për tani, ne nuk e dimë akoma se cilat janë qëllimet përfundimtare të Rusisë dhe nëse ato janë përmbushur me vetë njohjen e Republikave Popullore të Donetskut dhe Luhanskut, pushtimit të Krimesë, apo pushtimin e plotë të Ukrainës. Krimeja është një bazë jashtëzakonisht e rëndësishme për Rusinë, mirëpo tani ajo nuk ka rëndësi strategjike si e ka pasur në shekullin e 19-të, nuk e ka as Deti i Zi. Fakti që pjesa më e madhe e bregdetit të Detit të Zi mbahet nga NATO dhe sikur Ukraina të dominohet nga perëndimi, atëherë Rusia nuk do të kishte asgjë nga përpjekjet për t'u bërë një fuqi rajonale. Ndërsa pjesët lindore të Ukrainës janë të pasura me burime dhe rrjedhimisht ajo cilësohet ndër vendet e para në botë për sa i përket burimeve natyrore - nga rafineritë e hekurit dhe çelikut te uji, çka nënkupton se Evropa në aspektin e gjeoekonomisë, nëse do t'i vinte nën kontroll Ukrainën, do të zgjidhte problemin e saj të madh të mungesës së burimeve natyrore.

Përpjekjet e ndikimit rus janë paraqitur në tri drejtime: drejtë Azisë Qendrore, drejtë Kaukazit dhe patjetër drejtë Perëndimit, si dhe Baltikut dhe Evropës Lindore.

Në anën tjetër, për SHBA-të, Ukraina dhe shtetet në Kaukaz paraqesin një çështje të vërtetimit të besueshmërisë ndaj NATO-s dhe aleatëve të saj.

Burokratët dhe elita politike e Evropës, të cilët shpesh shohin ëndrra me sy hapur, nuk deshën apo nuk e kuptuan rrezikun real të një Rusie revanshiste. As atëherë kur Rusia i pushtoi dy provinca të Gjeorgjisë në 2008; as kur Rusia ja u ndërpreu ëndrrat në Vilnius në 2013; as kur një vit më vonë pushtoi Donbasin dhe e aneksoi Krimenë. Problemi qëndron se, nga brenda, Evropa është inerte dhe duke qenë se akoma është në proces të riorganizimit, pas humbjes së perandorisë së saj, ajo po bënë përpjekje për të ripërtërirë imazhin e saj vendimmarrës në gjithë këtë agresivitet të rusëve. Mirëpo, lufta në Ukrainë, e sfidon një çështje, nëse Evropa paraqet një vullkan të shuar, apo është një vullkan pothuajse i fjetur. Thembra e Akilit për stabilitet, mbetet statusi i pa zgjidhur i gjermanëve në sistemin evropian, sepse gjermanët ishin të përjashtuar nga sistemi perandorak i krijuar nga Evropa Atlantike. Pikërisht Rusët me një konotacion të fortë gjeopolitik e ndërtuan, Nord Stream 1 dhe 2 dhe ku u njoh nga Gjermania, e cila synonte të lidhej drejtpërdrejt me Rusinë. Kjo nga perëndimi shihej si përpjekje e krijimit të boshtit Moskë-Berlin. Nëse do të lejohej krijimi i këtij boshti, bazuar në disiplinën dhe kapitalin gjerman, nga njëra anë dhe nga burimet ruse, vlerat njerëzore dhe territori nga ana tjetër, atëherë vendet talasokratike, përfundimisht nuk kanë çfarë të kërkojnë në Evropë. Prandaj reagimi i parë amerikan ishte ndërprerja e tubacioneve të gazit në të gjitha mënyrat e mundshme, mbyllja e tyre ishte e nevojshme për ta penguar kërcënimin strategjik rus. Rusia nuk është e interesuar për ta pushtuar Evropën, por për ripërsëritjen e kontrollit të saj. Dhe kjo, sipas këndvështrimit



rus, është një përpjekje e logjikshme për vendosjen e një sfere ndikimi minimal, që në thelb paraqet synimet për një masë mbrojtëse.

## II

Ti kthehemi Ballkanit.

Në Gjeopolitikë konfliktet madhore përsëriten. Kur një luftë nuk e zgjidhë një çështje themelore gjeopolitike, kjo luftë ribëhet derisa çështja të zgjidhet përfundimisht. Politika ruse për shekuj e ka synuar Ballkanin, dhe me radhë përmbushi aspiratat kombëtare të popujve ballkanik, jo vetëm të serbëve, por edhe i bullgarëve, malazezëve, rumunëve dhe grekëve, sepse Ballkani ndodhet në brendësi të Bosforit dhe Dardaneleve dhe kjo ishte pika kryesore strategjike e politikës së jashtme ruse. Në funksion të kësaj, Rusia copëtoi tokat tona dhe krijoi shtetet sllave ortodokse satelite ruse në Ballkan. Asimiloi shqiptarët ortodoks dhe i dëbuan shqiptarët e besimit islam në Turqi. U bë kështu de facto holokausti i parë mbi shqiptarët, e që do të vazhdojë tutje përgjatë dy shekujve të fundit në mënyrën më barbare nga serbët. Rusët, në bashkëveprim me portën e Lartë serbët dhe të tjerët, miliona shqiptar i asimiluan në grek, sllav e turq. Sot shqiptarët me pesë shtetësi në Ballkan dhe me shumë të tjera në botë, akoma nuk e kanë një agjendë kombëtare të mirëfilltë, ndonëse të kufizuar me vetveten. Pak nga frika e nga gjykimi i ndërkombëtarëve, po aq edhe nga mungesa e vizionit dhe të lidërshiptit.

Janë shumë gjëra duke ndodhur në të njëjtën kohë në politikën globale dhe se situata do të bëhet edhe më interesante javët e ardhshme. Filozofia analitike na ka mësuar se 'Koha' në politikë është themel i suksesit. Pa ardhur koha, politika kot vepron, por kur të vije koha, politika duhet jetë e gatshme. Prandaj ne duhet shfrytëzuar momentin e duhur për anëtarësim të Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian, në Këshillin e Evropës, në cilindo institucion që mund ta forcojë sigurinë e Kosovës. Tashmë Turqia dhe Kroacia e kanë përkrahur edhe publikisht idenë për anëtarësim të përsheptuar të Kosovës në këto mekanizma. Pikërisht tani koha ka ardhur, dhe është momenti i duhur për të parë se çfarë po bën Kosova për të rritur anëtarësimin në institucionet euroatlantike.

Shqiptarët në përgjithësi nuk guxojnë t'ia lejojnë veti luksin që, protagonist të caktuar politik të ndjellin klimë anti-amerikane. Gjithashtu nuk guxojmë të lejomë luksin që mos të kemi miq të fuqishëm, sepse kemi armiq shumë të fuqishëm të cilët i kemi pasur në gjithë historinë tonë. Falë vendosmërisë absolute të politikës amerikane, ne sot kemi të kthyer pak a shumë identitetin tonë kombëtar. Prandaj ne shqiptarët kemi detyrim të madh ndaj politikës anglosaksone, e jo vetëm, duke filluar nga Austro-Hungaria, Londra dhe ShBA-të, të cilët ekzistencën e kombit shqiptarë, e konsideronin dhe e konsiderojnë si një mundësi për një aleancë natyrale me Ne, për politika të gjeografisë politike, strategjike, pa e përjashtuar edhe atë ekonomike.

### III

Nga studiues dhe analistë politikë, Rusia po kalon në një fazë të patologjisë së vet, në të cilën ata po kërkojnë përgjigje përtej kufijve të saj. Dhe shikuar nga ky prizëm, shumë vende po përpiqen të jenë neutrale dhe të japin angazhime të përgjithshme me fjalët e tyre të përgjithësuar. Të njëjtën gjë po e bënë edhe Serbia. Por në Ballkan, realisht, ekziston një ndarje e përpjekjeve për sferën e influencës dhe interesit midis Perëndimit, Rosisë dhe Kinës. Kina po kujdeset për interesat e saj në Lindjen e Largët. Për momentin, përveç ekonomikut, nuk ka një depërtim të madh në Evropë, por kjo nuk do të thotë se “nesër” nuk do të ketë. Kina shpalli politikën neutrale si pozicion të saj, por gjithashtu ajo shihet si një fuqi antiamerikane, ashtu si është edhe Rusia.

Ndërlidhur me Ballkanin, një dokument të rëndësishëm që Ministria e Punëve të Jashtme e Rosisë, në të cilën e kishte drejtuar DASH-it, Rusia kishte përcaktuar qartë se cilat janë tokat që NATO-ja nuk duhet të hyjë dhe nuk duhet të vendosë njësi dhe forca raketore me koka bërthamore në zonat e ish-BRSS-së, si Ukraina, Gjeorgjia, dhe Moldavia. Në këtë dokument nuk përmenden shtetet baltike dhe Ballkani. Kjo nënkupton që Ballkani nuk bënë pjesë në sferën e interesit rus. Rusia, e cila nëpërmjet vendeve me popullsi sllave, e kishte mbajtur flamurin e pansllavizmit në Ballkan, por ndikimet politike për vendosjen e një baraspeshe në Ballkan kanë ndikuar që Rusia dhe boshti sllavo-grek, dalë nga dalë të dobësohet dhe të zvogëlohet ndikimi i tyre në Ballkan.

Në këtë drejtim, Ukraina nuk është larg nesh, vetëm Rumania na ndan prej saj, dhe realisht lind pyetja se në sferën e kujt do të jetë Ballkani dhe hapësira post-jugosllave. Këtu shtrohet pyetja: cilat janë qëllimet e Rosisë në Ballkan në kontest të luftës në Ukrainë. Synimet e saj, a janë vetëm të pjesshme apo shtrihen më gjerë? Në dritën e ngjarjeve të sotme, kur raketat ruse po godasin apartamente e po vrasin civilë në Kiev, nuk përjashtohet mundësia që konfliktet e para të armatosura të fillojnë edhe në Ballkanin Perëndimor, duke filluar nga veriu i Malit të Zi, Veriu i Kosovës, e duke e përfshirë në një luftë të re në tërësi Bosnjë-Hercegovinën.

A do të përdorë Rusia potencialet dhe kapacitetet e saj për destabilizimin e Ballkanit?

Përgjigjja është: po! Dhe disa, madje edhe janë përdorë.

Vetë fakti se ka demonstrata pro-ruse në Beograd dhe Mal të Zi, (në Shqipëri po kamuflohen nën petkun e kërkesave sociale, pavarësisht se një pjesë e demonstruesve janë të dirigjuar nga eshaloni i ashtuquajtur “i djathtë” të cilit i prijnë eksponent të caktuar anti Amerikanë) dhe vende tjera të Evropës, duke ushqyer propagandë në televizion dhe rrjetet sociale, ndikimi rus mund të themi se është prezent, madje fuqishëm.

Mirëpo shtrohet pyetja se, kur është momenti i përshtatshëm për destabilizimin e rajonit sipas direktivave ruse? Rusia do të përpiqet të ngriejë potencialin në Evropë me veprimet e saj të veçanta për të provokuar trazira, në Kroaci, Serbi, Mali i Zi, Maqedoninë Veriore, Kosovë Veriore apo edhe në Shqipëri, kudo që e ka ndikimin e saj. Në këtë mënyrë ata synojnë të devijojnë fokusin nga lufta në Ukrainë, sepse atje nuk po shkon siç e kishin të planifikuar.

Ata do të përpiqen të përdorin aksione speciale për të ngritur rrjetin e tyre në Ballkan, mbetet të shihet. Qëllimi është për të provokuar trazira sociale për shkak të çmimeve të larta të naftës dhe shportës familjare. Territorët ideale janë ato për të cilat po flasim, territore kryesisht të paintegruara në BE dhe NATO si: Serbia, Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina. Reflektimi për rajonin, në këtë kontekst, dëshmon “aksidenti” i avionit pa pilot që goditi afër Zagrebit. Se do të ketë një fazë kur vijat e frontit të luftës në Ukrainë do të stabilizohen, pikërisht atëherë mendohet se do të fillojnë bisedimet serioze në mes palëve në konflikt, me qëllim të ndaljes së luftimeve dhe për ndarjet e sferës së interesit, dhe pikërisht atëherë të gjithë ata që kanë marr dhe marrin para dhe mbështetje nga Rusia, do të detyrohen të dalin në rrugë. Atëherë ekziston rreziku real, ndërkaq hë për hë, këto veprimi janë të përqendruara veçanërisht në Bosnjë-Hercegovinë. Koha për zgjerim të gamës së veprimeve ruse është në ardhje, por shumë varet nga zhvillimet në Ukrainë.

Rusisë i mjafton që ata ta destabilizojnë një vend të NATO-s si Mali i Zi, Maqedoninë Veriore apo edhe Shqipërinë, dhe pastaj qëllimi i parë është përhapja e një konflikti të armatosur që do të përfshinte mercenarë, struktura të paraushtarakëve dhe ekstremistëve në të gjitha vendet e rajonit dhe më gjerë. Kështu, Ballkani Perëndimor është ideal për të hedhur vëmendjen e botës demokratike perëndimore. Kjo do t’i mundësonte Rusisë ngritjen e pozicionit të tyre negociator me palën e Ukrainës-Perëndimit, sepse e gjithë historia nuk ka të bëjë ekskluzivisht vetëm me Ukrainën, ajo është një histori de fakto midis Rusisë dhe Amerikës, domethënë Perëndimit dhe Rusisë.

A do të ketë kompromis strategjik mes Perëndimit dhe Rusisë, NATO-s-Rusisë, Amerikës dhe Rusisë, mbetet të shohim, por këtu ngre tezën se; Kur një luftë nuk e zgjidhë një çështje themelore gjeopolitike, kjo luftë ribëhet derisa çështja të zgjidhet përfundimisht? Dhe pikërisht këtu qëndron thembra e Akilit, dhe shtrohet pyetja. A do ti shkoj Perëndimi deri në fund zgjidhjes së çështjes ruse përfundimisht?

Kjo përgjigje do kohë!

## 4.2 UKRAINA, MAKTHI I EVROPËS E TMERRI I RUSISË



### **Xhafer SHATRI, publicist**

Blickrieg e Putinit në Ukrainë nuk po shkon ashtu siç e kishte planifikuar ai; ukrainasit nuk po i tuten armatës ruse, po qëndrojnë dhe, siç po shihet, kjo do të jete një luftë e gjatë, kryesisht një luftë rraskapitëse gjysmëguerile e organizuar dhe e udhëhequr nga Shtatmadhoria. Agresioni i ri, Ruisë do t'i kushtoje shume..., gati si pushtimi i dikurshëm i Afganistanit.

Iluzionet e Putinit më së miri i shpërfaqti, gabimisht, me 27 shkurt, agjencia shtetërore e lajmeve “Ria novosti”, kur publikoi shkrimin e përgatitur paraprakisht të Pjoter Akropovit, përmes të cilit shpallej fitorja e Ruisë mbi Ukrainën.

Në artikull përshkruhej poshtërimi që kishte pësuar Rusia pas shpalljes së Ukrainës shtet i pavarur dhe përgëzohej Putini që çështjen e zgjidhjes së Ukrainës nuk ua kishte lënë gjeneratave të ardhshme, por e kreu vet, duke e bërë një shtet të pavarur 40 milionësh e me sipërfaqe prej 600 000 km katror, pjesë të “Botës ruse”.<sup>1</sup>

Teksti u tërhoq menjëherë, por ishte tepër vonë, sepse veç e kishte marrë dhenë.

Ashiqare, zhgënjimi i Putinit është i shumëfishtë;

së pari, u bind se nuk ka një ushtri të mirëorganizuar, të trajnuar dhe të motivuar;

së dyti, e pa me sytë e tij se ukrainasit nuk do “ta presin pushtimin rus me lule“;

së treti, BE-ja, ani se e infiltruar keq nga politikanë që Moska i kishte korrupuar me vite, nuk reagoi për “operacionin special“ mefshtë si për aneksimin e territoreve të Gjeorgjisë apo aneksimin e Krimesë dhe Donbasit; së katërti, furnizimi i ekonomive perëndimore me gaz e naftën ruse, pas agresionit në Ukrainë, nuk doli të jetë jetik, sepse BE-ja sidomos, jo vetëm u zgjua nga gjumi, por u mobilizua e u bashkua si rrallëherë, kundër Putinit e në mbështetje të Ukrainës duke aplikuar sanksione dërrmuese për ekonominë e Ruisë;

se pesti, mbështetja ndërkombëtare për vendosjen e një rendi të ri botëror, bipolarë ose shumëpolare, à la Putinçe, doli të jetë zero me hiç...

Këtë e shpërfaqti votimi masiv i Rezolutës kundër pushtimit të Ukrainës në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, ku Rusia doli e zhveshur cullak dhe krejt e vetmuar.

\* \* \*

Gjithsesi qëndrimin e civilizimit perëndimor më së miri e kristalizoi, në 6 pikat e tij, kryeministri anglez, Boris Jonson:

1. Mobilizimi i një koalicioni ndërkombëtar për Ukrainën;
2. Të përkrahet Ukraina në përpjekjet për vetë-mbrojtje;
3. Të rritet presioni ekonomik ndaj regjimit të Putinit;
4. Të parandalohet normalizimi i asaj se çka është duke bërë Rusia në Ukrainë;
5. Të ndiqen rrugët diplomatike për de-eskalim, por vetëm në bazë të pjesëmarrjes së plotë të qeverisë legjitime në Ukrainë;
6. Të fillohet një fushatë e shpejtë për fuqizimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë në gjithë regjionin euro-atlantik.

Ne zallahinë e lajmeve dhe analizave për agresionin rus në Ukrainë është me rëndësi të dimë se çka mendojnë analistët eminentë, dija dhe fjala e të cilëve ka thellësi e peshë.

**Henri Kissinxher**, doajeni i lagjes së analistëve, i jep përparësi dialogut. Nuk është çudi për një kryemjeshtër të negociatave e të kompromiseve si ai. Por ajo që ky këmbëngulë është se Ukraina nuk guxon te heqë dorë nga Krimeja. Dhe ky është thelbi i analizës së tij në “Washington Post”.

**Yuval Noah Harari**, historiani e shkrimtari i njohur izraelit në “The Guardian” shprehet kështu:

“Ende pa u bërë një javë nga fillimi i luftës, po del gjithnjë e më besueshëm se V. Putin po shkon drejt disfatës historike. Ai mund t’i fitojë të gjitha betejat,

po megjithatë do ta humbë luftën. Ëndrra e Putinit për rivendosjen e Perandorisë Ruse mbështetet në rrenën se Ukraina nuk është komb, se ukrainasit nuk janë popull i mirëfilltë dhe se banorët e Kijevit, të Harkovit e të Lavovit mezi presin që t'i sundojë Moska. Kjo është një rrenë e madhe, Ukraina është një komb me një histori më shumë se njëmijë vjeçare dhe se Kijevi ishte metropoli i madh në kohën kur Moska, nuk ishte madje as fshat...”

**Francis Fukuyama:** “Gjatë javës së kaluar, rusët i shumëfishuan justifikimet, njërin më qesharak se tjetrin. Sipas tyre Ukraina ishte një shtet fashist dhe neonazist... Aty po kryhej një gjenocid kundër popullsisë rusisht-folëse të Donbasit, apo më tej akoma, se ishte duke u përgatitur një operacion i gjerë ushtarak kundër Ruisë. Këto argumente pushtimi (i Ukrainës) i demaskoi deri në palcë”.

Çuditërisht, por kurrsesi rastësisht, politologu i famshëm i Stanfordit nga Ukraina del te Republikanët e Amerikës:

“Nëse agresioni i Putinit kundër Ukrainës ka sukses dhe nëse Partia Republikane e ndjek Trump-in në admirimin që ai ka për aktet dhe veprimet e diktatorit rus, atëherë ajo do i këpusë të gjitha lidhjet me vlerat kryesore të demokracisë amerikane.

Kjo do të konsolidonte kthesën autoritare që mori kjo parti dhe do të qe vazhdimi i linjës së sulmeve të 6 janarit 2021 kundër Kapitolit. Dhe duke pasur parasysh rëndësinë që kanë Shtetet e Bashkuara për ruajtjen e rendit liberal botëror, ky do të ishte një ogur shumë i keq për botën e lirë në tërësi.”<sup>2</sup>

**Andrej Kozirjev,** ish-ministër i Punëve të Jashtme i Ruisë:

- “20 vitet e fundit Putini ka jetuar me bindjen se Ukraina, në rastin më të mirë, duhet të jetë një shtet satelit. Sheshi i Majdanit, me 2014 e bindi se kjo është e pamundur; prandaj duhej përdorë ushtrinë për t’ia arritur këtij qëllimi;

- Kremli 20 vitet e fundit është përpjekur ta modernizojë ushtrinë. Pjesa më e madhe e këtij buxheti është vjedhur dhe është harxhuar në mega-jahte në Qipro. Por si këshilltar ushtarak, nuk mund t’ia thuash këtë kryetarit, kështu që në vend të kësaj i kanë treguar rrena;

- Elitat sunduese në Rusi, i kanë besuar propagandës së vet se presidenti Joe Bajden është mentalisht i paaftë. Gjithashtu kanë menduar se BE-ja është e dobët dhe se sanksionet e vitit 2014 nuk patën ndonjë ndikim. Pastaj edhe tërheqja e amerikaneve nga Afganistani ia forcuan këto bindje Putinit;

- Nëse besoni se këto që u përmendën janë të vërteta dhe se qëllimi juaj është t’ia ktheni lavdinë Ruisë cariste, atëherë del te jetë i logjikshëm invazioni në Ukrainë...”<sup>3</sup>

**Wesli Klark:**

“Ka 22 vjet që presidenti Putin po përpiqet ta ringjallë Bashkimin Sovjetik. Kjo do të thotë: t’i kthejë nën kontrollin e Rosisë Ukrainën, Moldavinë, Gruzinë, Lituania, Letoninë, Estoninë; t’i nënshtroje Poloninë, Sllovakinë, Hungarinë dhe, në një mënyrë ta forcojë Serbinë. Pra, kjo është receta për rikthimin e rendit botëror, të pas Luftës së Ftohtë, ku sërish do të dominonte Rusia. Në anën tjetër ajo nuk ka se çka të ofrojë, sepse nuk ka ekonomi reale, pos resurseve energjetike...

Krejt kjo përbën një anakronizëm historik, por edhe rrit rrezikun e një konflikti të madh”. [4]

Komentatori i njohur i The New York Times, **Thomas Friedman**, për agresionin e Rosisë në Ukrainë, i parashikon tre skenarë të mundshëm:

- a. Katastrofë e plote, në rast se lufta gjeneralizohet dhe kthehet edhe në luftë bërthamore;
- b. Kompromis i pistë; në rast se gjunjëzohet Ukraina dhe pranon t’i merret Donbasi e Krimea, ndërsa Perëndimi e pranon gjunjëzimin dhe, për më keq, ia heqë sanksionet Rosisë;
- c. Shpëtimi: në rast se ngrihet populli rus dhe e rrëzon Putinin nga pushteti... [5]

Në pikëpamjen time analizën më largpamëse e ka bërë **Januzs Bugajski**;

Në shkrimin “ Një strategji për ta mundur imperializmin e Rosisë”, ndër të tjera, ai shkruan:

“Qeveritë perëndimore kanë tentuar politika të ndryshme defansive për ta frenuar ekspansionizmin e Moskes. Por, dështimet e tyre e kanë forcuar perceptimin e Kremlinit, sipas të cilit Perëndimi definitivisht nuk ka vullnet për t’iu kundërvënë Rosisë agresive. E vetmja strategji e prekshme për ta shungulluar besimin e tepruar të Putinit në vetveten, është koncentrimi (perëndimor) në të ardhmen e vetë Rosisë. Një qasje e tillë ka nevojë për një synim dhe metodologji të qartë. Qëllimi i fundit është t’i kundërkthejë ofensivat neoimperiale të Rosisë, duke i ndihmuar qytetarët e saj ta transformojnë shtetin në një federatë të vërtetë, e cila i pranon fqinjët e saj si shtete të pavarura që mund të vendosin vetë për marrëveshjet dhe aleancat ndërkombëtare.

Meqë ky “skenar transformimi” është gjithnjë e më i pasigurt, për shkak të rezistencës së Kremlinit ndaj çdo reforme politike, planifikuesit amerikanë duhet të përgatisin një opsion tjetër - “skenarin e prishjes“. Pasi që federalizmi dhe pluralizmi nuk do të arrijnë të konkretizohen, në një kontekst të rrëzimit ekonomik dhe të embargos paralizuese financiare, rrugët e separatizmave (brenda Rosisë vetë) do të fitojnë terren.

\* \* \*

Është në interesin e sigurisë nacionale të SHBA-se ta ndihmojë Rusinë të federalizohet, ose të shkallmohet, të decentralizohet ose të dezintegrohet...6 Shumë analistë serbë dhe jo vetëm, e pranojnë se agresioni rus në Ukrainë i ka dëmtuar rëndë interesat strategjike të Serbisë. Kjo ia ka ndalur turrin Vuçiqit që, nën mjegullën e Open Ballkan-it, kishte për synim ta aneksojë pa ndonjë telashe të madhe Malin e Zi, ta ndajë Kosovën dhe ta shpartallojë Bosnjë e Hercegovinën.

Pushtetarët e cucërruar e të përçarë shqiptarë kanë një rast e fat historik që, përmes një koordinimi serioz ndërshtetëror, të imponohen jo vetëm si faktor vendimtar, por edhe të bëhen digë e patejkalueshme përballë strategjisë dhe synimeve agresive e pansllaviste të Moskës e të Beogradit në Ballkan.

- 
1. <http://www.nspm.rs/.../putin-je-izgleda-ocekivao-da-ce...>
  2. <https://lapsi.al/.../francis-fukuyama-historia-e-botes.../>
  3. <https://www.tportal.hr/.../bivsi-sef-ruske-diplomacije...>
  4. VOA, 10 mars 2022
  5. <https://balkans.aljazeera.net/.../new-york-times-tri...>
  6. <https://istraga.ba/janusz-bugajskis-washington-view-a.../>



### 4.3 Putini dhe shqiptarët



**Si është e mundur që në mes të një lufte, presidenti i Rusisë së madhe përmend vazhdimisht Shqipërinë e vogël?**

**Shaqir VUKAJ\***

Presidenti rus, Putin mbasi “verifikoi” ato që tha kasneci i tij Lavrov para fillimit të sulmit kundër Ukrainës, për “Mercenarë nga Shqipëria në Ukrainë për të nxjerrë Rusinë nga vetja...”, gjatë një bisede me kancelarin e Gjermanisë, Sholz tha se *“Në Ukrainë po shohim gjithnjë e më shumë mercenarë nga vendet e tjera, përfshirë Shqipërinë dhe Kroacinë, militantë nga Kosova dhe madje xhihadistë me përvojë operacionale në Siri”*.

Si për t’i kaluar lehtë këto fjalë të Putinit, disa persona, madje ndonjë edhe politikan me peshë, shqiptar apo i huaj, u shprehën se ai “përhap gënjeshtër të tilla për të shmangur vëmendjen nga lufta dhe nga humbjet që po pëson në Ukrainë...”.

Mendoj se nuk duhet marrë kaq lehtë, por duhet vlerësuar me seriozitetin më të madh nga qeveritarë dhe politikanë në Shqipëri e më gjerë. Putini nuk është prej atyre që i lëshon fjalët kot. Ai çdo gjë e ka të llogaritur e të mirëmenduar. Duke qenë ambasador në Moskë e kam ndjekur Putinin që kur Presidenti Jelcin e emëroi Kryeministër (gusht 1999) dhe i shtroi rrugën për president... madje edhe më përpara. Që atëherë ai ishte i matur dhe për çdo fjalë që thoshte, qoftë edhe gënjeshtër, ndiqte një qëllim të caktuar, madje me qitje të largët... Shumë bukur e ka përcaktuar Stroub Talbot, ish z/Sekretar Shteti i SHBA (gjatë krizës së Kosovës, përfaqësues i presidentit Klinton, për zgjidhjen e

kësaj krize). Në librin me kujtime “Billi dhe Borisi” – (Shënime mbi diplomacinë presidenciale) duke përshkruar takimin e parë me Putinin, (më datë 11 qershor 1999), në atë periudhë Shef i Shërbimit Federal të Sigurimit, ndërmjet të tjerave shkruan:

*“Putini nuk donte të dukej, i shmangej konflikteve dhe publicitetit, prandaj edhe figuronte diku në periferi të panoramës tonë të politikës ruse... Putini i kishte mësuar kompetencat e drejtimit, aftësinë për të arritur rezultat pa nxitim dhe fërkime të kota... Putini ishte rus “i ftohtë”, të tillë unë nuk kisha takuar. Ai dëgjonte me vëmendje, vëmendje që dukej sa e llogaritur, aq edhe modeste....”.*

Putini është marrë që herët me shqiptarët dhe Kosovën. Siç ka dalë nga dokumentet e botuara tani vonë, kur Presidenti Jelcin kërkonte ndonjë person të përshtatshëm si përfaqësues i tij për zgjidhjen e krizës në Kosovë, Putini i kishte propozuar që të caktonte Çernomerдинin. Në një intervistë të para pak kohëve, ai pranoi se kishte këshilluar Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Kvashnjin (pa dijeninë e ministrave të Mbrojtjes dhe të Jashtëm) që rusët të pushtonin aeroportin e Prishtinës, para hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Pas nënshtrimit të Milosheviqit, kur diskutohej futja e trupave paqeruajtëse në Kosovë dhe Rusia pretendonte të çonte aty deri në dhjetë mijë trupa (në kuadrin e forcave ndërkombëtare që do vendoseshin në Kosovë) Putini, si Shef i Shërbimit Federal, kërkoi zyrtarisht dhe insistonte që rusët të kishin zonë të veçantë në Kosovë, sepse siç deklaroi ai “Ne do të insistojmë që të kemi zonën tonë, sepse serbët kanë besim vetëm te rusët”.

Gjatë atyre pak muajve që Putini ishte kryeministër (Presidenti Jelcin pothuajse gjithë kohën ishte i sëmurë e i përhumbur) Rusia vazhdonte të mbështeste Serbinë dhe Milosheviqin me të gjitha mënyrat, madje më me zell. Kështu gjatë atyre muajve Rusia u deklarua haptazi e me prepotencë për mbajtjen e Kosovës brenda Serbisë, rriti aktivitetin dhe presionin ndaj ndërkombëtarëve, madje edhe duke kërcënuar në mbledhje apo takime zyrtare, u shtuan ankesat e sulmet kundër udhëheqjes ruse e direkt kundër Jelcinit se përse Rusia nuk kishte ndihmuar me armatime moderne Jugosllavinë etj. Nuk ishte e rastit që pikërisht në atë periudhë, ministri i mbrojtjes i Rusisë vizitoi Beogradin... Sigurisht që pas të gjitha këtyre veprimeve qëndronte Kryeministri Putin.

Mbas ardhjes në postin e Presidentit, marrëdhëniet me SHBA dhe NATO-n u dukën sikur po shkonin drejt përmirësimit, veçanërisht mbas 11 Shtatorit (sulmit mbi kullat binjake ), sulmit të SHBA kundër Afganistanit (Putini i krijoi mundësi logjistike dhe ndihma të tjera SHBA për pushtimin e tij). Në vitin 2002 u krijua këshilli Rusi-NATO, që sipas disa analistëve ishte hapi i

parë i Ruisë drejt NATO-s (Rusia nuk kishte kundërshtuar fort për pranimin e Polonisë, Republikës Çeke dhe Hungarisë në NATO) etj.

Por pavarësisht nga këto, Moska zyrtare vazhdonte të shprehej ashpër dhe haptazi kundër gjithçkaje shqiptare në Kosovë, madje me doza të shtuara, duke përfshirë në disa raste edhe Shqipërinë (U sulmua ashpër Presidenti Rexhep Meidani, u shumëfishuan gënjeshtat për gjenocidin e shqiptarëve kundër serbëve, madje arritën deri aty sa trumbetonin me të madhe se “Nga dhuna e shqiptarëve, nga Kosova janë larguar 500 mijë serbë dhe po kaq shqiptarë kanë ardhur nga Shqipëria”). Rusia kërkoi zyrtarisht që të mbyllej Gjykata e Hagës, ministri i Mbrojtjes kërkoi zyrtarisht që ushtria jugosllave të kthehej në Kosovë etj.

Edhe më i ashpër ishte qëndrimi i Ruisë kundër shqiptarëve mbas daljes në skenë të UÇK-së në Maqedoni. Me gjithë se Putini ishte i angazhuar fort për konsolidimin e pushtetit të tij, kryesisht në planin e brendshëm, së pari për stabilitet politik, për daljen e Ruisë nga kriza ekonomike, në luftën kundër korrupsionit etj., ai gjeti rastin të angazhohej publikisht kundër shqiptarëve. Kështu në mbledhjen e Qeverisë Ruse të dt. 5.03.2001, ndërmjet tjerave ai tha:

*“Në Ballkan po ndodh ajo që ne kishim parashikuar. Mbas largimit të ushtrisë Jugosllave nga Kosova aty u krijua vakum, të cilin e mbushën **terroristët shqiptarë...**”*

Çdo gjë që ndodhte në botë, Putini përpiquej ta lidhje me “terroristët shqiptarë”. Kështu, pak ditë mbas ngjarjes së 11 shtatorit në SHBA, duke folur në mbledhjen e Këshillit të Ministrave ai tha:

**“Atë që terroristët po bëjnë në Çeçeni që nga viti 1996, tani po e bëjnë në Kosovë, nga ku përpiqen të veprojnë edhe jashtë saj”.**

Gjithë kjo periudhë (vitet 2001-2003) është e mbushur me akuza të pabesueshme kundër shqiptarëve, ku u aktivizuan hapur Kryeministri e ministrat (në mënyrë të veçantë ai i Jashtëm dhe i Mbrojtjes) ushtarakë, deputetë, analistë, gazetarë etj., Putini fliste më rrallë, por sa herë fliste ishte tepër i ashpër ndaj shqiptarëve e Kosovës... U rritën dukshëm deklaratat zyrtare e sulmet kundër nesh, ku krahas artikujve e analizave pa fund u botuan disa libra, ndërmjet të cilëve ai i ish Kryeministrit të Bashkimit Sovjetik, Nikolaj Rizhkov “Golgota Jugosllave”, “Tetë muaj plus” i ish-kryeministrit të Ruisë Evgeni Primakov, “Historia e Krizës Jugosllave” i historianes Elena Guskova etj. me qëndrime të theksuara antishqiptare, ku termat kriminelë, vrasës, trafikantë, sadistë etj. përdorëshin pa asnjë lloj dogane, pa folur për gënjeshtra, akuza e falsifikime të paimagjinueshme kundër nesh.

Siç thamë më sipër, gjithë kjo periudhë karakterizohet nga hapa të matur të Putinit në marrëdhëniet me Perëndimin e përmirësim të dukshëm të marrëdhënieve. Në këtë kuadër, në vitin 2003 ai tërhoqi trupat ushtarake nga Ballkani (Bosnja Hercegovina dhe Kosova) për çka në Rusi pati shumë kritika, duke u quajtur si “Tërheqja më e madhe dhe humbja më e madhe e interesave ruse në Ballkan”

Mbasi u gozhdua në karrigen e tij dhe autoriteti në radhët e popullit rus iu rrit dukshëm, ai doli haptazi dhe publikisht, madje mjaft kërcënueshëm kundër shqiptarëve. Kështu në mbledhjen e këshillit të Sigurimit të Sigurimit të Rusisë, të dt. 21.03.2004 ai tha:

*“Rusia nuk mund të shohë me indiferencë atë që po ndodh na Kosovë, ku nuk është gjë tjetër përveç se spastrim etnik, prandaj duhet dhënë kundërpërgjigje e ashpër në mbrojtje të serbëve”.*

Duhet venë në dukje se Putini çdo fjalë që thoshte e llogariste mirë dhe ndiqte qëllime të caktuara. Në periudhën kur problemi i Kosovës ishte vënë në rrugën e vështirë të shpalljes së pavarësisë, e Perëndimi, si për ta zgjatur... kishte dalë me kërkesën “më përpara standardet e më vonë statusi”, Rusia u kap fort mbas kësaj teze dhe u angazhua në të gjitha takimet e rëndësishme ndërkombëtare, në OKB, në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit, të Grupit të Kontaktit etj., ku nëpërmjet gjuhës diplomatike e jo rrallë kërcënuese shprehej kundër pavarësimin të Kosovës.

Pikërisht në këtë periudhë, në fund të viti 2004, pa pritur (sipas shumë analistëve rusë e të huaj) Putini pranoi publikisht se:

*“Përse ne bëjmë sikur nuk shohim se ç’proces ndodhin sot në botë dhe Evropë? A nuk u shpërbë Jugosllavia? U shpërbë. Dhe e gjithë bota i njohu shtetet e reja. Gjithë kohën kemi thënë: **nuk ka pavarësi për Kosovën. Kosova kurrë nuk do të jetë e pavarur, ajo është pjesë e Jugosllavisë. Por ç’po ndodh në praktikë? Praktikisht Kosova po ndahet dhe të gjithë bëjnë sikur nuk shohin, nuk dëgjojnë”.***

Por ky pohim i Putinit ishte tërheqje vëmendjeje e thirrje institucioneve ruse për të ashpërsuar qëndrimin ndaj pavarësimin të Kosovës, çka u pa realisht gjatë vitit 2005.

Me qenë se Kosova po ecte drejt pavarësimin, dhe Rusia nuk kishte forcë ta ndalonte, mbasi bëri disa tentativa, siç ishte propozimi për bashkimin e të gjitha shteteve të Ballkanit (ide e hedhur nga ministri i jashtëm Lavrov në gusht 2005) etj., atëherë Putini “e drodhi” dhe kërkoi ta shfrytëzonte për qëllimet e veta. Kështu ai doli me idenë e “universalizimit” të problemit të

pavarësisë së Kosovës dhe në një konferencë shtypi në fillim të vitit 2006 ai deklaroi:

*“Nëse ndokush mendon se Kosovës mund ti jepet pavarësia shtetërore, atëherë përse ne duhet t’ia refuzojmë këtë abhazëve apo osetino-jugorëve...”* parim që ai e shtjelloi më vonë, dhe që u bë baza e politikës ruse, nga një anë për të kundërshtuar pavarësimin e Kosovës, e nga ana tjetër, për të joshur e nxitur kërkesat e disa rajoneve e krahinave në Gjeorgji, Azerbajxhan e Moldavi për t’u shkëputur nga shtetet e tyre. Që atëherë pati ndonjë analist që shkruante se Putini kishte parasysh edhe Krimenë... Madje ai bëri një sondazh në takimin e BE-Rusi në Helsinki ku tha: **“Pavarësia e Kosovës krijon precedent për situata të ngjashme”**, duke u dhënë zemër atyre krahinave që kërkonin shkëputje nga shtetet e tyre. Në mbledhjen e qeverisë, më 30.1.2006, duke folur kundër pavarësisë së Kosovës, ai e shtjelloi edhe më gjerë idenë e tij:

*“Tërheq vëmendjen tuaj, se nga pikëpamja e respektimit të parimit të së drejtës ndërkombëtare, ky është një problem jashtëzakonisht i rëndësishëm për ne, por edhe nisur nga interesat praktike të hapësirës postsovjetike. Të gjitha variantet e propozimeve për zgjidhje, duhet të kenë karakter universal. Kjo është tepër e rëndësishme për hapësirat post-sovjetike....”*

Nga kjo periudhë, parimi i universalizimit për zgjidhjen e problemeve të kësaj natyre u bë ndër “argumentet” kryesore të Moskës, nga njëra anë për të kundërshtuar pavarësinë e Kosovës, nga ana tjetër, për të nxitur kërkesat e disa rajoneve në Gjeorgji, Azerbajxhan, Moldavi e siç do të rezultonte vite më vonë edhe në Ukrainë... Me që kjo ide nuk gjeti përkrahje, në takimin e Helsinkit, Rusi-BE ai kërcënoi se **“Pavarësia e Kosovës krijon precedent për situata të ngjashme”**.

Ndarja e Malit të Zi nga Serbia, në vitin 2006, në Rusi u prit me kritika të ashpra kundër malazezëve që kishin votuar për ndarje, por problemi më shqetësues për Moskën ishte se rasti i Malit të Zi, do të bëhej shembull, madje i bazuar ligjërisht, për pavarësinë e Kosovës. Sipas zëdhënësës së Putinit, e cila duke folur për pasojat e ndarjes së Malit të Zi nga Serbia, ndërmjet të tjerave tha:

*“Kryesorja që mund të vëmë në dukje, jo pa keqardhje, është fragmentarizmi dhe copëtimi i popullit sllav ortodoks në Ballkan...Përpara kemi ekstremizmin shqiptar, sepse sipas doktrinës së “Shqipërisë së madhe” 40 për qind e Malit të Zi të sotëm, një pjesë e madhe e Maqedonisë dhe pjesa veriperëndimore e Greqisë duhet t’i jepen Shqipërisë”*.

Tepër i ashpër u tregua Putini në Konferencën Ndërkombëtare për Sigurinë, mbajtur në Munihi më 10 shkurt 2007, ku shpalosi disa nga synimet e tij për rolin e Rusisë në të ardhmen, duke përcaktuar “Vijat e kuqe” në Ballkan,

Kaukaz etj. Edhe aty gjeti rastin të fliste kundër pavarësimit të Kosovës, kur tha se: “Vetëm kosovarët dhe serbët mund ta zgjidhin këtë çështje... nëse njëra nga palët ndjehet e lënduar, **kjo do të zvarritet në shekuj**”.

Mbas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ai u shpreh tepër ashpër, madje kërcënoi:

*“Precedenti i Kosovës është precedent i tmerrshëm. Në thelb ai shkatërroi gjithë sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare të krijuar jo gjatë disa dekadave, por gjatë qindra vjetëve. Dhe pa asnjë dyshim mund të sjellë një seri pasojash të paparashikueshme”.*

Pas një aksioni ushtarak (një aventure ushtarake do ta quaja unë) që ndërmori presidenti i Gjeorgjisë, Saakashvili (jo pa nxitjen e disa qarqeve perëndimore) kundër Osetisë së Jugut (në verë të vitit 2008), realisht kundër Rusisë, ushtria ruse, duke dashur të tregonte aftësitë e saj, jo vetëm shpartalloi brenda pak ditësh ushtrinë gjeorgjiane, por po të donte merrte edhe kryeqytetin, Tbilisin... Putinit iu dha rasti, që krahas të tjerave t'i kthehej problemit të Kosovës, dhe më 29.8.2008 u shpreh:

*“Kur ne u përpoqëm të ndalojmë pavarësinë e Kosovës, nuk na dëgjoi askush... Çfarë mund t'u themi popujve të vegjël të Kaukazit, përse Kosova mund të fitojë pavarësinë dhe këta jo?”*

Pa pikë turpi e pa iu dridhur qerpiku, fliste pikërisht ai Putin që pak vite më përpara kishte mbytur me zjarr e hekur Çeçeninë vetëm se kërkonte pavarësinë nga Rusia...

Sigurisht që ai e shfrytëzoi rastin Kosovë për të shpallur shtete të pavarura (realisht të varur krejtësisht nga Rusia) Osetinë e Jugut (me rreth 70 mijë banorë) dhe Abhazinë, (me rreth 300 mijë banorë), shtete që deri më sot nuk i ka njohur askush.

\* \* \*

Në vitin 2014, mbas aneksimit të Ukrainës nga Rusia, Putini është marrë shumë herë me Kosovën dhe shqiptarët, herë duke bërë krahasime midis Krimesë dhe Kosovës, herë duke thënë se Kosova ishte shembull për Krimenë etj.

Kështu një herë ai deklaroi se **“Për rastin e Krimesë ne përdorëm precedentin Kosovë”** ndërsa një herë tjetër deklaroi se **“Në një vend, në Kosovë mund të përmbushet vullneti i popullit dhe këtu jo. E gjitha kjo është lojë politike”**.

Në vitin 2017, duke folur për referendumin e zhvilluar në Katalonjë për shkëputje nga Spanja, Putini përsëri gjeti rastin të merrej me Kosovën, kur

ndërmjet të tjerash tha: *“Perëndimi nxori xhindet nga shishja për pavarësinë e Kosovës”*

Në shkurt 2018, gjatë takimit Putin-Vuçiq ai deklaroi: *“Ne vazhdojmë të mbështesim Serbinë dhe tërësinë territoriale të saj”*

Më 25 nëntor 2021, gjatë takimit me Presidentin serb Vuçiq ai deklaroi se: *“Rusia mbështet pozicionin e Serbisë për pavarësinë e Kosovës” dhe shtoi se “Kosova është Serbi ashtu siç është Ukraina Rusi”*... Pak ditë para këtij takimi zëdhënësja e MP Jashtme kishte deklaruar:

*“Situata në Ballkan po acarohet nga veprimet e ekstremistëve kosovarë. Radikalët shqiptarë vazhdojnë tentativat për të “shpëtuar” nga serbët”.*

Këto janë disa nga deklaratimet antishqiptare edhe qëndrimet e hapura në mbrojtje të Serbisë, por ai ka folur dhe na ka përmendur shumë herë të tjera, madje më shumë se çdo popull e vend ballkanik, dhe më gjerë...

\* \* \*

Me të drejtë lind pyetja, si ka mundësi që në këtë kohë kur Putini është jashtëzakonisht i zënë me luftën në Ukrainë i bie ndërmend të merret me shqiptarët e me Shqipërinë, një vend i vogël që nuk lot asnjë rol të rëndësishëm në politikën e madhe botërore. Për disa politikanë e diplomatë kjo është e pashpjegueshme, por jo për ata që njohin mirë problemet e Ballkanit.

Putini që llogarit çdo fjalë nuk e ka me Ukrainën, sepse sado mercenarë shqiptarë të shkojnë në Ukrainë, nuk çojnë asnjë peshë kundër ushtrisë ruse prej qindra mijëra forcash, të pajisur me mjetet më moderne të kohës. Putini e ka me Ballkanin e në këtë kuadër me Shqipërinë e Kosovën... me shqiptarët. Historikisht Rusia ka qenë tepër e lidhur me Ballkanin, madje edhe alfabetin e fenë ortodokse i ka marrë nga Ballkani. Ai ka qenë tepër i rëndësishëm në politikën e jashtme të Rosisë, jo vetëm nga pikëpamja strategjike, por, sipas saj, për realizimin e misionit “të shenjtë” për “mbrojtjen e popujve vëllezër sllavë”. Po t’i referohemi historisë, rezulton se nuk ka asnjë ngjarje me rëndësi në Ballkan ku të mos ketë marrë pjesë Rusia, apo Bashkimi Sovjetik. Mjafton të kujtojmë takimin e Stalinit me Çerçilin, ku u vendos që në vendet ballkanike (përveç Greqisë) të vendosej sistemi socialist. Kujtoni si i sollën të paketuara nga Moska udhëheqjet e Rumanisë dhe Bullgarisë në Bukuresht dhe Sofje (deri në fund të Luftës Dytë Botërore aleate të Gjermanisë naziste).

**“Historia e Ballkanit është vazhdim organik i historisë së Rosisë, pjesë e ndërgjegjes së saj kombëtare”** është një tezë e përhapur dhe e mbrojtur nga shumë politikanë, historianë, ushtarakë, politolog, gazetarë e analistë rusë dhe që është ngulitur në ndërgjegjen dhe mendjet e shumë rusëve...

Sigurisht që Putini, në vazhden e politikës së paraardhësve, pavarësisht si rrodhën ngjarjet dhe dobësimi i ndikimit rus këto dekadat e fundit, ai dhe

bashkëpunëtorët e tij nuk kanë hequr dorë nga Ballkani, përkundrazi presin rastin e madje e nxisin...

Sipas llogarive të tyre, po piqen kushtet për t'iu turrur Ballkanit (sipas tyre mbasi të mbyllin hesapet me Ukrainën) sigurisht duke shfrytëzuar Serbinë, situatën në Bosnjë Hercegovinë e deri diku në Mal të Zi etj. dhe një lloj pasiviteti të BE që prej vitesh rreket e shtyn pambarimisht pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE... Dhe kryesorja, duke parë e analizuar qëndrimet e Evropës e SHBA, që pavarësisht nga sanksionet që kanë ndërmarrë ditët e fundit kundër Ruisë, praktikisht e lanë në baltë Ukrainën, megjithëse e kishin nxitur e i kishin premtuar shumë... dhe siç pohoi këto ditë shefi i Diplomacisë së BE, J. Borell "Perëndimi nuk duhej t'i bënte premtime jo reale Ukrainës". Krahas të tjerave, këto i kanë dhënë zemër Putinit e shokëve të tij...

Me të drejtë shtrohet pyetja përse Putini u mor me problemin e mercenarëve nga Ballkani, dhe përmendi shqiptarët dhe kroatët. Pikërisht këta dy popuj janë bërë pengesë kryesore për "Serbinë e Madhe" apo siç kanë filluar ta quajnë kohët e fundit për "Botën Serbe".

Para pak ditëve, mbas kërkesës për pranimin e Kosovës në NATO, Presidenti i Serbisë Vuçiç kërcënoi ndërkombëtarët se po e pranuat Kosovën, do të ketë luftë, njëlloj siç kërcënonte Putini për Ukrainën... Serbia është armatosur këto vitet e fundit si asnjë vend në Ballkan, kryesisht nga Rusia, përfshirë armatimet më moderne. Sot, ajo është blerësi më i madh në Europë i armatimeve nga Rusia. Pa u zgatur në shifra, vetëm dy-tri vitet e fundit, Rusia ka furnizuar Serbinë me dhjetëra tanke T-72MS, pajisje të blinduara zbulimi, avionë MIG-29 të modifikuar, Helikopterë Mi-35 M dhe Mi-17V5, komplekse raketash "Kornat", "ZRKP", "Pancer C1M" etj. Aq shumë është armatosur Serbia, sa para pak kohësh, ish ushtaraku i lartë i Ushtrisë Jugosllave Dejan Beriç deklaroi se: "Sot ushtria serbe ka tre herë më shumë armatime se sa oficerë e ushtarë me pagesë".

Situata në Bosnjë-Hercegovinë sa vjen e acarohet. Presidenti i Republikës Serbe, miku i Moskës, Dodik pothuajse e ka shkëputur këtë republikë nga Federata... në perspektivë për t'u bashkuar me Serbinë.

Nuk duhen nënvleftësuar thirrjet e ditëve të fundit të opozitës serbe "Për kthimin e Kosovës në Serbi" apo "Kurrë nuk do ta dorëzojmë Kosovën", ashtu siç nuk nënvleftësuar mitingjet madhështore në Beograd në mbështetje të Ruisë për luftën kundër Ukrainës.



Edhe situata në Mal të Zi nuk është aq e qetë. Klanet proruse e sidomos proserbe janë të fuqishme, çka u pa edhe në demonstrimet e tyre rrugëve të Podgoricës e qyteteve të tjera në mbështetje të luftës së Rosisë kundër Ukrainës. Nuk duhen harruar përpjekjet e Rosisë për grusht shteti aty dhe në Maqedoninë e Veriut apo përpjekjet për të penguar pranimin e saj në NATO.

I dërguari i SHBA për Ballkanin Perëndimor, G. Eskobar para pak ditëve, tha se Perëndimi duhet të shtojë përpjekjet e punën për të penguar Rusinë në Ballkan.

Këto dhe zhvillime të tjera duhet të kthejnë më me këmbë në tokë NATO-n dhe BE-në, por në radhë të parë ne, shqiptarët, politikanët dhe ata që drejtojnë Shqipërinë. Nuk duhet harruar se për Putinin (që aq shumë është marrë me ne) e për disa putinër të tjerë, ne shqiptarët jemi “mercenarë”, “terroristë, ekstremistë, fundamentalistë, trafikantë” etj.”, “që shkatërroam Jugosllavinë”, që “bëmë spastrim etnik në Kosovë”, që “armiqësua NATO-n e më gjerë SHBA-të dhe Evropën me Rusinë e Serbinë”, që “pengojmë krijimin e Botës serbe”, që “propozuam Rezolutë të posaçme në OKB kundër Rosisë” etj. etj. Këto dhe të tjera që ka deklaruar Putini dhe shokët e tij, ne shqiptarët duhet ti marrim seriozisht e të jemi të përgatitur, sepse jo rastësisht Moska e shpalli Shqipërinë vend jo mik që në gjuhën jodiplomatike do të thotë vend armik.

Vërtetë jemi vend anëtar i NATO-s, e siç thuhet përditë, na mbron NATO-ja. Vërtet na mbron ajo, por në radhë të parë ne duhet të mbrojmë veten, të jemi të përgatitur për çdo rast. Serbia nuk ka hequr dorë nga Kosova (jo vetëm nga Kosova...) e çdo gjë mund të nxitet e të ndodhë aty dhe ne duhet të jemi një me Kosovën...

Do të ishte një hap pozitiv për ruajtjen e paqes në Ballkan që në këto kushte, NATO të avanconte pranimin e Kosovës, sepse ndoshta nesër mund të jetë vonë dhe nuk do të mund të bëjë gjë, ashtu siç po ndodhë në Ukrainë...  
[DITA/ISHGJ]

**\* Autori është ish-ambasador i Shqipërisë në Rusi**

## 4.4 LUFTA DHE DOBITË E SAJ



**“Sa të ketë njerëz do të ketë edhe luftëra”. - Albert Ajnshtajn**

**Enis REÇICA, Msc, Integritim Evropian dhe Administratë Publike**

### *Abstrakt*

Njeriun, përgjatë gjithë historisë e kanë përcjellë luftërat. Të njëjtat e pasqyrojnë një veprim politik, fillimisht mes individëve, e më pas të popujve, kombeve e shteteve. Përmes luftës, aktorët synojnë t’i arrijnë synimet që me metoda të tjera nuk i mbërrijnë dot. Së fundmi, edhe Rusia po tenton që përmes luftës (agresionit) mbi Ukrainë ta arrij qëllimin e saj, që përmes paqes nuk mundi ta detyrojë Kievin zyrtar për të mos shprehur interesim mbi anëtarësimin në NATO.

Pavarësisht se sa e dhimbshme është lufta në Ukrainë, dhe se sa shumë plagë njerëzore e dëme në masë sjellin përgjithësisht luftërat, në njërin anë, ka edhe dobi nga to. Shtetet arrijnë t’i realizojnë interesat e tyre përmes luftës, duke detyruar tjetrin të bëjë atë që dëshiron - i forti. Edhe në aspekte ekonomike, luftërat janë aktivitete që sjellin qarkullim të majmë parash. Madje, në qarqe të caktuara studiuesish, argumentohet se lufta nis vetëm për përfitime ekonomike, sidomos në shitblerjen e armëve, që njihet si një prej sektorëve më profitabil. Kësisoj, edhe nga lufta në Ukrainë, janë kompanitë e mbrojtjes

dhe derivateve amerikane, që po sjellin të ardhura të majme. E po ashtu edhe sektori i teknologjisë ka shtuar të hyrat, siç është rasti i kompanisë së dronëve Bayraktar të Turqisë, që po përdoren në Ukrainë. E shembuj të tillë, të përfitimit nga lufta, ka edhe në rrugëtimin historik.

### ***Fillimi dhe mbarimi i një lufte***

Nga 24 shkurti i vitit 2022, bota perëndimore u tronditë nga një konflikt mbi Ukrainën, që për Rusinë sulmuese është “agresion” (luftë që nuk është shpallur zyrtarisht ende, por vetëm si aksion e invazion). Për botën perëndimore, hyrja e trupave ruse e armatimi ajror mbi territorin ukrainas, është një luftë madje me përmasa gjenocidale, siç e quajti edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, kur iu drejtua popullit të tij, pas ngritjes së çmimeve të produkteve, “buxheti i familjes suaj, fuqia juaj për të mbushur serbatorin e makinës, nuk duhet të varet nga shpallja e luftës ndaj Ukrainës dhe kryerja e gjenocidit nga ana e një diktatori në anën tjetër të botës”<sup>24</sup>. Zyrtarisht apo jo, efektet e këtij konflikti po ndihen në gjithë botën, sidomos në ngritjen e çmimeve të produkteve esenciale, derivateve, vajit e drithërave.

Beteja mes Ruisë e Ukrainës, ringjalli diskutimet teorike të luftës. Shumë kush, pas përfundimit të Luftës së Ftoftë, nisi diskutimet se Lufta ka marr formë të re, sidomos pas zhvillimit të teknologjisë. Në këtë periudhën e fundit, lufta hibride dhe informative është tejet e theksuar mes shtetesh, por që pasojat nuk janë në njerëz e në shkatërrime në masë. Andaj, u besua se lufta, si aktivitet vrasës e shkatërrues i së kaluarës, mbaroi. Por, “tradicionalistët, nga ana tjetër, fokusohen në vazhdimësinë. Ata pretendojnë se ndërsa karakteri i luftës ka ndryshuar, natyra e saj thelbësore vazhdon”.<sup>25</sup> Kësisoj, lufta çdo herë është kuptuar si shfaqje e një grupi të organizuar, të armatosur, dhe shpesh si një “konflikt i zgjatur” që është kryer në mes të shteteve, kombeve, ose palëve të tjera, shprehimisht me dëme nga agresioni ekstrem apo përçarjeve sociale dhe e shprehur zakonisht me shkallë të lartë të vdekshmërisë. Martin van Creveld, që cilësohet si njëri nga më të mirët në teorinë e luftës dhe strategjisë “e përkufizon luftën si dhunë e organizuar për të arritur qëllime politike”<sup>26</sup>. Lufta cilësohet edhe si një formë e dhunës politike, meqenëse, janë politikat shtetërore ato që nisin luftën, apo edhe vet njerëzit siç janë thellë-thellë qenie politike, siç thotë edhe Aristoteli “njeriu është kafshë politike”. Egërsinë e kafshës, njeriu mund ta shpalos pa doreza në fushë betejat e luftës.

---

24 Biden përdori për herë të parë fjalën “gjenocid” për veprimet e Ruisë në Ukrainë, <https://www.trt.net.tr/shqip/bota/2022/04/13/biden-perdori-per-here-te-pare-fjalengjenocid-per-veprimet-e-rusise-ne-ukraine-1811636>, 13.04.2022

25 Metz, Steven. dhe Cuccia, Phillip, DEFINING WAR FOR THE 21ST CENTURY, <https://www.files.ethz.ch/isn/126626/pub1036.pdf>, faqe 1, shkurt 2011.

26 Po aty, faqe 2, shkurt 2011.

Përmes luftës, popujt, kombet a shtetet tentojnë të detyrojnë palën tjetër, të bëjë veprime apo mos veprime siç i shko përshtati të parit - të fortit. Kësisoj, lufta përcaktohet një nga agjencitë e mëdha me të cilat progresi i njerëzimit është realizuar. Prej kohësh luftërat ekzistojnë, dhe shumë kombe-shtete janë bërë nga luftërat.

Por, shpeshherë nuk dihet se kur përfundon zyrtarisht një luftë. Ndonëse, as nuk dihet se kur zyrtarisht fillon një luftë. Siç është rasti i agresionit rus mbi Ukrainë, ku edhe zyrtarisht Moskë nuk ka nënshkruar aktin e luftës, porse në terren, forcat e tyre po bëjnë shkatërrime e vrasje mbi tokën ukrainase. E kur të përfundoj, nuk dihet nëse presidenti rus, Vladimir Putin do të vendos për “përfundim të luftës zyrtarisht” apo për ndalje të agresionit apo armëpushim. Në këtë situatë, parashihen disa metoda të përfundimit të luftës. E njëjta “mund të jetë një zgjidhje e negociuar që u sinjalizon forcave ushtarake, publikut në vendet pjesëmarrëse dhe shteteve të tjera se lufta ka mbaruar. Njëra anë mund të jetë fitimtare dhe të vendosë kushtet e zgjidhjes..., dhe luftërat mund të përfundojnë përmes asgjësimit të njëres palë ose tjetres. Apo një luftë thjesht të shuhet pa ndonjë njohje formale se e njëjta ka përfunduar”<sup>27</sup>. Përfundimet e luftërave, të çfarëdo tipi qofshin, i lëshojnë vendin vuajtjeve të dëmeve anësore.

Ekzistojnë disa variacione të idesë se luftërat e mëdha në sistemin ndërkombëtar janë rregullisht të përsëritshme. Një pikëpamje e tillë i lidhë luftërat e mëdha me luhatjet e gjata në ekonominë botërore me kohëzgjatje rreth pesëdhjetëvjeçare. Një mënyrë tjetër trajtimi i lidh luftërat e mëdha me një përsëritshmëri 100-vjeçare të mbështetur mbi krijimin e rënien e rëndeve botërore<sup>28</sup>. Kjo, masë si nevojë e një rigjallërimi të fuzionimit ekonomik global, dhe lipset si nevojë krijimi i krizave, për të rifreskuar investimet, e qarkullimin e parave. Historia njih rastin (fokusohe mi në shekujt e fundit nga shtetet perëndimore) e mbisundimit të Spanjës në shekullin 16, atë të Holandës në shekullin 17, Britanisë së shekullin 19 dhe tani jemi duke u mbisunduar nga një hegjemoni Amerikane, e cila tenton të mbaj luftën larg tokës së saj, duke ndërhyrë në shumë shtete të botës. Njëherësh, SHBA është shteti me fuqinë më të madhe ushtarake, duke shpenzuar më së shumti në ushtri, krahasuar me shtetet e botës. Së fundmi, “Kongresi miratoi një projekt-ligj masiv për shpenzimet e Pentagonit prej 783 miliardë dollarësh për vitin fiskal 2022,

---

27 Metz, Steven. dhe Cuccia, Phillip, DEFINING WAR FOR THE 21ST CENTURY, <https://www.files.ethz.ch/isn/126626/pub1036.pdf>, faqe 14, shkurt 2011.

28 Goldstein, Joshua S. et Cooper, Louis F. Marrëdhënie Ndërkombëtare, përkthyes Starova, Ariana e Teuta, Dituria, 2003, faqe 199.

Presidenti Biden kërkoi një shumë të madhe 813 miliardë dollarë për vitin 2023”<sup>29</sup>.

## ***Dobitë e një lufte***

Me të vërtetë lufta është zemërthyesë, por pavarësisht ajo ka dobitë e saj, të cilat vetë lufta synon ti arrijë. “Luftërat fillojnë me vendime të vetëdijshme e të arsyeshme të mbështetura mbi përlllogaritje të bëra nga dy palët, sipas të cilave ato mund të arrijnë diçka më shumë nëpërmjet luftës sesa duke mbetur në paqe”<sup>30</sup>. Si parim, në secilën nismë luftuese, synohet të përfitohet diçka. Dikush pavarësinë ndaj një shteti tjetër, dikush të drejta më të mëdha, dikush edhe territor të zgjeruar. Nga dobitë e saj është se ajo stimulon rritjen kombëtare, zgjidhë ndryshe problemet e patretshme të ekonomisë politike të vendit, ku me përfundimin e luftës, historia njih raste të shpeshta të ringjalljeve ekonomike të shteteve luftuese dhe spastrimit të një kombi homogjen. Lufta në të vërtetë ka përfitimet e saj, kjo është arsyeja pse luftërat ndodhin. Në fakt, nëse ju shikoni në vizionin për të ardhmen, një shtet në luftë të vazhdueshme e konsideron jetike ruajtjen e një status quo-je në kuptimin ekonomik<sup>31</sup>.

Kompanitë mund të bëjnë një shumë të madhe të të hollave, nëse ato shesin produkte të nevojshme për luftë. Ka qëndrime që luftërat shkaktohen me qëllime që armët ushtarake tu shiten shteteve luftuese dhe në këtë formë të gjitha rezervat e industrisë ushtarake të kenë përfitime të majme. Në një intervistë të bërë së fundmi nga ekonomisti amerikan, njëherësh ish pjesëtarë i ushtrisë amerikane, referuar zhvillimeve mes Ruisë dhe Ukrainës, Daniel Ellsberg thotë se “lufta është shumë fitimprurëse për njerëzit që po furnizojnë ato armë për ta vazhduar”<sup>32</sup>. Duke iu referuar zhvillimeve të pranverës së sivjetme (2022), Shtetet e Bashkuara u fokusuan shumë në “luftim” nga larg të Ruisë, “duke dërguar më shumë armë në Ukrainë, duke ndihmuar në vendimet strategjike dhe duke dhënë miliarda ndihmë. Së fundmi ata miratuan një projekt-ligj që siguron gati 14 miliardë dollarë për të financuar mbrojtjen

---

29 Pentagon Spending, Friends Committee on National Legislation, [https://www.fcnl.org/issues/us-wars-militarism/pentagon-spending?gclid=EAIAIqObChMIo5qJq7LX9wIVB4bVCh1LFA-iEAAAYAiAAEgIvD\\_BwE](https://www.fcnl.org/issues/us-wars-militarism/pentagon-spending?gclid=EAIAIqObChMIo5qJq7LX9wIVB4bVCh1LFA-iEAAAYAiAAEgIvD_BwE)

30 Goldstein, Joshua S. et Cooper, Louis F. Marrëdhënie Ndërkombëtare, pëkthyes Starova, Ariana e Teuta, Dituria, 2003, faqe 196.

31 The North American Review. 1891, December. The Benefits of War, S.B.Luce <http://www.jstor.org/stable/25102290?seq=2>, 08.04.2012.

32 Who really benefits from war?, Intervistw e Daniel Ellsberg pwr UpFront, AlJazera, <https://www.aljazeera.com/program/upfront/2022/4/29/who-really-benefits-from-war>, 29 prill 2022.

e Ukrainës kundër Rusisë”<sup>33</sup>. Në këtë shembull të freskët lufte, kemi hapëruar në lëvizje të çmimeve, që po ngrihen çdo ditë, sidomos në sektorin e derivateve. Por, edhe këtu, dikush përfiton. “Kompanitë e naftës dhe prodhuesit e armëve tashmë po shohin fitime nga pushtimi ukrainas. Aksionet e Lockheed Martin dhe Northrop Grumman, dy nga kompanitë më të mëdha të mbrojtjes në SHBA, u rritën me 20% në javën pas pushtimit, dhe çmimet e gazit në SHBA arritën një rekord prej 4,33 dollarë për gallon”<sup>34</sup>. E për naftën, shtetet perëndimore po i bëjnë presion njëra tjetrës, me theks të veçantë SHBA po tenton të shtyj gjithë Bashkimin Evropian të krijoj strategji tërheqëse që të mos varet nga nafta dhe gazi rus. Në një skemë të tillë, janë kompanitë e mëdha amerikane e perëndimore, që prodhojnë naftë, ato që mund të përfitojnë lehtësisht nga këto lëvizje të orientimit të ri global. “Kompanitë amerikane po bëjnë presion për të rritur prodhimin vendas të naftës. Në Kaliforni, një koalicion dypartiak ligjvënësish po i kërkon guvernatorit Gavin Newsom të rrisë prodhimin e naftës në shtet..., kjo sugjeron që njerëzit e pasur do të bëhen shumë më të pasur”<sup>35</sup>.

Më pas, rindërtimi i pasluftës në shumë vende do të josh investitorët dhe bizneset për ndërtim dhe prodhuesit e tjerë të pajisjeve të ndryshme. Shembull, në Ukrainë, ndonëse lufta është ende në zhvillim, dëmet infrastrukturore janë miliardëshe. Në gjysmë të prillit, “Banka Botërore konsideron se dëmet nga pushtimi rus i Ukrainës arrijnë në vlerë prej 60 miliardë dollarësh”<sup>36</sup>. Në anën tjetër, vet presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy ka thënë se “Ukrainës do t’i duhen 7 miliardë dollarë në muaj për të kompensuar humbjet ekonomike të shkaktuara nga lufta”<sup>37</sup>. Sigurisht, këto para do t’i siguroj nga ndihma e huazuar apo nëpërmjet kredive nga organizatat ndërkombëtare apo edhe shtetet përkras. Në anën tjetër, Rusia parashihet të ketë humbje të larta financiare, për ta furnizuar ushtrinë e saj në territorin e Ukrainës. Kësisoj, “kostoja ditore e luftës për Rusinë mund të kalojë 20 miliardë dollarë”<sup>38</sup> duke përfshirë shpenzimet që do t’i bëjë për personelin ushtarak, municionet, karburantet, raketat e lëshuara, e çdo gjë tjetër të nevojshme për këtë betejë.

---

33 Mallett, Kandist. Who Benefits From War? What to Keep in Mind About Military Conflicts, <https://www.teenvogue.com/story/who-benefits-from-war-reminders>, 18 mars, 2022

34 Po aty.

35 Po aty.

36 Banka Botërore: Dëmet në Ukrainë arrijnë në 60 miliardë dollarë, <https://www.koha.net/bote/321777/banka-boterore-dem-et-ne-ukraine-arrijne-ne-60-miliarde-dollare/> 21 prill 2022.

37 Po aty.

38 Lufta në Ukrainë mund t’i kushtojë Rusisë mbi 20 miliardë dollarë në ditë, <https://www.aa.com.tr/sq/bota/lufta-n%C3%AB-ukrain%C3%AB-mund-ti-kushtoj%C3%AB-rusis%C3%AB-mbi-20-miliard%C3%AB-dollar%C3%AB-n%C3%AB-dit%C3%AB/2522462>, 03.03.2022

Luftërat gjithashtu priren të përqendrohen në kërkime dhe zhvillimin e produkteve të reja teknologjike. Synimi i luftës në këtë kontekst paraqet bërjen e eksperimenteve ashtu si ka ndodhur në Hiroshima dhe Nagasaki e shumë raste e vende të tjera. E në Ukrainë, kundër forcave ruse po përdoren disa dronë ushtarakë të prodhuar në Turqi, që sipas shumë raportimeve edhe nga ana e ukrainasve, të njëjtit po korrin sukses në terren. “Bayraktar TB2 është 6,50 metra i gjatë dhe 12 metra i gjerë. Ky dron mund të qëndrojë mbi 24 orë në ajër dhe arrin shpejtësinë maksimale rreth 220 km në orë”<sup>39</sup>. Është një çmim i tmerrshëm për të paguar, por ka përfitime.

Përfitime tjera mund të jetë blerja e tokave të tilla si rasti i Izraelit në luftën e vitit 1973, i cili u mundësoi qytetarëve të blejnë toka për të zgjeruar kufijtë dhe të vendosen në territoret e ndaluara më parë<sup>40</sup>. Historikisht, mjetet ushtarake kanë qenë mjeti më veprues ndikues për kontrollin e një territori, kurse luftërat shpesh kanë çuar në ripërcaktimin e kufijve shtetërorë<sup>41</sup>. Edhe Kosova, është një shembull, që luftën kundrejt Serbisë, e përdori për të qenë e pavarur në territorin e saj, deri në pavarësim të shtetit më 2008.

E nëse e shohim luftën, si një aktivitet për të tentuar mbrojtjen e paqes së botës, duke luftuar agresorët e dhunshëm që i njohu bota, sigurisht edhe në këtë vështrim historia ka shembuj. Lufta e Dytë Botërore ka eliminuar Hitlerin, si një kërcënim për paqen në botë. Lufta e Dytë Botërore nuk kishte ndodhur Holokaustit. Edhe pse shpëtimi i tyre nuk ishte pika kryesore e luftës, ajo ishte një prej efekteve të luftës. Kur lufta shpëton njerëzit nga tmerret si kjo ose jetojnë nën regjimet e këqija, ajo qartë mund të shihet veprim i dobishëm. Pa Luftën e Dytë Botërore, Evropa dhe SHBA ndoshta do të ishin nën sundimin nazist, ndërsa Azia do të ishte nën sundimin japonez. Lufta e Dytë Botërore ndoshta është një nga rastet e pakta në të cilën të dy palët, fitimtarët dhe humbësit, përfituan nga lufta; fituesi nga mposhtja e tiranit, ndërsa humbësit duke u liruar nga tirani. Pra, gjatë kësaj lufte, çdo gjë që kishte ndodhur ishte në përputhshmëri me fitoren e të gjithëve<sup>42</sup>. Kësisoj, edhe pas shumë humbjeve në njerëz, e dëmeve të tjera që i lë pas një luftë, përfundojmë

---

39 Dronët luftarak turq në luftën e Ukrainës, <https://www.dw.com/sq/dron%C3%ABt-luftarak-turq-n%C3%AB-luft%C3%ABn-e-ukrain%C3%ABs/a-61036322>, 07.03.2022.

40 Enotes – Stydy smarter. 2012, February 28. Are there any benefits of wars? <http://www.enotes.com/political-science/discuss/there-any-benefits-wars-118683>, 08.04.2012.

41 Goldstein, Joshua S. et Cooper, Louis F. Marrëdhënie Ndërkombëtare, përkthyes Starova, Ariana e Teuta, Dituria, 2003, faqe 202.

42 Enotes – Stydy smarter. 2012, February 28. Are there any benefits of wars? <http://www.enotes.com/political-science/discuss/there-any-benefits-wars-118683>, 08.04.2012.

me qëndrimin e Daniel Ellsberg se edhe “një luftë e dështuar është po aq fitimprurëse sa një luftë fituese”<sup>43</sup>.

### ***Bibliografia***

1. Goldstein, Joshua S. et Cooper, Louis F. Marrëdhënie Ndërkombëtare, përkthyes Starova, Ariana e Teuta, Dituria, 2003.
1. Goldstein, Joshua S. et Cooper, Louis F. Marrëdhënie Ndërkombëtare, përkthyes Starova, Ariana e Teuta, Dituria, 2003.
2. Enotes – Study smarter. 2012, February 28. Are there any benefits of wars? <http://www.enotes.com/political-science/discuss/there-any-benefits-wars-118683>, 08.04.2012
3. Pentagon Spending, Friends Committee on National Legislation, [https://www.fcnl.org/issues/us-wars-militarism/pentagon-spending?gclid=EA1aIQobChMIo5qJq7LX9wIVB4bVCh1LFA-iEAAAYAiAAEgIxIvD\\_BwE](https://www.fcnl.org/issues/us-wars-militarism/pentagon-spending?gclid=EA1aIQobChMIo5qJq7LX9wIVB4bVCh1LFA-iEAAAYAiAAEgIxIvD_BwE)
4. The North American Review. 1891, December. The Benefits of War, S.B.Luce <http://www.jstor.org/stable/25102290?seq=2>, 08.04.2012
5. Mallett, Kandist. Who Benefits From War? What to Keep in Mind About Military Conflicts, <https://www.teenvogue.com/story/who-benefits-from-war-reminders>, 18 mars, 2022
6. Metz, Steven. dhe Cuccia, Phillip, DEFINING WAR FOR THE 21ST CENTURY, <https://www.files.ethz.ch/isn/126626/pub1036.pdf>, shkurt 2011

### ***Resurse nga mediat:***

1. Who really benefits from war?, Intervistw e Daniel Ellsberg pwr UpFront, AlJazera, <https://www.aljazeera.com/program/upfront/2022/4/29/who-really-benefits-from-war>, 29 prill 2022.
1. Biden përdori për herë të parë fjalën “gjenocid” për veprimet e Rusisë në Ukrainë, <https://www.trt.net.tr/shqip/bota/2022/04/13/biden-perdori-per-here-te-pare-fjalen-gjenocid-per-veprimet-e-rusise-ne-ukraine-1811636>, 13.04.2022
2. Banka Botërore: Dëmet në Ukrainë arrijnë në 60 miliardë dollarë, <https://www.koha.net/bote/321777/banka-boterore-demet-ne-ukraine-arrijne-ne-60-miliarde-dollare/> 21 prill 2022.
3. Lufta në Ukrainë mund t'i kushtojë Rusisë mbi 20 miliardë dollarë në ditë, <https://www.aa.com.tr/sq/bota/lufta-n%C3%AB-ukrain%C3%AB-mund-ti->

---

43 Who really benefits from war?, Intervistw e Daniel Ellsberg pwr UpFront, AlJazera, <https://www.aljazeera.com/program/upfront/2022/4/29/who-really-benefits-from-war>, 29 prill 2022.



kushtoj%C3%AB-rusis%C3%AB-mbi-20-miliard%C3%AB-dollar%C3%AB-n%C3%AB-dit%C3%AB/2522462, 03.03.2022

4. Dronët luftarak turq në luftën e Ukrainës,  
<https://www.dw.com/sq/dron%C3%ABt-luftarak-turq-n%C3%AB-luft%C3%ABn-e-ukrain%C3%ABs/a-61036322>, 07.03.2022.

## V GJEOEKONOMI

### 5.1 SFIDAT ENERGJETIKE TË QEVERISË SË KOSOVËS



**Skenarët me përqindje shumë të larta të energjisë së rinovueshme, ose ata që kërkojnë zgjatjen e punës së reaktorëve bërthamorë ekzistues përtej 60 viteve, përfshihen në një bast të rëndë teknologjik. Me fjalë të tjera, ne po luajmë me të ardhmen tonë në rulet - rus, natyrisht**

**Ali MEHMETI , inxh. dipl. el. [Gjenevë]**

Energjia elektrike është vetëm një formë e energjisë, që në epokën tonë është më e përshtatshme për përdorim në jetën e përditshme dhe në industri. Si e tillë ajo nuk ndodhet në natyrë, prandaj duhet të fitohet nga ndonjë burim tjetër i energjisë që ndodhet në natyrë duke e shndërruar atë në energji elektrike. Edhe pse gabimisht, ky shndërrim sot quhet “prodhim” në të gjitha gjuhët e botës, prandaj do e përdorim edhe ne.

Burimet që sot përdoren për prodhimin e energjisë elektrike janë: nga energjia e rrjedhave të lumenjve (ujit); nga energjia termike e fituar me djegie të thëngjillit, karburanteve të lëngëta apo të gazta dhe biomasës; energjia e erës; energjia e diellit; energjia termike që vjen nga thellësia e tokës (energjia gjeotermike) dhe nga energjia bërthamore që lirohet gjatë zbërthimit të bërthamës së atomit.

Krahas faktorëve tjerë, janë tri nga burimet e përmendura që kanë shkaktuar rritjen enorme të çmimit të energjisë elektrike në tregun evropian dhe jo vetëm, madje që janë përpëthur me një periudhë mjaft të ashpër të dimrit që ka rritur

kërkesën për energji.

Në shumicën e shkrimeve të javëve të fundit, me të drejtë, faji kryesor i lihet çmimit të gazit natyror që vjen nga Rusia, me të cilin plotësohet gjysma e nevojave të përgjithshme evropiane. Pjesa tjetër, një e treta vjen nga tregu ndërkombëtar në formë të gazit natyror të lëngshëm që transportohet me anije dhe pjesa e mbetur nga Algjeria dhe Libia. Nga gazi natyror prodhohet rreth 20% të energjisë elektrike në Evropë, 40% nga burimet e rinovueshme, 25% nga energjia bërthamore dhe 15% nga qymyri. Rritja e çmimit të gazit është provokuar nga sjellja e Ruisë e cila refuzon të dërgoj gaz në sasi më të mëdha sesa që i ka të kontraktuar me kontrata afatgjata. Me fjalë tjera refuzon kontrata të reja, të atypëratyshme sikurse edhe transportimin e gazit nëpërmjet Ukrainës.

Kjo vjen ndoshta edhe në shenjë hakmarrjeje ndaj mos lëshimit në punë të gazsjellësit verior (Nord Stream2), që lidh direkt Rusinë me Gjermaninë.

Rritja e çmimit, i cili u shtatëfishua dhe kursimi i gazit, u provokua edhe për shkak të situatës së krijuar në kufirin ndërmjet Ukrainës dhe Ruisë, ku nuk përjashtohet as konfrontimi ushtarak që edhe më shumë ul sigurinë e furnizimit me gaz të Evropës. Nuk mund të neglizhohet as fakti që kërkesa botërore për gaz natyror, para së gjithash në Azi, nga Kina dhe Japonia ka ndikuar në rritjen e çmimit. Këto fakte ndikuan që gazi i deponuar në Evropë, i cili edhe ashtu nuk ishte në kuotat e tij maksimale, të kursehet dhe termocentralet me gaz të ulin ose ndalojnë prodhimin, kurse gazi të përdoret kryesisht për ngrohje.

Burimi i dytë që ndikoi në mungesë të energjisë elektrike, respektivisht në rritjen e çmimit, është prodhimi i energjisë elektrike nga energjia bërthamore në Francë. Atje, gjatë këtij viti kanë dalë jashtë përdorimit 15 nga 56 reaktor bërthamor, për arsye të ndryshme. Këta 15 reaktor me fuqi 15x900MW, në vitin 2020, prodhuan 74TWh (tera-vat-orë) nga gjithsej 500TWh, sa ishte prodhimi i gjithmbarshëm nga të gjitha burimet. Pra, kaq energji mungoi në vitin 2021. Sa për krahasim, Kosova dhe Shqipëria bashkë, prodhojnë pak mbi 10TWh në vit. Si pasojë Franca, nga eksportuesi prej 45TWh në vitin 2020, në muajin dhjetor 2021 u shndërrua në importues ditor prej 10-15GW (fuqia e barabartë me 10-15-fishin e kapacitetit të Kosovës A dhe B së bashku).

Burimi i tretë, edhe pse, sot për sot me më pak ndikim në sasi, është shumë domethënës. Mungesa e erërave në detet veriore, vetëm në Gjermani, ka zvogëluar prodhimin e energjisë elektrike për 42% nga turbinat me erë. Gjermania parasheh se deri në vitin 2030, 80% e prodhimit të energjisë elektrike të bazohet në energji të rinovueshme.

Paradigma se energjia elektrike e prodhuar nga era dhe dielli është e pashtershme, është falas dhe është e pastër, është e gabuar. Mund të ndryshoj

dhe shteret, madje disa herrë brenda ditës, javës apo muajit, në vartësi nga era që fryn ose jo, nga retë që mbulojnë diellin, dita dhe nata apo lartësia e diellit në horizont. Nuk është falas, sepse çdo transformim në energji elektrike kushton, sepse kërkon fuqi punëtore të specializuar, pajisje të shtrenjta dhe tokë mbi të cilën do të vendosen. Nuk është as e pastër, sepse prodhimi i pajisjeve të nevojshme nuk është pa ndikim negativ në ambient. Pra, edhe këto burime të energjisë kanë limitet e veta. Para së gjithash në fushën e deponimit, nëse në ndërkohë nuk zbulohet ndonjë teknologji e re për magazinimin e energjisë elektrike të prodhuar në periudhat kur kushtet atmosferike janë të volitshme. Diçka e tillë nuk shihet në horizont. Niveli i sotshëm teknologjik i baterive, nuk e mundëson magazinimin më masiv me çmim të pranueshëm. Bateria më e madhe në botë, me kapacitet prej 900MWh ndodhet në Florida (ShBA) dhe zen një sipërfaqe prej 16 hektarë! Këtë energji e jep Kosova A+B për një orë. Imagjeroni pastaj çmimin!

Vendimi i Gjermanisë për të mbyllur 6 reaktorët e fundit bërthamor deri në fund të vitit 2022 me fuqi prej 8,1GW (3 prej tyre u mbyllën para pak ditësh), patjetër se do ta rris prodhimin e energjisë elektrike nga gazi, i deklaruar sikur burim tranzitor, dhe qymyri. Nga ana tjetër, mos aprovimi i kërkesës së Francës që energjia bërthamore të shpallet sikur energji e pastër, përkundër insistimit të saj, do ta rris edhe më shumë përdorimin e gazit dhe qymyrit. Në të kundërtën, nëse aprovohet kërkesa e Francës, i bie që të vazhdojë përdorimi i reaktorëve bërthamorë të vjetër 50-60 vjet(!) dhe ndërtimi i të rinjve.

Vetëm naivët mund të besojnë që Franca do të heqë dorë nga prodhimi i energjisë elektrike nga energjia bërthamore dhe të mbështetet në gazin rus, që përveç në Rusi, tjetrin rubinet e ka në Gjermani! Aq më parë kur dihet se 67% të energjisë elektrike në Francë ka origjinë bërthamore (viti 2020). Si dëshmi, një reaktor i ri do lëshohet në punë në fund të vitit 2022. E njëjta logjikë do pasohet edhe nga shumica e shteteve tjera me centrale bërthamore, që janë shtetet më të zhvilluara evropiane.

Taksa e aplikuar në emetimin e dyoksid karbonit (CO<sub>2</sub>) prej 86 €/t, që në të ardhmen do të rritet edhe më shumë, luan rolin e vet. Emetimi i këtij gazi gjatë prodhimit të energjisë elektrike nga qymyri është 800g/KWh, nga gazi natyror 500g/KWh dhe nga bërthamorja 12g/KWh. Pra, çdo kilovatore të prodhuar nga qymyri do ti shtohet taksa e karbonit prej 6,88eurocent, nga gazi 4,3eurocent dhe nga bërthamorja 0,1eurocent.

Për ta parandaluar emetimin e dyoksid karbonit gjatë prodhimit të energjisë elektrike nga qymyri, ekziston teknologjia efikase e quajtur CCS (Carbon Capture Storage - Kapja dhe Deponimi i Karbonit). Kapja e karbonit në këtë mënyrë ka kosto prej 72€/t, ku duhet shtuar transportin dhe deponimin prej 35€ (sipas çmimeve amerikane dhe fondit zviceran për investime swisscanto.com). Duke e ditur se taksa evropiane për karbon parashihet të

rritet në të ardhmen, kurse çmimi i teknologjisë CCS mund edhe të zbret, ky opsion duhet marrë në shqyrtim, pavarësisht se në momentin e sotshëm është me i shtrenjtë, Sepse e mbron ambientin dhe hap rrugë për kredi ndërkombëtare. Politika evropiane ka integruar CCS në Marrëveshjen e Gjelbër për Evropën, ku përveç kapjes parashihet edhe shfrytëzimi i karbonit dhe shpesh shkruhet sikur CCUS. Fondet evropiane po mbështesin projektet fillestare, duke përfshirë Fondin e Inovacionit, i cili nisi thirrjen e parë për projekte të mëdha në vitin 2020.

Tani ka me dhjetëra projekte në Evropë, që po përshpejtohen dhe projektet e para në shkallë të gjerë do të funksionojnë nga viti 2024. Vendet e Evropës Veriore si Norvegjia, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar janë më të avancuarat.

Politika evropiane rreth energjisë, duke pasur parasysh kontradiktat dhe interesat e ndryshëm, qysh tani po hap luftë, para së gjithash atë franko-gjermane. Jo aq të hapur siç ishte “lufta e maskave” apo ajo “e vaksinave” në fillimet e pandemisë, por megjithatë të dukshme. Në Francë qarkullojnë akuzat, ku thuhet se “Në këtë luftë ekonomike, duhet t’i frikësohemi presionit “miqësor” nga Gjermania” apo “organizatat gjermane, siç është Fondacioni H. Böll, po financojnë sondazhe për të shpërndarë informacionin se francezët janë kundër energjisë bërthamore” (lemondedelenergie.com). Kancelari i ri gjerman Olaf Scholz në një intervistë dhënë së fundmi, nuk e ka vënë në dyshim braktisjen e bërthamores: “Energjia bërthamore është rrugë e gabuar, në këtë pikë, ne kemi qartazi një qëndrim të ndryshëm nga ai i qeverisë franceze. Problemi i mbetjeve nukleare nuk mund të zgjidhet. Ndërtimi i impianteve të reja është shumë i shtrenjtë”.

Pastaj, gazi natyror është pjesë edhe e gjeopolitikës. Në Evropë, siç thamë më lartë, gjysma e gazit natyror importohet nga Rusia, një vend ku ekziston monopoli i gazit nga një kompani, Gazprom. Kjo kompani është publike dhe nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Vladimir Putinit. Prandaj, gazi rus mund dhe momentalisht (keq)përdoret në kontekstin aktual, pasi vazhdon kriza rreth Krimesë dhe Ukrainës, midis Rosisë, Shteteve të Bashkuara dhe Evropës, apo në të ardhmen në ndonjë krizë tjetër, ku nuk përjashtohet as Kosova.

Nga sa u tha më lartë rrjedhin edhe disa konkluzione që sigurisht do ta tërheqin vëmendjen e autoriteteve evropiane në lidhje me politikat e tyre energjetike. Ideja që gazi të vendoset sikur ndërlidhje tranzitore ndërmjet energjisë së prodhuar nga burimet fosile (qymyri dhe nafta) dhe energjisë të rinovueshme (jo fosile dhe pa karbon), ndoshta mund të rishqyrtohet, sikurse edhe vendimi që deri në vitin 2050 prodhimi i gjithë energjisë elektrike të mbështetet në burime të rinovueshme, nga ato, 8% nga uji. Aq më parë kur është parë (në praktikë) se, sa më e madhe të jetë pjesëmarrja e energjisë së rinovueshme nga

era dhe dielli në prodhimin e energjisë elektrike, aq më e vogël do të jetë siguria e furnizimit të pandërprerë. Situata e krijuar gjatë këtij dimri, i vë në sprovë serioze këto vendime. Nëse kjo politikë nuk ndryshon sot, nuk përjashtohet mundësia që të ndryshojë më vonë, kur shihet se objektivi është i paarrtshëm. Shumë nga ekspertët janë pesimist në mundësinë e realizimit të agjendës 2050. Madje njëri nga ta shkruan: “Skenarët me përqindje shumë të larta të energjisë së rinovueshme, ose ata që kërkojnë zgjatjen e punës së reaktorëve bërthamorë ekzistues përtej 60 viteve, përfshihen në një bast të rënd teknologjik. Me fjalë të tjera, ne po luajmë me të ardhmen tonë në rulet - rus, natyrisht” - shprehet decidivisht Serge Gil, ish shef teknik dhe i sigurisë në Komisaratin për Energji Bërthamore në Francë.

## ***PËRFUNDIM***

Me teknologji të njohura deri më sot, energjia elektrike e fituar nga era dhe dielli (pjesërisht as ajo nga uji), nuk mund të magazinohet në masë të mjaftueshme për të siguruar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike. Si pasojë, ka nevojë për burime të sigurta, qoftë edhe vetëm sikur rezervë;

Taksa progresive e karbonit do të ndikojë në mbylljen e termocentraleve me qymyr, ose do të kërkohet modernizimi i tyre me teknologjinë CCS, që nuk është aspak e lirë;

Duke pasur parasysh kontradiktat franko-gjermane, është e pritshme që dy burimet e energjisë do të mbesin dominante në Evropë: e rinovueshme (me ujë, erë dhe diell) të shtyra nga Gjermania dhe ajo bërthamore e shtyrë nga Franca. Energjia e prodhuar me gaz natyror do të mbetet në rezervë, kur do të mungojë ajo e rinovueshme;

Shtetet e Evropës veriore, në shumicën e rasteve, si energji të rinovueshme do ta përdorin erën, kurse ato në jug energjinë diellore, sikurse edhe ujin ato që disponojnë me kapacitete të mjaftueshme hidrike me topografi të përshtatshme;

Shtrohet pyetja se çka do bëjnë shtetet më pak të zhvilluara, pa mundësi të ndërtojnë centrale bërthamore, pa resurse ujore, me pozicion gjeografik ku nuk ka mjaftueshëm as erë, as diell, në rast se do të detyrohen, në një mënyrë ose në një tjetër, të mbyllin termocentralet e tyre të bazuara në qymyr? Asgjë tjetër, përveçse të investojnë para të mëdha në panele diellore, në turbina me erë dhe, në të njëjtën kohë të lëngojnë nga pasiguria energjetike dhe nga pasiguria sociale?!

Duket se zgjidhja më e arsyeshme për Kosovën, e të cilën do t’ia sugjeronim Qeverisë së Kosovës, është pikërisht teknologjia CC(U)S, në kombinim me energjinë e rinovueshme.

***Gjenevë, 2. 1. 2022***

## VI. HISTORI

### 6.1 Përballja e Serbisë me tapitë e Sanxhakut të Nishit



**Dëbimi i shqiptarëve, myslimanëve e të tjerëve nga Sanxhaku i Smederevës, filloi që kur shpërtheu Kryengritja e Parë serbe (1804). Kryengritësit, të nxitur nga udhëheqësit e tyre, njëkohësisht u vërsulën egërsisht mbi ta, pa zgjedhur mjetet: bënë vrasje, dhunime, keqtrajtime, dhënia e flakëve shtëpive e objekteve etj.**

#### **Dr. Ramiz ABDYLI**

Shqiptarët ishin të pranishëm në Serbinë Jugore që nga mesjeta. Gjurmët e tyre në këto treva, duhet të jenë të mëhershme. Është thënë se ndonjë shqiptar i këtyre trevave mori pjesë në Betejën e Kosovës (1389). Historiografia serbe pretendon se shqiptarët depërtuan në Serbi, si nizamë të ushtrisë osmane, për t'i paraqitur ata bashkëpueshtues, tezë tendencioze, pasi në radhët e kësaj ushtrie pushtuese janë shquar edhe serb, përfshi edhe ndonjë knjaz, siç ishte S. Lazareviqi, që mori pjesë me ushtrinë e tij në betejën e Angorës (Ankarasë), Kraleviq Marko etj. Gjithsesi çështja e pranisë së hershme të shqiptarëve në Serbi duhet mbetet të sqarohet nga historiografia jonë në mbështetje të argumenteve të qëndrueshme, që mund t'i bëjë ballë kritikës shkencore.

Dokumentet osmane, dhe dokumente të proveniencave të tjera kanë dëshmuar se shqiptarët në shek.18 përbënin shumicën e popullsisë në Sanxhakun e Nishit, Kazanë e Vrajës, dhe Kazanë e Pirotit, që ishin pjesë të Vilajetit të Kosovës, i cili kishte statusin e një province në Perandorinë Osmane. Gjithnjë sipas këtyre dokumenteve, shqiptarët kishin një përqindje të vogël të

popullsisë edhe në Sanxhakun e Smederevës, i njohur si Pashallëku i Beogradit. Njëra nga 12 nahijet e këtij sanxhaku, Nahija e Jagodinës, banohej me shumicë shqiptare. Është për të theksuar se shqiptarësinë e këtyre trevave e thotë edhe akademiku, dhe politikani serb, Vasa Çubrilović, i njohur për qëndrimin e tij fashist ndaj shqiptarëve. Në Elaboratin e tij të vitit 1937 për shpërngulën e shqiptarëve nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë ai ka lavdëruar qeverinë e vendit të tij, që ia kishte dalë ta zhbënte “pykën shqiptare që nga Jagodina” e në jug të saj. Prandaj, këto treva i ka cilësuar si Arnautluk (Vasa Čubrilović, *Politički uzroci na Balkanu od 1860-1880*, GGD, So. C VI, Tom XVI, Belgrade, 1930, 43). Po kështu, edhe anglezi, Xhon Ros shprehet për shqiptarësinë e këtyre trevave: “Po thuaj popullsia e pjesës perëndimore të Sanxhakut të Nishit, janë shqiptarë, të besimit mysliman” (Nikola P. Ilić, *Vojne operacije srpske vojske za oslobođenje Leskovca od Turaka 1877 godine*).

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme historiografia shqiptare i ka cilësuar trevat e mësipërme si Troje Etnike Veriore Shqiptare, rrjedhimisht troje etnike të Kosovës Verilindore (Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës*, 2014; Gazmend Zajmi, në: *Gjenocodi dhe aktet gjenocidale. . .*, Prishtinë, 1995, 14).





## ***DËBIMI NGA SANXHAKU I SMEDERËVËS***


Dëbimi i shqiptarëve, myslimanëve e të tjerëve nga Sanxhaku i Smederevës, filloi që kur shpërtheu Kryengritja e Parë serbe (1804). Kryengritësit, të nxitur nga udhëheqësit e tyre, njëkohësisht u vërsulën egërsisht mbi ta, pa zgjedhur mjetet: bënë vrasje, dhunime, keqtrajtime, dhënia e flakëve shtëpive e objekteve etj. “Bëmat” e tyre i ka pohuar edhe K. Nenadoviq, biograf i udhëheqësit të kryengritjes, Karagjorgje Petroviqit, i cili midis tjerash thotë: “(. . .) serbët e zemëruar vrisnin turqit kudo që i hasnin , nuk kursyen as të plagosurit, as fëmijët”. Ndërsa historiani amerikan Philip Cohen, ka arritur në përfundimin se këto krime ndaj jo serbëve ishin të pashembullta: “Fashizmi serb është me i vjetër se ai hitlerian, rrënjët e të cilit datojnë nga viti 1804” (Philip Kohen, Tajni rat Srbije, Zagreb 1997).

Është për të vënë në spikamë faktin se Serbia pati mbështetjen e gjithanshme të Ruisë dhe të Francës për dëbimin e shqiptarëve, e të jo serbëve nga Sanxhaku i Smederevës në Konferencën ndërkombëtare të Kalnixhes, pranë Stambollit (1862). Me insistimin e tyre, konferenca vendosi që jo serbët të “shpërnguleshin sa më parë nga Principata e Serbisë”. Përrjashtim do të bënin vetëm ata që do të deklaroheshin “myslimanë serb”, apo romë. Për dëbimin përfundimtar të tyre nga territori i principatës serbe u sajua incidenti i njohur në Çukur Çezme, kur u vra djaloshi, Sava Petkoviç (16 qershor 1862). Ndërkaq, për efekte të popullimit me të shpejtë të trevave të braktisura me serb, Princi serb, Millosh Obrenoviç, nxori Ligjin e veçantë (1865), sipas të cilit kolonët që do të vendoseshin në pronat e të dëbuarve, përjashtoheshin nga taksat dhe nga shërbimi ushtarak. Pasuan aksionet e ushtrisë serbe për dëbimin përfundimtar të gjithë jo serbëve. Këto aksione u shoqëruan edhe me plaçkitje, përvetësim të pasurisë dhe rrënimin e objekteve të te kultit islam (xhami e teqe).

## ***PASTRIMI ETNIK I SANXHAKUT TË NISHIT***

Pastrimi etnik i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, Kazaja e Vrajës dhe Kazaja e Pirotit, ndodhi gjatë dhe pas Luftë serbo-osmane (1977-1878). Princi Milan Obrenoviç, para se ushtria e tij të fillonte operacionet luftarake kundër ushtrisë osmane, do t’i drejtohej shqiptarëve me një Proklamatë, me të cilën kërkonte që nëse nuk do të luftonin kundër ushtrisë së tij, ju garantonte jetën dhe paprekshmërinë e pronave. Ndërkaq, në Proklamatën drejtuar ushtarëve të tij, ky sundimtar përkonte prej tyre që “Sa më shumë shqiptarë të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja për Atdheun” (J. Hadzi Vasileviç, Arbanaska liga-Arnautska kongra i srpski narod u turskom carstvu, Beograd 1909, 14). Ushtria serbe, e mbështetur nga ushtarë e instruktorë rusë, do t’ia dilte ta dëbonte ushtrinë osmane nga Sanxhaku i Nishit dhe trojeve për rreth,

për një kohë relativisht të shkurtë (13 dhjetor 1877-5 shkurt 1878) dhe zbatoi me përpikëri urdhrin e sovranit të saj. Operacionet luftarake të saj, u pasuan njëkohësisht me vrasje, masakrime, e keqtrajtime të mijëra burrave, dhunime të grave, rrënimin e shtëpive, vënien e zjarrit të shumë fshatrave e lagjeve



shqiptare në qytete, shumë burra u hodhën në burgjet e Serbisë etj. Gjetën vdekjen, po kështu, edhe shumë shqiptarë të tjerë, sidomos fëmijë e pleq, që morën arratinë drejt Vilajetit të Kosovës, për të shpëtuar jetën. Këto masakra i kanë pohuar edhe disa dëshmitarë serb (S. Uka, Dëbimi me dhunë i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit (18, 1995, 77-1878, në: Gjenocidi . . . , 74-75). Është për të theksuar se qeveria serbe urdhëroi të masakroheshin edhe shumë shqiptarë të tjerë që vendosën të ktheheshin në trojet e tyre, në verë të vitit 1878, pasi kuptuan se Kongresi i Berlinit (10. 06-10-07), ju garantonte atyre jetën dhe pronën, nëse dëshironin të jetonin në Serbi. Por kjo e drejtë iu mohua. Vetë Knjazi serb, Milan Obrenoviq, do të urdhëronte ushtrinë dhe xhandarmërinë e tij që këta të mjerë të dëboheshin, sikurse të tjerët më parë, pa zgjedhur mjetet (Nikola. P. Ilić, Oslobodjenje Južne Srbije 1877-1878, Beograd 1977, 19-23). Pasoj masakra e radhës e ushtrisë dhe xhandarmërisë serbe, ndërsa Fuqitë e Mëdha, garantuese të vendimeve të këtij kongresi, nuk e panë të arsyeshme të ndërmerinin ndonjë hap për të parandaluar këtë akt barbar të Serbisë. Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, M. Piroqanac i arsyetonte këto veprime ndër kabinetet e qeverive të Fuqive të Mëdha se “Nëse nuk do t’i dëbonim nga këtu, do të na shkaktonin fatkeqësi”. Po kështu, edhe Kryeministri, Jovan Ristiç, e thotë se por të mos bëhej ky veprim “shqiptarët do t’i shkaktonin vështirësi shtetit serb, madje edhe luftë të përgjakshme ” (J. Ristic, v. c. 241-247) .

Si rrjedhojë e dhunës, terrorit e gjenocidit të ushtrisë e të xhandarmërisë serbe, edhe Sanxhaku i Nishit, Kazaja e Pirotit, dhe Kazaja e Vrajë, do të ktheheshin në toka të pastra serbe, që kapnin një sipërfaqe prej rreth 12.000 km<sup>2</sup>. Gazmend Zajmi, duke trajtuar shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje, e ka cilësuar këtë akt si formë të gjenocidit: “Shpërngulja e qëllimshme dhe e dhunshme e popullatës është shënuar si krim gjenocidal në kuadër të krimit kundër njerëzimit” (G. Zajmi, në: Gjenocidi. . . , Prishtinë, 1995, 15).

## ***ÇËSHTJA E PRONAVE TË PALUAJTSHME***

Kongresi i Berlinit obligonte Serbinë me anë të dy neneve (35, 39), që të pranonte kthimin e shqiptarëve në trojet e tyre. Midis tjerash thuhej: “Në trevat e bashkuara të Serbisë, myslimanët dhe të krishterët duhet t’i gëzojnë të drejtat e barabarta qytetare dhe politike. Ata gëzojnë të drejtat e tyre mbi pronat e tyre Ndërsa ata që nuk dëshironin të ktheheshin, mund ta jepnin tokën me qira, në formë gjysmatarie, rrjedhimisht ta shisnin (J. Ristić, Diplomatska istorija Srbije (1875-1878), knj. II, deo II, Beograd, 1898, 256-264). Princi serb, Milan Obrenović, përballë këtij obligimi deklaroi: “Njerëzit mund të kthehen e të jetojnë ku të duan në Principatën e Serbisë”. Mirëpo, doli se premtimi i tij bëhej vetëm për efekte taktike kundrejt Fuqive vendimmarrëse së Kongresit të Berlinit. Për të pamundësuar jetësimin e këtyre neneve, qeveria e tij nxori një varg pengesash, për të pamundësuar realizimin e kësaj të drejte të ligjshme të shqiptarëve. Për dhënien e tokës me qira, pronarët shqiptarë duhej t’i parashtronin kërkesë personalisht pushtetit vendor, që përbënte vështirësi përplot rreziqe; askush nuk e garonte jetën e tyre. Pra, pronarët shqiptarë e kishin vështirë të ndiqnin procedurën. Ndërkohë, qeveria serbe, një pjesë të pronave të shqiptarëve i tjetërsoi përmes ankandëve publike, me arsyetimin se po laheshin “borxhet e pronave të tokave ndaj shtetit serb”. Pati raste kur pronarët shqiptarë të tokave që shkuan në Serbi për të zbatuar të drejtën mbi pronat e tyre, u dënuan me shumë vite burg, me arsyetimet nga më të ndryshmet.

Fuqive e Mëdha, vendimmarrëse të Kongresit të Berlinit, nuk ndërmorën ndonjë hap kundër Serbisë për të detyruar atë që të zbatonte dy nenet e përmendura. Kështu Serbisë iu lanë duart e lira për t’i kthyer tokat shqiptare në toka të pastra serbe. Edhe Perandoria Osmane nuk qëndroi në lartësinë e detyrës ndaj këtij problemi.

Ç’është e vërteta, ajo bëri ndonjë hap për zgjidhjen e tij, por këtë e bënte nga trysnia e kraut radikal të Lidhjes së Prizrenit, i cili ishte i vendosur të luftonte për çlirimin e Trojeve Veriore të Vilajetit të Kosovës. Pra, qenë shqiptarët ata që vunë në lëvizje Perandorinë Osmane, që ajo të bënte disa përpjekje, tek

përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha në Stamboll, kinse interesohej për fatin e shtetasve të saj, të dëbuar me dhunë.



Presionin diplomatik të saj, Serbia fillimisht e shpërfilli, me arsyetimin se “shqiptarët ishin shpërngulur vet, pasi kishin luftuar kundër ushtrisë së saj” (J. H. Vasilevic, v. c, 17-17). Por ky arsyetim nuk pëlqej nga përfaqësuesit diplomatikë rusë e britanikë në Stamboll. Ata kërkonin me ngulm kthimin e shqiptarëve në Serbi. Ngulmonte sidomos Rusia, përmes ambasadorit të saj në Stamboll, Labanov, e bindur se shqiptarët nuk do të qëndronin në Serbi, se do të ktheheshin atje ku ishin shpërngulur , siç vepruan turqit e Bullgarisë. Trysnia e qeverisë ruse për kthimin e shqiptarëve në trojet e tyre, detyroi Serbinë që të ndërmernte ndonjë hap konkret, për zbatimin e neneve të përmendura të Kongresit të Berlinit. Në këtë kuadër. Kryetari i Qeverisë serbe, Jovan Ristiç organizoi një takim midis përfaqësuesve të tij me përfaqësuesit e Lidhjes së Prizrenit (4 gusht 1879). Në takim përfaqësuesi i qeverisë serbe shprehu gatishmërinë për kthimin e shqiptarëve. Ndërsa, njëri nga përfaqësuesit shqiptarë, Zeqir Ahmeti deklaroi: “Mbretit tuaj nuk i besohet, sepse ai nuk ka besë. Ai nuk e mbajti fjalën kur na garantoj se po të qëndronin urtë nuk do të ngiteshim, por ushtria serbe na dëboi të gjithëve me forcën e armëve” (J. H. Vasilevic. 17-19). Fjalët e tij demaskuan politikën dyfytirëshe të qeverisë serbe, që pati për rrjedhojë dështimin e takimit.

Pas dështimit të “përpyekjeve” të Portës së Lartë për kthimin e shqiptarëve në tokat e tyre në Serbi, qeveria serbe i pati duart e lira për ta zgjidhte çështjen e pronave të tyre përmes Ligjit mbi Reformën Agrare (01. 04. 1880). Sipas tij, të gjitha vendbanimet e shpopulluara do të “plotësoheshin me pronarë të rinj” (me kolonë serb R. A). Neni 4 i tij precizonte qartë: ”Toka i përket atij që e

punon”. Serbia këtë hap e bëri me arsyetimin se shqiptarët nuk po ktheheshin në trojet e tyre, ndërsa Porta e Lartë nuk ishte e interesuar të zgjidhte çështjen e pronave të shqiptarëve, rrjedhimisht shtetasve të saj, pasi ajo tashmë kishte shtypur në gjak Lidhjen e Prizrenit.

## ***PSE DUHET TË PUBLIKOHEN TAPITË?***

Botimi i tapive të Sanxhakut të Nishit, e të trevave të tjera për rreth, të njohura si Troje Veriore Shqiptare, janë me peshë shkencore, dhe me efekte politike. Përmes këtyre dokumenteve me interes të veçantë, do të dihej deri ku saktësisht shtriheshin këto troje, dhe cili ishte numri i bartësve të tapive, rrjedhimisht i pronarëve të pronave të paluajtshme. Nga ky numër do të rezultonte numri i përgjithshëm i shqiptarëve në këto troje, sepse nga autorë të ndryshëm shqiptarë janë dhënë shifra, me dallime mëdha, që shkojnë nga 150.000 deri 350.000. Përmes tapive do të saktësohej edhe numri i fshatrave në të cilët banonin shqiptarët, sepse studiuesit kanë dhënë shifra që dallojnë dukshëm midis, që shkojnë nga 656-700. Bymimi i shifrave, dhe i fakteve të tjera, nuk është në interes të historiografisë së Kosovës, sepse bie ndesh me të vërtetën.

Është me interes shkencor, që në arkivat e Turqisë, të Serbisë, e në ndonjë arkiv tjetër, të sigurohen informacione për numrin e saktë të shqiptarëve të vrarë, të keqtrajtuar, të arrestuar, të grave të dhunuara, të shtëpive e të lagjeve të qyteteve të rrënuara etj. Po kështu, do të ishte me interes të dihen detaje të tjera, që kanë të bëjnë me çështjen e tjetërsimit të pronave të paluajtshme të shqiptarëve të dëbuar, qëndrimin e Perandorisë Osmane ndaj këtij problemi, si dhe të shteteve vendimmarrëse të Kongresit të Berlinit. Botimi i tapive duhet të bëhet në gjuhën angleze, dhe të shpërndahen në qendrat vendimmarrëse politike, në Bruksel, Nju Jork, si dhe në shtetet evropiane e më gjerë. Përmes tyre do të ndërrohet mendimi qartë vendimmarrëse politike për pastrimin e parë etnik të tokave shqiptare nga Serbia, rrjedhimisht për gjenocidin e parë të saj mbi shqiptarët. Mbase në këtë mënyrë do të diskreditohej politika shoviniste e Serbisë, që ka ndjekur me konsekuencë ndaj shqiptarëve dhe Kosovës në një periudhë mbi 200-vjeçare.

Kosova duhet ta plasojë të vërtetën e historisë së saj që nga Mbretëria e Dardanisë, tash e 2 400 vjet më parë, e cila shtrihet nga Nishi e Piroti deri në Maqedoninë Veriore. Është për të vënë re se kufijtë e saj përkrijnë përafërsisht me kufijtë e Vilajetit të Kosovës, i banuar me shumicë shqiptare. Të rikujtojmë se në marrëveshjen, e nënshkruar midis Komisionit të Qeverisë osmane dhe përfaqësuesve shqiptarë të Kryengritjes së Përgjithshme në Shkup (18. 8. 1912), Perandoria Osmane njohu autonominë e Shqipërisë brenda katër

vilajeteve të banuara me shumicë shqiptare, siç iu njohtë kjo e drejtë Serbisë e vendeve sllave dhe Greqisë. Por kjo e drejtë e ligjshme e Shqipërisë, nuk u jetësua, si rrjedhojë e Luftës së Parë Ballkanike. Ndërkaq, Fuqitë e Mëdha, të ndara në dy blloqe politike-ushtarake, vendosën t'ia jepnin më tepër se gjysmën e tokave shqiptare Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë, për t'i kënaqur interesat e tyre imperialiste gjeopolitike.

## 6.2 Prapavija strategjike e denigrimit të historisë kombëtare



**Përse denigrohet historia jonë kombëtare?**

**Pse hidhet baltë mbi Skënderbeun, edhe kur për të janë thurur mijëra vargje si mbrojtës i krishterimit?**

**Pasi e festuam 108-të vjetorin e Pavarësisë Kombëtare, merr dhenë teza se Ismail Qemali nuk krijoi dot shtet!**

**Prej nga na dalin disa pseudo “gjuhëtarë”, që thonë se gjuha shqipe, rrjedh nga rumanishtja etj. ...**

**Kush i financon këta pseudoshkencëtarë?**

**Dr. Odise ÇAÇI**

Vlorë, 25 korrik 2021 - Kohët e fundit në debatet televizive dhe në shtypin e shkruar po hidhet baltë edhe për atë periudhë, edhe për ato personalitete, që kanë derdhur mund e djersë për këtë vend të martirizuar.

E ndjej për detyrë, në radhë të parë si qytetar dhe së dyti si historian, të shfaq mendimin tim për problemet që diskutohen aktualisht, në media dhe në shtypin e shkruar.

Të shkruash për historinë tonë kombëtare shqiptare është një obligim i madh qytetar. Të pasqyrosh me vërtetësi dhe me argument shkencor, është prapë një detyrim moral. Por të ulesh dhe të përpëlitesh kujtesën tënde, për atë që nuk e vërteton dot, është një marrëzi.

Është katërçipërisht e vërtetë që gjenia krijuese e popullit shqiptar i ka dhënë njerëzimit dhjetëra perandorë Perandorisë Romake, dhjetëra vezirë e pashallarë Perandorisë Osmane, si dhe shumë personalitete si Lindjes dhe Perëndimit, duke filluar nga Rumania, Bullgaria, Rusia, Greqia, SHBA-të dhe deri në Argjentinë.

Shqiptarët vendosën barazi kur sundonin Jerusalemin, dhe u pritën si çlirimtarë.

Shqipëria i ka dhënë shkencës e teknikës botërore personalitete në fushën e shkencës dhe në atë ushtarake; i ka dhënë Vatikanit Papë dhe sekretarë që kanë shërbyer me devotshmëri. Kjo nuk është mburrje, por një vitalitet i një kombi tepër enegjik e kurajoz. Por ka dhe anën tjetër të medaljes, që historia jonë kombëtare është denigruar, jo vetëm nga shovenë të tipit Garashanin, Koleti, Çubrilloviq, Selishev etj., monstra, që me “teoritë” e tyre kanë kërkuar shfarosjen e popullit shqiptar, por edhe disa nga njerëzit tanë, deri në atë masë, sa dhe ata që përmenda, nuk do kishin kaq guxim ta bënin një gjë të tillë me historinë tonë kombëtare.

“Sajesa, argumente, teza e hipoteza” që gjoja “vërtetojnë mendimet e tyre shkencore”!

### ***Pse mohohet autoktonia e popullit shqiptar?***

Së pari, të hedhësh tezën sot se, shqiptarët kanë ardhur në shekullin IX se nuk janë pasues të ilirëve, dhe ilirët pasues të pellazgëve, është njësoj sikur trupit t'i heqësh palcën e shtyllës kurrizore. Kjo më kujton Çajupin e madh tek fejtoni: “Klubi i Selanikut”, ku shprehet: “Po pse nuk fole një fjalë për Shqipërinë, o beu ynë?”

Ne dimë se shumë djem e vajza shqiptare me djersën e këtij populli studiuar në universitetet Perëndimore dhe Lindore, ku kanë shkëlqyer për dijet e tyre. Ata, shumica prej tyre, i kanë sjellë diçka të re për këtij vendi që i lindi dhe i rriti. Ndonjë sosh ngjanë që kthehen dhe i thonë babait se kush ka lindur më parë... Dhe babai gjakftohtë i përgjigjet djalit të arsimuar tashmë:

“Djalo! E shikon atë bajgë te petavrat e tavanit - më thuaj si ka hipur lopa deri aty?” Dhe djali ende vazhdon të vrasë mendjen....

Jam i detyruar si shumë të tjerë t'u kujtojme këtyre “sfidantëve”, “studiues”, se arkeologjia shqiptare, që nga fillimi i viteve ‘20 të shekullit të XX-të, ka studiuar dy periudha :

- a) atë të vonë antike;
- b) mesjetën e hershme.



Materialet arkeologjike të gjetura vërtetojnë vazhdimësinë nga antikiteti në mesjetë, nuk kemi ndryshime të popullsisë autoktone, por del me një emër të ri (arbër-shqiptarë). Historianë të shumtë, albanologë me emër, u janë drejtuar burimeve indirekte historike e deduksioneve logjike.

Mendimi gjuhësor mbizotërues është se gjuha shqipe është vazhduese e denjë e ilirishtes, bijë e gjuhës ilire ose e njëres prej dialekteve të saj, siç shprehet profesori i mirënjohur Eqrem Çabej. Androkli Kostallari thekson “vazhdimësinë iliro-shqiptare dhe autoktoninë e shqiptarëve në trevat e tyre”(Konferencë shkencore, 2-4 korrik 1982, Tiranë). Mahir Domi, profesor, gjuhëtar, mbron tezën mbi “origjinën ilire të popullit shqiptar”; Shaban Demiraj: “Gjuha shqipe si një degë më vete në familjen e gjuhëve indoevropiane”; Leonidha Ndrenika, gjuhëtar shqiptar që hulumtoi në Vatikan 60 burime historike, filologjike, e letrare në bibliotekën e Vatikanit e në Itali, botoi më 1936 në Shkodër: “Pellazgët dhe gjuha e tyre”; filozofi Lajbnic deklaroi: “shqipja është gjuha e ilirëve të lashtë”; Hans Erik Tunman, historian suedez shprehet se “shqiptarët janë vazhdues autoktonë të popullsisë së lashtë ilire, të cilët as u romanizuan, e as u asimiluan nga dyndjet e mëvonshme”...

Johan Georg Fon Han: “Ilirishtja rridhte nga Pellazgjishtja”; Franc Bop, gjuhëtar në Universitetin e Berlinit: “Një ngjashmëri midis sankrishtes dhe shqipes në gramatikë”; Dhimitër Kamarda, filolog italian me origjinë shqiptare “vërteton me dokumente lashtësinë e gjuhës shqipe “... ishte ndër më të vjetrat e të gjithë popujve të Evropës”; Gustav Majer, profesor austriak pohon se “gjuha shqipe rridhte nga ilirishtja”; Eduart Shnajder, studiues francez, shkruan se “gjuha shqipe paraqitet si tingëllimi më i pastër e më besnik i gjuhës pellazge”; Holger Pedersen, gjuhëtar danez pohon se, “gjuha shqipe rridhte nga pararendësit e saj indoevropianë e ilirë”...

Jensen “pranoi mundësinë e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja”. Norbert Jorkli, gjuhëtar austriak, por me origjinë gjermano-hebreje, gjuhën shqipe ai e përcaktoi “si gjuhë indoevropiane”; Maksimiljan Lamberc, “mbështeti tezën e prejardhjes së shqiptarëve nga ilirët dhe të gjuhës shqipe nga ilirishtja”; Zef Skiroi, filolog italian me origjinë arbëreshe njihet tok me Jorklin dhe danezin Pedersen “si tri albanologë më të shquar”(Drizari, 1947); Jeronim De Rada pohoi “origjinën e shqipes si një gjuhë indoevropiane me prejardhje nga pellazgjishtja përmes ilirishtes”;

Vaso Pasha shkruan se “perënditë e lashta greke ishin huazuar nga stërgjyshërit pellazgë të shqiptarëve dhe tregoi se emrat e tyre nuk rridhnin nga greqishtja, por nga shqipja”; Kostandin Çekrezi dhe Kristo Dako kanë të njëjtin mendim si Vaso Pasha...

Jozef Suajer, studjues anglez pohon se “Raca shqiptare e ka prejardhjen nga emigrantët e hershëm arianë dhe gjatë kohës historike është përfaqësuar nga trako-ilirët dhe epirotët ose pellazgët, të cilët dikur patën populluar të gjithë Gadishullin e Ballkanit, që nga Danubi deri në Detin Egje...

Shkrimtarët grekë i cilësonin epirotët si jo helenë. Dhe se banorët e Maqedonisë, Ilirisë dhe Epirit flisnin gjuhë të njëjtë dhe kishin zakone të ngjashme”. [Suajer:1929, f.4]

Ka sot studiues të rinj si akademiku Arief Matheu, me banim në Paris, që vërteton me argumente bindëse se, “Pellazgët janë paraardhësit e Ilirëve dhe ilirët janë vazhdues të saj, ndërsa shqiptarët vazhdues të ilirëve në trojet e tyre, në Ballkanin Perëndimor”.

Këto teza i mbështesin sot dhe gjuhëtarë e studiues të rinj si Agron Dalipaj, Luftulla Peza etj., të cilët me studimet e mirëfillta shkencore japin argument për lashtësinë e gjuhës së hyjnishme shqipe.

Faktet arkeologjike hedhin dritë se ilirët kanë mbijetuar edhe pas pushtimeve romake, por nuk u romanizuan; ata ruajtën me fanatizëm gjuhën e traditat tona.

Në antikitetin e vonë, Ilirët e Jugut përbënin një popullsi vitale të qëndrueshme, e cila kishte banuar në vazhdimësi truallin e vetë, ku gjatë pushtimit romak, kishin depërtuar dhe elementë kulturorë të karakterit provincial, që ishin përvetësuar nga popullsia autoktone si p.sh. veglat e punës, stolitë etj...Duhet theksuar se Ilirët e Antikitetit të vonë në katër provincat e Ilirisë, si: Prevalia, Dardania, Epiri i ri dhe Epiri i vjetër, sipas prof. dr. Skënder Anamali “Përballojnë invazionet avaro-sllave.”

Në viset e Ilirisë së Jugut nuk kemi asnjë dëshmi që vjen nga burimet e shkruara etj., për vendosjen në masë të sllavëve; nuk përjashtohet mundësia që dyndjet sllave të ketë pasur në Ilirinë e Jugut, por ato kanë qenë kalimtare. Për vazhdimësinë ilire në Mesjetën e hershme arkeologjia shqiptare ka sot në dorë një material të pasur nga gjetjet e Kulturës së Komanit.

Gjuha shqipe është gjuhë e folur jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe më gjerë. Sipas profesorit francez R.Anzhely “ajo flitet nga Azia e Vogël deri në Gjibraltari”(Enigma).Ajo është gjuhë indoevropiane dhe vazhduesja e ilirishtes. Dhe sot shumica e gjuhëtarëve dhe albanologëve mbështesin origjinën ilire të gjuhës shqipe, ndërkaq ka ca kuazishkencëtar që na dalin me tezën se gjoja gjuha shqipe na rrjedhka nga rumanishtja!

Nuk është çudi të dëgjojmë një ditë edhe tezën tjetër se shqipja rrjedh nga sllavishtja!

Në ditët e sotme, disa pseudo gjuhëtarë, kanë hedhur idenë që gjuha shqipe nuk është folur në bregdet, por në thellësi të Shqipërisë. Kjo kuazitezë shkencore na lë hapësira të tilla bosh, duke na rezultuar se tri luftërat iliro-romake na i paskan bërë romakët mes tyre dhe jo me ilirët!

Historiani Skymi, në shek. III-II p.l.k., thekson: “Iliria një tokë e gjatë me shumë popuj brenda, nga këta popuj, disa banojnë në viset e brendshme, duke lëruar tokën, disa të tjerë, anës detit Adriatik.”

Ndërsa Straboni në shek. I p.l.k. shkruan: “bregu i Ilirisë është plot me ullishta dhe vreshta të mira...”

Mos vallë të gjitha këto janë mbjellë nga jashtëtokësorët dhe jo nga këta banorë autoktonë në mijëvjeçarë?

Mos vallë Kerkyrën e pushtuan ilirët në vitin 229 p.l.k. me Teutën, dhe la si mëkëmbës Dhimitër Farin. As edhe këtu nuk banonin në bregdet, mos vallë epirotët e e Finiqit e Kaonët nuk flisnin shqip, që grekët e lashtë i quanin “barbarë”?

Shembuj ka plot, po të jesh i predispozuar të shpalosësh atë të vërtetë historike. Edhe Gjergj Kastriot Skënderbeun këta pseudo akademikë e nxjerrin vasal të Alfonsit të V-të të Napolit, pastaj të Papës së Romës... Dhe për ta vërtetuar na nxjerrin nga sënduku i shtëpisë dokumente pa vulë e firmë, gjoja nga Arkivat e Aragonës dhe harrojnë se Skënderbeu luftoi për 25 vjet me Perandorinë më të madhe të kohës, Perandorinë Osmane, duke mbrojtur jo vetëm Shqipërinë, por dhe qytetërimin evropian. Të pranosh që Skënderbeu ishte vasal ose mercenar, më shqip do të thotë të denigrosh një figurë që është kthyer në legjendë për shqiptarët dhe për Evropën, ku atij i kanë thurur mijëra vargje si mbrojtës i Shqipërisë, krishterimit dhe qytetërimit evropian. Ai është konsideruar Princ, Mbret nga personalitete evropiane të kohës. Bustet e tij janë vendosur në dhjetra kryeqytete të botës perëndimore, nga Argjentina, SHBA, Filipine dhe gjithandej në Evropë. Dhe sot pas 616 vjet nga lindja e tij, na dalkan “ca shqiptarë”, “patriotë”, “studiues”, të cilët e zbresin nga kali, i heqin shpatën, përkrenaren ...të shëtisë principatat shqiptare, që sipas këtyre mediokërve nuk kanë ekzistuar kurrë.

Dhe këtyre sahanlëpirësve do t’u shkonin mirë fjalët e Faik Konicës: “Shqipërinë e prishën shqiptarët”. Jo, zoti Faik Konica, se Shqipërisë imazhin nëpër botë po ja prishin mediokrit, sharlatanët, aventurierët, karrieristët, antishqiptarët, që gjoja për të sjellë diçka të re nën maskën e evropianizimit të Shqipërisë, në emër të njëfarë petku akademik neutral, po mohojnë çdo gjë shqiptare!

O Tempora, O mores!

Pasi festuam dhe 108- vjetorin e Pavarësisë Kombëtare na dalka prapë një ide që, Ismail Qemali nuk krijoi dot shtet! O Zot, çfarë po na dëgjojnë veshët! Është njëlloj të thuash se, Dielli ka lindur për herë të parë në vitin 2020.

Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Ai ngelet një figurë poliedrike, siç shprehet historiani Viron Koka, prandaj “kaloi në labirintet e kohës, duke projektuar e krijuar shtetin e pavarur shqiptar”. Të mohosh meritat e këtij burri shteti, këtij diplomati me përmasa evropiane, për krijimin e shtetit shqiptar, është sikur të thuash se Shqipëria është ende nën perandorinë Osmane.

Ja disa fakte historike, që të gjithë i dinë, por bëjnë sikur nuk na paskan qenë kurrë:

1. Ismail Qemali më 4 dhjetor 1912 udhëhoqi Kuvendin shqiptar në Vlorë, që krijoi organet më të larta të Administratës Shtetërore, Qeverinë e Përkoshme dhe Pleqësinë. Këtu u hodhën themelet e shtetit të ri shqiptar, pas 500 vjetësh robërie osmane.

A nuk ishte Ismail Qemali kryetar i Qeverisë së parë Shqiptare të pavarur dhe Atë Nikollë Kaçorri nënkryetar, ndërsa Pleqësia me kryetar Vehbi Dibrën, që ishte një organ Këshillues dhe Kontrollues i Qeverisë.

Qeveria e Vlorës hartoi “Kanunin e përshtatshëm të Administratës Civile” dhe “Kanunin e Jurisë”. Kjo bëri një ndarje të re administrative të Shqipërisë. U krijua një forcë e vogël e armatosur me vullnetarë atdhetarë.

2. Në fushën arsimore dhe kulturore u morën masa, ku gjuha shqipe u shpall gjuhë zyrtare.

3. Në fushën ekonomike, krahas masave tjera, ajo likuidoi Bankën Bujqësore Turke dhe filloi mbledhjen e të ardhurave fiskale.

U krijua Banka Kombëtare me kapital austro-italian.

4. Në diplomaci, ishte Ismail Qemali që dërgoi në Londër një delegacion të kryesuar nga çami Rasih Dino dhe më vonë e kryesoi vetë një delegacion të Nivelit të Lartë në Romë, Paris, Londër, së bashku me Isa Buletinin dhe Luigj Gurakuqin, (pranverë 1913), për të mbrojtur çështjen shqiptare në Kancelaritë Perëndimore.

A nuk mjaftojnë këto fakte për të thënë që Ismail Qemali krijoi një shtet shqiptar të bazuar në përvojën shqiptare me orientim Perëndimor?

Mjaft argumente të tjerë mund të sillen se gjuha shqipe është vazhduese e ilirishtes. Sipas dokumentave historikë, ilirishtja është gjuhë e pellazgjishtes dhe ilirët kanë qenë në këto troje ku ne banojmë që nga mijëvjeçari II p.l.k. që:

1. “Etnosi ilir nis gjatë bronzit të mesëm, formohet në bronzin e vonë dhe merr lulëzim në epokën e hekurit”;

2. Bregdeti Ilir i Jonit dhe Adriatikut ka qenë i populluar gjithë kohën, por me lëvizje dinamike nga bregdeti në thellësi dhe anasjelltas;

3. Skënderbeu është simbol i bashkimit dhe unitetit mes shqiptarëve, është Hero Kombëtar dhe s’do ketë kuazi-shkencëtar që ta zbresë atë nga Piedestali i Historisë Kombëtare Shqiptare;

4. Në panteonin e Kombit shqiptar rrinë tok, Ismail Qemali e Hasan Prishtina

Prandaj, sa mund të mohojë Roma Jul Cezarin, Maqedonia Aleksandrin e Madh, aq dhe Shqipëria Gjergj Kastriot Skënderbeun.

### 6.3 Në kohët Dradane e Arbërore të Kosovës së sotme dokumentohet gjithmonë shumica katolike



#### Prend Buzhala, shkrimtar

Shkas i këtij shkrimi është një status tekst i Jahja Dtrançollit në rrjetin social si dhe pohimet se në Kosovë ka pasur një shumicë ortodokse e jo arbërore katolike. Ka shumë zëra pseudo-intelektualësh që i mohojnë praninë me shumicë iliro-arbërore në Kosovë, duke pohuar se ortodoksia ishte shumicë arbërore në viset e dikurshme të Kosovës, në Dardani. Sot në Kosovë nuk ka asnjë shqiptar të besimit ortodoks për bé.

#### 1.

Porse me këtë rast, shtrohet pyetja në formë tezash: Së paku, për 10 shekuj e këndeje (ç'prej se ka ekzistuar Kisha ortodokse... edhe ndër shqiptarët e Kosovës), shfaqet edhe një paradoks i habitshëm: përse, për kaç shekuj, në fushën e kulturës e të besimit dokumentohen e dëshmohen vetëm emra intelektualësh, të njerëzve të letrave e klerikësh të arbërorëve të besimit katolik e jo (pothuajse asnjë për bé) i konfesionit ortodoks arbëror?! Rrjedhimisht: aty ku ka edhe një kishë ortodokse arbërore, si në Jugun e Shqipërisë apo, më parë si në Maqedoninë e sotme, hasen përplot emra intelektualësh apo të njerëzve të letrave, përkthyes, piktorë etj etj. Por në Kosovë, për këta 10 shekuj, nuk e has absolutisht asnjë emër për bé të ketë deklaruar se është arbëror ortodoks (të paktën, me aq sa kam lexuar deri më sot).

Te librat e Jahja Drançollit kam identifikuar dhjetëra e dhjetëra emra arbërorësh njerëz të letrave, të dijës e klerikë të lartë me emër të shquar publik. Bie fjala, Martin Segoni (latinisht: Martinus Segonius Nouomotanus), meqë ishte nga Noua Bërda e Dardanisë (Kosovës së sotme), është biografi i parë i Skënderbeut (sipas (Jahja Drançolli: “Kosovari Martin Segoni biograf i parë i Skënderbeut”, te studimi monografik “Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës”, Zagreb, 2008, f. 379-384). Dhe përplot emra të tjerë. Dihet se në jugun e Shqipërisë ka pasë në vazhdimësi ortodoksë shqiptarë që kanë dhënë kontributin e tyre jo vetëm ndaj religjionit të krishterë, por edhe në fushën e kulturës, gjuhës e letërsisë shqipe (Dhaskal Thodri, Vosdkopoja, Onufri etj etj, ani se ishin bashkë me grekët)... Por, së paku, nuk mund të përmendet asnjë emër ortodoks nga Kosova, për këta dhjetë shekuj që të ketë dhënë një kontribut në këtë drejtim, madje as emrin e një kleriku të vetëm arbëror-shqiptar ortodoks!!!

## 2.

Nëse ata autorë, ndryshe nga ju, theksojnë që Kishat ortodokse greke e sllave (serbe), me të ardhur Perandoria otomane, e pranuan vasalitetin dhe ruajtën autonominë, kulturën, gjuhën, shkrimin etj. etj. (gjë që është e vërtetë); atëherë, si është e mundshme që këto nuk i ruajti Kosova (a Dardania “ortodokse”, por u islamizua?!!!) – por besimin e braktisi, kishat ua dorëzoi serbëve nën otomanët që u bënë me fe të njëjtë me arbërorët, përqaftuan vullnetarisht islamit?

E habitshme: d.m.th. nëse nën otomanët arbërorët braktisën besimin e kulturën e tyre (u hodhën andej, në islamizëm, për ta ruajtur identitetin kombëtar e besimin fetar ortodoks, të rrezikuar nga serbët), si është e mundshme, pra, që ato t’i braktisin vullnetarisht nën otomanët!!!??? Ndërkohë që Mark Krasniqi, Jahja Drançolli, dr. prof Zef Mirdita, Gaspër Gjini etj etj) pohojnë të vërtetën ndryshe edhe për këto objekte kishtare. Kjo, do të thotë se këta historianë nuk ia qëllojnë: në Kosovë gjithnjë ka pasur një shumicë arbërore-shqiptare katolike... Madje, shumicën e familje që ta pyetni (jo vetëm në Dukagjin, po edhe në rajonet tjera), do t’ua tregojë të parin e tyre katolik shqiptar... Po sot? Cilët qenkan ata besimtarë që u dashka të qëndrojnë në këto kisha ortodokse (meqë i kërkojmë me ngulm) dhe kush duhet të lutet në to?! E habitshme pafundësisht!!!

## 3.

Emra që përmenden (gjithnjë në kuadrin e Kishës katolike-arbërore e shqiptare), gjenden gjerësisht te vëllimet “Arbërit ndërmjet Perëndimit e Lindjes gjatë Mesjetës” (me 510 faqe) të Prof. dr. Jahja Drançollit dhe “Dilemat e Arbërit” (studime mbi Shqipërinë mesjetare) të Pëllumb Xhufit (tekst me 617 faqe). Ndër ta, po përmendim, pos Niketë Dardanit, edhe Shën

Hilaronin (vdiq më 420), familje bujarësh arbërorë në Raguzë, si Berisha, Gjini, Spani, Rchusi, Sorgo, Spani, Gjoni, Tani etj. përmenden zejtarë, tregtarë e klerikë katolikë arbërorë, ipeshkvi Graciani, kleriku dominikan Dominik Topia... Ndërkaq, burri i shquar i urdhrit dominikan Valeri Novobërdasi (1474) ishte profesor i teologjisë, konventual në Raguzë e Lezhë; Gjon Vaji (1450) që vepron në Kosovë, kishte titullin bacalareus; at Arman Teutoni, Gjon Mazreku (1393), at Shtjefë Zaharia (1393, Ulqin), frati Jan Nika (1488, pleban i Novobërdës), motër Domenika nga Tivari (1493), at Alberti i Novobërdës konventual i Raguzës (1499-1529), at Lukë Mazi i Trepçës (1534-36), i shquar për kujdesin e të krishterëve arbër.

Urdhrat kishtarë katolikë e arbërorë, pas rënies së Kosovës (1455), Shkodrës (1479), Durrësit (1501), Tivarit e Ulqinit (1501) nën sundimin e gjenocidin otoman, pushuan së vepruari, por kleri katolik arbëror vazhdoi qëndresën e organizuar kundër Perandorisë otomane.



## VII. OPINIONE

### 7.1 RRUGËT E BOTËS DHE ATO TË SHQIPTARËVE



*Zhvillimi i infrastrukturës rrugore nuk është më i rëndësishmi sa i përket komunikimit, madje as sa i përket transportit. Rrugët e asfaltuara e autostradat janë të kushtueshme e më shumë janë zgjidhje për transport individual sesa për atë publik apo tregtar. Përqendrimi i politikanëve tek asfalti ka ndodhur për shkak të interesave të drejtpërdrejta të kompanive të ndërtimit dhe atyre të karburanteve, shpesh i shoqëruar edhe me korrupsion të vendimmarrjes.*

**Arbër ZAIMI, politolog**

Nuk është çudi që të lindurit pas viteve 2000, ata që nuk e përfytyrojnë dot një botë pa telefona mobilë dhe pa internet, të mendojnë se komunikimi është një e dhënë, një e drejtë njerëzore, diçka që e gëzojnë të gjithë me vetë faktin se lindin. Sidomos interneti, rrjetet e ashtuquajtura sociale, e bëjnë kaq të lehtë shpërndarjen e mesazheve dhe imazheve, sa që ajo ndodh edhe vetvetiu, pa qëllim, pa kahje, në mënyrë kaotike, bën shumëkënd të mendojë edhe për ndotje të hapësirës publike të komunikimit.

Por, shpërndarja e mesazheve dhe imazheve është vetëm një dimension i komunikimit. Pjesë tjetër, po aq e rëndësishme, është transporti i njerëzve e mallrave, i energjisë dhe informacionit. Të gjitha këto bashkë bëhen të mundura vetëm prej zhvillimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, e cila përfshin satelitë e fibra optike, tunele e infrastrukturë nëntokësore e nënujore,

mirëpo përfshin po ashtu, sot si para pesë mijë vjetësh, rrugë, ura e porte. Duke funksionuar bota si e ndarë në shtete, këto të fundit vazhdimisht rivalizojnë sa i përket rregullimit (domethënë sundimit) të infrastrukturës që mundëson komunikimet, madje edhe aty ku shtetet nuk kanë më sovranitet, si p.sh. në ujërat ndërkombëtare. Infrastruktura dhe teknologjia konsiderohen si rrafshet në të cilat do të zhvillohet rivaliteti politik ndërkombëtar tash e tutje, të lidhura siç janë me kontrollet e territoreve e popullsive, me format dhe mënyrat e jetesës, me kulturat, qytetërimet, identitetet dhe takimet e zhvendosjet e tyre, me sigurinë dhe luftën.

Dikush, i përqendruar në telefonin e vet “të mençur” mund të mendojë se këto janë punë “të mëdha”, që nuk kanë të bëjnë me jetën e përditshme të tij. Mirëpo, infrastruktura dhe politika që e kontrollojnë atë (dhe shpërndahet përmes saj) në masë të madhe përcakton deri edhe se çfarë të sugjerohet të lexosh në telefonin “e mençur”, e të mos vetëdijesohesh si qytetar për rëndësinë politike të infrastrukturës mund të të bëjë më të pamëshur se vetë telefoni. Shtetet, por edhe aktorë të ndryshëm joshjetërorë, kapitali i madh korporativ, institutet shkencore e universitete, organizatat religjioze etj., tashmë janë duke përpiluar e duke aplikuar strategjitë e tyre për zhvillim infrastrukturor ose për qasjen ndaj infrastrukturave që i kontrollojnë tjetërkush.

Deri edhe infrastruktura në dukje “e parëndësishme”, si ajo që lidh individin e thjeshtë me botën, është subjekt i kontrollit e nuk ka se si të jetë ndryshe kur edhe mesazhet në dukje të parëndësishme, të lëshuara prej një kompjuteri a telefoni në një vend, mund të arrijnë impakt të madh në një vend e kontinent krejt tjetër, duke ndikuar deri edhe vullnetet elektorale të vendeve. Liria e fjalës mbetet një e drejtë njerëzore, mirëpo e drejta për të përdorur një platformë me impakt të madh publik nuk ka të bëjë me lirinë e fjalës e nuk mund të jetë e pakufizuar, sidomos duke e ditur se liria individuale jo vetëm në rrafshin e fjalës, përfundon aty ku cenohet objektivisht tjetri ose të tjerët.

Këto janë tema që ngjallin stërhollime e thellime të shkencave e disiplinave të ndryshme, por jo më pak të gjeopolitikës. Është interesante të vëzhgohet se si rrugët e lashta të mëndafshit, që lidhnin perëndimin evropian me lindjen e largët, përdoren ende e jo vetëm në sens metaforik për rrjetet e reja infrastrukturore, që përbëjnë pikë akute të shfaqjes së një “Lufte të Ftohtë të Re”. Hillary Clinton dikur sugjeronte një program investimesh amerikane të quajtur “New Silk Road” (Rruga e Re e Mëndafshit), për të lidhur Evropën veriatlantike me Azinë Qendrore e për të zhvilluar një “rrethim” të Rusisë e Kinës, mirëpo ky propozim mbeti vetëm në letër. Kina, e cila po përjeton një rritje të madhe të volumit ekonomik, nisi projektin e saj infrastrukturor, me të njëjtin emër, por me kahje të kundërt. Dikush mund të thotë “shumë mirë,

projekti amerikan tash po realizohet, i njëjti por me para të Kinës”. Rruga e Re e Mëndafshhtë e Kinës ose Iniciativa e Brezit dhe e Rrugës (BRI) synon vërtet vektorin me drejtim të njëjtë ama me kahje të kundërt. Synimi i Kinës është pikërisht “të çajë rrethimin” dhe të nxjerrë në tregun evropian e aziatik, por edhe afrikan e më gjerë, kapitalin e produktin e saj i cili konkurron me çmim të lirë (për shkak të krahut të punës të lirë), por së fundmi edhe me cilësi (për shkak të avancimit kinez në teknologji). E njëjta rrugë, pra, në varësi të atij që e zotëron dhe në varësi të kahjes më shumë se sa të drejtimit, mund të sjellë rezultate aq të ndryshme politike. Prandaj perëndimi veriatlantik është shfaqur i shqetësuar me projektin kinez. Udhëheqësit e diarkisë evropiane, Merkel e Macron, shfaqin si zakonisht shqetësim të dobët e ankimtar, duke mos i dalë drejtpërdrejt kundër projektit kinez, por duke dëshiruar që ai të jetë i dyanshëm dhe reciprok (gjë që nuk ka gjasa të ndodhë, pasi rruga kontrollohet vetëm nga fuqia që investon ekonomikisht e ushtarakisht për ta kontrolluar). Ndërkaq SHBA-të, me një qasje shumë më aktive, ka filluar të propozojë kundërprojekte infrastrukturore në Oqeanin Paqësor, atë të quajtur Rrjeti i Pikave të Kaltra (Blue Dot Network), filluar gjatë mandatit të ish-presidentit Trump, e së fundmi me iniciativën e shpallur para pak ditësh në mbledhjen e G7-tës në Kornuell, të quajtur Rindërtim më i Mirë i Botës (Build Back Better World – B3W), me të cilin parashikohet se do të investohen 40 trilion dollarë deri në vitin 2035 në vendet e ashtuquajtura “në zhvillim”. Të dyja projektet, si ai amerikan, ashtu edhe ai kinez, përpiqen t’i joshin vendet ku duan t’i zhvillojnë projektet e tyre infrastrukturore me investime, por dallimi është se ekonomia e centralizuar kineze e ka më të lehtë ta drejtojë kapitalin privat ose publik sipas projekteve të caktuara. Ndërsa SHBA-të dhe partnerët e G7-të, që veprojnë në suaza të “tregut të lirë”, nuk mund ta drejtojnë në mënyrë aq të drejtpërdrejtë e të shpejtë kapitalin privat drejt investimeve të paracaktuara, ndërsa – nga ana tjetër – për shkak të doktrinës së disiplinës fiskale, shtetet nuk mund të jenë investues të drejtpërdrejtë. Ky dallim i rëndësishëm përcakton zhdërvjelltësinë e projektit, pasi shpesh politika e shteteve në zhvillim është e detyruar të ndjekë agjenda afatshkurtra, ndërsa nevoja e ekonomisë për investim të atypëratyshëm nuk ua lejon luksin të presin “vetëdijësimin” e korporatave private amerikane. Ky problem, i cili nuk ka për të ndryshuar për sa kohë që në perëndim sundon ideologjia neoliberalë, që dobëson shtetet për të fuqizuar korporatat, krijon një disavantazh strategjik. E këtë disavantazh strategjik vendet perëndimore përpiqen ta mbushin me vlera tërheqëse njerëzore, të cilat Kina nuk i ka ose nuk i propagandon, p.sh. iniciativa e sipërpërmendur B3W u shpall se do të synojë përveç investimit ekonomik, edhe përmirësimin e kushteve klimatike, shëndetin dhe shëndetësinë, teknologjinë digjitale, barazinë gjinore dhe luftën kundër pabarazisë. Këto vlera, përveçse që adresojnë probleme reale dhe mund të jenë joshëse sidomos për gjeneratat e reja të popullsisë, kanë edhe një

impakt si armë e butë gjeopolitike, p.sh. përmes luftës kundër patriarkalizmit dhe promovimit të koncepteve të reja gjinore dobësohen edhe struktura të normuara shoqërore, të cilat përbëjnë rezistencë ndaj mobilitetit dhe fluiditetit të pandalshëm shoqëror, si dhe ndaj penetrimit të tregut në çdo qelizë. E aty ku vlerat nuk mjaftojnë për të joshur shtete të caktuara, ndërhyjnë epërsia ushtarake dhe institucione të ndryshme të sigurisë që punojnë haptazi ose heshturazi.

Përveç rivalitetit të madh mes Uashingtonit dhe Pekinit, i cili nuk ka asnjë gjasë të mos shkojë drejt një skenari të Luftës së Ftohtë të Re, ka edhe rivalitete më të vogla, rreth të cilave ndërtohen e prishen partneritete politike pikërisht duke pasur ndërmend infrastrukturën dhe lidhjet e saj me sovranitetin. P.sh. India e kundërshton haptazi zhvillimin e projektit prej 46 miliardë dollarësh, që lidh Kinën me Pakistanin, me arsyetimin se ai kalon nëpër një territor që India e pretendon si të vetin, në Gilgit-Baltistan. Kundërshtimet e Indisë janë të reja dhe ato kanë të bëjnë më shumë me fuqizimin e ekonomisë dhe pozitës globale të Kinës sesa me vetë territorin, pasi në vitet '70 e '80 në të njëjtat lokacione Kina e Pakistani kanë ndërtuar infrastrukturë ndërlidhëse, pa pasur objeksione indiane. India pretendon territor, i cili kontrollohet ushtarakisht nga Kina, por edhe të tillë që kontrollohet nga Pakistani. Megjithatë, kundërshtimet e Indisë më shumë interpretohen në kuadër të rivalitetit të saj rajonal me Pakistanin, sepse interesi indian është të mos i prishë raportet me Kinën, e cila po investon edhe në Indi për linjën detare të projektit të saj BRI.

Si projekt konkurrent ndaj atyre kineze e amerikane, Rusia, Irani e India zhvillojnë alternativën e tyre, Korridorin Ndërkombëtar të Transportit Veri Jug, që lidh Oqeanin Indian me Detin Baltik dhe Evropën Verilindore me Azinë Qendrore e atë Jugore. Sigurisht, edhe ky projekt mbart me vete kritikizëm e kundërshtime nga aktorë rajonalë e globalë që kanë shqetësime ose synime konkurrencte.

Edhe dy shtetet shqiptare, Shqipëria e Kosova, sado të vogla me popullsi, territor e ekonomi, sërish janë shtete e pritët të sillen si të tilla edhe në raport me interesat e tyre politike mbi infrastrukturën. Për vite me radhë politika infrastrukturore në këto vende është përqendruar në asfaltim rrugësh e autostradash, gjë e cila ka qenë e nevojshme, sepse rrjeti i trashëguar prej sistemeve socialiste ka qenë rudimentar. Por, zhvillimi i infrastrukturës rrugore nuk është më i rëndësishmi sa i përket komunikimit, madje as sa i përket transportit. Rrugët e asfaltuara e autostradat janë të kushtueshme e më shumë janë zgjidhje për transport individual sesa për atë publik apo tregtar. Përqendrimi i politikanëve tek asfalti ka ndodhur për shkak të interesave të drejtpërdrejta të kompanive të ndërtimit dhe atyre të karburanteve, shpesh i

shoqëruar edhe me korrupsion të vendimmartjes. Por, ka lënë në harresë infrastrukturën hekurudhore e atë portuale, të cilat janë ku e ku më të rëndësishme sa i përket gjeopolitikës së komunikimit.

Qeveritë e reja të Shqipërisë e Kosovës duket se kanë nisur të marrin parasysh nevojën për zhvillim hekurudhor e portual. Në planet e qeverisë së Shqipërisë, për mandatin e tretë të Edi Ramës, qëndron riparimi dhe riinvestimi i rrjetit të vjetër, që lidh qendrën e Shqipërisë me kufirin verior me Malin e Zi, si edhe me zonat naftëmbajtëse në jug e me kufirin juglindor me Greqinë e Maqedoninë e Veriut. Po ashtu, planifikohet të investohet për një tren të shpejtë që lidh Tiranën me portin kryesor shqiptar, atë të Durrësit dhe me aeroportin kryesor, atë të Rinasit. Një projekt i shpallur së fundmi është ai i lidhjes së hekurudhës shqiptare prej Pogradecit e deri në fshatin grek Kristalopigji, hekurudhë e cila më pas bashkohet me rrjetin e hekurudhave greke ose, më saktësisht, me linjën “Egnatia Railway”, një linjë e drejtimin lindje-perëndim, e cila lidh Aleksandrupolin krejt në lindje të Greqisë me Gumenicën në detin Jon.

Ndërsa qeveria e re e Kosovës, e drejtuar nga Albin Kurti, përveç zhvillimit dhe modernizimit të rrjetit të vjetër hekurudhor, që lidh Fushëkosovën me Hanin e Elezit dhe kufirin me Maqedoninë e Veriut, por edhe me Mitrovicën e kufirin me Serbinë, ka vendosur në planet e saj edhe hekurudhën që lidh Prishtinën me Aeroportin, si edhe studimet e fizibilitetit e, më tej, zhvillimet e infrastrukturës rrugore ndërshtetërore që lidh Prizrenin me Tetovën, Deçanin me Plavën, Gjilanin me Kumanovën, por edhe infrastrukturës hekurudhore, që lidh Fushëkosovën me Prizrenin dhe me kufirin Shqipëri-Kosovë.

Së pari le të lavdërojmë atë çka është pozitive. Modernizimi dhe riinvestimi në hekurudhat ekzistuese është hap i vonuar, por i mezipritur, si për Shqipërinë, ashtu edhe Kosovën. Po ashtu, edhe projektet për të lidhur kryeqytetet me aeroportin dhe Tiranën me Durrësin, edhe pse konglomerati urban Tiranë-Durrës për popullsinë që ka, pozitën gjeografike dhe intensitetin e popullsisë e të kapitalit, do të meritonte zhvillimin e një metroje bazike, me tre deri në pesë linja. Metrotë janë të shtrenjta, por vënë në perspektivë kohore, kushtojnë më pak se asfalti i cili ndot ambientin dhe duhet shtruar e rishtruar çdo tre-katër vjet.

Po ashtu është pozitive nisja e punës për aksin Prizren- Tetovë, ndërkohë që në Shqipëri është pranë përfundimit (siç thuhet) Rruga e Arbrit, që lidh Tiranën me Peshkopinë. Një hap i mëtejshëm do të ishte zhvillimi i infrastrukturës Tetovë – Dibër i cili është në dorë të Maqedonisë së Veriut, por meqenëse zhvillohet në komuna me shumicë të padiskutueshme shqiptare,

është i realizueshëm. Këto dy projekte, Rruga e Arbrit dhe Rruga Prizren-Tetovë, krijojnë kushtet për zhvillim ekonomik e shoqëror në krahinat e izoluara e të varfëruara të Shqipërisë veriore e lindore, të Kosovës jugore, por edhe të RMV-së perëndimore dhe të Luginës së Pollogut, vend ku jeton një komunitet i rëndësishëm shqiptar, i cili pavarësisht energjive njerëzore e kapitalit privat, nuk ka mbërritur të zhvillohet në aspektin infrastrukturor edhe për shkak të korrupsionit lokal, por edhe si pasojë e politikave diskriminuese afatgjata kundër shqiptarëve.

Me të njëjtin arsyetim meritojnë lavdërim edhe projektet Gjilan-Kumanovë e ai Deçan-Plavë, edhe pse ky i fundit do të duhej të shoqërohej nga ana e Shqipërisë me projekte që lidhin Vermoshin dhe Bajram Currin me Plavën e Gjakovën.

Por, projekti kryesor i Kosovës, që nuk gjen përgjigje nga politika e zhvillimit infrastrukturor të Shqipërisë, është ai i hekurudhës që do ta lidhte Kosovën me Shqipërinë, Prishtinën me Tiranën ose Mitrovicën me Vlorën. Në kongresin e PS-së, mbajtur në fillim të verës 2021, u tregua se prioritet infrastrukturor i qeverisë socialiste është lidhja hekurudhore e Shqipërisë me Greqinë, e cila qenka gati për t'u kryer (Pogradec-Kristalopigji).

Linja e Kristalopigjisë, siç e përmendëm edhe më sipër, është një degëzim i hekurudhës Aleksandrupoli-Gumenicë, e pagëzuar si “Egnatia Railway”. Ky projekt i shtetit grek është zhvilluar kryekëput si projekt rival i Korridorit Paneuropian 8. Korridori 8 nuk i intereson Greqisë, sepse lidh Detin e Zi me Adriatikun, duke ia ulur rëndësinë Selanikut. Greqisë i intereson ruajtja e hegjemonisë së Selanikut, pra i intereson promovimi i Korridorit Paneuropian 10, prandaj e ka zhvilluar edhe rrugën paralele me Korridorin 8, “Egnatia Railway”, e cila kalon e gjitha nëpër Greqi, me ndonjë degëzim periferik si ky në Pogradec. Nga ana tjetër, Korridori 8 i intereson shumë Shqipërisë, si në aspektin gjeostrategjik (ringjall e faktorizon shqiptarët në Maqedoni të Veriut, forcon lidhjen Bullgari-Shqipëri, dhe rrit peshën specifike të portit tonë në Adriatik), ashtu edhe në atë ekonomik.

Çështja e akseve kryesore rrugore, e sidomos e hekurudhave, ka qenë e lidhur vazhdimisht me gjeopolitikën, në fakt një nga elementët kryesorë të saj, dhe është dritëshkurtësi nëse Shqipëria nuk e kupton këtë.

Sa për kuriozitet, qysh në vitin 1908, ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, Aehrenthal, pas aneksimit të Bosnjë-Hercegovinës, shpalli projektin për realizimin e hekurudhës Sarajevë-Mitrovicë, që do të zgjatej më pas drejt Selanikut, për dalje në Egje. Ndërsa Italia, si konkurrenente direkte, shpallte

projekte për hekurudha që lidhnin Adriatikun me Danubin, e në territorin shqiptar, një hekurudhë Vlorë-Manastir.

Linjat dhe perandoritë konkurrenente nuk janë të njëjtat me sot, mirëpo Korridorit 8, që lidh Adriatikun (Durrësin, Vlorën) me Detin e Zi, rimon me projektet italiane të asaj kohe, ndërsa Korridorit 10, që lidh Selanikun me Evropën Qendrore (Danubin, e më tej Rinin), rimon me projektet austro-hungareze të asaj kohe.

Problemi është se Austro-Hungari nuk ka më dhe në kuadër të aksit që e pret vertikalisht Ballkanin (Selanik e përpjetë, Korridorit 10), aktorët kryesorë janë Greqia e Serbia, si dhe vendet e ashtuquajtura të Vishegradit, njohur për qasjen e afërt me Rusinë. Po ashtu, në këtë projekt diskutohet haptazi për përfshirjen e investimit masiv kinez, si në portin e Selanikut, ashtu edhe në zhvillimin e hekurudhës dhe të projekteve ujore që lidhin Vardarin me Moravën, pra Selanikun me Danubin në Beograd, duke krijuar një rrugë shumë më të shkurtër për të dalë prej Suezit e në Rotterdam. Ky projekt i Korridorit 10, përveçse mund të ngjallë shqetësime për SHBA-në për shkak të qasjes që kanë ndaj investimeve kineze, ngjall shqetësim edhe për vendet e tjera, që do të mbeteshin të lëna anash, vende si Italia, e cila në vitin e shkuar ka pasur një angazhim tepër të shtuar në Ballkanin Perëndimor, ku ka bërë pesë vizita të njëpasnjëshme edhe kreu i diplomacisë, pra ministri i Jashtëm italian. Sipas analizave të botuara nga institutet italiane që e studiojnë gjeopolitikën, shqetësim kryesor atje përbën pikërisht avancimi i projekteve dhe i ndikimit rus e kinez, si edhe fakti se Gjermania, e cila e ka marrë flamurin me Procesin e Berlinit, nuk po shqetësohet shumë nga projekte të tilla. Sigurisht, për Gjermaninë një lidhje më e shkurtër e Mesdheut Lindor me rrjetin lumor të Evropës Qendrore sjell veç përfitim, duke qenë se një pjesë e mirë e këtij rrjeti lumor kalon nëpër Gjermani (Danubi lidhet me Rinin në Bavari, e pastaj lundrohet deri në detet veriperëndimore).

Trojet shqiptare mbeten tërësisht periferike në projektin e Korridorit 10, sepse sot nuk ka më hekurudhë funksionale Mitrovicë-Sarajevë dhe korridorit kryesor Selanik-Beograd kalon i gjithi jashtë kufijve të Kosovës e Shqipërisë (vetëm pak zona ku kalon kjo vijë banohe nga shqiptarë, në trekëndëshin Kumanovë, Bujanoc, Preshevë, gjë që shkakton tensione të herëpashershme pikërisht në ato vende, sepse gjeostrategjia serbe-ruse nuk dëshiron të ketë popullsi shqiptare anash rrugës kryesore, pasi i konsideron agentë pro-amerikanë).

Shqiptarëve, krejt logjikisht, u interesojnë rrugët që e presin horizontalisht Ballkanin, ato që e lidhin Adriatikun me pjesët e brendshme, sepse shqiptarët

janë popull që shtrihet në breg të Adriatikut dhe Jonit (edhe Kosova që nuk ka bregdet, është veç një orë larg detit). Krijimi i një blloku infrastrukturor (pra edhe ekonomik) shqiptar në breg të Adriatikut dhe Jonit dhe lidhja e tij me Bullgarinë në Detin e Zi, do t'i interesonin edhe Italisë, edhe Bullgarisë, por edhe SHBA-ve, si një projekt që i kundërvihet pranisë ruso-kineze në rajon.

Si ka mundësi, pra, që qeveria e Shqipërisë dhe kryeministri Rama ta përkrahin fuqizimin e konkurrentëve të Korridorit 8, duke investuar për një hekurudhë që lidh Pogradecin me Kristalopigjinë, një degëzim anësor i projektit grek "Egnatia Railway"? Nënvizojmë edhe një herë se ky projekt horizontal ballkanik është bërë i gjithi në territorin grek, për të nxjerrë si të panevojshëm Korridorin 8 dhe për ta përqendruar vëmendjen evropiane te projekti vertikal, Korridori 10. Dritëshkurtësia e qeverisë Rama, nëse vazhdon, rrezikon ta shndërron Shqipërinë edhe më tej në një provincë të anashkaluar, si ato qytetet e krahinat fatkeqe brenda Shqipërisë, të cilat i kanë lënë larg rrugëve kryesore dhe i kanë bërë të pakuptimta, duke shkaktuar braktisjen masive prej popullsisë.

